

UNIVERSITETI I SHKODRËS  
“LUIGJ GURAKUQI”

# **BULETIN SHKENCOR**

**Seria e shkencave ekonomike**

**Viti XVI**

**2022**

*Shkodër, 2022*

## **REDAKSIA**

*Prof. as. dr. Fatbardha Molla (kryeredaktore)*  
*Dr. Ylvije Kraja (sekretare shkencore)*  
*Prof. dr. Arjeta Troshani, prof. as. dr. Albana Begani,*  
*prof. as. dr. Blerta Dragusha, prof.as.dr.Elidiana Bashi,*  
*prof. as. dr. Mirjam Dibra (anëtarë)*

**DREJTOR I REVISTËS**  
*Prof. dr. Suzana GOLEMI*

*Korrektori dhe punoi në kompjuter:*

*Arta Bajrami*

---

*Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*

---

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”  
Redaksia e Buletinit Shkencor  
Seria e shkencave ekonomike  
Tel fax: 00355 22800651

## PASQYRA E LËNDËS

### **Xheride SHABAJ, Arjeta TROSHANI**

Zhvillimi i ekoturizmit në Syrin e Sheganit

*The development of ecotourism in the Eyes of Shegani*.....5

### **Klodjana SHEJI, Blerta DRAGUSHA**

Niveli i edukimit dhe paga.

(Rasti i Shkodrës)

*Level of education and salary. (The case of Shkodra)*.....19

### **Erjola BARBULLUSHI, Jozefina LAÇINEJ**

Efektet e tatimeve në rritjen ekonomike

*The effects of taxes on economic growth*.....31

### **Blerta MJEDA**

Analiza e riskut dhe pasigurisë në projektet e naftës. Rasti kompania

Albpetrol

*Analysis of risk and uncertainty in oil projects.*

*The case of Albpetrol Company* .....41

### **Aurora KINKA (PULTI), Junida MYRTJA**

Ndikimi i mikrofinancës në rritjen ekonomike të Shqipërisë

*The impact of microfinance on the economic growth of Albania*.....59

### **Rudin BEKA, Romina DHORA, Ormela LIKA**

Kërkesa për marketues dhe trendet më të reja të punësimit në këtë industri

*Demand for marketers and newest employment trends in this*

*industry*.....75

**Romina DHORA, Rudin BEKA, Alkida HASAJ**

Rëndësia e studimeve në programet marketing sipas perceptimit të studentëve. Një studim empirik rreth faktorëve që ndikojnë në zgjedhjen e tyre.

*The importance of studies in marketing programs according to students' perception. An empirical study on the factors affecting their choice .....85*

**Joana MARKU, Elidiana BASHI**

Ndikimi i sistemit të informacionit kontabël në efektivitetin e firmave në Shkodër

*The Impact of the Accounting Information System on the Effectiveness of Firms in Shkodër.....97*

**Orsola DEDA, Fatbardha MOLLA (BEQIRI)**

Largimi i kapitalit njerëzor, “Brain Drain” dhe ndikimi ekonomik

*Human capital flight, “Brain Drain” and the economic impact.....115*

**Albana KASTRATI, Gjovani MARLECI**

Decentralizimi i pushtetit vendor dhe efektet në pasqyrat financiare. Rasti i bashkisë Shkodër

*Decentralization of local power and effects on the financial statements. The case of the municipality of Shkoder.....129*

**Dorina KOÇI (JANKU) Ingrid KONOMI**

Një qasje përshkruese mbi zhvillimin e Sektorit Fintech dhe pritshmëritë e tij për rimodelimin e shërbimeve financiare

*A descriptive approach on the development of the FinTech sector and its expectations for the remodeling of financial services..... 147*

**Sabrina KUÇI, Samina KRAJA**

Legjislacioni i trashëgimisë kulturore në vendin tonë nga pushtimi osman deri në ditët e sotme

*Cultural heritage legislation in our country from the ottoman conquest to present days..... 157*

## ZHVILLIMI I EKOTURIZMIT NË SYRIN E SHEGANIT

Xheride Shabaj<sup>1</sup>, Arjeta Troshani<sup>2</sup>

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Turizmit*

### **ABSTRAKT**

Qëllimi - Ky punim ka për qëllim studimin e një zone të njohur dhe të promovuar së fundmi, për të nxjerrë në pah mundësitë e saj të zhvillimit si një fshat ekoturistik. Syri i Sheganit ka potenciale për zhvillimin e ekoturizmit. Vendndodhja e tij, pasuritë natyrore dhe kulturore mundësojnë një gjë të tillë. Gjithçka fillon me një menaxhim të qëndrueshëm të zonës. Vlen për t'u theksuar kuptimi i rëndësisë së ekoturizmit në ruajtjen e burimeve natyrore dhe kulturore të zonës. Përmes këtij punimi do të njohim më mirë këtë pjesë të liqenit të Shkodrës, çfarë ofron ai, çfarë ka të veçantë dhe si banorët e kësaj zone kanë ruajtur tradita dhe zakone brez pas brezi, të cilat sot janë shumë interesante për t'u dëgjuar. Qëllimi i punimit është të përcaktojmë se si mund të zhvillohet ekoturizmi në Syrin e Sheganit, si mundësia më e mirë e zhvillimit të tij.

Metodologjia - Ky punim është realizuar nga të dhëna primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë të kërkimit sasior përmes pyetësorëve

---

<sup>1</sup> Xheride Shabaj, diplomuar në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, *Bachelor*, dega Marketing-Turizëm (2016-2019).  
MSc Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (2019-2021).

<sup>2</sup> Prof. dr. Arjeta Troshani - Prof. Troshani është pedagoge e Marketingut me 27 vjet eksperiencë në mësimdhënie dhe kërkim në fusha të ndryshme që lidhen me ekonominë e sidomos me sfidat e vendeve në tranzicion. Ajo është autore e disa artikujve që lidhen me zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe marketingun e produkteve turistike kryesisht në Ballkanin Perëndimor e sidomos në Veri të Shqipërisë. Ajo ka kryer disa eksperiencë kërkimore dhe mësimdhëniet në Universitetet Perëndimore, si: Universiteti i Ekonomiksit dhe Biznesit i Vjenës (WU), Austri, Universiteti i Karolinës së Veriut dhe Qendrore, Universiteti i Pembrikut, SHBA, Universiteti i Opatise, Kroaci, Universiteti i Sarajevës, Bih etj. Gjithashtu, prof. Troshani, ka qenë mjaft aktive në tërheqjen e fondeve në Fakultetin Ekonomik nga BE nëpërmjet disa projekteve akademike perëndimore të Universitetit të Shkodrës në fushën e cilësisë në mësimdhënie, krijimin e lidhjeve midis ndërmarrjeve, administratës publike dhe universitetit dhe në lidhje me reformën e Arsimit të Lartë në Ballkanin Perëndimor. Prof. Troshani ka qenë dekanë e Fakultetit Ekonomik gjatë periudhës 2008- 2016.

dhe kërkimit cilësor përmes intervistave. Të dhënat sekondare janë siguruar nga literatura të ndryshme.

Gjetjet- Gjatë studimit kemi kuptuar tipologjinë e turistëve që aktualisht vizitojnë këtë zonë, jemi njohur me vlerësimet e tyre për zonën dhe sugjerimet për zhvillimin e saj. Duke njohur territorin janë përcaktuar mundësitë e zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme pa dëmtuar mjedisin. Shohim se në këtë zonë kemi mbizotërimin e turistëve vendas. Gjatë studimit kemi parë mundësitë e zhvillimit dhe investimeve të mundshme nga sektori publik dhe privat.

Ndikimi praktik- Ky punim i vjen në ndihmë sektorit publik dhe privat për investimet e mundshme në zonë. Gjithashtu edhe operatorëve turistikë për krijimin e paketave turistike dhe përfshirjen e kësaj zone në itinerare turistike.

Originaliteti- Është studimi i parë i realizuar në këtë zonë për njohjen e tipologjisë së turistëve, e cila na ndihmon ta shohim zonën nga këndvështrimi tyre, me elementet e mira dhe më pak të mira të saj.

Fjalët kyçe- Ekoturizëm, zhvillim i qëndrueshëm, aktivitete ekoturistike, pasuri mjedisore, pasuri kulturore.

### **The development of ecotourism in the Eyes of Shegani**

#### ***ABSTRACT***

Purpose- The purpose of this paper, is the study of an area, recently recognized and promoted, showing his development opportunity like an eco-tourism village. Syri i Sheganit has potential for ecotourism development, his location, natural and cultural assets, provide this. Everything starts with a sustainable management in the area. It is very important to understand the importance of ecotourism in preserving the natural and cultural resources of the area. Through this paper, we will get to know better this part of Shkodra lake, what it offers, what is special about it and how the inhabitants of this area have preserved traditions and customs from generation to generation, which today are very interesting to hear. The purpose of the paper is to determine how ecotourism can be developed in Syri i Sheganit, as the best opportunity for its development.

Methodology- This paper has been realized by primary and secondary data. Primary data are based on quantitative search through questionnaires and qualitative search through interviews. Secondary data are provided by different literatures.

Results- During the study, we understood the typology of tourists who currently visit this area, we got to know their assessments of the area and suggestions for its development. By knowing the territory, the possibilities of developing various activities without damaging the environment have been determined. We see that in this area we have the predominance of local tourists. During the study we have seen the possibilities of development and possible investments from the public and private sector.

Practical impact- This paper helps the public and private sector for possible investments in the area. Also tourist operators for creating tourist packages and including this area in tourist itineraries.

Originality- It is the first study carried out in this area to know the typology of tourists, which helps us to see the area from their point of view, with its good and less good elements.

**Keywords** - Ecotourism, sustainable development, ecotourism activities, nature assets, cultural assets.

## 1. Hyrje

Ekoturizmi është një nga fushat e turizmit me rritjen më të madhe, prandaj dhe industria e gjerë e turizmit duhet të adoptojë shumë nga vlerat e saj për të mbijetuar sa më gjatë.

Turizmi, veçanërisht ekoturizmi, siguron mjaft përfitime për komunitetin lokal. Ekoturizmi është një industri pune intensive, e cila mund të sigurojë një burim alternativ të ardhurash, ofron mundësi për të rinjtë në zonat rurale dhe krijon punësim. Gjithashtu siguron mundësi për diversifikim, mund të zvogëlojë varësinë nga industritë e tjera dhe të çojë në zgjerimin e faciliteteve të komunitetit dhe infrastrukturës. Duke rritur etikën e ruajtjes, duke nxjerrë në pah vlerat e mjedisit natyror, duke i siguruar komunitetit lokal mundësinë për të takuar njerëz nga vende të ndryshme dhe këmbime idesh, duke rritur krenarinë qytetare, duke krijuar mundësi të reja për biznes, janë gjithashtu qarkullime të mundshme nga turizmi në përgjithësi dhe ekoturizmi në veçanti.

Termi “ekoturizëm” është referuar në mënyrë të vazhdueshme disa herë, por çfarë do të thotë? Ky term është përdorur për herë të parë nga Hector Ceballos-Lascurain në Meksikë në 1988, dhe që atëherë ka ndezur mjaft debate se çfarë do të thotë dhe se si përdoret nga operatorët turistikë. Për elementet e ekoturizmit ka një dakordësi të përgjithshme. Më poshtë po rendisim tri elementet më kryesore:

- a) ekoturizmi është i bazuar në natyrë,
- b) është edukativ,

c) është i menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme.

Duke marrë parasysh rëndësinë që ka zhvillimi i ekoturizmit, studimi është fokusuar në zonën e Syrit të Sheganit, pjesë e Parkut Natyror të liqenit të Shkodrës.

### 1.1 Syri i Sheganit

**Vendndodhja.** Është burimi nëntokësor më i rëndësishmëm i liqenit të Shkodrës. Ka një temperaturë konstante përgjatë të gjitha stinëve 14.5°C. Syri i Sheganit është një burim i madh karstik, që gjendet në afërsi të fshatit Aliaj, të komunës Kastrat në rrethin Malësi e Madhe, pranë buzës lindore të liqenit të Shkodrës, në lartësinë rreth 6 m mbi nivelin e detit. Nga banorët njihet edhe me emrin sifoni i Virit. Përbën një burim të madh karstik, që del vertikalisht në çarjet tektoniko-karstike dhe lidhet me dy burime të tjera karstike, që quhen hurdhana, me prurje deri 1500 l/sek. Uji i burimit të Sheganit del nga një oxhak karstik me thellësi rreth 22 - 28 m dhe gjerësi 3 - 5 m. Kanë ujë të pastër dhe të ftohtë, i cili vjen nga ujërat karstike të Alpeve Perëndimore të Shqipërisë. Eksplorimet e tanishme kanë arritur deri në gjatësinë 80 m të rrugës që bëjnë ujërat e këtij burimi. Më pas është një shpellë e shembur që pengon eksplorimin. Në ujërat e tyre ka peshq e gjallesa të tjera. Burimet krijojnë një mjedis shumë tërheqës me vlera shkencore (hidrologjike, speleologjike, gjeomorfologjike, didaktike, estetike, turistike). Vizitohet sipas itinerarit qyteti i Shkodrës - Koplik - Bajzë - Gashaj - Shegan. Uji i tij i pastër si kristali buron nga një thellësi e madhe që po ta shohim nga droni jep pamjen e një syri të bukur njerëzor.

**Burime të tjera:** Syri i Virit, Syri i Vakës, Syri i Vijës së Mullirit, Syri i Zi.

**Peshkimi në zonën e Sheganit.** Në vijën liqenore të Sheganit janë 20 peshkatarë të licencuar, që bëjnë gjuetinë me rrjeta dhe grepa në bazë të rregullores të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit. Llojet kryesore që gjenden në zonë dhe që peshkohen janë: krapa (autokton në liqenin e Shkodrës), karasi, ngjala, gjuca, mlyshi, sharmaku, skorti, trofta, llaska. Në këtë zonë gjendet një specie e rrallë, specifike në Shegan, trofta e egër që vjen nga lumi i Cemit, e cila gjendet në sasi të limituara dhe pranë burimeve, pasi jeton në ujëra shumë të pastra. Në liqenin e Shkodrës kemi edhe specie që hyjnë me sezone në liqen, të tilla janë: qefulli, kubla, levreku i cili është shumë i rrallë. Kemi specie që janë pothuajse në zhdukje, si: blini, omuri dhe ballëgjani. Ndërsa specie totalisht e zhdukur konsiderohet leshnja, e cila ka mbi 5 vite që nuk është parë në liqen.



Peshkimi konsiderohet një aktivitet i rëndësishëm për banorët që jetojnë përgjatë liqenit, por i pamjaftueshëm për të përballuar jetesën vetëm me këtë punë. Sipas banorëve deri para gjuetisë së paligjshme edhe mund të konsiderohej i tillë, si i mjaftueshëm për jetesë. Personat që gjuajnë me gjeneratorë zënë sasi më të mëdha peshku dhe tregtinë e bëjnë me treg ilegal, dhe kjo ka bërë që të ulen të ardhurat për peshkatarët e licencuar. Sipas banorëve peshku i zënë në këtë mënyrë është jo i mirë për shëndetin, në krahasim më peshkun që zihet nga rrjetat.

Kjo zonë dhe zona e Kastratit në përgjithësi ka kushte të favorshme për zhvillimin e agrikulturës për shkak të klimës. Në pjesën fushore të Kastratit, kultivohen drithërat, si: gruri dhe misri, perimet dhe bimët industriale, si p.sh. duhani. Vreshtaria tradicionalisht ka qenë e zhvilluar në këtë zonë.

### **Strukturat pritëse**

Në Syrin e Sheganit kemi mungesën e bujtinave, çdo turist që vjen, mundësinë e qëndrimit të një nate e ka me anë të ngritjes së çadrave të kampingut.

Për shërbimin e restorantisë kemi vetëm një strukturë.

*Restorant "Syri i Sheganit"* ka filluar aktivitetin e tij në gusht të 2019-ës. Mund të presë deri në 80 klientë. Si një restorant pranë bregut të liqenit, baza në menunë e tij është peshku i liqenit. Si pjatë të veçantë në këtë restorant mund të përmendim troftën që gjendet pranë burimeve të zonës, por nuk mund të gjendet çdo herë në restorant, kjo për arsye se peshkohet rrallë dhe me periudha. Ndërsa gatimet më të preferuara nga klientët janë të krapit dhe ngjalës.

Përveç turistëve shqiptarë, kohët e fundit kemi edhe praninë e shqiptarëve të Kosovës. Ndërsa turistët e huaj vijnë nga vendet evropiane, si p.sh.: polakë, çekë, gjermanë, italianë etj. Turistët e huaj janë kryesisht të grupmoshës 40-50 vjeç dhe shumë prej tyre vijnë me rulota apo ngrejnjë edhe çadrat e tyre të kampingut.

*Shtëpizat e drurit.* Është një investim i bërë që në vitin 2011. Ka qenë një financim i një shoqate austriake me Komunën Kastrat, me një vlerë prej 80 000 \$. Ideja e këtij projekti ka qenë e një kampi, shkolle verore, për trajnimin e të rinjve në lidhje më aktivitete dashamirëse me mjedisin dhe gjithashtu si një qendër e vogël argëtimi. Janë 4 shtëpiza druri dhe janë të pozicionura pak metra nga Syri i Sheganit. Aktualisht ky investim vazhdon të mos jetë funksional dhe arsyeja mbetet një çështje gjyqësore mbi pronësinë e tokës ku janë ndërtuar këto shtëpiza.

**Ana kulturore e zonës së Kastratit**

Fjala Kastrat vjen nga një fjalë tjetër që përcakton një luftim apo një zonë rezistence, si kështjellë, fortesë. Gjurmët e vjetra në territorin e Komunës Kastrat, datojnë që në kohët antike. Studimet historike dhe arkeologjike, si në: Kalanë e Marshejit, shpellën e Shkurtajve, shpellën e Bajrakut, Gomilat dhe shumë objekte të tjera, si dhe studimet etnologjike tregojnë qartazi origjinën Ilire të banorëve në këtë zonë. Territori i komunës së Kastratit, i cili ka qenë pjesë e një rajoni të madh, i banuar nga fisi ilir i Labeatëve.

Më pas ky rajon u bë pjesë e principatës së Balshajve. Në vitin 1506, territori i Kastratit bëhet pjesë e Sanxhakut të Shkodrës. Është ineteresante të përmendet këtu se për shkak të rezistencës dhe mospranimit të qeverisë osmane, Kastrati ishte pjesë e krahinës autonome të Malësive të Shkodrës. Në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, territori i Kastratit dhe Hoti bëhen pjesë e Pashallëkut të Shkodrës. Historia e Kastratit është bërë hap pas hapi me hapjen e shkollës së parë në 1901-in në qytetin e Bajzës. Kisha e fshatit Kastrat e ndërtuar në 1600-ën, kisha e Bajzës e ndërtuar në 1889-ën, dhe kisha e Brigjës e ndërtuar në 1800-ën, kanë dhënë një kontribut të madh në zhvillimin social dhe kulturor të zonës.

**Gastronomia.** Si një zonë afër liqenit, gastronomia, është e lidhur me gatimet e peshkut të llojeve të ndryshme që gjenden në liqen, si: mishi i ferlikut, djathi në gjalp, produktet dhe nënproduktet e qumështit, verë dhe raki e nxjerrë nga vreshtat e zonës, lëngje të nxjerra nga shegat e egra, reçel i përgatitur nga fruta të ndryshme, përgatitja e gjalpfit (tlyn).

**Festat lokale.** Në zonë kemi banorët të dy besimeve: të krishterë dhe myslimanë. Vlejnë të përmenden marrëdhëniet e mira mes tyre, lidhjet e kumarisë dhe sigurisht martesat mes të dy feve. Historikisht nuk njihet asnjë rast në zonën e Kastratit që feja të ketë shërbyer si përçarëse e banorëve të kësaj krahine. Përkundrazi, në ditë festash fetare apo ditë të diela, ka pasur mjaft raste që në kishë të kenë marrë pjesë edhe banorë myslimanë nga fshati Aliaj. Edhe sot e kësaj dite, mjaft familje myslimane të fshatit Aliaj, festojnë Ditën e Shënkollit. Nga ana tjetër, edhe familjet katolike, për të nderuar dhe respektuar fenë myslimane, mbanin në shtëpi enë të posaçme, si: pjata, lugë, fultere, etj., posaçërisht për miqtë myslimanë, enë në të cilat nuk përdorej asnjëherë mishi i derrit, duke respektuar kështu ritet fetare të miqve myslimanë. Ndër vite janë festuar festat lokale që i përkasin shpeshherë të dy feve apo edhe të veçanta për secilën prej tyre. Ndër këto festa mund të përmendim: Shën Marku, Shën Gjergji, Shën Kolli.

**Festa e peshkut.** Festa e peshkut është aktiviteti i parë i realizuar në zonën e Syrit të Sheganit dhe që ka patur ndikim në njohjen dhe promovimin e

zonës. Aktiviteti është zhvilluar më 13 prill 2019. Ideja dhe organizimi i festës së peshkut ka qenë e organizatës VIS Albania, ndërsa propozimi i zonës së Syrit të Sheganit për realizimin e saj erdhi nga njësi administrative Kastrat.

Objektivat për realizimin e kësaj feste janë: promovimi i zonës dhe ndërgjegjësimi i banorëve për vlerat që ka zona.

Në Festën e Peshkut ka pasur të pranishëm rreth 200 persona, ndër ta kanë qenë: administrata lokale, shoqata të ndryshme nga rajoni i Shkodrës, operatorë turistikë nga rajoni i Shkodrës, prodhues lokalë, banorë të zonës, të rinj, një grup prej 20 personash nga Kosova.

VIS Albania shpreh dëshirën e tij për ta kthyer në traditë këtë festë, por ndoshta në një datë tjetër, pasi muaji prill është në periudhën e ndalimit të gjuetisë së peshkut.

## **2. Qëllimi, Objektivat dhe Hipotezat Kërkimore**

Qëllimi i këtij studimi është kuptimi i rëndësisë së ekoturizmit në ruajtjen e burimeve natyrore dhe kulturore të zonës. Përmes këtij punimi do të njohim më mirë këtë pjesë të liqenit të Shkodrës. Qëllim i punimit është të përcaktojmë se si mund të zhvillohet ekoturizmi në Syrin e Sheganit, si mundësia më e mirë e zhvillimit të tij.

Objektivat e kërkimit: përcaktimi i potencialeve turistike të kësaj zone, promovimi i zonës, krijimi i një ideje të fshatit turistik, krijimi i itinerareve të thjeshta brenda kësaj zone.

Ky studim përpiqet të vërtetojë këto hipoteza:

- Syri i Sheganit ofron potenciale në zhvillimin e ekoturizmit;
- Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm sjell impakt pozitiv për turizmin kulturor, natyror dhe ruajtjen e biodiversitetit dhe është një mundësi e mirë e zhvillimit ekonomik në zonë;
- Zhvillimi i infrastrukturës mund të sjellë zhvillimin e turizmit në zonë.

## **3. Metodologjia**

Të dhënat për realizimin e kësaj teme janë bazuar në të dhëna primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë bazuar në kërkimin cilësor duke zhvilluar intervista mbi mundësitë e zhvillimit të ekoturizmit, në institucionet që ligjërisht kanë ndikimin e tyre në këtë zonë, si: bashkia Malësi e Madhe, Komuna Kastrat, Administrata e Zonave të Mbrojtura Shkodër, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit Shirokë. Intervistë është realizuar pranë organizatës VIS Albania, intervistë pranë restorantit “Syri i Sheganit”, si e vetmja strukturë restorantierie në këtë zonë. Pyetjet në të

gjitha këto struktura kanë qenë në bazë të funksionit që ato kryejnë si institucione. Gjithashtu me peshkatarët e zonës kam biseduar mbi gjendjen e peshkimit dhe me autorin e librit “Kastrati” Gjokë Luli.

Të dhënat primare të bazuara në kërkimin sasior kanë qenë pyetësorët e turistëve që kanë vizituar Syrin e Sheganit. Pyetjet janë të një shkalle të lartë instruktimi, ku shumica kanë pyetjet dhe përgjigjet e paracaktuara dhe kanë një shkallë të ulët fshehtësie, për vizitorët është bërë i ditur qëllimi i studimit. Të dhënat sekondare janë siguruar nga artikuj shkencorë, libra për zonën e Kastratit dhe website të ndryshme, që paraqiten si referenca në fund të temës.

#### 4. Analiza dhe rezultatet kërkimore

Është realizuar një pyetësor për vizitorët në Syrin e Sheganit, me anë të të cilit kemi parë tipologjinë e tyre. Gjithsej kemi 100 pyetësorë të vlefshëm për studimin.


##### 4.1. Nga pyetësorët kemi nxjerë këto rezultate:

Mbizotërojnë vizitorët shqiptarë me 68%. Ata kryesisht janë nga Malësia e Madhe, Shkodra dhe Tirana dhe një pjesë nga Lezha dhe Kruja, një pakicë janë nga qytetet tjera të Shqipërisë dhe Kosova. 12 % e vizitorëve janë emigrantë shqiptarë nga Evropa dhe USA. Të huajt vijnë kryesisht nga Evropa Qendrore dhe Lindore, si: polakë, gjermanë, çekë, suedezë, kroatë, anglezë etj. Ka patur edhe nga vende të largëta si Arabia Saudite. Ka një dominancë të grupmoshës 19-40 vjeç me 61%, më pas grupmosha 41-60 vjeç me 23%, pjesa tjetër 8% nën 19 vjeç dhe 8% mbi 60 vjeç. Gjithashtu mbizotëron gjinia mashkullore me 54 %.

Për arsimimin dhe punësimin kemi këto rezultate:

grafiku 4-1 arsimimi

grafiku 4-2 punësimi




Pjesa më e madhe e vizitorëve udhëtojnë me familjen (55%) apo miqtë (38%) dhe pjesa tjetër vetëm. Udhëtimi organizohet nga vetë vizitorët

(78%), një pjesë e vogël me agjenci turistike (5%) dhe në forma të tjera (17%). 68% e vizitorëve kanë dëgjuar për këtë destinacion nga miqtë apo të afërmit, nga rrjetet sociale 24%, agjenci turistike 5% dhe forma të tjera 3%. Për 50% të vizitorëve është hera e parë që e vizitojnë këtë destinacion. Pjesa më e madhe e tyre janë këtu posaçërisht për këtë destinacion (76%), janë pjesë e një itinerari (7%) dhe rastësisht (17%).

Përsa u përket ditëve të qëndrimit kemi këto rezultate:

grafiku 4-3 ditët e qëndrimit



Si arsye të vizitës së tyre 69% e turistëve kanë si qëllim kalimin e kohës së lirë, 18% janë për pushime, 11% janë për vizitë tek miqtë dhe të afërmit, 1% për qëllime studimi dhe 1% për qëllime të tjera.

**Tabela 4-1 Vlerësimi nga turistët**

	1	2	3	4	5
Peizazhi	-	-	-	10%	90%
Shërbimi	-	-	1%	10%	89%
Mikpritja	-	-	-	5%	95%
Gatimi	-	-	3%	27%	70%
Infrastruktura	8%	42%	35%	7%	8%

Në pyetësorë kemi edhe pyetje të hapura në lidhje me çfarë u ka pëlqyer më shumë, ankesat dhe sugjerimet e tyre. Tek gjërat e mira thuajse 100% e përgjigjeve të tyre lidhen me peizazhin dhe mikpritjen. Gjithashtu dhe për qetësinë që ofron ky vend dhe vijnë shpeshherë për të kaluar disa orë, për të shijuar një drekë të shijshme, përballë një pamjeje të qetë dhe relaksuese. Turistët e vënë theksin shumë edhe tek mikpritja dhe dashamirësia e njerëzve, të cilët u japin atyre një shërbim shumë të mirë. Gatimet janë gjithashtu shumë të pëlqyera.

Tek ankesat mbizotëron një përgjigje, e cila është infrastruktura. Rruga për në destinacion është ajo ku turistët zhgënjehen më së shumti. Ka edhe mungesë të një vendi të posaçëm për parking, ku i vetmi është parkingu i restorantit. Ankesa të tjera lidhen me hedhjen e mbeturinave, që nuk ofrohet shërbimi i shëtitjes me varka në liqen apo që nuk ka një vend të caktuar për t'u larë. Turistëve nuk u pëlqen gjithashtu që kanë mundësi të

pakëta përzgjedhjeje, pasi në zonë është vetëm një restorant dhe nuk kanë mundësi tjetër zgjedhje për të konsumuar ushqim.

Sugjerimet e vizitorëve janë të lidhura me ankesat e tyre. Ata sugjerojnë përmirësimin e infrastrukturës. Pakënaqësia e tyre mbetet tek rruga tejet e konsumuar, mungesa e sinjalistikës apo tabelave. Vizitorët shohin mungesën e shërbimeve, si mundësia për të bërë plazh, për të shëtitur me varka, kushte për kamping, kënd lojërash, investime në restorante të reja apo zhvillimi i aktiviteteve në natyrë. Sugjerime të tjera lidhen me mënyrën e promovimit.

Nga të gjithë të anketuarit kemi rezultatin se 99% do të ktheheshin sërish në këtë destinacion dhe vetëm 1% jo.

#### **4.2 Mundësitë e zhvillimit të ekoturizmit**

Aktivitetet se ku mund të zhvillohet ekoturizmi, mundësitë e zhvillimit të tij dhe se si duhet të zhvillohet, janë nxjerrë nga intervistat e realizuara në institucione të ndryshme, si: bashkia e Malësisë së Madhe, Administrata e Zonave të Mbrojtura Shkodër, Komuna Kastrat dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit Shirokë, nga intervista pranë organizatës VIS Albania dhe vizita pranë Lake Shkodra Resort. Në fund kemi dalë në përfundimin se këto janë pikat ku mund të zhvillohet ekoturizmi në Shegan:

- 1) Kamping. Në Shegan nuk ka zona të përcaktuara për kamping, por kjo nuk i ka penguar turistët, kryesisht të huaj të ngrejné çadrat e tyre të kampingut në këtë zonë. Në këtë zonë kemi parë të vijnë turistë të huaj më rulota dhe me çadra kampingu. Nëse ne po mendojmë, që kjo zonë është e përshtatshme për kamping, tashmë turistët e huaj e kanë dhënë përgjigjen dhe është “po”;
- 2) Ekopeskimi. *“Peshkimi ekoturistik - një alternativë peshkimi ekonomike dhe pro mjedisore”*. Është ai që ndryshe njihet si peshkimi sportiv dhe që është dashamirës me mjedisin. Duhet të bëhet me mjete që nuk prodhojnë ndotës dhe është një mënyrë peshkimi që detyrimisht duhet të ndiqet nga peshkatarët. Përveç kësaj duhet që të kryhet vetëm nga personat e licencuar nga organizata e menaxhimit të peshkimit.

Ekopeskimi përmbush disa objektiva:

- Promovon biodiversitetin e zonës dhe mbron resurset e peshkimit nga mbishfrytëzimi;
- I shërben përmirësimin të mbrojtjes dhe menaxhimit të burimeve të trashëgimisë kulturore;
- Krijon bazë dhe mbështetje për përdorimin e qëndrueshëm të zonës së liqenit për peshkim;

- Ndhmon në shtimin dhe pasurimin e paketave turistike lokale me ekoturizëm, peshkim artizanal/tradicional, gastronominë specifike.

Ka një presion të rritur mbi resurset peshkore, të cilat e kanë një limit. Në ujëra të brendshme, që janë kategori të mbyllura ujore, presioni është më i madh dhe mbishfrytëzimi i resursve peshkore sjell pasoja të parikuperueshme;

- 3) Lëvizjet me varka. Ndër aktivitetet më të thjeshta që mund të realizohen në liqen, janë lëvizjet me varka. Lëvizjet me varka kërkojnë kushtet e përshtatshme atmosferike për t'u realizuar. Ato mund të realizohen nga persona që e njohin mirë këtë pjesë të liqenit;

Figura 4-2-1 itinerari në liqen



- 4) Kundrimi i zogjve. Bota e shpendëve ka tërhequr kurdoherë vëmendjen e njerëzve. Shpendët janë dalluar si simbole të bukurisë, lirisë, paqes dhe dashurisë, ndërsa bazuar në interpretimin e shkencëtarëve, si tregues të cilësisë së mjedisit. Liqeni i Shkodrës është i përshtatshëm për kundrimin e zogjve, duke marrë parasysh larmishmërinë e zogjve, numrin e shumtë të tyre dhe hapësirat e pafundme për kundrimin

e tyre. Syri i Sheganit ofron mundësi shumë të mira për kundrimin e shpendëve, jo vetëm për larmishmërinë e tyre, por edhe për fushëpamjen e gjerë që ai ka. Ndër shpendët që ndeshen më së shumti në këtë zonë janë: pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*), i cili është ndër shpendët më të mëdhenj fluturues në Evropë; karabullaku i vogël (*Phalacrocorax pygmeus*), një shpend i rrezikuar globalisht dhe që gjen qetësi në liqenin e Shkodrës; karabullaku i madh (*Phalacrocorax carbo*); bajza (*Fulica atra*); bilbili i ujit (*Alcedo atthis*), është një ndër llojet e reja në liqen; kryekuqja e madhe (*Anas penelope*); kryekuqja e vogël (*Aythya nyroca*); rosa bishtgjel (*Anas acuta*); dallëndyshja faqebardhë e detit (*Chlidonias hybrida*), është një ndër llojet e reja që është vënë re vitet e fundit, është një specie e rrezikuar në Evropë, kryen riprodhimin në pjesën shqiptare të liqenit, konkretisht në Shegan, Kamicë, Dobraq;

- 5) Krijimi i shtigjeve. Të krijosh shtigje mund të jetë një ndër investimet më pak të kushtueshme dhe ndër më të bukurat. Nëse tenton të bësh shëtitje

përgjatë liqenit në këtë zonë është shumë e vështirë për shkak të bimësisë që pengon kalimin. Me anë të një projekti të thjeshtë mund të krijohen kalime pa e dëmtuar mjedisin. Kjo do të ishte edhe një mundësi e mirë për krijimin e një guide të shkurtër përgjatë burimeve dhe atraksioneve afër liqenit. Ajo fare mirë mund të realizohet nga banorët e zonës si njohës shumë të mirë të saj. Një itinerar i thjeshtë mund të jetë Hurdhana e ftohtë, Hurdhana e ngrohtë, Syri i Sheganit, Syri i Virit, Syri i Vakës, Syri i Vijës së Mullirit, Syri i Zi;

- 6) Kthimi i shtëpive në bujtina. Këto bujtina janë mundësia më e mirë që turistët të prekin realisht jetën që bëjnë banorët, jetën e thjeshtë të zonës rurale, një zonë rurale e bekuar për nga natyra dhe burimet që ka, akoma të pashfrytëzuara siç duhet. Pranë një zonë turistike ata shumë mirë mund të bëhen udhërrëfyes të turistëve, t'u tregojnë dhe mësojnë turistëve gatime të thjeshta me produkte të zonës, turistët mund të marrin pjesë në punët e fshatit apo të shohin se si pjeket rakia, duke dëgjuar gojëdhëna për zonën apo histori të ndryshme të një periudhe si ajo e komunizmit. Ata mund të mësojnë nga banorët se si ishte liqeni i ndaluar për ta dhe se nga shumë banorë ai ishte një mundësi arratisje nga diktatura komuniste. Le të njohin në këtë zonë bashkëjetesën fetare, respektin dhe dashamirësinë mes tyre, sesi festojnë festat së bashku, sesi respekti mes njëri-tjetrit është aq i madh sa më përpara të krishterët nuk gatuanin për myslimanët në të njëjtat enë kuzhine ku gatuanin mishin e dërrit, por mbanin enë të posaçme për miqtë myslimanë. Apo ndihmesa që kanë dhënë për njëri-tjetrin në ndërtimin e kishave dhe xhamiave dhe së bashku kanë qenë të pranishëm në inagurimin e tyre. Mund të dëgjojnë mbi traditat e vjetra, mbi fejesat, martesat, lindjet e vdekjet dhe sidomos për pajtimet. Këta banorë kanë plot për të treguar.

## **5. Konkluzione dhe rekomandime**

### **5.1 Konkluzione**

Ekoturizmi është zgjidhja më e mirë për ruajtjen e mjedisit, biodiversitetit dhe kulturës së zonës, ka potencialin të rrisë vlerën e turizmit në ekonominë lokale. Ky lloj turizmi ndikon në ndërgjegjësimin e banorëve për ruajtjen e vlerave të zonës. Diferenca e ekoturizmit nga llojet e tjera të turizmit është aspekti edukues. Liqeni i Shkodrës me problematikat që ka kaluar dhe po kalon aktualisht, institucionet përgjegjëse për këtë zonë, po vënë theksin në zhvillimin e ekoturizmit si zgjidhjen më të mirë për të nxjerrë liqenin nga kjo situatë jo e mirë e tij.

Kjo zonë ka të ndërthurur shumë mirë bukuritë natyrore, biodiversitetin dhe pasuritë kulturore, pra shohim se ka potenciale të mira për zhvillimin e



ekoturizmit, tashmë fokusi duhet të vendoset tek menaxhimi i qëndrueshëm i tyre. Me rritjen e gamës së aktiviteteve, do të fillojnë edhe banorët të kenë përfitimet e tyre.

Nga rezultatet e pyetësorëve mund të dalim në një konkluzion se vizitorët në Shegan janë përgjithësisht të një moshe të re 19-40 vjeç, më arsim të mesëm ose të lartë, kryesisht të punësuar me kohë të plotë, e njohin vendin nga miqtë apo të afërmit e tyre dhe organizojnë vetë një udhëtim 1-ditor veçanërisht këtu për të kaluar pak kohë të lirë me miqtë apo familjen.

Ajo që turistët pëlqejnë më së shumti në këtë zonë është peizazhi dhe qetësia që të ofron ajo dhe vlerësohet maksimalisht mikpritja e banorëve. Gjithashtu zhgënjimi më i madh i tyre mbetet infrastruktura.

Që zhvillimi të fillojë drejt ekoturizmit, duhet të bëhet projeksioni i zonës, duke përcaktuar pjesët e territorit, se për cilin aktivitet janë të përshtatshëm, në mënyrë që të arrihet menaxhimi i qëndrueshëm i tyre.

## 5.2 Rekomandime

- Përmirësimi i rrugës kryesore për në Syrin e Sheganit. E para në listën e gjërave që turistët pëlqejnë më pak në Shegan është rruga për në destinacion, si rruga kryesore edhe rruga dytësore.

-Ndërgjegjësimi i banorëve për vlerat që ka zona dhe mundësitë e zhvillimit. Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në këtë destinacion, si një zonë në hapat e para të zhvillimit të tij, është i lidhur ngusht, me ndërgjegjësimin e banorëve mbi vlerat e turizmit dhe përfitimet që mund të kenë nga ai si dhe rolit të tyre në këtë mes.

- Trajnime për burimet njerëzore. Është e nevojshme që çdo pune t'i gjejnë personin e duhur për ta realizuar atë. Të gjithë ata që punojnë dhe do të punojnë në këtë fushë duhet të trajnohen për të ofruar një shërbim sa më të mirë.

- Vazhdimi i projekteve të papërfunduara, konkretisht shtëpizat e vogla të pushimit. Kjo zonë ka nevojë për investime, dhe lënia e tyre në gjysmë nuk është një zgjedhje aspak e mirë.

- Investime të reja në kuadër të ekoturizmit dhe aktiviteteve të tij, si p.sh. kullë vrojtimi të shpendëve. Zona ofron një larmishmëri të shpendëve dhe një kullë vrojtimi është në ndihmesë të të apasionuarve pas kundrimin të shpendëve dhe studiuesve të tyre.

- Zgjidhja e problemeve të pronësisë, të cilat kanë lënë pezull investimet dhe çenojnë disi edhe investimet e reja. Shtëpizat e drurit kanë një problem të tillë. Dhe markimi i shtigjeve këtë ka problematikën më të madhe për t'u realizuar, pronësia e tokës deri në brigjet e liqenit.

**BIBLIOGRAFIA**

- Ashworth, G. & Goodwill, B. (1990). *“Tourism in Europe – Structures and Development”*, Routledge.
- Beeton, S. (1998). *Ecotourism: A practical guide for rural communities*. Landlinks press.
- Dibra, A. & Bakiu, V. (2000). *“Zhvillimi i turizmit në Rajonin e Shkodrës - Realiteti dhe Perspektiva”* - Monografi, Idromeno.
- Hoti, M. *“Konsiderata Biogjeografike për faunën e Ulëtës së Shkodrës”*- Buletini i Shkencave të Natyrës Nr.1.1994.
- Law, C. (1993). *“Urban tourism - Attracting Visitors to Large Cities”*, Mansell publishing Limited.
- Luli, Gj. (1999). *“Kastrati, vështrim historiko-shoqëror dhe doko-zakonor”*, Camaj-Pipa, Shkodër.
- Lundberg, D. & Krishnamoorthy, M. & Stavenga, H. (1995). *“Tourism Economics”*, John&Sons.Inc.
- Ritchie, J. & Goeldner, C. (1994). *“Travel, Tourism and Hospitality Research”* Botimi i dytë, John Wiley&Sons, Inc.
- Topi, M. & Nikolov, S.(2016). *“Udhëzues i shpendëve të Shqipërisë”*.
- Troshani, A. *“Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në Rajonin e Shkodrës”*.
- *“Profile of Kastrat Commune”* Cafod Albania.
- Plani i menaxhimit për rezervatin natyror të menaxhuar të liqenit të Shkodrës, Association for Protection of Aquatic Wildlife of Albania Në partneritet me GR ALBANIA & FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS UNIVERSITETI I SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”, Tiranë, Qershor, 2012.
- Projekt i bashkëpunimit italo-shqiptar *“Mbështetje e peshkimit artizanal dhe mbrojtja mjedisore e liqenit të Shkodrës”* n. 6661/COOPI.
- *“Promoting accessible and sustainable tourism for future-P.A.S.T.4FUTURE”* Project NO. 176/1ST Call for standard projects.
- *Grante të vogla për zhvillimin socio-ekonomik dhe restaurimin e habitatit/ekosistemit*, Shirokë.

## **NIVELI I EDUKIMIT DHE PAGA. (RASTI I SHKODRËS)**

Klodjana Sheji<sup>1</sup>, Blerta Dragusha<sup>2</sup>

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Financë-Kontabilitet*

### **ABSTRAKT**

Ky punim shkencor realizohet në kuadrin e studimeve të ciklit të dytë Master Shkencor në degën Financë dhe *ka për qëllim të vërtetojë statistikisht nëse një person me nivel më të lartë edukimi paguhet më shumë se një person me nivel më të ulët edukimi*. Kampioni i këtij studimi janë banorët e qytetit dhe rrethinave të Shkodrës.

Në këtë studim zbulojmë se kalimi nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë edukimi sjell rritjen e pagës. Diferenca më e theksuar e pagës është mes nivelit 9-vjeçar dhe nivelit Bachelor duke u pasuar me diferencën mes nivelit Master dhe Doktoraturë. Rreth 50% e variacionit në pagë është shpjeguar me anë të variablave: gjinia, mosha, niveli i edukimit, sektori dhe kënaqësia në punë, dhe 50 % tjetër shpjegohet nga variabla të tjerë që nuk janë përfshirë në këtë punim, si: vitet e eksperiencës së punës, turni i punës, lloji i kontratës, njohuritë dhe aftësitë e punonjësit etj.

Lidhja mes pagës dhe këtyre variablave mund të jetë objekt i një punimi të ardhshëm shkencor dhe në këtë mënyrë do të arrihet të studiohet dhe të shpjegohet se cilët janë faktorët ose variablat totalë që shpjegojnë 100% të variacionit në pagë.

---

<sup>1</sup> Klodjana Sheji, MSc Financë-Kontabilitet, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër - Shqipëri (2020-2022)

Bachelor në Administrim-Biznes, Universiteti “Luigj Gurakuqi” (2017 - 2020).

Njohje e mirë e gjuhës së huaj angleze.

Klodjana\_sheji@unishk.edu.al

<sup>2</sup> Prof. as. dr. Blerta Dragusha është pedagoge në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti Ekonomik, departamenti i Financë-Kontabilitetit që nga viti 1998 dhe dekanë e Fakultetit Ekonomik që nga viti 2016.

Prof. Dragusha ka një diplomë BA në Administrim-Biznes, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, diplomë MBA (Master në Administrim Biznesi), nga Southern Illinois University në Carbondale, SHBA dhe Doktoraturë, nga departamenti i Financës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.

Që nga korriku i vitit 2013, ajo është një "Profesore e asociuar". Prof. Dragusha ka qenë pjesë e shumë projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ky punim mund të përdoret si bazë për realizimin e punimeve të tjera me të njëjtën temë, por për qytetet e tjera të Shqipërisë, në mënyrë që të bëhet krahasimi mes qyteteve dhe qeveria të marrë masa për zvogëlimin e pabarazive të kthimit në arsim. Ky punim është shumë i vlefshëm, sepse pasqyron në mënyrë objektive realitetin aktual të Shkodrës dhe rrethinave të saj.

**Fjalët kyçe:** Paga, niveli i edukimit, gjinia, sektori, profesioni, përputhja page-edukim.

**Level of education and salary. (The case of Shkodra).**

***ABSTRACT***

This scientific paper is realized in the framework of the studies of the second cycle Master of Science in the branch of Finance and aims to statistically prove whether a person with a higher level of education is paid more than a person with a lower level of education. The sample of this study are the inhabitants of the city and districts of Shkodra. In this study we find that the transition from a lower level to a higher level of education leads to an increase in salary. The most significant salary difference is between the 9-year level and the Bachelor level being followed by the difference between the Master and Doctoral level. About 50% of wage variation is explained by variables: gender, age, level of education, sector and job satisfaction, and the other 50% is explained by other variables not included in this paper such as: years of experience work, work shift, type of contract, knowledge and skills of the employee, etc. The relationship between salary and these variables may be the subject of a future scientific paper and in this way it will be possible to study and explain what are the factors or total variables that explain 100% of the variation in salary. This paper can be used as a basis for the realization of other works on the same topic but for other cities in Albania in order to make a comparison between cities and the government to take measures to reduce inequalities of return to education. This paper is very valuable because it objectively reflects the current reality of Shkodra and its districts.

**Keywords:** Salary, level of education, gender, sector, profession, pay-education matching.

## Hyrje

Agjentët ekonomikë të një vendi, pra individ (familja), bizneset dhe qeveria janë zinxhir dhe funksion i pandashëm i njëri - tjetrit.

Çdo gjë fillon nga familja. Çfarë dua të them me këtë?

Individët, anëtarët e një familjeje, edukohen që në vegjëli me idenë se duhet të arsimohen që të bëhen dikushi në jetë dhe “dikushi” ka një rol shumë të rëndësishëm për secilin nga agjentët ekonomikë të sipërpërmendur.

Individi arsimohet, punësohet dhe me të ardhurat e tij siguron jetesën personale dhe familjare, me punën e tij kontribuon në mirëfunksionimin e biznesit ku punon dhe me taksat që paguan ndihmon në rritjen e buxhetit të shtetit dhe rrjedhimisht në ekonominë e vendit në përgjithësi. Pra, individ, duhet të punojë që të sigurojë të ardhura dhe duhet të arsimohet që të punojë. Këtu del në pah një çështje tjetër, pasi arsimimi është me nivele dhe i detyrueshëm është vetëm niveli 9-vjeçar i edukimit, ndërsa niveli i mesëm, universitar dhe pasuniversitar mbeten zgjedhje e individit.

Në teorinë ekonomike një risk më i lartë sjell një kthim më të lartë, por a gjen zbatim kjo teori në lidhjen mes nivelit të edukimit dhe pagave në qytetin e Shkodrës?!

Në realitetin e vendit tonë ka shumë persona me nivel edukimi 9-vjeçar të punësuar në pozicione të kënaqshme pune dhe shumë persona me nivel të lartë edukimi të papunë dhe gjithsecili prej nesh e njeh një person të tillë.

Secilit nga ne i kanë thënë të paktën një herë në jetë “*Kot po e bën shkollën e lartë se gjithsesi kamarier/e do të përfundosh*”. Kjo fjali nuk tregon vetëm pesimizmin e këtyre personave për të ardhmen, por edhe mendimin e tyre për një realitet të vendit ku jetojnë.

Në parim, sa më i lartë të jetë niveli i edukimit, aq më e lartë duhet të jetë pagesa për një person, si një meritë për formimin profesional dhe kapacitetin më të lartë të njohurive dhe aftësive.

Pyetja kërkimore e këtij punimi shkencor është: “*Si ndikojnë nivelet e edukimit në pagë në qytetin e Shkodrës?*”

Qellimi i këtij punimi shkencor është të vërtetohet statistikisht nëse një person me nivel më të lartë edukimi paguhet më shumë se një person me nivel më të ulët edukimi.

Objektivat e këtij punimi shkencor janë:

- 1- Të analizohet hierarkia e niveleve të edukimit për të studiuar nëse paga do të rritet, me kalimin nga niveli më i ulët i hierarkisë në nivelet më të larta,

2- Të zhvillohen disa analiza të ndryshme statistikore të lidhjes mes variablave në mënyrë që pyetja kërkimore të marrë përgjigjen më të saktë të mundshme.

Edhe pse realiteti lë shumë për të dëshiruar, unë jam optimiste dhe pres të vërtetohet që të qenit në master do të më sjellë më shumë të ardhura sesa po ta kisha ndërprerë edukimin tim në nivelin 9-vjeçar ose të mesëm.

### **Metodologjia**

Për mbledhjen e të dhënave është hartuar një pyetësor me Google Forms (të dhëna primare). Pyetësi është shpërndarë vetëm brenda Shkodrës dhe rrethëve të saj me anë të e-mail, whatsapp, instagram, google teams si dhe anketimi fizik. Pyetësi është plotësuar nga 251 persona ndër të cilët 191 femra dhe 50 meshkuj. Pas mbledhjes së të dhënave është bërë përpunimi i tyre dhe më pas të dhënat janë futur në analiza të ndryshme univariate, bivariate dhe multivariate. Përpunimi dhe analiza e të dhënave është realizuar me paketën statistikore SPSS.

### **Rishikimi i literaturave**

*Marco Biagetti dhe Sergio Scicchitano, (2011)* në punimin e tyre me temë “Arsimi dhe pabarazia në paga në Evropë”, zbuluan se, edhe pse me një heterogjenitet ndërvendor, pagat rriten me arsimin.

*Rosa Maria dhe Cerdeira Barros, (1991)* në një punim me temë “Pabarazia në paga dhe shpërndarja e arsimit”, treguan se arsimi shpjegon 50% të pagës në Brazil. Kjo fuqi shpjeguese ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nëpër rajone.

Punimi “Arsimi dhe hendeku gjinor i pagave: Dëshmi nga Indonezia” nga *Suharyono, S., dhe Digdowiseiso, K. (2021)* zbuloi femra me diplomë kolegji dhe më lart marrin një pagë më të lartë se ato pa atë diplomë nga rreth 156% në 1996 në 132% në 2016.

*Castex, G., dhe Kogan Dechter, E. (2014)* studiuat rolet e arsimit dhe aftësive në përcaktimin e pagave dhe zbuluan se kthimet në një diplomë bachelor në vitet 1980 janë 5.5% për meshkujt dhe 6.3% për femrat.

*Smith, W. C., dhe Fernandez, F. (2017)* në studimin me temë “Arsimi dhe boshllëqet e pagave në Kanada dhe SHBA” zbuluan një hendek të pagave në Kanada, me emigrantë që bëjnë 233 dollarë më pak në muaj se punëtorët vendas ( $p < .001$ ).

*Tansel, A., dhe Bodur, F. B. (2012)* zbuluan se të gjitha nivelet e arsimit kontribuan pozitivisht ndaj pabarazisë së pagave, por kthimet në nivele të ndryshme shkollimi ranë ndjeshëm nga viti 1994 në 2002 në Turqi.

Liu, A. Y. (2006) në punimin me temë “Ndryshimi i strukturës së pagave dhe arsimit në Vietnam” rezultuan se femrat shpërblehen më shumë për një vit shtesë arsimimi sesa homologët meshkuj në vitin 1998 dhe paga mesatare reale rritet me 68 % për meshkujt dhe me 84 % për femrat.

### **Lidhja mes nivelit të edukimit dhe statusit të punës.**

**Tabela 1 .Analiza e lidhjes mes nivelit të edukimit dhe statusit të punës.**

<b>Variablat</b>	<b>I/e punësuar</b>	<b>I/e vetëpunësuar</b>	<b>I/e papunë</b>
9- vjeçar			
% brenda nivelit	16.7%	66.7%	16.7%
% ndaj totalit	0.6%	12.9%	1.7%
I mesëm			
% brenda nivelit	57.1%	4.8%	38.1%
% ndaj totalit	7.5%	3.2%	13.6%
I lartë (Bachelor)			
% brenda nivelit	48.3%	14.9%	36.8%
% ndaj totalit	26.1%	41.9%	54.2%
Master			
% brenda nivelit	76.4%	9.4%	14.2%
% ndaj totalit	60.2%	38.7%	30.5%
Doktoraturë			
% brenda nivelit	90.0%	10.0%	0.0%
% ndaj totalit	5.6%	3.2%	0.0%

**Burimi: SPSS, Viti 2022**

Më sipër paraqitet lidhja mes nivelit të edukimit dhe statusit të punës, ku për secilin nivel edukimi paraqitet frekuenca dhe përqindja e personave që janë të punësuar, të vetëpunësuar apo të papunë. Siç mund ta shohim nga tabela pjesa më e madhe e personave me arsim 9-vjeçar janë të vetëpunësuar, konkretisht 66.7% , ndërsa në raport me totalin e kampionit, 12.9% janë me nivel edukimi 9-vjeçar dhe të vetëpunësuar. Vetëm 0.6% e të anketuarve janë me nivel edukimi 9-vjeçar dhe të punësuar, gjithsesi vlen të theksohet se vetëm 2.4% e totalit të të anketuarve janë me nivel edukimi 9-vjeçar.

Duke kaluar në nivelin e mesëm të edukimit vëmë re një rënie të numrit të personave të vetëpunësuar dhe një rritje të numrit të personave të punësuar dhe të papunë.

Kjo tregon që mundësitë e një personi me nivel të mesëm edukimi për t'u punësuar ose jo, janë pothuajse të barabarta dhe mund të varen nga faktorë të ndryshëm jashtë objektit të këtij studimi.

Në nivelin e edukimit bachelor kemi numrin më të lartë të të vetëpunësuarve dhe të papunëve si dhe një numër të konsiderueshëm të të punësuarve. Rreth 41.9% e të anketuarve janë me nivel edukimi bachelor dhe të vetëpunësuar dhe 54.2% e tyre të papunë. Ky rezultat tregon që pjesa më e madhe e të anketuarve të papunë dhe të vetëpunësuar janë me nivel të lartë edukimi bachelor.

Në nivelin e edukimit master kemi numrin më të lartë të të punësuarve, rreth 60.2% e totalit të zgjedhjes. Në këtë nivel numri i të vetëpunësuarve dhe i të papunëve është më i ulët sesa në nivelin e mëparshëm. 90% e personave me nivel edukimi doktoraturë janë të punësuar (5.6% e totalit të të anketuarve).

Numri më i madh i të anketuarve kanë nivel edukimi bachelor ose master, dhe po të kalojmë nga njëri nivel tek tjetri vëmë re një rritje të numrit të të punësuarve dhe një rënie të numrit të të papunëve. Kjo evidenton rëndësinë e nivelit Master në punësim.

### **Lidhja mes pagës dhe niveleve të edukimit.**

*Tabela 2 .Analiza e lidhjes mes Pagës dhe Niveleve të edukimit.*

Variablat	Koeficienti $\beta$	Gabimi standard	Statistika t	Vlera p
Konstantja	53000.870	1736.769	30.517	.000**
nëntë_vjeçar	-19000.870	8508.397	-2.233	.027**
i_mesëm	-29278.647	4720.975	-6.202	.000**
doktoraturë	19079.130	6140.407	3.107	.002**
i_lartë_bachelor	-10992.650	2787.145	-3.944	.000**
R	0.483			
R square	0.233			

*Burimi: SPSS, Viti 2022*

Në tabelën e mësipërme paraqitet lidhja mes pagës dhe nivelit të edukimit. Kjo lidhje studiohet me anë të një analize regresioni dhe mund të konsiderohet lidhja kryesore e këtij punimi, sepse përmban VV dhe VP të pyetjes kërkimore.

Modeli ekonometrik i kësaj analize është si më poshtë:

$$Paga = \beta_0 + \beta_1 \text{ nëntë vjeçar} + \beta_2 \text{ i mesëm} + \beta_3 \text{ i lartë bachelor} + \beta_4 \text{ doktorature}$$



$\beta_0$  është konstantja e cila përfaqësohet nga kategoria Master e nivelit të edukimit. Modeli ekonometrik i vlerësuar është si më poshtë:

***Paga = 53 000 - 19 000 nëntë vjeçar – 29 278 i mesëm - 10 992 i lartë bachelor + 19 079 doktorature***

Konstantja tregon që paga e një personi me nivel edukimi Master është 53 000 lekë të reja në muaj.

$\beta_1$  tregon që një person me nivel edukimi 9-vjeçar paguhet 19 000 lekë të reja më pak në muaj se një person me nivel edukimi Master. Ky efekt është brenda pritshmërive dhe logjikës.

$\beta_2$  tregon që një person me nivel edukimi i mesëm paguhet 29 278 lekë të reja më pak në muaj se një person me nivel edukimi Master. Ky efekt është më i lartë se ai i nivelit 9-vjeçar të edukimit dhe kjo tregon që një person me nivel edukimi i mesëm paguhet më pak se një person me nivel edukimi 9-vjeçar dhe kjo nuk i përmbush pritshmëritë e këtij punimi.

$\beta_3$  tregon që një person me nivel edukimi i lartë Bachelor paguhet 10 992 lekë të reja më pak në muaj se një person me nivel edukimi Master. Ky efekt është brenda pritshmërive dhe logjikës.

$\beta_4$  tregon që një person me nivel edukimi Doktoraturë paguhet 19 079 lekë të reja më shumë në muaj se një person me nivel edukimi Master. Ky efekt është brenda pritshmërive dhe logjikës.

Të gjithë koeficientat e mësipërm janë matematikisht të ndryshëm nga zero, por për të testuar nëse janë statistikisht të ndryshëm nga zero përdorim statistikën t me hipotezë bazë  $H_0 : \beta_0, \beta_1, \beta_2, \beta_3$  ose  $\beta_4 = 0$  dhe hipotezë alternative  $H_1 : \beta_0, \beta_1, \beta_2, \beta_3$  ose  $\beta_4 \neq 0$  Marrja e vendimit: Meqenëse vlera p për secilin nga koeficientat  $< \alpha=0.05$ , hidhet poshtë hipoteza bazë  $H_0$  dhe pranohet hipoteza alternative  $H_1$ . Kjo do të thotë që të gjithë koeficientët e pjesshëm të regresionit janë të rëndësishëm statistikisht. Koeficienti i korrelacionit  $R=0.483$  tregon një lidhje të moderuar pozitive mes nivelit të edukimit dhe pagës, ndërsa koeficienti i determinacionit  $R\text{ square}=23.3\%$  tregon që vetëm 23.3% e variacionit të pagës shpjegohet nga variacioni i variablave të pavarur të niveleve të edukimit.

Pavarësisht se të gjithë variablat e niveleve të edukimit janë të rëndësishëm statistikisht, fakti se koeficienti i determinacionit është i vogël, tregon që ka variabla të tjerë që ndikojnë në pagë. Këta variabla janë variabla kontrolli që përdoren për të parë nëse efekti i variablave kryesorë të pavarur është me të vërtetë i rëndësishëm statistikisht (efekti placebo) dhe për të parë sesi ndryshon koeficienti i determinacionit pas përfshirjes në model të këtyre variablave.

**Lidhja mes pagës dhe gjithë variablave të studimit.****Modeli 1**

Modeli ekonometrik i vlerësuar është si më poshtë:

*Paga = -5952.7 + 6309 mashkull + 865.8 mosha + 748 i mesëm + 21602.7 i lartë bachelor + 31444.6 master + 43894.9 doktoraturë + 1451.5 i vetëpunësuar + 7020.3 privat + 1253.1 ojf -666.8 prodhim + 2064.9 shërbime + 2488 tjetër - 2680.5 ekonomist + 7743.7 drejtor + 4242.4 kushte mesatare + 6236.9 kushte të mira -10919 mesatarisht i kënaqur - 8941.2 shumë i kënaqur + 3361.2 përputhje mesatare + 4408.7 përputhje e lartë - 3288.9 mesatarisht i motivuar - 1781.3 shumë i motivuar .*

Bazuar në faktin që vlera p e secilit prej variablave të mëposhtëm është  $> \alpha=0.05$ , mund të themi se nuk ka lidhje mes nivelit të mesëm të arsimit dhe pagës, pra një person me nivel edukimi të mesëm nuk paguhet më shumë se një person me nivel edukimi 9-vjeçar.

Nuk ka lidhje mes statusit të punës dhe pagës, pra një person i vetëpunësuar nuk paguhet domosdoshmërisht më pak ose më shumë se një person i punësuar.

Gjithashtu, nuk ka lidhje mes sektorit ekonomik dhe pagës, pra punësimi i një personi në bujqësi, prodhim, shërbime apo në ndonjë sektor tjetër ekonomik nuk ndikon në variacionin e pagës.

Mes profesionit dhe pagës nuk ka lidhje, sepse një drejtor në një punë të caktuar paguhet më pak se një ekonomist në një punë tjetër.

As kushtet e punës, kënaqësia në punë, mendimi mbi përputhjen pagës edukimi dhe motivimi nuk kanë lidhje me pagën. Edhe konstantja është e parëndësishme statistikisht, sepse në të janë përfshirë variabla të parëndësishëm. Këta variabla shpjegojnë rreth 42.8% të variacionit në pagë.

**Modeli 2**

**Tabela 3. Analiza e lidhjes mes Pagës dhe variablave të rëndësishëm statistikisht.**

Variablat	Koeficienti $\beta$	Gabimi standard	Statistika t	Vlera p
Konstantja	10287.148	5324.008	1.932	.055
Mashkull	6816.982	2600.888	2.621	.009**
Mosha	886.353	116.473	7.610	.000**
I lartë bachelor	21196.100	3934.425	5.387	.000**
Master	29767.852	3898.175	7.636	.000**
Doktorature	42756.886	6437.142	6.642	.000**
Privat	7478.530	2351.297	3.181	.002**

Shumë i kënaqur	4212.288	2208.837	1.907	.058
R	0.670			
R square	0.448			

**Burimi: SPSS, Viti 2022**

Tabela e mësipërme prezanton lidhjen mes Pagës dhe variablave të rëndësishëm statistikisht, dhe në këtë lidhje është paraqitur kombinimi më i mirë i mundshëm mes variablave, i cili siguron koeficientin më të lartë të mundshëm të determinacionit, prandaj mund të themi se modeli që paraqitet më poshtë është modeli kryesor dhe më i saktë i analizës së regresionit.

Marrëdhëniet midis variablave ekonomikë janë përgjithësisht të pasakta, prandaj përveç variablave shpjegues që ne kemi marrë në shqyrtim, tek paga mund të ndikojnë edhe faktorë të tjerë që përfshihen tek termi i gabimit u, si për shembull: vitet e ekperiences së punës, turni i punës, lloji i kontratës, njohuritë dhe aftësitë e punonjësit etj.

Modeli ekonometrik i kësaj analize është:

$$\text{Paga} = \beta_0 + \beta_1 \text{ mashkull} + \beta_2 \text{ moshë} + \beta_3 \text{ i lartë bachelor} + \beta_4 \text{ master} + \beta_5 \text{ doktoraturë} + \beta_6 \text{ privat} + \beta_7 \text{ shumë i kënaqur} + u.$$

Modeli ekonometrik i vlerësuar është si më poshtë:

$$\text{Paga} = 10287 + 6817 \text{ mashkull} + 886 \text{ moshë} + 21196 \text{ i lartë bachelor} + 29768 \text{ master} + 42757 \text{ doktoraturë} + 7478 \text{ privat} + 4212 \text{ shumë i kënaqur} + u.$$

Konstantja  $\beta_0$  tregon që një femër e moshës mesatare me nivel edukimi 9-vjeçar e cila punon në sektorin publik dhe është aspak e kënaqur me punën e saj, ka një pagë 10 287 lekë të reja në muaj.

$\beta_1$  tregon që një mashkull paguhet 6 817 lekë të reja në muaj më shumë se një femër kur krahasojmë një mashkull dhe një femër me të njëjtën moshë, nivel edukimi, sektor pune dhe nivel kënaqësie në punë. Këtu del në pah efekti gjinor në pagë kur mbajmë konstant të gjithë variablat e tjerë (ceteris paribus).

Ky efekt dëshmon se ekziston pabarazi gjinore në pagë dhe kjo pabarazi është në nivelin 13 %, pasi paga mesatare e një femre është 45 603 dhe e një mashkulli 52 420 lekë të reja në muaj.

Pra, paga e meshkujve është 13% më e lartë se paga e femrave në qytetin e Shkodrës.

Kjo diferencë në pagë është pothuajse dyfishi i diferencës gjinore në pagë në Shqipëri për vitin 2020<sup>3</sup>.

<sup>3</sup>Hendeku gjinor në paga në vitin 2020 është 6,6 %. Pra burrat kanë një pagë mesatare mujore bruto 6,6 % më të lartë sesa gratë. Krahasuar me vitin e mëparshëm, në vitin 2020 vihet re një ulje e hendekut gjinor në paga me 3,5 pikë përqindje.

Hendeku gjinor në pagë lidhet më një sërë faktorësh socialë, kulturorë dhe ekonomikë në një shoqëri.

$\beta_6$  tregon që një person që punon në sektorin privat paguhet 7 478 lekë të reja në muaj më shumë se një person që punon në sektorin publik, kur të gjithë variablat e tjerë mbahen konstant.

$\beta_7$  tregon që një person që është shumë i kënaqur me punën e tij paguhet 4 212 lekë të reja në muaj më shumë se një person që është aspak i kënaqur në punën e tij, kur të gjithë variablat e tjerë mbahen konstant.

Koeficientët  $\beta_1, \beta_2, \beta_3, \beta_4, \beta_5, \beta_6$  janë matematikisht dhe statistikisht të ndryshëm nga zero, meqenëse vlera p për secilin prej tyre  $< \alpha = 0.05$ .

Konstanten  $\beta_0$  dhe koeficientin  $\beta_7$  mund t'i konsiderojmë gjithashtu të rëndësishëm statistikisht edhe pse vlerat p të tyre janë respektivisht 0.055 dhe 0.058, sepse këto vlera p janë shumë afer vlerës  $\alpha = 0.05$ .

Koeficienti i korrelacionit  $R=0.670$  tregon një lidhje pothuajse të fortë pozitive mes nivelit të edukimit dhe pagës, ndërsa koeficienti i determinacionit  $R^2=44.8\%$  afërsisht 50% tregon që rreth 50% e variacionit të pagës shpjegohet nga variacioni i variablave të pavarur të gjinisë, moshës, niveleve të edukimit, sektorit të punës dhe nivelit të kënaqësisë në punë.

Të dy këta koeficientë janë përmirësuar në krahasim më modelin e mëparshëm.

<http://www.instat.gov.al/kapitulli/arsimi-dhe-pun%C3%ABsimi/paga/>

$\beta_2$  tregon që me kalimin e një viti në moshë, paga e një personi të së njëjtës gjini, nivel edukimi, sektor pune dhe nivel kënaqësie në punë, rritet me 886 lekë të reja në muaj. Kjo rritje e pagës me moshën është mjaft logjike, pasi personat që punojnë në sektorin publik përfitojnë 2% shtesë page për çdo vit vjetërsi pune deri në 25 vite.

Gjithashtu mund të ndikojnë edhe faktorë të tjerë si rritja e viteve të eksperiencës, përvetësimi më i mirë i punës me kalimin e moshës etj.

$\beta_3$  tregon që një person me nivel edukimi i lartë Bachelor paguhet 21 196 lekë të reja më shumë në muaj se një person me nivel edukimi 9 - vjeçar, kur të gjithë variablat e tjerë mbahen konstant.

$\beta_4$  tregon që një person me nivel edukimi Master paguhet 29 768 lekë të reja më shumë në muaj se një person me nivel edukimi 9-vjeçar, kur të gjithë variablat e tjerë mbahen konstant.

$\beta_5$  tregon që një person me nivel edukimi Doktoraturë paguhet 42 757 lekë të reja më shumë në muaj se një person me nivel edukimi 9-vjeçar, kur të gjithë variablat e tjerë mbahen konstant. Siç mund ta shohim, kalimi nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë edukimi sjell rritjen e pages. Diferenca e pagës mes nivelit 9-vjeçar dhe nivelit Bachelor është 21 196, mes nivelit Bachelor dhe Master është 8 572 (29 768 – 21 196), ndërsa mes nivelit Master dhe Doktoraturë është 12 989 (42 757 – 29 768) lekë të reja në muaj.

## Konkluzione dhe Diskutime

Në përfundim të këtij punimi shkencor me temë “Lidhja mes nivelit të edukimit dhe pagës” kemi arritur në disa konkluzione mjaft të rëndësishme. Pjesëmarrja e ulët në nivelin 9-vjeçar (2.4%) mund të shihet si diçka pozitive, sepse tregon që pjesa tjetër e të anketuarve (97.6%) e kanë vazhduar arsimimin e tyre në nivelet më të larta, ndërsa pjesëmarrja e ulët në nivelin doktoraturë (4%) nuk mund të shihet aq pozitivisht, pasi tregon që qyteti i Shkodrës ka shumë pak persona me titullin Doktor (Dr.).

Niveli i punësueshmërisë së gjetur në këtë punim shkencor është 22.4% më i lartë krahasuar me vitin 2021 në qytetin e Shkodrës. **Disa nga arsyet e pagave më të larta se paga max dhe më të ulëta se paga min mund të jenë:** puna me kohë të pjesshme, pjesëmarrja në praktikat profesionale ku pagesa është sa 50% i pagës minimale ose kur personi është në periudhë prove para punësimit të rregullt.

Bazuar në gjetjen që pjesa më e madhe e personave me arsim 9-vjeçar janë të vetëpunësuar mund të themi se këta persona kanë tendencë të vetëpunësohen dhe në këtë mënyrë ata shmangin kriterin e nivelit të edukimit si kriter për t’u punësuar.

Pjesa më e madhe e të anketuarve të papunë dhe të vetëpunësuar janë me nivel të lartë edukimi bachelor, ndërsa pjesa më e madhe e të anketuarve të punësuar janë në nivelin e edukimit Master. Ky rezultat tregon që pjesa më e madhe e punëve dhe profesioneve ka si kriter diplomimin në nivelin Master të edukimit.

Fakti që 90% e personave me nivel edukimi doktoraturë janë të punësuar tregon që personat mbarojnë këtë nivel edukimi kanë mundësi shumë të larta për t’u punësuar.

Hendeku gjinor në pagë mund të shpjegohet me karakteristikat e burrave dhe grave në arsim, eksperiencë pune apo me preferencat në profesione të ndryshme.

Kalimi nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë edukimi sjell rritjen e pagës. Diferenca më e theksuar e pagës është mes nivelit 9-vjeçar dhe nivelit Bachelor duke u pasuar me diferencën mes nivelit Master dhe Doktoraturë.

Mund të konkludojmë se në këtë punim shkencor diplome është shpjeguar me anë të disa variablave rreth 50% e variacionit në pagë dhe 50 % tjetër shpjegohet nga variabla të tjerë që nuk janë përfshirë në këtë punim, si: vitet e ekperiences së punës, turni i punës, lloji i kontratës, njohuritë dhe aftësitë e punonjësit etj.

Lidhja mes pages dhe këtyre variablave mund të jetë objekt i një punimi të ardhshëm shkencor dhe në këtë mënyrë do të arrihet të studiohet dhe të shpjegohet se cilët janë faktorët ose variablat totalë që shpjegojnë 100% të variacionit në pagë.

Si përfundim mund të themi se përgjigjja e pyetjes kërkimore është “*Nivelet e edukimit ndikojnë pozitivisht në pagë, sepse me rritjen e nivelit të edukimit rritet paga e një personi në qytetin e Shkodrës*”.

Gjithashtu, qëllimi i këtij punimi shkencor është arritur dhe objektivat janë realizuar në mënyrën më të mirë të mundshme.

### **Rekomandime**

1. Qeveritarët e shtetit dhe të qytetit të Shkodrës duhet të marrin masat e nevojshme për zhdukjen e fenomenit të pabarazisë gjinore në pagë.
2. Ky punim mund të përdoret si bazë për realizimin e punimeve të tjera me të njëjtën temë, por për qytetet e tjera të Shqipërisë, në mënyrë që të bëhet krahasimi mes qyteteve.
3. Nxënësit dhe studentët duhet të vazhdojnë edukimin e tyre deri në nivelin më të lartë në mënyrë që edhe kthimi për investimin e tyre të jetë sa më i lartë.

### **REFERENCA**

1. Biagetti, M., & Scicchitano, S. (2011). Education and wage inequality in Europe. *Economics Bulletin*, 31(3), 2620-2628.
2. Castex, G., & Kogan Dechter, E. (2014). The changing roles of education and ability in wage determination. *Journal of Labor Economics*, 32(4), 685-710.
3. dos Reis, J. G. A., & De Barros, R. P. (1991). Wage inequality and the distribution of education: A study of the evolution of regional differences in inequality in metropolitan Brazil. *Journal of Development Economics*, 36(1), 117-143.
4. INSTAT. (2021-2022). *Tregu i Punës dhe Arsimit*. Retrieved from Studente per çdo universitet sipas programit.
5. Liu, A. Y. (2006). Changing wage structure and education in Vietnam, 1992–98: The roles of demand. *Economics of Transition*, 14(4), 681-706.
6. Suharyono, S., & Digdowiseiso, K. (2021). Retracted: Education and gender wage gap: Evidence from Indonesia. *Accounting*, 7(1), 33-40
7. Smith, W. C., & Fernandez, F. (2017). Education, skills, and wage gaps in Canada and the United States. *International Migration*, 55(3), 57-73.
8. Tansel, A., & Bodur, F. B. (2012). Wage inequality and returns to education in Turkey: A quantile regression analysis. *Review of Development Economics*, 16(1), 107-121.

## EFEKTET E TATIMEVE NË RITJEN EKONOMIKE

Erjola Barbullushi<sup>1</sup>, Jozefina Laçinej<sup>2</sup>

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Financë-Kontabilitet  
Master shkencor Kontabilitet*

### **ABSTRAKT**

Qeveritë kanë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi, pra është në dorën e tyre që të zgjedhin politikat fiskale të duhura për një të ardhme më të mirë. Sistemi tatimor kalon në një përmirësim të vazhdueshëm me anë të reformave të ndryshme dhe përpjekjeve për të sjellë më shumë përfitime në sistemin e mbledhjes së taksave duke i rritur të ardhurat nga tatimet e taksat.

Qëllimi kryesor është vërtetimi i hipotezës së ngritur, pikërisht identifikimi i ndikimit që ka lloje të ndryshme tatimesh mbi rritjen ekonomike. Pyetja e ngritur është: “A ndikojnë tatimet në rritjen ekonomike?” Një ndër objektivat e punimit është ndërtimi i një modeli ekonometrik për Shqipërinë. Metoda kryesore e përdorur për kërkimin është e bazuar në të dhëna sekondare, të cilat janë seri kohore për Shqipërinë, me bazë mujore të marrë nga baza e të dhënave të Bankës Botërore. Meqenëse periudha e studiuar është 2016- 2020, mund të nxjerrim rezultate rreth efektivitetit që ka pasur në rritjen ekonomike të vendit sistemi progresiv tatimor i hyrë në fuqi që nga janari i vitit 2014. Shqipëria është një vend në zhvillim që ka kryer shumë ndryshime në sistemin e taksave në mënyrë që të rrisë ekonominë e vendit, si dhe kryen shpenzimet për të bërë financime dhe investime që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë.

**Fjalët kryesore (kyçe):** rritja ekonomike, TVSH, TAP, tatimi mbi fitimin, politikat fiskale, sistemi tatimor.

<sup>1</sup> Dr. Erjola Barbullushi (Sakti) është lektore pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti Ekonomik, në departamentin Financë-Kontabilitet që nga viti 2005. Ajo është titullare e lëndëve të Kontabilitetit dhe Financës, si: Menaxhim Risku, Taksim, Kontabilitet Menaxherial, në nivelet bachelor dhe master. Ka mbaruar studimet e larta pranë Fakultetit Ekonomik në Shkodër në 2005-ën për Financë-Kontabilitet dhe Master Shkencor në Financë në 2008-ën në Universitetin e Tiranës. Ajo zotëron një doktoraturë në Drejtim Bankar, të fituar në Universitetin e Tiranës në vitin 2016. Gjatë viteve ka marrë pjesë në evente ndërkombëtare brenda e jashtë vendit si dhe ka eksperiencën të ndryshme ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies dhe projekteve.

<sup>2</sup> Jozefina Laçej është diplomuar në vitin 2016 - 2019 në Bachelor Financë-Kontabilitet pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”. Në vitin 2019-2021 ka marrë titullin Master Shkencor Kontabilitet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi”.

## The effects of taxes on economic growth

### *ABSTRACT*

Governments have a very important role in the economic development of a country, so it is up to them to choose the right fiscal policies for a more promising future. The tax system is undergoing continuous improvement through various reforms and efforts to bring more benefits to the tax collection system by increasing tax revenues.

The main purpose is to prove the hypothesis raised, it is precisely the estimation of the effects that different kinds of tax have on economic growth. The question raised is whether taxes affect economic growth, therefore one of the reasons for this paper is to establish the connection between them, what impact they have. One of the objectives of the study is the determination of the econometric model for Albania. The main method used for the research is based on secondary data, monthly time series data from World Bank database. The study covers a period from 2016-2020, and we can come to conclusions about the effect of the progressive tax system in the economic growth of the country, since it was implemented from January 2014. Albania is a developing country that has made many changes to the tax system in order to boost the country's economy; as well as incur expenses to make financing and investments that affect the development of the economy.

**Keywords:** economic growth, VAT, PIT, profit tax, fiscal policies, tax system

### *Hyrje*

Tatimet dhe taksat kanë një rol të pazëvendësueshëm në shoqëri dhe si të tilla ato ndikojnë në jetën e gjithsecilit duke e ulur fuqinë blerëse. Ulja e fuqisë blerëse për tatimpaguesit bën që t'i rezistojnë detyrimeve të tyre tatimore dhe nëse munden t'i shmangin ato. Tatimet dhe taksat janë një formë nëpërmjet të cilit shteti siguron të hyrat në buxhet, me të cilat financon nevojat për shpenzime publike për veprimtaritë e institucioneve të ndryshme publike si dhe sigurimin e të mirave publike. Roli i qeverisë në ekonomi është thelbësor, prandaj për vendimet që marrin duhet të mbajnë parasysh efektet në sjelljen e tatimpaguesve.

Funksionimi i një sistemi tatimor në mënyrë eficiente dhe efikase, ndihmon në reduktimin e pakënaqësive të tatimpaguesve. Për këtë ai duhet të funksionojë në mënyrë sa më të thjeshtë e të kuptueshme, që të mos



shkaktojë keqkuptime ose të krijojë mundësi për evazion fiskal. Ndër efektet më të rëndësishme është rritja e të ardhurave tatimore, të cilat përkthehen në të mira e investime publike e që janë në dobi të të gjithë shoqërisë.

Ndikimi i politikës fiskale në ekonomi është gjithashtu thelbësore, ajo ka të bëjë me shpenzimet qeveritare, strukturën e taksave dhe gjithashtu me deficitin buxhetor (huamarrja), të cilat synojnë që t'i mbajnë sa më në ekuilibër në mënyrë që të sigurojë një rritje ekonomike të qëndrueshme (të mbajë inflacionin në nivelet e duhura), madje të sigurojë edhe zhvillimin shoqëror. Ajo vepron qëllimisht në mënyrë që të ndikojë në variablat makroekonomike, nëpërmjet ndyshimit të nivelit të shpenzimeve qeveritare dhe taksave. Në këtë punim bëhet përpjekje për të kuptuar si ndikojnë taksat e tatimet në rritjen ekonomike, për të provuar lidhjen mes tyre.

Me anë të këtij punimi synohet të zbulohet ndikimi që kanë tatimet mbi PBB-në si dhe cila taksë ka kontributin më të madh. Diskutimi i të ardhurave nga taksat ofron një tablo për kuptimin e situatës ekonomike në vend.

### ***Rishikimi i literaturës***

*Gatawa. N.M, Aliero H.M, Aishatua. A.M (2016)* ka studiuar ndikimin e TVSH-së në rritjen ekonomike në Nigeri. Të dhënat e përdorura janë dytësore, tremujore për periudhën 1994 deri në 2014. Rezultatet e studimit bazuar në një model regresioni të shumëfishtë, tregojnë për një korrelacion pozitiv rreth 98% dhe një ndikim të rëndësishëm statistikisht të TVSH-së në GDP. Gjithashtu edhe të ardhurat e tjera rezultojnë në një ndikim të rëndësishëm statistikisht në rritjen ekonomike.

*Njogu.W.K(2015)* përdor të dhëna dytësore për periudhën 1990 - 2014 për Kenian dhe ka përfshirë si variabla normat e TVSH-së, produktin e brendshëm bruto, indeksat e çmimeve të konsumit dhe nivelet e papunësisë. Model i përdorur është një gjysmëlogaritmik i regresionit të shumëfishtë, ku variabli i varur është rritja ekonomike (PBB), indeksat e çmimeve të konsumit dhe norma e papunësisë gjatë periudhës së studimit, ndërsa variablat e pavarur ishin nivelet e ndryshme të TVSH-së. Në Kenia TVSH-ja kishte një normë standarde prej 17%, por me 14 norma të tjera, kjo gjë çoi në rritjen e evazionit fiskal. Aktualisht ka vetëm një normë të vetme standarde prej 16%, me disa shitje të vlerësuara me zero dhe të tjera i përjashtuar. Koeficienti i pjerrësisë është -0,07 i rezultuar nga regresioni do të thotë se një rritje më 1% i TVSH çon në një rënie prej 7% të PBB. Autori e argumenton këtë lidhje negative me faktin se zvogëlimi i normave të

TVSH-së rezulton në rritjen e përgjithshme të PBB-së, sepse sjell çmime më të ulëta dhe kërkesë më të lartë të mallrave dhe shërbimeve.

*Simionescu. M, Albu L.L(2016)* studiuin rolin e tatimit mbi vlerën e shtuar në rritjen ekonomike për pesë vende të ndryshme të Evropës, si: Bullgaria, Republika Çeke, Hungari, Poloni dhe Romani. Ky studim u realizua për periudhat 1995 - 2015. Për të analizur lidhjen mes këtyre variablave është përdorur metoda e katrorëve më të vegjël. Modeli për të gjitha vendet të marra së bashku, pra për pesë shtetet Evropiane tregoi një ndikim pozitiv të normës së TVSH-së në rritjen ekonomike, por nuk rezultoi i njëjti përfundim edhe për analizat individuale. Analiza individuale tregoi një ndikim pozitiv të normës së TVSH-së në normën e PBB-së vetëm për Hungarinë, ndërsa vendet tjera, si: Bullgaria, Republika Çeke, Polonia dhe Rumania ka një ndikim të ngadaltë negativ të normës së TVSH-së në rritjen ekonomike. Autorët kanë rekomanduar që Hungaria të ulë normën e TVSH-së, sepse ka normën më të lartë standarde të TVSH-së në BE. Në afatshkurtër rritja e normës së TVSH-së gjeneron probleme në mbledhjen e taksave të konsumit, e cila sjell ulje të shkallës së PBB-së, ndërsa në afatgjatë rritja e normës së TVSH-së ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike në të gjitha vendet.

*Ahmad.Sh, Maqbool H. Sial, Ahmad. N (2018)*, kishin për qëllim të studionin e të vëzhgonin marrëdhënien mes taksave indirekte dhe rritjes ekonomike në Pakistan ku janë përdorur të dhënat vjetore të serive kohore 1974 - 2010. Studiuesit kanë përfshirë si variabla të pavarur taksat indirekte, kapitalin fizik, kapitalin njerëzor dhe shkallën e inflacionit dhe variabël të varur GDP. Modeli i ndërtuar është regresion logaritmik për të sjellë vlerat në të njëjtën shkallë dhe për të lehtësuar interpretimin e variablave në formë përqindjeje. Ngritën si hipotezë zero për studimin, taksat indirekte nuk kanë lidhje negative me rritjen ekonomike.

Nga studimi rezultoi se rritja e taksave indirekte ka një ndikim negativ të rëndësishëm statistikisht, prandaj studiuesit sugjerojnë uljen e taksave indirekte që kontribuojnë me 63% dhe rritjen e taksave direkte që kanë një peshë 33% për të rritur rritjen ekonomike. Rritja me 1% e kapitalit fizik sjell rritje të GDP(rritja ekonomike) me 1.66%, ndërsa variablat e kapitalit njerëzor dhe shkalla e inflacionit janë të parëndësishme statistikisht.

*Ogundana. O.M, Ogundana. O.M, Ogundana.O.M, Ibidunni.A.S, Adetoyinbo. A (2017)*, studiuin ndikimin e tatimit të drejtpërdrejtë, indirekt dhe kapitalit në rritjen e ekonomisë nigeriane për periudhën 1994-2013. Studimi bazohet në të dhëna dytësore duke marrë si variabla PBB, formimin e kapitalit, doganat dhe akcizat, tatimin mbi fitimin e kompanisë dhe TVSH-së. Rezultati tregon se taksat e drejtpërdrejtë është e lidhur

pozitivisht me GDP, por statistikisht i parëndësishëm, ndërsa koeficienti i taksës indirekte është pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm. Një rritje me 1 njësi në taksën indirekte rezulton në një rritje prej 0,0291% në GDP. Koeficienti i variablit të kapitalit është pozitiv dhe i rëndësishëm statistikisht, ku 1% rritje në kapital rezulton me 0,134% rritje në rritjen reale ekonomike. Ato konkluduan se tatimi indirekt në krahasim me tatimin direkt ka një ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm në rritjen ekonomike. Autorët arrijnë në përfundimin se vendi duhet të përqendrohet më shumë në taksën indirekte si një mjet për rritjen e rritjes ekonomike, sidomos TVSH-ja si dhe gjithashtu një riorganizim i sistemit tatimor.

*Pisarek, R, Dragoshi. G (2015)* kërkonin t'i përgjigjeshin pyetjes se cila është lidhja midis politikës fiskale dhe ritmit të rritjes ekonomike në Shqipëri. Ata u bazuan në të dhënat dytësore të marra nga statistikat e financave të qeverisë dhe Bankës Botërore, seri kohore për një periudhë 19-vjeçare, për vitet 1995 - 2013. Studiuesit kanë arritur në përfundimin se në Shqipëri efektet e taksave, të shpenzimeve qeveritare janë pozitive në rritjen ekonomike. Ka një ndikim pozitiv në rritjen e prodhimit edhe formimi i kapitalit fiks bruto nga qeveria gjithashtu, si për shembull shkalla e rritjes ekonomike rritet me 4.65% për çdo rritje prej 1% të produktivitetit real të punës. Gjithashtu të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisë kanë një efekt të rëndësishëm në rritjen reale të PBB-së. Një ndikim negativ në rritjen ekonomike ka variabli i papunësisë, sepse kjo sjell prodhim më të ulët dhe gjithashtu ka një ndikim negativ në buxhetin e shtetit.

Variablat e pavarur të përfshirë në model e shpjegojnë rritjen e ekonomike me rreth 65%. Vlera e p-së, e cila rezultoi më e ulët se vlera kritike prej 0.05, tregon se variablat shpjegues të përfshirë në model kanë një ndikim statistikisht të rëndësishëm në shkallën e rritjes ekonomike.

*Asllani, Gan (2018)* u morën me studimin nëse ndryshimet e bëra në normat e TVSH-së në Kosovë në 2015 kanë pasur efektet e tyre në shportën konsumatore dhe ndikim në rritjen ekonomike për periudhën 2013-2016. Në bazë të këtij studimi rezultoi një lidhje e fortë pozitive midis PBB-së dhe TVSH-së dhe me një koeficient korrelacionit prej 0.97. Analiza kryhet duke u bazuar në ndarjen e produkteve në dy grupe, ato produkte bazë ku norma e TVSH-së ka rënë nga 16% në 8% dhe ato produkte ku përfshihen mallra luksoze ku norma e TVSH-së është rritur nga 16% në 18%.

Për grupin e produkteve luksoze regresioni tregon se ndikimi i duhanit, pijeve alkoolike kanë një efekt të madh në rritjen e TVSH dhe të gjithë këto variabla janë të rëndësishëm statistikisht. Ato kanë vërtetuar hipotezën se TVSH-ja ka një efekt pozitiv në rritjen ekonomike, duke sjellë rritjen e

PBB-së, për grupin e mallrave luksoze, rritja e TVSH-së ka pasur një efekt pozitiv në rritjen e PBB-së 0.506%.

Grupi i produkteve themelore rezulton me efekt të rëndësishëm statistikiisht në TVSH dhe të gjithë koeficientët e mbledhur janë 0.73, duke treguar se niveli ekonomik ka një rritje mesatare të rendimenteve. Analiza ekonometrike e regresionit për grupin e produkteve bazë konkludoi se zbritja e TVSH-së nga 18% në 8% kishte një efekt pozitiv që ndikoi në rritjen e PBB-së 0.73%.

### ***Metodologjia***

Në kërkimin empirik të bërë, hipoteza kërkon të zbulojë lidhjen, ndikimin mes rritjes ekonomike dhe taksave të ndryshme, të cilat janë të grupuara në dy grupe të mëdha. Pyetja kërkimore e ngritur, është a ndikojnë taksat në rritje ekonomike?

Vendi jonë ka synime të qarta drejt rrugës për në integrimin në Bashkimin Evropian dhe për këtë arsye për rastin e Shqipërisë do të vlerësohet se cila nga taksat ka ndikimin më të madh tek të ardhurat e qeverisë dhe tek produkti brendshëm bruto, për të parë se nëse është e përqendruar tek ato taksa ashtu si vendet e Evropës. Për rastin e Shqipërisë janë ndërtuar këto hipoteza:

H0: TVSH-ja, tatimi mbi fitimin dhe TAP nuk ndikojnë në rritjen ekonomike.

H1: TVSH-ja, tatimi mbi fitimin dhe TAP ndikojnë në rritjen ekonomike.

H0: TVSH-ja, tatimi mbi fitimin dhe TAP nuk kanë lidhje të rëndësishme në gjenerimin e të ardhurave.

H1: TVSH, tatimi mbi fitimin dhe TAP kanë lidhje të rëndësishme në gjenerimin e të ardhurave.

Në kërkim janë përfshirë të dhëna në seri kohore për Shqipërinë, të vendosur në mënyrë kronologjike për periudhën 2016-2020 me bazë mujore, ku variabli i varur janë të ardhurat totale nga taksat dhe variablat e pavarur janë TVSH, tatimi mbi fitimin, tatimi mbi të ardhurat personale, të dhënat janë të shprehura në milionë lekë. Seritë kohore janë përdorur edhe në rastin ku variabli i varur është PBB për frymë vjetore për periudhat 1991-2020, të dhënat janë të shprehura në miliardë lekë.

Në punim është përdorur modeli i regresionit të shumëfishtë duke përdorur metodën e katrorëve më të vegjël (OLS) për të studiuar lidhjen mes variablit të varur dhe variablave të pavarur, synohet të shihet kahu i lidhjes dhe se cili ka ndikim më të madh.

Janë krijuar dy modele të regresionit të shumëfishtë linear, ku si variabël i varur janë të ardhurat nga taksat në njërin model (me të dhëna mujore për 59 periudha) dhe PBB (me të dhëna vjetore për 30 periudha) në tjetrin dhe si variabla të pavarur tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi fitimin dhe tatimi mbi të ardhurat personale.

$$Y = \beta_0 + \beta_1 * X_1 + \beta_2 * X_2 + \beta_3 * X_3 + u_i \quad (1)$$

Y- totali i të ardhurave nga taksat

X<sub>1</sub> - TVSH në milionë lekë

X<sub>2</sub>- tatimi mbi fitimin në milionë lekë

X<sub>3</sub>- tatimi mbi të ardhurat personale në milionë lekë

$$Y = \beta_0 + \beta_1 * X_1 + \beta_2 * X_2 + \beta_3 * X_3 + u_i \quad (2)$$

Y- PBB për frymë ( në dollar)

X<sub>1</sub> – TVSH në miliardë lekë

X<sub>2</sub>- tatimi mbi fitimin në miliardë lekë

X<sub>3</sub>- tatimi mbi të ardhurat personale në miliardë lekë

### **Rezultate**

Në bazë të përllogaritjeve me anë të programit Gretl, rezultojnë ekuacionet e regresionit linearë të shumëfishtë si më poshtë.

*Modeli 1:* 
$$PBB = 334 + 27 * TVSH + 22.7 * TAP + 3.6 * TF + u_i \quad (3)$$

Në modelin si variabël i varur është PBB për frymë, i cili shpjegohet nga TVSH, TAP, tatimi mbi fitimin. Në bazë të rezultateve të marra nga ekuacioni i shumëfishtë i regresionit mund të thuhet se PBB për frymë mesatarisht kur mbahet konstant ndikimi i variablave të tjerë të përfshirë në model, është 334 dollarë dhe është i rëndësishëm statistiki.

Variabli i pavarur TVSH ka një lidhje pozitive me PBB ashtu siç ka rezultuar edhe në kërkimet individuale të marra nga studiues të ndryshëm të cilët janë paraqitur në këtë punim. Ky variabël tregon se një rritje prej 1 mld lekë nga TVSH sjell që PBB për frymë rritet me 27 dollarë, dhe ky ndikim është i rëndësishëm statistiki për  $\alpha=5\%$ . Vlera e  $t=5.8$  tregon gjithashtu kështu rëndësi statistikore.

Koeficienti 22.7 tregon se rritja me 1 mld lekë në vit i TAP sjell rritjen e PBB për frymë me 22.7 dollarë kur mbahet konstant ndikimi i variablave të

tjerë, ky koeficient nuk është i rëndësishëm statistikisht për  $\alpha=5\%$ , por vetëm për  $\alpha=10\%$ .

Tabela 1: Rezultatet e regresionit për Shqipërinë

	Model 1 PBB për fyrmë (n=30)	Model 2 Të ardhurat nga taksat(n=59)
Konstante	334 (121) t 2.8 p-value 0.01**	2.3 (0.9) t 2.5 p-value 0.1**
TVSH	27 (4.7) t 5.7 p-value 5.4e-06***	1.4 (0.07) t 18 p-value 9.4e-025***
Tatimi mbi të ardhurat pesonale	22.7 (13.8) t 1.7 p-value 0.1	1.2 (0.12) t 10.3 p-value 1.7e-014***
Tatimi mbi fitimin	3.6 (14) t 0.8 p-value 0.8	0.9 (0.06) t 13.7 p-value 2.02e-019***
<b>R<sup>2</sup></b>	<b>97%</b>	<b>90%</b>

Burimi: Gretl, llogaritje të autorit.

Koeficienti për variablin e tatimit mbi fitimin nuk është i rëndësishëm statistikisht për vendin tonë, kjo tregohet edhe nga vleta e  $t=0.8$  e cila është brenda segmentit  $[-2.;2]$ .

Ky model me koeficientin e korrelacionit të rezultuar tregon se variablat shpjegues të përfshirë e shpjegojnë variablin e varur me 97%.

Vlerat brenda kllapave tregojnë gabimin standard, i cili është i vogël në rastin kur tregohet një lidhje e rëndësishme statistikore mes variablit të varur dhe të pavarur, si rasti i TVSH dhe anasjelltas.

$$\text{Modeli 2: } TA = 2.3 + 1.4 * TVSH + 0.9 * TAP + 1.25 * TF + u_i \quad (4)$$

Variablat e përfshirë në model e shpjegojnë variablin e varur të ardhurat nga taksat me 90%. Ajo që bie në sy për rastin e Shqipërisë është se tatimi mbi vlerën e shtuar ka rolin thelbësor në të ardhurat tatimore të vendit tonë, pasi një rritje në TVSH sjell që të ardhurat tatimore të rriten me 1.4 mln, kur variablat tjerë mbahen konstant, kjo rritje është e rëndësishme statistikisht, pasi vlera e p-value është më e vogël se  $\alpha=5\%$ .

Rritja e tatimit mbi fitimin me 1 mln kur variablat e tjerë mbahen konstant tregon se sjell rritjen në të ardhurat totale nga taksat me 0.9 mln, një rrije e cila është e rëndësishme statistikisht.

Rritja e tatimit mbi të ardhurat personale kur ndikimi i variablave tjerë mbahet konstant sjell rritjen e të ardhurave totale nga taksat me 1.25 mln, e cila është e rëndësishme statistikisht.

Ajo që vëhet re në këtë rast është se ndikimin më të madh në të ardhurat nga taksat në vendin tonë e ka TVSH, e cila ndiqet nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Modeli i parë paraqet të dhëna për një periudhë 30- vjeçare, si rezultat i mungesës së të dhënave për të krijuar një seri kohore me periudha më shumë, të cilat do ta përforconin më tepër rezultatin e modelit. Modeli i parë rezulton me variabla të rëndësishëm statistikisht, që do të thotë se kanë ndikim tek rritja ekonomike e vendit tonë. Ky model nxjerr në pah gjithashtu edhe nevojat për përmirësimin e sidomos tatimit mbi fitimin. Duke u bazuar tek rezultatet e tij vërehet se Shqipëria është e bazuar më shumë tek taksat indirekte, në ndryshim me vendet e zhvilluara evropiane ku përgjithësisht i kushtojnë pak më rëndësi atyre direkte. Nuk mund të përjashtohet si mundësi zhvillimi përqendrimi tek taksat indirekte, pasi shumë vende kanë politika dhe sisteme të ndryshme.

Në bazë të modelit të parë mund të krijohen pritshmëri gjithashtu për modelin e dytë, ku pritet që TVSH të ketë më shumë ndikim tek totali i të ardhurave nga taksat dhe në fakt ashtu sugjeron edhe modeli, gjithashtu tregon se rendimenti i tatimit mbi fitimin tek të ardhurat totale nga taksat nuk është në nivelin e duhur.

### ***Kufizimet e kërkimit***

Gjatë realizimit të kërkimit janë ndeshur disa kufizime të cilat e kanë vështirësuar analizën empirike.

Kufizimet e hasura për Shqipërinë kanë qenë mungesa e informacionit për periudha më të gjata kohore për të dhënat në lidhje me TVSH, TAP dhe tatimin mbi fitimin.

### ***Përfundime***

Shqipëria ka bërë shumë përmirësime dhe kjo vërehet në të ardhurat totale nga që nga periudha e “tranzicionit” ekonomik e deri në ditët e sotme, ku paraqitet një trend gjithnjë rritës. Qeveria u ka ardhur në ndihmë tatimpaguesve duke bërë lehtësime në taksa aty ku është e nevojshme, duke luftuar evazionin fiskal, duke i përmirësuar ligjet e taksave dhe duke ndërmarrë reformën e fiskalizimit, e cila është më e fundit. Kjo reformë ka synim modernizimin e sistemit tatimor dhe rritjen e të ardhurave nga tatimet. Ky modernizim shërben jo vetëm për edukimin e punonjësve, por ai sjell reduktimin e mashtrimit në taksa e tatime, pasi deklaratimet bëhen në kohë reale, madje mund të thuhet se ky është një hap më afër drejt Bashkimit Evropian dhe drejt zhvillimit të mëtejshëm ekonomik.

Nga analiza e realizuar për Shqipërinë përfundimet treguan se të gjitha tatimet e përfshira në model, tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi mbi fitimin janë të lidhura pozitivisht me produktin e brendshëm bruto.

Gjatë këtij punimi kemi arritur në përfundimin se në vendin tonë tatimi mbi vlerën e shtuar është ai që luan rolin kryesor në totalin e të ardhurave nga taksat, madje dhe rezulton i rëndësishëm statistikisht për  $\alpha = 1\%$  që do të thotë që shkalla e gabimit është shumë e vogël. Ajo që rezulton nga modeli i parë për vendin tonë është gjithashtu e rëndësishme të përmendet se tatimi mbi fitimin nuk është i rëndësishëm statistikisht, që do të thotë që nuk ka ndikim në rritjen ekonomike, por gjithashtu edhe tatimi mbi të ardhurat personale rezulton i rëndësishëm statistikisht për një  $\alpha = 10\%$ .

Shqipëria është një vend i cili për një kohë të gjatë ka funksionuar si ekonomi e centralizuar, e cila me rënien e saj i ka krijuar mundësinë e rimëkëmbies, por rruga që ka patur përpara ka qenë e vështirë, prandaj dhe mund të thuhet se vendi ynë ka bërë një sërë përpjekjesh e reformash të cilat kanë ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike. Duhet patur parasysh që gjithmonë ka vend për përmirësim të mëtejshëm dhe ajo që mendojmë është se u duhet kushtuar më shumë vëmendje tatimeve direkte, që të rrisin peshën e tyre në totalin e të ardhurave.

#### REFERENCA

1. Amadeo. K, Boyle.M (2020) Contractionary Fiscal Policy And Its Purpose With Examples.
2. Gani. A (2018) Impact of Change in VAT in Kosovo And His Effect in Economic Development (2013-2016).
3. Gatawa. N.M , Aliero H.M, Aishatu M (2016) Evaluating The Impact of Value Added Tax on the Economic Growth Of Nigeria.
4. Simionescu. M, Albu. LI (2016) The Impact of Standard Value Added Tax on Economic Growth In CEE-5 Countries: Econometric Analysis and Simulations.
5. Ministria e Financave RSh Treguesit Analitik Fiskal Dhjetor 2017.
6. Financave Dhe Ekonomisë RSh Treguesit Analitik Fiskal Nëntor 2020.
7. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2014) Drejtoria e Politikave Fiskale Analiza e të Ardhurave në Shqipëri 1992-2012, Faqe 9-14.
8. Nyaga, J. N. & Omwenga, J. (2016). Factors Influencing Tax Revenue Growth at Kenya Revenue Authority: A Case of Meru Station. International Academic Journal of Economics and Finance.
9. Njogu L.K (2015) The Effects of Value Added Tax on Economic Growth in Kenya .
10. Ogundana. O.M, Ogundana O.M, Ogundana O.M, Ibidunni. A.S, Adetoyinbo. A (2017) Impact of Direct and Indirect Tax on the Nigerian Economic Growth.
11. Oordt M. V. (2016). Value Added Tax Effort And the Influence Of Governance. Paper Presented at the VAT in Developing Countries: Policy, Law And Practice Symposium.
12. Pisarek. R, Dragoshi.G (2015) The Impact of Fiscal Policy Upon Economic Growth in Albania. Fq 14.
13. Publications Office (2020) Taxation Trends in The European Union 2020.
14. Tax Policies in the European Union (2018 Survey) Faqe 83-84.
15. World Bank Group Raport i Vlerësimit Të Performacës Shqipëria. (2018) Faqe 19.



## **ANALIZA E RISKUT DHE PASIGURISË NË PROJEKTET E NAFTËS. RASTI KOMPANIA ALBPETROL**

Blerta Mjeda<sup>1</sup>

*Bashkia Shkodër*

### **ABSTRAKT**

Industria e naftës është një nga industritë më të vjetra në Shqipëri. Duke qenë se në vend ka pak studime të kryera, punimi do të zgjerojë literaturën dhe prurjet empirike. Ky kërkim është një përpjekje për të ofruar oportunitete për vendime më të analizuara.

Të shpjegosh të kaluarën është më e qartë sesa të parashikosh të ardhmen. Kjo pasiguri ngre një numër të konsiderueshëm çështjesh kur krijon një plan financiar për një kompani.

Në këtë studim paraqitet analiza e modelimit dhe simulimit për marrjen e vendimeve në projektet e naftës. Për të realizuar këtë qëllim në fillim janë trajtuar çështjet e pasigurisë dhe riskut në projektet e naftës.

Risku dhe pasiguria janë një nga çështjet më të rëndësishme, sepse përcaktojnë nëse duhet të ndërmerim një projekt investimi dhe çfarë duhet të parashikojmë e të vendosim kur ndodhemi në këto kushte. Për të bërë karakterizimin e këtyre koncepteve në këtë studim janë përdorur metoda përshkruese dhe analitike duke përdorur metodën Monte Carlo, nëpërmjet Analizës së Ndjeshmërisë.

---

<sup>1</sup> Diplomuar në 2003 pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës. Në vitin 2005 ka përfunduar studimet master për Informatikë Ekonomike Projekt për vendet Post-Komuniste (BRIE Bulgarien Romanien Inter-University Business Informatics), Rumani-Gjermani. Në korrik të vitit 2019 i jepet grada Doktor i Shkencave Ekonomike nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës. Ka marrë pjesë dhe ka përfunduar me sukses shumë kualifikime, trajnime, internship, si: Matra Patrol, 2012 në Hollandë, për Menaxhimin e Kontrollit Financiar, Fondazione për l-Ambiente, Shkollë verore për Shërbimet Publike, Itali 2013, Shkolla e Studimeve Politike, Akademia e Liderimit, në shtator, 2018. Ka punuar si as/lektore e jashtme pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës që nga viti 2007 e në vazhdim. Ka marrë pjesë në konferenca, aktivitete dhe publikime shkencore kombëtare e ndërkombëtare, si në: Poloni, Itali, Angli. Nga viti 2016 punon në bashkinë Shkodër, Drejtor Finance.

Për të dyja metodat kemi përcaktuar skenarë për Vlerën Aktuale Neto (Net Present Value), dhe objektivin për optimizimin e vlerës aktuale neto.

Nga procesi i simulimit janë përcaktuar rezultatet për skenarët e vlerës aktuale neto në prodhimin e naftës.

**Fjalë kryesore (kyçe):** modelim, optimizim, pasiguri, risk, simulim, vendimmarrje në projektet e naftës.

**Analysis of risk and uncertainty in oil projects.  
The case of Albpetrol Company**

***ABSTRACT***

The oil industry is one of the oldest industries in Albania. Since there are few studies in the country, the paper will expand literature and empirical journals. This study is an attempt to provide opportunities for more analyzed decisions.

Clarifying the past is clearer than anticipating the future. This uncertainty raises a considerable number of issues when it creates a financial plan for a company.

This study presents modeling and simulation analysis for decision-making in petroleum projects. To accomplish this goal at first, the issues of uncertainty and risk in petroleum projects have been addressed.

Risk and uncertainty are one of the most important issues because they determine whether we should undertake an investment project and what to expect and decide when we are in these conditions. To characterize these concepts in this study, manual methods and simulation methods were used using the Monte Carlo method through Sensitivity Analysis.

For both methods I have set scenario for the Net Present Value, and the objective for optimizing the net present value.

In this paper, a simulation procedure is also proposed for forecasting capital projects in the petroleum industry, proposing the most optimal scheme.

From the result of the simulation are determined the statistical results by determining the current net present value scenarios in oil production

**Keywords:** decision making in petroleum project, modeling, optimization, risk, simulation, uncertainty.

## **1. Hyrje**

Analiza e riskut paraqet një komponent të rëndësishëm në shumë studime dhe sipërmarrje. E pranishme dhe në prodhimin, ekonominë dhe financat e naftës, kjo analizë kërkon zgjerimin e përdorimit të metodave probabilitare dhe thellimin e analizës për të optimizuar rezultatet dhe minimizuar pasigurinë.

### ***1.1 Sfondi i kërkimit***

Si në çdo sipërmarrje ekonomike edhe në kompanitë e naftës vendimi për të investuar bazohet në vlerësimin e rentabilitetit të projektit. Por sa i sigurt është përfitimi i llogaritur? Po sikur shpenzimet të tejkalohen gjatë zbatimit të projektit? Po nëse përfundimi i projektit është vonuar?

### ***1.2 Qëllimi dhe objektivat***

A është e mundur që të zbatohen metoda më të avancuara për të optimizuar rezultatet e kompanisë në kushtet e riskut e të pasigurisë? Për t'i dhënë përgjigje pyetjes thelbësore në punim do të synohet të arrihet qëllimi dhe objektivi i kërkimit.

Qëllimi i punimit është të ofrojë analizën e menaxhimit në kushtet e riskut dhe pasigurisë në projektet e naftës për të rritur performancën e aktivitetit në naftë.

Objektivi i kërkimit është optimizimi i treguesve të ndryshëm ekonomikë financiarë në Kompaninë e Naftës Albpetrol ShA me anën e simulimit duke përdorur teknikën Monte Carlo.

### ***1.3 Të dhënat dhe Metodot***

Të dhënat: Në studim janë marrë të dhënat e kompanisë Albpetrol Sh.a. Të dhënat dhe treguesit në shqyrtim janë: madhësia e mbulimit, mbulimi, koha e mbulimit, shpimi i puseve, norma minimale, kostot e objektit, çmimi marzhinal i naftës, përfundimi i mbulimit, norma e shkallës së vlerësimit, kosto e puseve, kjo duke marrë në konsideratë Pasqyrën e Pozicionit Financiar, Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Cash Flow të prodhimit të naftës.

Metodat: Në punim janë përdorur metodat përshkruese dhe analitike, nëpërmjet përdorimit të grafikëve, tabelave dhe figurave dhe metodës së simulimit sipas teknikës Monte Carlo.

### ***1.4 Rrishtë e Punimit***

Risi të punimit mund të konsiderohen:

- Analiza e riskut dhe pasigurisë në kompanitë e naftës dhe rrugë të menaxhimit të tyre,
- Llogaritja e Vlerës Aktuale Neto, me simulim me metodën Monte Carlo nëpërmjet programit Crystal Ball.

## **2 Analiza dhe menaxhimi i riskut**

### **2.1 Analiza e riskut**

Analiza e riskut është projektuar për të përmbushur nevojat e organizimit, integritimit dhe komunikimit. Risku është kudo dhe ne duhet të marrim në konsideratë marrjen e vendimeve për projekte të cilat janë shumë të rëndësishme. Nëse përdorim të dhëna për të zgjidhur problemet, për të bërë parashikime, për të zhvilluar strategji ose për të marrë vendime, atëherë patjetër duhet të konsiderojmë të bërit e analizës së riskut.

Qëllimi i këtyre metodave është duke përdorur teknikën sasiore ose cilësore për të ndihmuar vendimmarrësit të zgjedhin një kurs veprimi, duke pasur një kuptim më të mirë të rezultateve të mundshme që mund të ndodhin. Ju mund të pyesni veten nëse ajo që bëni do të ishte e përshtatshme për Analizën e riskut. Pasiguritë mund të trajtohen në mënyrë më efektive përmes teknikave të ndryshme të analizës së riskut.

Analiza e riskut në përgjithësi përbëhet nga tre komponentë: vlerësimi i riskut, menaxhimi i riskut dhe komunikimi me riskun. Analiza e riskut, përveç vlerësimit të riskut dhe menaxhimit të riskut, është pjesë e konceptit të vlerësimit të riskut.

Simulimi si një mjet për analizën e riskut në vendimmarrje u zbatua për herë të parë në investimet e eksplorimit të naftës në vitin 1960 (Grayson, 1960). Teknika mund të zbatohet për çdo lloj llogaritje duke përfshirë variablat e rastit. Mund të përdoret për t'u përgjigjur pyetjeve teknike të tilla si ("Cili është vëllimi i rezervave të rikuperueshme të hidrokarbureve në një sipërfaqe?") dhe ato ekonomike të tilla si ("Cili është probabiliteti që VAN e kësaj pritshmërie të kalojë objektivin prej x milion \$ ? ") (Bailey et al., 2000).

### **2.2 Shembull i përdorimit të metodës Monte Carlo.**

Shembulli i Albpetrol Sh.A. tregon analizën e besueshmërisë për maksimizimin e vlerës aktuale neto. Për të zgjidhur këtë problem, mund të përdoren metoda analitike të drejtpërdrejta. Nëse variablat hyrës kanë shpërndarje Normale, marzhi i prodhimit (nafta) ka gjithashtu shpërndarje Normale, por faktori zbritës nuk ka shpërndarje Normale (Mjeda, 2018).

Meqenëse ne kemi zgjidhjen e saktë të këtij problemi, e krahasojmë atë me simulimin Monte Carlo për të njëjtin problem.



Për çdo provë, gjenerohen dy numra të rastësishëm  $x$  dhe  $y$ , me shpërndarje Normale standarde.





Simulimi Monte Carlo u bë për 100, 1000 prova ku japin rezultatet përkatësisht për variabla jo të korreluar dhe të korreluar, tregojnë grafikët përkatës të rezultateve të provave. Përgjithësisht, sa më i lëmuar të jetë grafiku, aq më të sakta janë rezultatet. Llogaritjet jepen për variabla të korreluar dhe jo të korreluar.

Simulimi lejon përshkrimin e riskut dhe pasigurisë së variablave që ndikojnë probabilitetin e projektit sipas shpërndarjes së probabilitetit. Për modelin VAN, variablat e pasigurtë që paraqesin risk në llogaritjen e VAN janë: rezervat, çmimi i naftës, norma e rënies eksponenciale, kostot e shpimit - CAPEX, kostoja e objekteve sipërfaqësore - CAPEX dhe variabli OPEX. Programi Crystal Ball përdoret për simulimin me metodën Monte Carlo (Mjeda, 2016).

Hapi i parë është përcaktimi i supozimeve mbi shpërndarjet. Variablat e pavarur dhe shpërndarjet e tyre të supozuara probabilitare përcaktohen si më poshtë në Tabelën 2-1

***Tabela Error! No text of specified style in document.-1 Variablat e inputit dhe shpërndarjet e supozuara***

Variablat e Pavarur	Shpërndarja	Forma	Inputet
Rezervat	Trekëndore		Minimale E mundshme Maksimale
Çmimi i naftës	Trekëndore		Minimale E mundshme Maksimale

Faktori zbritës	Normale		Mesatarja Devijim Standard
Kosto e shpimit – CAPEX (Kapitale)	Trekëndore		Minimale E mundshme Maksimale
Kosto e objektit – CAPEX (Kapitale)	Trekëndore		Minimale E mundshme Maksimale
Kostot variabël OPEX	Trekëndore		Minimale E mundshme Maksimale

**Burimi:** Bailey, et al, 2000

### 3 Analiza dhe diskutimi i Rezultateve Financiare në Kompaninë

#### Albpetrol Sh.A


Duke parashikuar për vitin 2018, se të ardhurat janë 4,152 milionë lekë, dhe shpenzimet janë 2,619 milionë lekë, na paraqitet se Rezultati Financiar për kompaninë Albpetrol Sh.A, është 1,533 milionë lekë. Kështu që fitimi mund të jetë 1,533 milionë lekë.

Sa të sigurt jemi se fitimi do të jetë 1,533 milionë lekë apo a kemi ndonjë mundësi që do të humbasim para në këtë parashikim? Të tjera pyetje mund të jenë të vështira pa bërë një parashikim, pa bërë një simulim. Ne mund të bejmë një paraqitje si më poshtë:

Për të Ardhurat kemi zgjedhur një Shpërndarje Trekëndore me vlerat minimale, maksimale dhe më të mundshme kjo e paraqitur si në Figurën 1-1, dhe për Shpenzimet kemi zgjedhur një Shpërndarje Uniform, kjo e paraqitur si në Figurën 3-1.


Në teorinë statistikore dhe probabilitare, shpërndarja e vazhdueshme uniform ose shpërndarja drejtkëndore është një shpërndarje simetrike e probabilitetit ku të gjitha intervalet e të njëjtës gjatësi në mbështetjen e shpërndarjes janë njësoj të mundshme.

**Figura 3-1** Shpërndarja Trekëndore për të Ardhurat



*Burimi: Autori, 2018*

**Figura 3-2.** Shpërndarja Uniform për Shpenzimet



*Burimi: Autori, 2018*

Në shpërndarjen uniforme Figura 3-2, të gjitha vlerat ndërmjet minimumit dhe maksimumit kanë gjasa të ndodhin njësoj. Kjo është një shpërndarje e përhapur e probabilitetit. Parametrat e shpërndarjes uniforme janë minimale, maksimale dhe vlerat e mundshme. Janë tri kushte që qëndrojnë në bazë të shpërndarjes uniforme:


1. Vlera minimale është e fiksuar,
2. Vlera maksimale është e fiksuar,
3. Të gjitha vlerat midis minimumit dhe maksimumit kanë gjasa të ndodhin njësoj.

Në teorinë statistikore dhe probabilitare, shpërndarja e vazhdueshme uniforme ose shpërndarja drejtkëndore është një shpërndarje simetrike e probabilitetit ku të gjitha intervalet e të njëjtës gjatësi në mbështetjen e shpërndarjes janë njësoj të mundshme.

Në shpërndarjen uniform, të gjitha vlerat ndërmjet minimumit dhe maksimumit kanë gjasa të ndodhin njësoj. Kjo është një shpërndarje e përhapur e probabilitetit. Parametrat e shpërndarjes uniform janë vlerat minimale dhe vlerat maksimale. Janë tri kushte që qëndrojnë në bazë të shpërndarjes uniform:

1. Vlera minimale është e fiksuar,
2. Vlera maksimale është e fiksuar,
3. Të gjitha vlerat midis minimumit dhe maksimumit kanë gjasa të ndodhin njësoj.

**Figura 3-3. Rezultati Financiar me siguri 100%**




*Burimi: Autori, 2018*



Grafiku i parashikuar, në Figurën 3-3 tregon gamën e përgjithshme të rezultateve të Rezultatit Financiar të parashikuara për skenarin. Çdo paraqitje histograme në tabelë paraqet gjasat ose probabilitetin për të fituar të ardhura. Shohim se probabiliteti ose siguria e një vlere që të bie në rangun e pafundësisë negative dhe pafundësisë pozitive është 100 për qind. Shohim gjithashtu se në cepin e sipërm të majtë të tabelës janë paraqitur 1000 prova, por këndi i sipërm djathtas i tabelës 998 shfaqet. Vlerat e përjashtuara, nëse ka, quhen të veçuara (të largëta). Ato janë të përfshira në llogaritje, por nuk përfshihen në skemën e parashikimit. Nëse vendosim, si në Figurën 3-4 që fitimi, rezultati do jetë 1,533 milionë lekë, na paraqitet që siguria për të bërë një fitim të tillë është 50,84%.


Paraqitur si më poshtë.

**Figura 3-4. Rezultati Financiar me siguri 50%**




*Burimi: Autori, 2018*

Nëse vendosim se siguria është 80%, kjo e paraqitur në Figurën 3-5, kemi një besueshmëri se ne do bëjmë para, do të kemi fitim në vlerat minimale prej 1,224 milionë lekë dhe në vlerat maksimale 1,827 milionë lekë.

**Figura 3-5. Rezultati Financiar me siguri 80%***Burimi: Autori, 2018*


Nëse ne vendosim se siguria jonë është 90%, kjo e paraqitur në Figurën 3-6, kemi një besueshmëri se ne do të bëjmë para, do të kemi fitim në vlerat minimale prej 2,321 milionë lekë dhe në vlerat maksimale 2,971 milionë lekë.

**Figura 3-6. Rezultati Financiar me siguri 90%***Burimi: Autori, 2018*

Nëse ne vendosim se siguria jonë është 95%, kjo e paraqitur në Figurën 3-7 kemi një besueshmëri se ne do të bëjmë para, do të kemi fitim në vlerat

minimale prej 2,277 milionë lekë dhe në vlerat maksimale 3,022 milionë lekë.


**Figura 3-7. Rezultati Financiar me siguri 95%**



*Burimi: Autori, 2018*

Nëse ne vendosim se siguria jonë është 99%, kjo e paraqitur në Figurën 3-8, kemi një besueshmëri se ne do të bëjmë para, do të kemi fitim në vlerat minimale prej 2,164 milionë lekë dhe në vlerat maksimale 3,075 milionë lekë.


**Figura 3-8. Rezultati Financiar me siguri 99%**



*Burimi: Autori, 2018*

Po të shohim grafikun e ndryshueshmërisë, kjo e paraqitur në Figurën 3-9, variabli të Ardhura ka ndikimin më të madh në ndryshueshmërinë e rezultatit financiar dhe variabli, Shpenzimet ka ndikim më pak në ndryshueshmërinë e rezultatit financiar, që do të thotë se është gjë e mirë, pasi ne në të vërtetë mund të kontrollojmë shpenzimet, më mirë, sesa mund të kontrollojmë të Ardhurat. Nëse ne kemi mundësinë të menaxhojmë të ulim ndryshueshmërinë rreth shpenzimeve ne duhet të jemi në gjendje të ulim riskun, ndryshueshmërinë rreth fitimit apo rezultatit financiar. Variabli Shpenzimet është me vlerë minus dhe tregon se ka ulje në variablin e rezultatit financiar.

**Figura 3-9 Grafiku Tornado, për Rezultatit Financiar**



*Burimi: Autori, 2018*

## 4 Konkluzione dhe Rekomandime

### 4.1 Konkluzione

Gjetja e vlerave optimale për variablat e vendimmarrjes përfshin drejtimin e simulimit për një sërë vlerash fillestare, analizimin e rezultateve, ndryshimin e një ose më shumë vlerave, ridrejtimin e simulimit dhe përsëritjen e procesit derisa të gjejme një zgjidhje të kënaqshme.

Pikërisht, përdorimi i simulimit nëpërmjet metodës Monte Carlo, me programin Crystal Ball, është efikase dhe e dobishme, për marrjen e një vendimi më të mirë për zhvillimin e naftës në Kompaninë Albpetrol. Mund të them se VAN zvogëlohet me rritjen e numrit të përsëritjeve në simulim, e cila është e arsyeshme, sepse kur numri i bashkëveprimeve është më i lartë, ka një konvergencë ndaj vlerës mesatare të VAN.

Përdorimi i teknikës së simulimit ka kompleksitet relativ operacional, vështirësi modelimi ose shkakton shqetësime për përdoruesit. Në këtë aspekt është e rëndësishme të theksohet se për sisteme të caktuara reale, për shkak të kostove të larta të përfshira, kompleksitetit të lartë, maksimizimit të VAN ose minimizimit të kostove në prodhimin e një fushe naftë, kjo metodë mund të aplikohet dhe do të riprodhojë më besueshmëri të arsyeshme në realitetin e subjektit tonë.

Në këtë punim është paraqitur një skenar optimizimi (duke zgjedhur variabla vendimesh, paraqitur objektivat dhe të gjitha kufizimet), OptQuest nëpërmjet programit Crystal Ball vlerëson modelin e simulimit për grupe të ndryshme të vlerave të ndryshueshme të vendimit. OptQuest vlerëson rezultatet statistikore nga modeli i simulimit, analizon dhe i integron ato me rezultatet e rrjedhave të simulimit dhe përcakton një sërë vlerash të reja për të vlerësuar. Ky është një proces përsëritës që gjeneron vazhdimisht grupe të reja vlerash. Jo të gjitha këto vlera përmirësojnë objektivin, por me kalimin e kohës, ky proces siguron një trajektore shumë efikase për zgjidhjet më të mira. Procesi i kërkimit vazhdon derisa OptQuest të arrijë disa kriteret të përfundimit ose një limit në sasinë e kohës që i kushtohet kërkimit, ose një numri maksimal të simulimeve.

Simulimi Monte Carlo është duke u bërë teknologjia e zgjedhur për vlerësimin dhe analizimin e asetëve, qoftë ajo e derivateve financiare apo e investimeve në aktive reale. Dy nga cilësitë kryesore të simulimit janë fleksibiliteti dhe thjeshtësia. Simulimi është gjithashtu i lehtë për t'u zbatuar dhe modelet mund të ndërtohen lehtë në formate tabelare. Shumë kompani të mëdha si Wall Street, tani përdorin simulimin me metodën Monte Carlo kryesisht kur vlerësojnë asetet letrë me vlerë etj. Por simulimi Monte Carlo nuk është vetëm i dobishëm për Wall Street, por dhe për profesionistët që analizojnë probleme reale të investimeve.

Simulimi na lejon të gjenerojmë ndonjë numër parashikimesh të mundshme nga një specifikim i përgjithshëm i shpërndarjes së rrjedhës së parave. Për më tepër, ne mund të krijojmë politika të menaxhimit që përcaktojnë se çfarë duhet të ndodhë nëse çmimi p.sh., rritet (zgjerimi i kapacitetit të impiantit) ose çfarë duhet të ndodhë nëse Kërkim-Zhvillimi është i suksesshëm (hedhja në treg e një produkti të ri).

Ky punim tregon hapat që duhen ndjekur për të bërë një analizë projekti me simulim. Shumica e hapave në një analizë të tillë nuk ndryshon nga hapat që kanë një analizë të rregullt të VAN.

Së pari, krijojmë modelin e rrjedhjes parave për projektin. Në këtë hap identifikojmë të gjithë komponentët përkatës të të ardhurave dhe kostot, si dhe jetëgjatësinë e planifikimit dhe vlerën e përfundimit.

Së dyti, identifikojmë komponentët e rrjedhës së parasë që janë shumë të ndikuar nga pasiguria dhe zgjedhim modele matematikore që pasqyrojnë karakteristikat e rastit të komponentëve.

Së treti, vendosim normat e skontimit dhe metodën e zbritjes. Metoda dhe normat duhet të pasqyrojnë llojet dhe format e paqartësive.

#### **4.2 Rekomandime**

Shumica e flukseve të mjeteve monetare janë deri diku të pasigurta. Megjithatë, në përgjithësi shkalla e pasigurisë në flukset e mjeteve monetare dallojnë shumë. Për më tepër, ndikimi në fitimin e pasigurisë së flukseve të mjeteve monetare zakonisht ndryshojnë ndjeshëm. Si rregull, kur krijohet një model, është më mirë të përqendrohemi në një ose dy flukse monetare, pasiguria e të cilit ka ndikim më të madh në fitim. Pasiguri të tjera me pak ndikim në fitim gjithashtu kanë pak ndikim në vlerën e projektit. Përveç kësaj, nëse përpqimi të modelojmë në çdo minutë, gabimet do të zvarriten në mënyrë të pashmangshme, modeli do të bëhet konfuz dhe simulimi do të zgjasë më shumë se sa nevojitet.

Për shembull, në rastin e kompanisë Albpetrol, nxjerrja e një burimi natyror, është një pasuri kombëtare. Çmimi i burimeve dhe madhësia e vlerësimit (STOIP) janë zakonisht dy variabla kryesorë të pasigurt. Edhe pse rritja e pritshme e çmimit është e ulët, ne presim që kjo të ndodhë për një periudhë të shkurtër kohore. Për më tepër, ne kurrë nuk e dimë me të vërtetë se sa ka mbetur burim derisa të arrijmë deri në fund.

Pas identifikimit të komponentëve të rrjedhjes së parave të pasigurtat ne zgjedhim modele që përputhen me pasigurinë, karakteristikat e komponentëve.

Analiza e Ndjeshmërisë dhe Mjeti Tornado janë metoda të veçanta që ndihmojnë vendimmarrësit të kuptojnë se cilat nga inputet e pasigurtat (p.sh., faktori i zbritjes ose çmimi i naftës) rrisin pasigurinë në modelet e rrjedhjes së parasë.

Optimizimi na ndihmon në përcaktimin e zgjedhjeve optimale për të maksimizuar ose minimizuar qëllimet për një vendimmarrje (p.sh., maksimizimin e kthimit në një portofol të aseteve, numrin optimal të mirë

të stërvitjes) dhe kufiri efikas bën optimizimin duke përcaktuar balancën më të mirë të riskut/humbjes dhe fitimin në kompaninë Albpetrol.

Analiza duke përdorur simulimin e bazuar në pasiguritë kyçe të përzgjedhura dhe shpërndarjet e duhura çon në rezultate më të sigurta të projektit.

Shumë vendimmarrës duhet të kuptojnë se metodat probabilitare mund të japin më shumë kohë të besueshme të projektit dhe vlerësime të kostos. Metoda të tilla mund të shtojnë vlerë shtesë dhe të mundësojnë qasje proaktive ndaj riskut.

#### BIBLIOGRAFIA

- Aven, T. (2008), Risk informed decision-making and its ethical basis Published 2008 in Rel. Eng. & Sys. Safety.
- Baecher, G Christian.J. (2003), "Reliability and Statistics in Geotechnical Engineering" 1st Edition.
- Black.A. James, Champion Dean J., (1976), "Methods and issues in social research", New York, Wiley.
- Black, F. and M. S. Scholes (1973), "The Pricing of Options and Corporate Liabilities." Journal of Political Economy 81(3): faqe 637-654.
- Bradley C.P, Thomas.L A. (2000). Bayes and Empirical Bayes Methods for Data Analysis (2nd ed.).
- Buckley, A., (2000), *Multinational Finance*, 4<sup>th</sup> edition, Prentice Hall, Englang.
- Dixit, A.K. and Pindyck, R.S., (1998), The options approach to capital investment, in Rutherford, J. (editor), *Financial strategy: Adding Stakeholder Value*, Wiley, Chichester.
- Dorfman, M. S. (2007), "Introduction to Risk Management and Insurance" (9 ed.). Englewood Cliffs, N.J: Prentice Hal.
- Driels, M. R. and Shin, Y. S. (2004), *Determining the Number of Iterations for Monte Carlo Simulations of Weapon Effectiveness*. Monterey, CA: Naval Postgraduate School, faqe 4.
- Eilon, S. and Fawkes, T.R., (1973), Sampling Procedures for Risk Simulation, *Operational Research Quarterly*, 24, number. 2, faqe 241-252.
- Fishman, S.G., (2008), "Monte Carlo: concepts, algorithms, and applications". Springer-Verlag New York Berlin Heidelberg, faqe 18-26.
- Goodwin, P., and Wright G., (1991), *Decision analysis for management judgment*, John Wiley&Sons Limited, Chichester, England.
- Graf T., (2005), "Shifting the Gaussian Curve to the Right – A Fully Stochastic Approach to marginal Offshore, Field Development , SPE, EAGE.
- Grayson, C.J., (1960), *Decisions under uncertainty: oil and gas drilling decisions*, Harvard University Press, Cambridge.
- Gutleber,D.S., Heigerger, E.M., Morris, T.D., (1995), Simulation Analysis for Integrated Evaluation of Technical and Commercial Risk, *Journal of Petroleum Technology*, December, faqe 1062.

- Higson, C., (1995), *Business Finance*, 2<sup>nd</sup> Edition, Butterworths, London.
- Hull, J.C., (1977), Dealing with dependence in risk simulations, *Operational Research Quarterly*, 28 (1), faqe 201-213.
- Kahaner, D. Moler, C, Nash.S, (1989), Numerical methods and software. Prentice Hall, Englewood Cliffs, New Jersey.
- Kerlinger. F, N (1986), "Foundations of Behavioral Research" (3rd edition) New York: Holt, Rinehart & Winston.
- Kester, W.C., 1984, Today's options for tomorrow's growth, *Harvard Business Review*, March -April.
- Knight, F. H. (2012). Risk, uncertainty and profit, Courier Dover Publications.
- Mian M.A., (2002), Project Economics and Decision Analysis: Vol 1: Deterministic Models, Penwell Corp, Oklahoma, USA, faqe18.
- Mian M.A May (2011), "Project Economics and Decision Analysis", Volume 2: "Probabilistic Models" Hardcover faqe 170-186.
- Mjeda, B. (2018), *Applying Simulation for Oil and Gas Industry Case Albpetrol Company* Academic Journal of Interdisciplinary Studies, Vol7, Nr.3, ISSN 2281-3993 E-ISSN 2281-4612I, faqe 195-198, Italy.
- Mjeda, B. (2018), *Risk Analyses. System and Modeling in Oil Industry*, International Journal Of Economics, Commerce And Management Rochester, ijecm.co.uk, vol 6 issue 12 releasing on 15<sup>th</sup> 2348-0386 United Kingdom.
- Mjeda, B. (2016), *Risk management & Analyses in Oil Company*, International Journal of Science, Innovation & New Technology , Vol. 1 Issue 15, ISSN printed:223-2257, ISSN online:2225-0751 faqe 27-29. , Tirane, Shqiperi.
- Mjeda, B. (2018), *Risk modeling by using Monte carlo Method at Albpetrol Company* 5Th Academic International Conference on Law, Economics and Finance 978-1-911185-83-3, faqe 56-63, United Kingdom.
- Mjeda, B. (2018), *Uncertainty Analyses in Albpetrol Company* Faculty of Applied Informatics and Mathematics. Departament of Enomometrics and Statistics. 19Th International Conference Quantitative Methods in Economics 2082-792X e-ISSN 2543-8565, faqe 411-418, Warsaw, Poland.
- Mjeda, B. Permeti (2014), *Applications and benefits of Simulation in SME*, 5Th International Conference Information "Information Systems and Technology Innovations: projecting trends to a New Economy, ISBN: 978-1-911185-85-7, Tirane, Shqiperi.
- Moore, K. S., Cockcroft, P. J. & PRASSER, R. (1995), Applications of Risk Analysis in Petroleum Exploration and Production Operations. SPE Asia Pacific Oil and Gas Conference. Kuala Lumpur, Malaysia: 1995 Copyright 1995, Society of Petroleum Engineers, Inc
- Murtha, J.A., 1997, Monte Carlo simulation: its status and future, SPE 37932, *Journal of Petroleum Technology*, 49, faqe 361.
- Myers, S.C., (1984), Financial Theory and Financial Strategy, *Interfaces*, number 14, January - February, faqe 126-137.
- Myers, S.C, (1977), The Determinants of Corporate Borrowing, *Journal of Financial Economics*, 5, November
- Nisbett, R., and Ross, L., 1980, *Human Inference: Strategies and shortcomings of social judgement*, Prentice Hall, Englewood Cliffs, New Jersey



- Paddock, J. and Siegel, D.R., and Smith, J.L.*, (1988), Option Valuation of claims on real assets: The case of offshore petroleum leases, *The Quarterly Journal of Economics*, August, faqe 479-507
- Ritter, A, Cherry.C, Dolan B*, (2011), data driven response generation in social media faqe 583-593, Edingurgh, Scotland, UK, Association for Computational Linguistics.
- Rose, P.R.* (2009), "Dealing with Risk and uncertainty in Exploration: How can we improve?", AAPG Bulletin 71, No.1, faqe 46-62.
- Ross, D.*, (1997), *Portfolio management applied in the oil industry*, TNO internal report, NITG 97-293-B.
- Ross, S. M.* (2014), Introduction to probability and statistics for engineers and scientists, fth ed. USA: Akademic Press, Elsevier Inc.
- Sadowski, D. Sadowski R, and D. Kelton*, (1998), "Simulation with Arena", Mc Graw Hill.
- Schmid, B.* (1988). Procedure for the representation and transformation of information on complex systems (PRTI). in Schmid and Signer (1988).
- Siegel, D. R., Smith, J.L., and Paddock, J.L.*, (1987), Valuing Offshore Oil Properties with Options Pricing Models, *Midland Corporate Finance Journal* 5, fq.22-30.
- Simkins, B.* (2010), "Enterprise Risk Management: Today's Leading Research and Best Practices for Tomorrow's Executives" Hardcover
- Simpson, G.S., Lamb, F.E., Finch, J.H. and Dinnie*, (2000), "The application of probabilistic and qualitative methods to asset management decision-making", paper submitted to Journal of Petroleum Technology, faqe 59-71.
- Singh, G. and Kinagi, G.*, (1987), *Risk and reliability appraisal on Micro Computers*, Chartwell-Brat, Lund.
- Smith, J.E., and McCardle, K.*, (1997), Options in the real world: Lessons learned in oil and gas investments, Fuqua/Duke University, Working paper, April
- Suslick, S. B., Schiozer, D. & Rodriguez, M. R.* (2008), Uncertainty And Risk Analysis in Petroleum Exploration and Production. Terræ.
- Trigeorgis, L.* (1996), *Real Options: Managerial Flexibility and Strategy in Resource Allocation*, Massachusetts Inst. of Technology Press, Cambridge, Massachusett
- Tversky, A. and Kahneman, D.*, (1981), The framing of decisions and the psychology of choice, *Science*, 211, faqe 453 - 458.
- Virine, L. & Rapley, L.* (2003) Decision and Risk Analysis Tools for the Oil and Gas Industry. SPE Eastern Regional Meeting.
- Yoe, C.* (2011) "Principles of Risk Analysis: Decision Making Under Uncertainty" Hardcover faqe 421-423, 150-167.
- Whiteside, M.*, (1997), Portfolio Optimisation, *Indeva Energy Consultants*, Oxon.
- Wilmot, P., Dewynne, J., and Howison, S.*, (1994), *Option Pricing*, Financial Press, Oxford
- Fletore Zyrtare nr.231*, (2013).[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)  
<https://www.oecd-ilibrary.org/oecd/about>  
<https://www.oceg.org/about/what-is-occeg>  
<https://www.oracle.com/middleware/technologies/crystalball.html>

<http://www.akbn.gov.al/wp-content/uploads/2013/11/P%C3%ABrshkrim-i-p%C3%ABrgjithsh%C3%ABm-i-historikut-t%C3%AB-naft%C3%ABs-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri.pdf>  
[https://eiti.org/sites/default/files/documents/2016\\_albania\\_eiti\\_report.pdf](https://eiti.org/sites/default/files/documents/2016_albania_eiti_report.pdf)

## NDIKIMI I MIKROFINANCËS NË RITJEN EKONOMIKE TË SHQIPËRISË

Aurora Kinka (Pulti)<sup>1</sup>, Junida Myrtja<sup>2</sup>

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Financë - Kontabilitet  
Master shkencor në Financë*

### **ABSTRAKT**

Në të gjitha vendet, kryesisht në vendet në zhvillim, mikrofinanca po konsiderohet gjithnjë e më tepër si një sektor i rëndësishëm financiar, i cili nëpërmjet shërbimeve të veta synon të nxjerrë individët nga varfëria dhe të ndikojë pozitivisht në ekonominë e një vendi. Mikrofinanca ofron produkte financiare për individët me të ardhura të ulëta të cilët janë të përjashtuar nga institucionet bankare. Edhe në Shqipëri gjatë kohëve të fundit, ky sektor po njuh rritje në mbështetje të të gjithë atyre që nuk janë të stabilizuar mirë financiarisht e si rrjedhojë t'i bëjë ata klientë të kualifikuar në të ardhmen për sektorin bankar.

Ky punim synon të analizojë ndikimin e mikrofinancës në rritjen ekonomike të Shqipërisë, duke përdorur të dhënat vjetore nga Banka Botërore dhe Banka e Shqipërisë gjatë periudhës 2005-2020. Pas rishikimit të literaturës teorike dhe empirike mbi ndikimin e mikrofinancës në rritjen ekonomike, nëpërmjet një modeli regresioni do të identifikohet nëse ekziston një lidhje domethënëse midis mikrofinancës dhe rritjes ekonomike në Shqipëri. Rezultatet e modelit tregojnë se mikrofinanca ka një ndikim negativ në rritjen ekonomike të Shqipërisë.

---

<sup>1</sup> Diplomuar në vitin 2004 në Bachelor Financë - Kontabilitet në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe në 2008 ka marrë titullin Master Shkencor në Financë pranë Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës. Në vitin 2017 ka marrë gradën shkencore Doktor në fushën e Financës në Universitetin e Tiranës. Që nga viti 2004 është pedagoge pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe lektore e lëndëve “Bazat e financës”, “Manaxhim financiar”, “Financa e Korporatave”.

<sup>2</sup> Diplomuar në Bachelor Administrim - Biznes në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Në vitin 2022 ka marrë titullin Master Shkencor në Financë pranë Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Në përfundim të studimeve master ka zhvilluar një praktikë profesionale gjashtëmujore pranë Spitalit Rajonal Shkodër në pozicionin e ekonomistes.

**Fjalët kyçe:** institucionet financiare jobankare, sektori bankar, portofoli bruto i kredisë, mikrofinanca, rritja ekonomike

## ***ABSTRACT***

### **The impact of microfinance on the economic growth of Albania**

In all countries, mainly in developing countries, microfinance is increasingly being considered as an important financial sector that, through its services, aims to lift individuals out of poverty and positively influence the economy of a country. Microfinance offers financial products to low-income individuals who are excluded from banking institutions. Even in Albania, during recent times, this sector is growing in support of all those who are not well financially stabilized, and as a result, to make them qualified clients in the future for the banking sector. This paper aims to analyze the impact of microfinance on the economic growth of Albania, using annual data from the World Bank and the Bank of Albania during the period 2005-2020. After reviewing the theoretical and empirical literature about the impact of microfinance on economic growth, through a regression model it will be identified if there is a significant relationship between microfinance and economic growth in Albania. The results of the model show that microfinance has a negative impact on the economic growth of Albania.

**Keywords:** non-banking financial institutions, banking sector, gross loan portfolio, microfinance, economic growth.

### **I. Hyrje**

Që nga koha e krijimit, mikrofinanca ka patur rritje graduale të veprimtarisë së saj. Në vitet e fundit, ajo ka njohur rritje jo vetëm për nga madhësia (numri i institucioneve mikrofinanciare), por edhe nga rëndësia, lidhur me stabilitetin financiar në të gjithë Evropën ashtu edhe në Shqipëri. Ndërsa bankat dominojnë sistemet financiare në shumicën e vendeve, institucionet mikrofinanciare janë plotësuese të tyre, duke ofruar një gamë të gjerë produktesh financiare për të fuqizuar ekonomikisht segmentet e popullsisë me të ardhura të ulëta, gratë, të rinjtë të cilët zhvillojnë biznese të vogla apo të mesme dhe për të rritur përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen e tyre në komunitet e më gjerë. Bankat nuk i plotësojnë kërkesat e tyre për shkak të mungesës së kolateralit, shumës së vogël të kredisë e cila gjeneron

kosto të larta, riskut që paraqesin bizneset e vogla, të cilat janë më të prekurat nga të gjitha krizat. Ndaj mikrofinanca përpiqet që me shërbimet e saj të përmirësojë standardet e tyre të jetesës dhe si rrjedhojë të kontribuojë në zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendit. Mbështetur nga e gjitha e thënë më sipër u mendua e arsyeshme që punimi të fokusohet në studimin e mikrofinancës, si sektor financiar dhe impaktin që ka në rritjen ekonomike të një prej vendeve në zhvillim siç është Shqipëria.

## II. Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i këtij punimi është të tregojë se si ka evoluar mikrofinanca në Shqipëri ndër vite dhe si paraqitet ajo sot sipas numrit të institucioneve mikrofinanciare dhe shërbimeve që ofron. Gjithashtu, punimi ka qëllim të tregojë nëpërmjet një analize ekonometrike se çfarë impakti ka ajo në rritjen ekonomike të vendit, duke përdorur të dhënat sekondare.

Objektivat të cilat synohen me anë të këtij punimi janë:

- ✓ Të kuptojmë mikrofinancën dhe funksionin e saj si pjesë të sistemit financiar;
- ✓ Të analizojmë zhvillimin e mikrofinancës në Shqipëri;
- ✓ Të vlerësojmë nëpërmjet teknikave statistikore dhe ekonometrike, nëse mikrofinanca ka ndikim në rritjen ekonomike në Shqipëri, për periudhën 2005-2020;
- ✓ Të japim disa konkluzione dhe rekomandime lidhur me temën e trajtuar për rastin e Shqipërisë.

## III. Pyetja kërkimore

Ky punim do t'i japë përgjigje pyetjes së mëposhtme:

- A ka ndikim mikrofinanca në rritjen ekonomike në Shqipëri?

### ***1. MIKROFINANCA SI SEKTOR FINANCIAR DHE ROLI I SAJ NË RRITJEN EKONOMIKE***

#### **1.1. Këndvështrim i përgjithshëm mbi mikrofinancën**

Sipas Joanna Ledgerwood (1998) mikrofinanca i referohet ofrimit të shërbimeve financiare ndaj klientëve me të ardhura të ulëta, si: të vetëpunësuar, sipërmarrësit me të ardhura të ulëta në zonat urbane dhe rurale. Shërbimet që ofrohen në përgjithësi janë kursimet dhe kreditë, megjithatë ka institucione mikrofinanciare që ofrojnë shërbime të tjera financiare sigurimesh dhe pagesash. Përveç ndërmjetësimit financiar, shumë institucione mikrofinanciare ofrojnë shërbime të ndërmjetësimit

social, si: formimi i grupit, zhvillimi i vetëbesimit dhe trajnimi për edukimin financiar dhe aftësitë e menaxhimit midis anëtarëve të një grupi.

E përcaktuar nga autorja Marguerite Robinson (2001) mikrofinanca përfshin shërbimet financiare të shkallës së vogël - kryesisht kreditë dhe kursimet, të cilat u ofrohen njerëzve që punojnë në bujqësi, peshkim; operojnë në ndërmarrje të vogla ose mikrondërmarrje ku prodhohen, riciklohen, riparohen ose shiten mallrat; ofrojnë shërbime; punojnë për pagë; fitojnë të ardhura nga dhënia me qira e pjesëve të vogla të tokës, automjeteve, makinerive dhe mjeteve; dhe individëve dhe grupeve të tjera në nivelet lokale të vendeve në zhvillim, si rurale ashtu edhe urbane. Shërbimet e kursimit i lejojnë kursimtarët të ruajnë likuiditetin e tepërt për përdorim në të ardhmen dhe të marrin kthime nga investimet e tyre. Shërbimet e kreditimit mundësojnë përdorimin e të ardhurave të parashikuara për investime ose konsum aktual. Marguerite Berger (2006) e përcakton mikrofinancën si shërbime financiare kryesisht për mikrondërmarrjet: pronarët, operatorët dhe punonjësit e tyre.

Mikrondërmarrja u referohet aktiviteteve individuale ekonomike që nga tregtarët të cilët shesin në rrugë e deri tek bizneset e vogla me punonjës. Mikrondërmarrjet janë punëdhënësit dominues të të varfërve. Mikrondërmarrësit kanë disa karakteristika të njëjta me të varfërit; ata posedojnë dokumentacione të limituara lidhur me të ardhurat dhe historinë e kreditit, në përgjithësi nuk kanë akses ndaj institucioneve formale financiare dhe ata priren të jetojnë në të njëjtat zona. Marguerite Berger (2006) ka bërë dallimin midis mikrofinancës dhe mikrokredisë.

Të dy termat i referohen transaksioneve me shuma të vogla, por ajo çka i dallon është se mikrokredia lidhet vetëm me ofrimin e kredisë, kurse mikrofinanca përveç mikrokredisë ofron edhe shërbime tjera, si: mikrokursimet, transferimin e remitancave, mikrosigurimin e të tjera. Ideja e mikrofinancës nuk është dhurimi për të varfërit. Në fakt, ajo po mundëson dhe mbështet shpirtin sipërmarrës të njerëzve të varfër (Philipp M. Becker, 2010).

Ajo është një formë investimi me ndikim që sjell jo vetëm kthime financiare, por edhe sociale; një kombinim i qëndrueshëm i performancës ekonomike dhe ndikimit social (Peter Fanconi & Patrick Scheurle, 2017).

### ***1.2. Institucionet mikrofinanciare***

Institucionet mikrofinanciare janë organizata që ofrojnë shërbimet financiare të përmendura më lart ndaj njerëzve me të ardhura të ulëta të cilëve u mungon akses në burimet kryesore të financimit nga institucionet bankare. Ata mund të jenë organizata joqeveritare, kooperativa të

kursimeve dhe kredive, unionet e kreditit ose institucione financiare jobankare (Joanna Ledgerwood, 1998). Institucionet bankare rrallë i marrin përsipër këto shërbime. Ata vlerësojnë se ofrimi i tyre shoqërohet me kosto të larta, pasi njerëzit me të ardhura të ulëta nuk janë në gjendje të informojnë për aftësinë e tyre kreditore. Janë organizatat joqeveritare dhe institucionet e tjera financiare jobankare të cilat i përgjigjen kërkesave të njerëzve për kreditë e vogla (Marguerite Robinson, 2001).

### ***1.2.1. Burimet e financimit të institucioneve mikrofinanciare***

Normalisht që institucioneve mikrofinanciare i nevojiten fonde për të funksionuar dhe për të vazhduar aktivitetin e tyre në mënyrë të qëndrueshme. Ata mund t'i sigurojnë fondet e tyre nga burime të ndryshme, si:

- Grantet dhe subvencionet, veçanërisht gjatë krijimit të tyre.
- Depozitat e anëtarëve dhe të klientëve, kryesisht për institucionet e organizuara si kooperativa ose fonde të përbashkëta, si dhe banka mikrofinanciare që ofrojnë edhe produkte kursimi.
- Kapitali i tyre.
- Kreditë e dhëna nga një ose më shumë banka partnere.
- Nga investitorë publikë, që zakonisht përbëhen nga organizata dypalëshe ose shumëpalëshe, si: Banka Evropiane e Investimeve, Korporata Ndërkombëtare Financiare, Banka Gjermane për Zhvillim etj.
- Nga investitorë privatë, të cilët shërbejnë si ndërmjetës midis IMF-ve dhe investitorëve që kërkojnë një investim me përgjegjësi shoqërore (group. bnpparibas, 2016).

Fondet e grumbulluara përdoren si për mbulimin e shpenzimeve operative që lidhen me aktivitetin e institucioneve ashtu edhe për dhënien kredi ndaj njerëzve në nevojë që nuk kanë akses në banka.

### ***1.2.2. Karakteristikat kryesore të institucioneve mikrofinanciare***

Disa nga karakteristikat kryesore mikrofinanciare janë:

- Kredimarrësit janë përgjithësisht me prejardhje me të ardhura të ulëta.
- Kreditë e përfituara janë zakonisht në shuma të vogla.
- Kohëzgjatja e kredisë është e shkurtër.
- Kreditë mikrofinanciare nuk kërkojnë asnjë kolateral.
- Këto kredi zakonisht paguhën me periudha më të shpeshta.
- Qëllimi i shumicës së kredive mikrofinanciare është krijimi i të ardhurave.
- Normat e interesit të ngarkuara nga IMF-të janë zakonisht më të larta se ato të bankave tradicionale (bankbazaar.com).

### ***1.3. Roli i mikrofinancës në rritjen ekonomike të një vendi***

Studimet tregojnë se kur njerëzit marrin pjesë në sistemin financiar, ata janë në gjendje të fillojnë dhe zgjerojnë bizneset e tyre, të investojnë në arsim, të menaxhojnë dhe trajtojnë rreziqet financiare. Kjo qëndron edhe për sa i përket sektorit të mikrofinancës.

Qasja në kredi ka efekte pozitive në konsum, si dhe në mundësitë e punësimit dhe të ardhurat, dhe në disa aspekte të shëndetit mendor dhe perspektivave të së ardhmes. Qasja në llogaritë financiare, llogaritë e kursimeve, mekanizmat e pagesave dhe rritja e kursimeve, fuqizon gratë dhe rrit investimet dhe konsumin produktiv.

Përfitimet shkojnë përtej individëve, sepse një akses më i madh në shërbimet financiare për ta dhe firmat e tyre mund të ndihmojë në uljen e pabarazisë së të ardhurave dhe përsheptimin e rritjes ekonomike.

Përfshirja financiare njihet gjerësisht si e rëndësishme në uljen e varfërisë dhe arritjen e rritjes ekonomike.

## **2. MIKROFINANCA NË SHQIPËRI**

### **2.1. Zhvillimi i mikrofinancës në Shqipëri**

Në vendin tonë mikrofinanca filloi aktivitetin e saj në vitin 1992 në kohën kur ekonomia shqiptare kaloi në ekonomi e tregut të lirë pas një regjimi të frikshëm komunist për 45 vjet. Në atë kohë vështirë se kishte ndonjë sipërmarrës, fermer apo biznes, pasi i gjithë aktiviteti ekonomik ishte pronë e shtetit. Ndaj mikrofinancimi u pa si mënyra më efektive për të mbështetur një tranzicion të suksesshëm drejt vetëpunësimit dhe pronësisë private. Zhvillimi i mëpasëm i mikrofinancës në Shqipëri i atribuohet përfshirjes së Bankës Botërore si një nxitës kryesor i përfshirjes financiare të shtresave të varfra me anë të mikrokredive.

Mikrofinanca tashmë ndodhet në një fazë tjetër zhvillimi. Ajo vjen në përputhje me zhvillimet socio-ekonomike të vendit, si dhe kërkesat në rritje të tregut jo vetëm për produktet dhe shërbimet që shërbejnë për të rritur standardet e jetesës për individët dhe për të mundësuar mbështetje për mikrobizneset, por gjithashtu për të siguruar qëndrueshmëri në cilësinë e jetës dhe konsolidim të aktivitetit të biznesit lokal, veçanërisht të biznesit familjar. Duke qenë se misioni i saj social është të mbështesë më të dobët pa qasje në financa dhe pa mundësi për zhvillim financiar ajo vazhdon të punojë me edukimin e klientëve dhe të rrisë nivelin e njohurive të tyre financiare.

### **2.2. Institucionet mikrofinanciare në Shqipëri**

Institucionet që ushtrojnë veprimtarinë e mikrofinancës janë pjesë e grupit të subjekteve financiare jobankare, që mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë. Ato ushtrojnë veprimtari financiare të tilla, si: kredidhënia, mikrokredia,



faktoringu, qiraja financiare, shërbimi i pagesave dhe transfertat e parave, pagesa elektronike. Gjithashtu janë edhe kooperativat financiare ose siç quhen Shoqëri të Kursim Kreditit. Këto shoqëri krijohen mbi bazën e organizimit vullnetar të anëtarëve, të cilët depozitojnë paratë e tyre në shoqëri, për t'u përdorur prej saj për dhënie kredie vetëm anëtarëve të shoqërisë së kursim-kreditit.


### 2.2.1. Ecuria ndër vite e institucioneve mikrofinanciare dhe shërbimeve që ofrojnë

Në vitet e para numri i institucioneve financiare jobankare në Shqipëri ka qenë i vogël diku tek pesë deri në dhjetë institucione. Shërbimet që ata ofronin në përgjithësi ishin shërbime pagesash, ndërmjetësim për transaksionet financiare, kredidhënie, financim për zonat rurale, financim i ndërmarrjeve të mesme e të vogla, këshillim financiar. Në vitin 2004 u krijua institucioni i cili ofronte vetëm shërbimin e qirasë financiare. Në vitin 2008 institucionet ofronin edhe kredi konsumatore e hipotekore. Në vitin 2009 e në vazhdim ata pësuan rritje duke rezultuar në 35 institucione aktualisht.

Gjatë kësaj periudhe me rritjen e tyre janë shtuar edhe shërbimet e ofruara përveç atyre të përmendura më sipër, si: mikrokredia, faktoringu, pagesa elektronike.

Për shoqëritë e kursim- kreditit, ata kanë qenë në një numër të lartë për disa vite rresht. Gjatë vitit 2016, struktura e shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre, ndryshoi tërësisht si pasojë e procesit të konsolidimit të iniciuar në vitin paraardhës si edhe hyrjes në fuqi të ligjit “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, duke rezultuar në 16 shoqëri dhe një union “Unioni shqiptar kursim-kreditit” në vitin 2021.

**Figura 2-1. Numri i institucioneve mikrofinanciare (2000-2021)**




**Burimi:** Banka e Shqipërisë, Raportet Vjetore të Mbikëqyrjes 2000-2021.

### 2.2.2. Cilat shërbime ofrohen më shumë nga institucionet mikrofinanciare?

Në vendin tonë institucionet e mikrofinancës ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh financiare ndaj njerëzve që nuk kanë akses në banka siç u përmendën edhe më sipër.

Për sa u përket institucioneve financiare jobankare, rreth 47.7% e tyre ofrojnë shërbimin e kredidhënies (për sipërmarrje, konsum, gratë sipërmarrëse, rininë, bujqësi etj.), ndjekur nga ato që ofrojnë shërbimin e pagesave dhe transfertën e parave rreth 23.4%, ato që ofrojnë qira financiare rreth 14.6% pastaj ato që ofrojnë mikrokredi rreth 9.8%. Vetëm 0.1% e tyre ofrojnë shërbime këshilluese dhe 1.6% e tyre ofrojnë pagesa elektronike duke rezultuar kështu shërbimet më pak të ofruara në tregun tonë.

**Figura 2-2. Struktura e IFJB-ve sipas llojit të shërbimit që ofrojnë**



*Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti i Stabilitetit Financiar 2021.*

### 3. METODOLOGJIA

Për t'iu përgjigjur pyetjes kërkimore nëse mikrofinanca ka ndikim në rritjen ekonomike të Shqipërisë është ndërtuar një model empirik bazuar në burime sekondare të dhënash. Të dhënat për realizimin e modelit janë marrë nga Banka Botërore për rastin e Shqipërisë nga viti 2005 deri në vitin 2020 pra në total 16 vëzhgime. Një përzgjedhje e tillë është bërë për arsye të vështirësisë në gjetjen e të dhënave kryesisht për variablin përfaqësues të mikrofinancës për vitet para 2005.

Mbështetur nga studimet e autorëve të ndryshëm dhe teori të ndryshme, për testimin e këtij ndikimi, u ndërtua një model regresioni i shumëfishtë me

disa variabla. Variablat e përdorur në model ishin: variabli i varur produkti i brendshëm bruto - përfaqësues i rritjes ekonomike dhe variabla të pavarur, si: portofoli i kredisë bruto - përfaqësues i mikrofinancës, punësimi, importet, norma reale e interesit, norma e inflacionit, oferta e gjerë monetare.

Në këtë rast duke qenë se kemi disa variabla shpjegues forma e modelit do të jetë e përbërë nga variablat shpjegues ( $X_1, X_2, X_3, X_4, X_5, X_6$ ) dhe një variabël i varur ( $Y$ ) duke marrë trajtën e një modeli regresioni të shumëfishtë:

$$Y_i = \beta_0 + \beta_1 X_{1i} + \beta_2 X_{2i} + \beta_3 X_{3i} + \beta_4 X_{4i} + \beta_5 X_{5i} + \beta_6 X_{6i} + u_i \text{ për } i=1,2,\dots,n.$$

Ku;  $Y$ - variabël i varur = PBB-ja ( rritja ekonomike % )

$X_{1i}$ - variabli i pavarur = Portofoli Bruto i Kredisë totale (miliardë lekë)

$X_{2i}$ - variabli i pavarur = Punësimi ( % )

$X_{3i}$ - variabli i pavarur = Importet ( % e PBB-së )

$X_{4i}$ - variabli i pavarur = Norma reale e interesit ( % )  $X_{5i}$ - variabli i pavarur = Inflacioni ( % )

$X_{6i}$ - variabli i pavarur = Oferta e gjerë monetare ( % )

$u$ - termi i gabimit i cili përfshin variablat që mund ndikojnë në rritjen ekonomike, por nuk janë të përfshira në këtë model, si për shembull: eksportet, shpenzimet qeveritare, investimet e të tjera.

$\beta_0$  - tregon vlerën e  $Y$  mesatarisht kur të gjitha vlerat e variablave shpjegues janë zero.

$\beta$  - tregon ndryshimin mesatar në  $Y$  për çdo ndryshim prej një njësi në  $X$  duke mbajtur variablat tjerë shpjegues të modelit të pandryshuara.

Portofoli i kredisë bruto tregon vlerën totale të kredive të lëshuara për klientët në një kohë të caktuar. Ky tregues do të përdoret si variabël përfaqësues i mikrofinancës nisur nga studimet e mëparshme si ato të Forcim Kola & Teuta Cerpja (2018), Yousuf Sultan & Mansur Masih (2016) të cilët e kanë përzgjedhur dhe kanë vlerësuar të rëndësishëm për ndikimin pozitiv të mikrofinancës në rritjen ekonomike. Portofoli i kredisë bruto totale të institucioneve financiare jobankare në Shqipëri përfshin portofolin e subjekteve të kredidhënies, mikrokredisë, qirasë financiare dhe portofolin e subjekteve të faktoring. Ai matet me shumën e vlerës së portofolit bruto të IFJB-ve dhe vlerës së portofolit bruto të SHKK-ve në miliardë lekë.

### **3.1. Statistika përshkruese**

Statistika përshkruese është aplikuar mbi të gjitha variablat e përzgjedhur bazuar në të dhënat e marra për periudhën 2005-2020. Nëpërmjet komandës

“Summary statistics” e programit gretl paraqitet një përmbledhje e karakteristikave në terma sasiorë për secilin variabël.

**Tabela 3-1. Statistika përshkruese e variablave**

Variabli	Mesatarja	Mesorja	Devijimi standard	Minimumi	Maximimi	N
<i>Variabli i varur</i>						
Rritja e PBB-së	3.17	3.33	2.55	-3.48	7.50	16
<i>Variabli i pavarur</i>						
Portofoli bruto i kredisë totale	2.374e+010	2.426e+010	1.163e+010	4.150e+009	4.509e+010	16
<i>Variablat e kontrollit</i>						
Punësimi	48.13	47.45	2.82	43.78	53.39	16
Importet	47.54	47.38	3.97	37.25	54.95	16
Norma reale e interesit	7.82	8.26	2.08	4.40	10.21	16
Norma e inflacionit	2.26	2.16	1.00	-0.37	3.63	16
Oferta e gjerë monetare	6.99	5.91	5.17	-0.22	16.05	16

**Burimi:** Programi statistikor “gretl”, Summary statistics

Për secilin variabël janë marrë të dhënat për periudhën 2005-2020 pra gjithsej 16 vlera.

### 3.2. Analiza e regresionit (Modeli 1)

Në këtë fazë do të bëhet vlerësimi i modelit të regresionit ku për secilin variabël do të tregohet nëse ka ndikim tek rritja ekonomike dhe a është i rëndësishëm statistikisht për një nivel rëndësie të caktuar.

Nëpërmjet teknikës Metoda e Katorëve Më Të Vegjël (OLS) në programin “gretl” do të gjenerohen rezultatet e modelit të regresionit të shumëfishtë.

**Tabela 3-2. Modeli 1: Analiza OLS, vëzhgimet e marra nga 2005-2020**

Variabël i varur: **Rritja e PBB-së**

	Koeficienti	Devijimi standard	Statistika t	Vlera p	
Konstantja	-12.2565	6.82198	-1.797	0.1060	
Portofoli i kredisë bruto	-2.70326e-010	5.66760e-011	-4.770	0.0010	***
Punësimi	0.323901	0.134208	2.413	0.0390	**
Importet	0.273923	0.116129	2.359	0.0427	**
Norma reale e interesit	-0.803014	0.211203	-3.802	0.0042	***
Inflacioni	-0.0260105	0.305875	-0.08504	0.9341	
M2	-0.0618404	0.0713103	-0.8672	0.4084	

Shënim: Koeficienti është i rëndësishëm statistikisht në nivelin 0.1, 0.05, 0.01 për \*, \*\* dhe \*\*\* respektivisht.

**Burimi:** Programi statistikor “gretl”, OLS

Meqë nga kontrolli individual konkluduar se koeficientët  $\beta_5$  dhe  $\beta_6$  janë të parëndësishëm statistikisht e si rrjedhojë inflacioni dhe oferta e gjerë monetare nuk kanë ndikim në rritjen ekonomike ato mund të hiqen nga modeli. Në këtë mënyrë mbeten variablat që u vërtetuan të rëndësishëm statistikisht në shpjegueshmërinë e rritjes ekonomike.

Me heqjen e dy variablave: inflacionin dhe ofertën e gjerë monetare rezulton modeli me katër variabla të pavarur dhe një të varur.

**Tabela 3-3. Modeli 2: Analiza OLS, vëzhgimet e marra nga 2005-2020**

Variabël i varur: **Rritja e PBB-së**

	<i>Koeficienti</i>	<i>Devijimi standard</i>	<i>Statistika t</i>	<i>Vlera p</i>	
Konstantja	-12.2455	6.40766	-1.911	0.0824	*
Portofoli i kredisë bruto	-2.47576e-010	4.76063e-011	-5.200	0.0003	***
Punësimi	0.283566	0.118900	2.385	0.0362	**
Importet	0.300798	0.0989063	3.041	0.0112	**
Norma reale e interesit	-0.851401	0.193163	-4.408	0.0010	***

Shënim: Koeficienti është i rëndësishëm statistikisht në nivelin 0.1, 0.05, 0.01 për \*, \*\* dhe \*\*\* respektivisht.

**Burimi:** Programi statistikor “gretl”, OLS

Ekuacioni i vlerësuar i regresionit të shumëfishtë:

$$PBB = - 12.24 - 2.47 \text{ ptf. i kredisë} + 0.28 \text{ n. punësimi} + 0.3 \text{ importet} - 0.85 \text{ n. reale interesit}$$

$$\begin{aligned} se &= (6.408) \quad (4.761) && (0.119) && (0.099)(0.193) \\ t &= (-1.911) \quad (-5.200) && (2.385) && (3.041)(-4.408) \\ p &= (0.082) \quad (0.0003) && (0.036) && (0.011)(0.001) \\ &&&&& R^2 = 0.89 \end{aligned}$$

### ➤ Kontrolli global për koeficientin e determinacionit (modeli 2)

Për të realizuar kontrollin global duhet ndjekur procedura pesëhapëshe:

1. Përcaktimi i hipotezës

$$H_0: R^2 = 0$$

$$H_1: R^2 \neq 0.$$

2. Përcaktimi i nivelit të rëndësisë

$\alpha = 0.05$  (5%)

3. Përcaktimi i statistikës së kontrollit

Përdorim formulën  $F = \frac{R^2/k}{1-R^2/n-(k+1)}$

Për shkallë lirie df në numërues (k)

dhe në emërues  $n-(k+1)$  ku, k – numri i variablave të pavarur

4. Rregulli për marrjen e vendimit

Për  $\alpha=0.05$  dhe shkallë lirie në numërues (k)  
dhe në emërues  $n-(k+1)$

**Tabela 3-4: Modeli 2: Analiza e variancës ANOVA në termat e  $R^2$**

Burimi	df	SS	MS	F
Regresioni	4	$R^2 = 0.89$	$R^2 / k = 0.89/4 = 0.2225$	$0.2225/0.01 = 22.25$
Mbetjet	11	$1-R^2 = 1-0.89 = 0.11$	$1-R^2 / n-(k+1) = 0.11 / 11 = 0.01$	
Totali	15	1		

**Burimi:** Programi statistikor “gretl”, ANOVA

Në apendaksin G- shpërndarja e Fisherit, gjejmë vlerën kritike F

Përcaktohet rregulli: Në qoftë se vlera F e llogaritur është më e madhe se vlera kritike F, hipoteza bazë  $H_0$  hidhet poshtë dhe anasjelltas.

5. Marrja e vendimit

Në apendaksin G- shpërndarja e Fisherit gjejmë vlerën kritike F për shkallë lirie në numërues (k) = 4

dhe në emërues  $n-(k+1) = 16-5 = 11$  dhe  $\alpha = 0.05 \Rightarrow$  Vlera kritike  $F = 3.36$ .

Vlera e llogaritur  $F = \frac{R^2/k}{1-R^2/n-(k+1)} = \frac{0.89/4}{0.11/11} = \frac{0.2225}{0.01} = 22.25$ .

Duke qenë se  $F$  e llogaritur  $>$   $F$  kritike, themi se hipoteza bazë:  $R^2 = 0$  hidhet poshtë për një nivel rëndësie 5%.

Pra konkludojmë se rreth 89% e variacionit total të rritjes ekonomike arrihet të shpjegohet nga kontributi i përbashkët i variablave të pavarur: portofoli i kredisë bruto, punësimi, importet dhe norma reale e interesit.

*Interpretimi i rezultateve*

✓  $\beta_0 = -12.24 \Rightarrow$  Vlera mesatare e PBB-së është -12.24%, kur të gjithë variablat shpjegues janë zero.

✓  $\beta_1 = -2.47 \Rightarrow$  Një rritje prej 1% në portofolin bruto të kredisë sjell një rënie mesatarisht prej 2.47% të normës së PBB-së Shqipërisë, kur variablat e tjerë shpjegues mbahen konstant. Kjo tregon se portofoli i kredisë bruto

ka një ndikim negativ në rritjen ekonomike.

✓  $\beta_2 = 0.28 \Rightarrow$  Një rritje prej 1% në normën e punësimit sjell një rritje mesatarisht prej 0.28% të normës së PBB-së Shqipërisë, kur variablat e tjerë shpjegues mbahen konstant. Kjo tregon se norma e punësimit ka një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike.

✓  $\beta_3 = 0.3 \Rightarrow$  Një rritje prej 1% në importe sjell një rritje mesatarisht prej 0.3% të normës së PBB-së Shqipërisë, kur variablat e tjerë shpjegues mbahen konstant. Kjo tregon se importet kanë një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike.

✓  $\beta_4 = -0.85 \Rightarrow$  Një rritje prej 1% në normën reale të interesit sjell një rënie mesatarisht prej 0.85% të normës së PBB-së Shqipërisë, kur variablat e tjerë shpjegues mbahen konstant. Kjo tregon se norma reale e interesit ka një ndikim negativ në rritjen ekonomike.

$R^2 = 0.89 \Rightarrow$  Rreth 89% e variacionit total të rritjes ekonomike arrihet të shpjegohet nga kontributi i përbashkët i variablave të pavarur: portofoli i kredisë bruto, punësimi, importet dhe norma reale e interesit. Ndërsa pjesa tjetër rreth 11% shpjegohet nga variablat tjerë të uj që mund ndikojnë në rritjen ekonomike, por nuk janë të përfshira në model.

Nga ky model rezulton se të gjithë variablat e pavarur duke përfshirë edhe interceptin janë të rëndësishëm statistikisht për një nivel rëndësie 10%, pasi vlera e p-së për marrjen e vlerës  $t(\beta_1) = 0.0003 < \alpha = 0.1$

vlera e p-së për marrjen e vlerës  $t(\beta_2) = 0.036 < \alpha = 0.1$

vlera e p-së për marrjen e vlerës  $t(\beta_3) = 0.011 < \alpha = 0.1$

vlera e p-së për marrjen e vlerës  $t(\beta_4) = 0.001 < \alpha = 0.1$

vlera e p-së për marrjen e vlerës  $t(\beta_0) = 0.082 < \alpha = 0.1$  (për konstanten).

Duke qenë se të gjithë variablat e mësipërm dolën të rëndësishëm statistikisht me 10% nivel rëndësie si dhe koeficienti i determinacionit me 5% nivel rëndësie, modeli i dytë OLS me 89% shpjegueshmëri është modeli më i mirë i arritur.

### ***Kufizime të punimit***

Seria kohore e vogël: Në punim është përdorur një seri kohore e përbërë nga vetëm 16. Kjo kushtëzon analizën tonë dhe nuk lë shumë hapësira për zgjedhjen e metodës ekonometrike. Arsyeja ka qenë vështirësia në gjetjen e të dhënave kryesisht për variablin përfaqësues të mikrofinancës për vitet para 2005.

### **Konkluzione**

✓ Në vendin tonë mikrofinanca filloi aktivitetin e saj në vitin 1992 në kohën kur ekonomia shqiptare kaloi në ekonomi e tregut të lirë pas një regjimi të frikshëm komunist për 45 vjet. Zhvillimi i mëpasëm i mikrofinancës në Shqipëri i atribuohet përfshirjes së Bankës Botërore si një nxitës kryesor i përfshirjes financiare të shtresave të varfra me anë të mikrokredivë.

✓ Institucionet që ushtrojnë veprimtarinë e mikrofinancës janë pjesë e grupit të subjekteve financiare jobankare, që mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë. Ato ushtrojnë veprimtari financiare të tilla, si: kredidhënia, mikrokrediva, faktoringu, qiraja financiare, shërbimi i pagesave dhe transferata e parave, pagesa elektronike.

✓ Studimi i bërë më sipër shqyrtoi ndikimin e mikrofinancës në rritjen ekonomike për rastin e Shqipërisë. Ky studim u bazua në të dhënat sekondare të marra nga Banka Botërore dhe Banka e Shqipërisë për periudhën 2005-2020. Një përzgjedhje e tillë është bërë për arsye të vështirësisë në gjetjen e të dhënave kryesisht për variablin përfaqësues të mikrofinancës për vitet para 2005. Ky është një kufizim i punimit.

✓ Mbështetur nga studimet e autorëve të ndryshëm dhe teori të ndryshme, për testimin e këtij ndikimi u ndërtua një model regresioni i shumëfishtë me disa variabla. Variablat e përdorur në model ishin: variabli i varur produkti i brendshëm bruto - përfaqësues i rritjes ekonomike dhe variabla të pavarur si: portofoli i kredisë bruto-përfaqësues i mikrofinancës, punësimi, importet, norma reale e interesit, norma e inflacionit, oferta e gjerë monetare.

✓ Rezultatet treguan se mikrofinanca kishte një lidhje të fortë negative me rritjen ekonomike. Një rritje prej 1% në portofolin bruto të kredisë sjell një rënie mesatarisht prej 2.47% të normës së PBB-së Shqipërisë, kur variablat e tjerë shpjegues mbahen konstant. Kjo tregon se portofoli i kredisë bruto ka një ndikim negativ në rritjen ekonomike. E thënë ndryshe me rritjen e nivelit të portofolit të kredisë bie PBB-ja, gjithashtu importet kishin një lidhje të fortë pozitive me rritjen ekonomike duke treguar se me rritjen e nivelit të importeve rritet edhe PBB-ja. Ndërkohë variablat tjerë të pavarur kishin një lidhje të dobët me rritjen ekonomike.



## REKOMANDIME

✓ Duke qenë se institucionet mikrofinanciare në Shqipëri dallohen për normat e larta të interesit që aplikojnë në kredihënje do të ishte mirë nëse do të vendosej një ligj i cili do të lejonte mbledhjen e depozitave nga ana e tyre. Mbledhja e depozitave do i ndihmonte ata të siguronin fonde duke ulur kështu kostot për sigurimin e tyre nga burime të tjera. Kostot më të ulëta do të ndikonin në norma më të ulëta interesi.

✓ Institucionet mikrofinanciare janë shprehur se nuk kanë buxhete të mëdha dhe mbështetje për të zbatuar edukimin financiar ndaj klientëve të tyre dhe publikut. Një rekomandim do të ishte që institucionet shtetërore si Ministria e Financave t'i ofrojnë mbështetje në këtë aspekt në mënyrë që klientët dhe publiku të njihen me produktet financiare që ofrohen, karakteristikat e tyre. Kjo do të nxiste përfshirjen financiare të tyre tek mikrofinanca.

✓ Gjithashtu mikrofinanca duhet marrë në konsideratë gjithnjë e më shumë si një pjesë e rëndësishme dhe bashkëfinancuese në projektet zhvillimore që ndërmerr qeveria shqiptare, si: për turizmin, bujqësinë e tjera duke dhënë kështu një kontribut të madh për vendin dhe ekonominë si dhe duke krijuar një imazh të mirë para publikut.

## BIBLIOGRAFIA

1. Becker, P. (2010). Investing in Microfinance: Integrating New Asset Classes into an Asset Allocation Framework Applying Scenario Methodology, Switzerland, fq.51-52.
2. Berger, M. (2006). An Inside View of Latin American Microfinance NW, Washington, D.C. 20577, fq.3-4.
3. Durlauf, S., & Blume, L. (2010). Economic Growth, USA, fq.38.
4. Fanconi, P., & Scheurle, P. (2017). Small Money – Big Impact Fighting Poverty with Microfinance, United Kingdom, fq.12-15.
5. Helpman, E. (2004). The mystery of economic growth, USA, fq. 3-4.
6. Hess, P. (2013). Economic Growth and Sustainable Development, New York, fq.3.
7. Ledgerwood, J. (1998). Microfinance Handbook: An Institutional and Financial
8. Perspective (Sustainable Banking With the Poor), Washington, D.C. 20433, U.S.A. (evolucion), fq.1-2.

9. Robinson, M. (2001). *The Microfinance Revolution: Sustainable Finance for the Poor* NW, Washington, D.C. 20433 USA, fq.9-10.

## REFERENCAT

1. Adonsou & Sylwester. (2015). *Macroeconomic Effects of Microfinance: Evidence from Developing Countries*. file:///C:/Users/User/Downloads/Donou-AdonsouandSylwester\_2015\_JE%20(1).pdf
2. AMA, Anëtarësia. <http://ama.com.al/anetaresia/>
3. AMA\_Raporti\_Vjetor\_2019\_shqip. [http://ama.com.al/wp-content/uploads/2020/10/AMA\\_Raporti\\_Vjetor\\_2019\\_shqip.pdf](http://ama.com.al/wp-content/uploads/2020/10/AMA_Raporti_Vjetor_2019_shqip.pdf)
4. Alimukhamedova, N. (2013). *Contribution of microfinance to economic growth: Transmission channel and the ways to test it*. file:///C:/Users/User/Downloads/201607060805\_04\_BEH\_Vol9\_Issue4\_2013\_Ali mukhamedova\_Contribution\_mic rofinance\_economic\_growth\_pp.27-43%20(6).pdf
5. Aziz., & McConaghy. (2014). *Promoting financial inclusion for growth and development in Iraq*. <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/18154/875490BRI0QN110VC000knowledge0notes.pdf?sequence=1&isAllowed=y>
6. Banka e Shqipërisë, Raporti i Stabilitetit Financiar 2021. [https://www.bankofalbania.org/rc/doc/RSF\\_6M1\\_2021\\_web\\_19576.pdf](https://www.bankofalbania.org/rc/doc/RSF_6M1_2021_web_19576.pdf)
7. Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes 2005-2021. [https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime\\_Periodike/Raporti\\_Vjetor\\_i\\_Mbikeqyrjes/](https://www.bankofalbania.org/Botime/Botime_Periodike/Raporti_Vjetor_i_Mbikeqyrjes/)
8. Cornwall, J. - *Economic growth* Halifax, Canada. <https://www.britannica.com/contributor/John-L-Cornwall/621>
9. *Effect of raising interest rates 2021*. <https://www.economicshelp.org/macroeconomics/monetary-policy/effect-raising-interest-rates/>
10. G.L. Sharma., & Puri, H. (2013). *An empirical testing of relationship between microfinance and economic growth in India*.
11. *Historiku i mikrofinancës në Shqipëri*. <http://ama.com.al/rreth-nesh/>
12. *How does an MFI work?* (2016). <https://group.bnpparibas/en/news/mfi-work>
13. Hucheson, G. D. (2011). *Ordinary Least-Squares Regression*. [https://datajobs.com/data-science-repo/OLS-Regression-\[GD-Hutcheson\].pdf](https://datajobs.com/data-science-repo/OLS-Regression-[GD-Hutcheson].pdf)
14. *Key Principles of Microfinance* CGAP, (2004).

- <https://www.cgap.org/sites/default/files/CGAP-Consensus-Guidelines-Key-Principles-of-Microfinance-Jan-2004.pdf>
15. Khalaf, L., & Saqfalhait, N. (2019). The Effect of Microfinance Institutions Activities on Economic Growth in Arab Countries, Jordani.  
<https://www.abacademies.org/articles/the-effect-of-microfinance-institutions-activities-on-economic-growth-in-arab-countries-7819.html>
  16. Kola, F., & Cerpja, T. (2018). Microfinance and economic growth in ALBANIA: An ARDL Approach.
  17. Londoño, D., & Garzón, C., & MaríaCollazos. (2020). The effect of microcredit on Colombia's GDP.  
<http://www.scielo.org.mx/pdf/prode/v52n204/0301-7036-prode-52-204-3-en.pdf>
  18. Loomba, Sh. (2014). Role of microfinance in women empowerment in INDIA.  
<https://jaipuria.edu.in/pgdm/wp-content/uploads/2013/07/Role-of-microfinance-in-women-empowerment-in-india.pdf>
  19. Microfinance Barometer, (2019).  
[http://www.convergences.org/wp-content/uploads/2019/09/Microfinance-Barometer-2019\\_web-1.pdf](http://www.convergences.org/wp-content/uploads/2019/09/Microfinance-Barometer-2019_web-1.pdf)
  20. Microfinance in India. <https://www.bankbazaar.com/personal-loan/microfinance.html>
  21. Microfinance Institutions, (2019). <https://strategicglobalcapital.com/micro-finance-institutions/>
  22. Muharremi, O., & Luçi, E., & Madani, F., & Pelari, E. (2018). "Evaluating the impact of microfinance at the individual level in Albania, particularly in the region of Vlora and Fier".  
<https://j.ideasspread.org/index.php/jems/article/view/59/34>
  23. Nakity, R., & Rana, F. (2021). Impact of microfinance in alleviating poverty in MENA countries.  
<https://archives.palarch.nl/index.php/jae/article/view/8097/7566>
  24. Oli, S. (2018). Impact of microfinance institutions on economic growth of Nepal. <https://sci-hub.se/https://doi.org/10.18488/journal.8.2018.62.98.109>
  25. Sultan, Y., & Masih, M. (2016). Does microfinance affect economic growth? Evidence from Bangladesh based on ARDL approach.  
[https://mpa.ub.uni-muenchen.de/72123/1/MPRA\\_paper\\_72123.pdf](https://mpa.ub.uni-muenchen.de/72123/1/MPRA_paper_72123.pdf)
  26. Wachukwu IP., & Onyema JI., & Amadi, SN. (2018). Microfinance banking and economic growth of Nigeria.  
[https://www.researchgate.net/profile/Princewill-Wachukwu/publication/334671239\\_microfinance-banking-and-economic-growth-of-nigeria/links/5d39679e92851cd046844b5f/microfinance-banking-](https://www.researchgate.net/profile/Princewill-Wachukwu/publication/334671239_microfinance-banking-and-economic-growth-of-nigeria/links/5d39679e92851cd046844b5f/microfinance-banking-)

and-economic-growth-of- nigeria.pdf

27. Wajeetongratana, P. (2020). Economic growth and its key factors: an alternative view on the factors stimulating agriculture growth, Thailand. [https://www.e3s-conferences.org/articles/e3sconf/pdf/2020/35/e3sconf\\_interagromash2020\\_13028.pdf](https://www.e3s-conferences.org/articles/e3sconf/pdf/2020/35/e3sconf_interagromash2020_13028.pdf)

## KËRKESA PËR MARKETUES DHE TRENDET MË TË REJA TË PUNËSIMIT NË KËTË INDUSTRI

Rudin Beka<sup>1</sup>, Romina Dhora<sup>2</sup>, Ormela Lika<sup>3</sup>

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Turizmit  
Eksperte e Marketingut Ndërkombëtar pranë kompanisë Relikaj*

### ABSTRAKT

**Qëllimi i punimit.** Studimi lidhet me nevojën që kanë sot studentët të orientohen për tregun e punës dhe mundësitë që u propozohen atyre për të avancuar në karrierë. Është marrë në studim, fusha e marketingut inovativ dhe janë analizuar trendet më të reja të punësimit në këtë industri.

**Dizenjimi/metodologjia/aplikimi.** Ky është një studim përshkrues diskriptiv, me intervista në terren si kërkim primar dhe rishikim të trendeve më të reja që kërkohen sot për punësim në industrinë e marketingut, si kërkim sekondar dhe që mbështet orientimin e studentëve.

**Gjetjet.** Një pjesë e mirë e termave, strategjive dhe mundësive për punësim që ishin para jo më larg se 10 viteve në marketing, sot nuk vlejnë më në ato dimensione. Nevoja për punësim në marketingun inovativ dhe atë digjital

---

<sup>1</sup> Dr. Rudin Beka është lektor pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” në qytetin e Shkodrës, Fakulteti Ekonomik. Lëndët e mësimi që ai jep janë Marketing Shërbimesh, Komunikim i Integruar dhe Menaxhim Evenimentesh. Ai zotëron një doktoraturë në dizajnin ambiental dhe interesat kryesore të kërkimit fokusohen rreth fushës së impresionizmit të produktit, inovacionit në turizëm dhe simbolika e markës. Ka eksperiencë të ndryshme ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, është ideator startupesh si dhe ka punuar për disa vite si konsulent marketingu për industrinë e turizmit dhe atë të ushqimit.

<sup>2</sup> Romina Dhora (Bushati) është pedagoge në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” që nga viti 2006 e në vazhdim. Ajo përfundoi studimet master në marketing në Universitetin e Tiranës në vitin 2009 dhe doktoraturën në fushën e marketingut në Universitetin e Durrësit “Aleksandër Moisiu” në 2016-ën.

Romina jep mësim në departamentin e Turizmit dhe është titullare e disa lëndëve si: Turizëm kulturor, Turizëm gastronomik, Drejtëm cilësia dhe shërbimesh në Turizëm dhe manaxhim ushqimi dhe pijesh, lëndë të cilat ofrohen në nivel bachelor dhe në nivel master shkencor dhe master profesional.

<sup>3</sup> Eksperte e Marketingut Ndërkombëtar pranë kompanisë Relikaj.

është në rritje dhe një pjesë e mirë e bizneseve në Shkodër e konfirmojnë atë.

**Implikimet praktike (nëse janë të aplikueshme)** - Ky është një studim me një trajtë praktike dhe bazohet në kërkesat aktuale të tregut për punësim në marketing, duke përfshirë mundësitë e pagesave, pozicionet që kërkohen dhe mundësitë për vetëpunësim

**Cila është vlera/originaliteti i punimit?** - Është ndër punimet e para mbi nevojën për punësim në industrinë e marketingut inovativ në Shqipëri, dhe do i shërbejë studentëve dhe të interesuarve të tjerë për të kuptuar nevojat e tregut dhe të ardhmen e punësimit në fushën e marketingut

**Fjalët kryesore (kyçe):** punësimi, marketingu inovativ, marketingu digjital, trendet e marketingut

### **Demand for marketers and newest employment trends in this industry**

#### ***ABSTRACT***

**Objective** – The study aims to help students and other job applicants to better understand the demand for marketers in the today job market

**Methodology** – This is a descriptive study, focusing on interviews as primary research, followed by literature review and trend analyses as second research.

**Findings** – It was interesting to recognise the current market needs for innovative marketers, which seems much different from what used to be.

The marketing terms, the strategies and vacancies in marketing applied 10 years ago, can barely be applied today. The results of the study shows that there is an increased demand for workers in the marketing field in Shkodra businesses.

**Practical Application** – The subject of the study is very practical oriented and is based on current market needs for marketers, including payments terms offered, positions and the right education necessary to pursue a career in the future marketing industry.

**Originality** – It is one the first studies, covering the field of marketer's job market in Albania and will serve to students and other interested parties, to better position their self within the innovative marketing industry of the future

**Keywords** - job market, innovative marketing, digital and marketing trends.

## **1. Hyrje**

Marketingu sot futet në industritë më dinamike, e cila sa vjen e më shumë i përshtatet shijeve individuale të klientëve. Konsumatori në vitet e fundit ka kaluar ndryshime të mëdha në stilin e jetës dhe mënyrën e blerjes. Në të njëjtën situatë janë përfshirë dhe bizneset, duke përshtatur strategjitë e komunikimit dhe shitjes në bazë të preferencave të blerësve.

Strategjitë marketing të përdorura jo më larg se para 10 viteve, sot mund të quhen të pasuksesshme dhe jokoherente me trendet dhe zhvillimin e ekonomisë. Duke u nisur nga këto ndryshime rrënjësore si në procesin e blerjes, ashtu dhe në atë të marketimit, është shumë e rëndësishme që të kuptohen kërkesat e tregut dhe nevoja për punësim në këtë industri. Studimi në fjalë, analizon nevojat që ka sot tregu i punës në aspektin ndërkombëtar ashtu dhe në atë lokal. E nisim me ndërkombëtar, sepse shumë të rinj mbasi diplomohen apo dhe gjatë studimeve, mund të punojnë online për kompani të ndryshme marketing në botë nëse kanë aftësitë e duhura. Janë të shumta kompanië që kërkojnë punonjës të pavarur për fushën e dizajnit të kontentit, fotografisë së produkteve, krijimit të videove apo ekspertë të brendimeve. Nga ana tjetër, studimi ndalet në kërkesën e bizneseve të qytetit të Shkodrës, duke intervistuar pronarë dhe menaxherë mbi nevojat që ata kanë për punonjës në marketingun inovativ. Një pjesë e mirë e bizneseve, kanë shumë dëshirë të përdorin metoda të reja të komunikimit me audiencën e tyre, por mungojnë burimet njerëzore dhe planifikimi i planeve marketing. Ky studim kërkon të ndalet në dy pyetjet e mëposhtme kërkimore:


- Cilat janë pozicionet më të kërkura në tregun ndërkombëtar dhe atë lokal për marketingun inovativ?
- A kanë nevojë bizneset e qytetit të Shkodrës për ekspertë marketingu dhe nëse po, sa do i paguanin?

## **2. Inovacioni në Marketing dhe Impakti në Tregun e Punës**

Mbas periudhës së COVID 19 dhe luftës në Ukrainë që pasoi me rritjen e çmimeve, kompanitë po e kanë më të vështirë të mbajnë klientët dhe të konkurrojnë në tregje ku sa vjen e më shumë konsumatori ka mundësi të ndryshme zgjedhjeje. Marketingu në këtë aspekt, po luan një rol të rëndësishëm dhe kompanitë janë vazhdimisht në kërkim të strategjive inovative të marketingut, për të kapur vëmendjen dhe ndikuar në procesin e blerjes së konsumatorit. Por si lindi marketingu dhe si kaluam tek marketing inovativ? Koncepti i marketingut daton rreth viteve 1900, ku

tekste të ndryshme filluan të shkruanin për institucione dhe biznese të cilat ofronin produkte për shitje (Edward et., al, 2020). Ishte viti 1967 kur filloi dhe periudha e marketingut modern, me Philip Kotler, kur nxori në treg librin “Menaxhimi i Marketingut”, një përmbledhje e koncepteve ekonomike, shkencës psikologjike dhe asaj të matematikës duke nxjerrë në pah nevojën e konsumatorit. Pesë dekada mbas publikimit të këtij libri, industria e marketingut ka ndryshuar rrënjësisht. Inteligjenca artificiale, të dhënat elektronike dhe interneti, po luajnë rolin kryesor në suksesin e aktiviteteve marketing (Rust, 2020). Nga ana tjetër marketingu inovativ, po shihet si promotori më i rëndësishëm në nxitjen e biznesit dhe orientimin drejt konsumatorit. Ai lidhet me implementimin e praktikave të reja marketing duke ndryshuar dizajnin, paketimin, shpërndarjen, komunikimin dhe mënyrën e shërbimit (Oslo, 2005).

**Figura 1-1 Marketingu Inovativ**



**Burimi:** Purchase, Sh & Volery, Th, 2020

Ducker, 1954 përmend konceptin që inovacioni dhe marketingu japin rezultate, departamentet e tjera janë kosto.



O’Cass, & Carlson, 2012, theksojnë që marketingu inovativ është aftësia që ka kompania për të gjetur zgjidhje të reja që plotësojnë kërkesat aktuale dhe të ardhmes së konsumatorit.


Fentes et. Al (2017), ndalen tek inovacioni marketing duke theksuar rëndësinë e teknikave të reja të shitjes. Kemi studimin e Yenyurt et al. (2014), të cilët theksojnë rëndësinë e komunikimit dhe promocionit në marketingun inovativ. Një koncept më të përmbledhur ka studimi i Purchase et al. (2020), i dhënë në figurën më sipër.

Ata kanë nxjerrë si bazë të marketingut inovativ pesë shtylla kryesore, atë të promocionit digjital, dizajnin e ekperiencës, çmimet kreative, simbolikën e markës dhe personalizimin e shpërndarjes. Këta sektorë marrin dhe vëmendjen më të madhe në kërkesën për punësim, ku pjesa me e madhe e kompanive sot janë në kërkim të vazhdueshëm për talente që kanë edukimin dhe eksperiencën e duhur për marketingun e së ardhmes.

### ***1.Pozicionet më të Kërkura në Marketingun Inovativ***

Duke parë trendet që po ndodhin në industrinë e marketingut dhe mënyrës se si konsumatori po ndryshon stil jete, duhet të studiohen vazhdimisht të rejtat e tregut të punës dhe cilat pozicione po kërkohen më shumë, në mënyrë që studentët dhe aplikuesit për punë të jenë sa më të përgatitur.

***Tabela 1-2 Aftësitë e Duhura për Marketuesit e së Ardhmes***



**Burimi:** O’Brien, 2022

Janë analizuar publikimet e organizatave më të njohura të fushës së marketingut, të cilat tregojnë faktin që edukimi në industrinë e marketingut duhet të ndryshojë dhe t'i përshtatet nevojave të tregut. AMA (American Marketing Organization) thekson që 70% marketuesave në USA, hasin vështirësi për të gjetur punonjës me aftësi të marketingut digjital (AMA, 2022). Digital Marketing Institute shkruan që po rritet numri i marketuesave NOMAD (që punojnë në lëvizje) dhe 20% e profesionistëve mendojnë të lënë punën me kohë të plotë dhe të vetëpunësohen duke marrë përsipër projekte të ndryshme në të njëjtën kohë (freelancer). Gjithashtu ky institucion ka kryer një studim duke intervistuar mbi 500 drejtues marketingu në botë, mbi aftësitë që duhet të kenë marketuesit për pesë vitet e ardhshme dhe më sipër në Tabelën 1-2, paraqitet përmbledhja me renditjen sipas rëndësisë (O'Brien, 2022). Studimet e Deloitte dhe LinkedIn Business tregojnë trendin gjithmonë e më në rritje për profesionistë të marketingut modern, ku vetëm për vitin 2022 janë postuar mbi 348,000 kërkesa për punë, ku pjesa më e madhe e tyre janë me fokus në marketingun digjital (LinkedIn, 2022). Por nga ana tjetër Seetharaman (Digital Marketing Institute, 2022), shefi ekzekutiv i The Economist Group, thekson se vetëm teknologjia nuk është e ardhmja e artë e marketingut modern, por kombinimi i gjithë elementëve kreativ, bashkë me talentin e punonjësve duhet të jetë fokusi i kompanive për vitet në vazhdim.

Duke u nisur nga kërkesat më të fundit në tregjet ndërkombëtare, pozicionet më të kërkura në marketing janë ato me bazë kreativitetin, teknologjinë dhe brendimin. Punësimi është i ndarë përgjithësisht në dy sektorë, ata që punojnë për një kompani dhe pjesa tjetër që punojnë të pavarur që kontraktohen për punë të caktuara. Profesionet më të kërkura sipas Indeed (2022) janë ato të *Influencerave Marketing*, të cilët ndalen të njerëz me influencë dhe që kanë ndjekës të shumtë online, duke shpjeguar për të mirat e produktit (Ozuem & Willis, 2022); *Krijues Videosh* për marketingun e reklamave dhe rritjen e prezencës në Youtube (Stieler, 2016); *Krijues Kontenti Marketing* të cilët përzgjedhin mesazhin dhe përmbajtjen e duhur për fushatat promovionale (Schulkind, 2022), *Specialist SEO* (search engine optimization) i cili ndihmon markat të renditen më lart në kërkimet e motorëve kërkues (Ni & Shin, 2013); *Menaxher i Mediave Sociale*, përgjegjës për krijimin dhe menaxhimin e prezencës në mediat sociale të kompanisë (Ozuem & Willis, 2022); *Copywriter*, personi përgjegjës për shkrimet dhe daljet para mediave (Wungu, Matulessy & Suryanto, 2019); *Drejtues Artistik Marketingu* i cili merret me dizajnin e ambienteve ku shërbehet produkti dhe orienton markën drejt rritjes së imazhit; *Specialist per Marketingun e Emailave*, që

krijon strategjitë e komunikimit në e-maile; *Specialist dhe Drejtues Digjital* që merret me gjithë prezencën e markës në web, duke u ndalur në analizimin e të dhënave online (Schulkind, 2022); *Grafik Dizajn* lidhet me dizajnimin e reklamave, brendimin dhe paketimet. *Dizajn Industrial*, ku fokusohen në krijimin e produkteve duke u ndalur tek forma, funksionaliteti dhe estetika e të mirës fizike (Vere, Dim & Sheahan, 2022).

Këto janë pozicionet më të kërkuara në industrinë globale të marketingut inovativ sot, që mund t'u shërbejë studentëve për të kuptuar se ku duhet që ata të fokusohen në edukime nëse kërkojnë të marrin projekte që mund t'i kryejnë nga shtëpia, siç është rasti i freelancerave digjital.

Më poshtë do të ndalemi tek tregu lokal duke analizuar më nga afër pozicionet që kërkohen dhe pagesat që bizneset janë të gatshme të bëjnë, duke dhënë një ide më të qartë mbi punësimin direkt në qytetin e Shkodrës.

## 2. Kërkesa për Marketues në Shkodër

Nga studimi në terren dhe takimi me bizneset e qytetit doli në pah nevoja për marketues në pozicione të ndryshme, ku pothuajse çdo biznes që është kontaktuar kishtë nevojë për ekspertë marketingu dhe pozicioni i marketuesit digjital ishte më i kërkuari. Janë intervistuar rreth 25 biznese dhe organizata të fushave të ndryshme në qytetin e Shkodrës, duke përfshirë biznese nga hoteleria, restorantëria, ai i pastiçerive, biznese të prodhimit, të artit dhe duke përfunduar me biznese të madhe dhe ato të eksportit. Pyetjet kryesore u ndalën në nevojën për marketues nëse ata kanë, nëse po, në çfarë pozicioni dhe sa do ishin të gatshëm të paguanin për atë pozicion. Më poshtë paraqitet tabela e përmbledhur me bizneset e intervistuar dhe kërkesat që ato kanë për marketues.

**Tabela 1-2 Kërkesa e Tregut në Qytetin e Shkodrës për Marketues**

Bizneset	Industria	Pozicionit që kërkohet	Pagesa në lekë/muaj	Orë pune në ditë
Cliche	Bar & Restorant	Krijues kontenti & menaxher rrjetesh sociale	50,000-100,000 lekë	4 orë

Rozafa	Hoteleri	Menaxher Marketingu	25,000	2
Floja	Pastiçeri	Marketing digjital	40,000	4
Hotel Coloseu	Restorant	Marketing digjital	35,000	4
Becks	Restorant	Menaxher rrjetesh sociale	20,000	4
Yellow.fit	Kompani Çaji	Krijues kontenti	40,000	3
B7 Zogaj	Restorant-Hoteleri	Menaxhim instagami	15,000	2
Kantina Miqësia	Prodhues Vere	Menaxhim shitjeje	60,000	8
Rosegarden	Hoteleri	Marketing digjital	15,000	2
Mist	Lounge	Menaxhim instagami	5,000	1
TD-Architecture	Arkitekture	Brandim	15,000	1
Inident	Klinikë dentare	Marketing digjital	15,000	1

Funksionet kryesore që kërkoheshin ishin ato të marketingut digjital, krijues të kontentit për reklamim dhe ato të menaxhimit të rrjeteve sociale. Por dhe funksionet si ato të shitjes apo brendimit ishin gjithashtu me interes. Bizneset e tjera të intervistuar, qe nuk kishin nevojë për marketues, kishin kërkesa të tjera ku dominonte ajo për punësim me fokus të arsimuarit profesionalë. Vlen të përmendet fakti që pagesat në fushën e marketingut janë 30% më të larta se pagesa mesatare në Shqipëri (INSTAT, 2022), duke e bërë këtë sektor me shumë interes për të kualifikuarit. Kjo e dhënë doli në pah nga përgjigjet që bizneset dhanë mbi gatishmërinë që ata kishin për pagesat. Gjithashtu ishte interesante të kuptohej që oferta në këtë sektor ishte shumë e limitur dhe të intervistuarit hasnin shumë probleme për të gjetur punonjës të kualifikuar për ato pozicione.

Orët e punës gjithashtu ishin ndryshe në krahasim me pozicionet e tjera, ku pjesa më e madhe e menaxherëve kërkonin punonjës me kohë të pjesshme, sidomos për rolin e menaxhimit të marketingut digjital.

### **3. Konkluzione**

Marketingu po ndryshon me ritme të shpejta si rezultat i sjelljes konsumatore dhe digjitalizimit. Në këtë drejtim, lind nevoja për studime të detajuara të kërkesave që ka tregu për marketues. Studimi në fjalë, analizoi nevojat që ka sot tregu i punës në aspektin ndërkombëtar dhe në atë rajonal duke u ndalur në qytetin e Shkodrës. Vendet kryesore që kërkoheshin në marketingun inovativ në vende të ndryshme të botës ndaleshin në dizajnin e kontetit, imazhin fotografik të produkteve, krijimin e videove të reklamave, marketingun digjital, influencerat, ekspertët e kontetit, si dhe kishte një kërkesë të madhe për profesionistë të markave me fokus dizajnin e ekperiencës. Nga ana tjetër, studimi u ndal dhe në kërkesën e bizneseve të qytetit të Shkodrës, duke intervistuar pronarë dhe menaxherë mbi nevojat që ata kanë për punonjës në sektorin e marketingut. Nga intervistat e ndryshme u arrit në konkluzionin se biznesi ka nevojë për ekspertë marketingu, ku shumica e pozicioneve ishin me fokus në marketingun digjital. Bizneset hasnin vështirësi të gjenin punonjës të kualifikuar në këtë fushë si dhe ishin të gatshëm të paguanin 30% më shumë se mesatarja e pagave në Shqipëri për punësime me kohë të pjesshme në këtë pozicion. Rekomandohet që edukimi dhe orientimi i studentëve për këtë industri është shumë i rëndësishëm. Hapja e programeve të reja apo krijimi i trajnimeve të vazhdueshme për marketingun digjital dhe atë inovativ do të ishin një mundësi e mirë, duke ndikuar jo vetëm në karrierën e studentëve, por dhe në suksesin e bizneseve që sa vjen e më shumë janë në nevojë për personel të kualifikuar.

Studimi ka limitet e veta, ku do të ishte me interes të zgjerohej mostra e studimit dhe me qytetet e tjera, duke u ndalur në Tiranë dhe qytetet e afërta të rajonit.

### **BIBLIOGRAFIA**

- Ama, <https://www.ama.org/marketing-news/the-market-for-marketers-hiring-and-salary-trends/>, gjetur në 12/2022.
- Deloitte, 2022 Global Marketing Trends, Deloitte Development LLC, 2022. <https://www.indeed.com/?from=gnav-homepage>, gjetur në 12/2022.
- Digital Marketing Institute, <https://digitalmarketinginstitute.com/blog/what-are-the-most-important-digital-skills-and-job-trends>, gjetur në 12/2022.
- Edwards, C, Bendickson, J. S, Baker, B. L, Solomon, Sh, Entrepreneurship within the history of marketing, Journal of Business Research, 2020.
- Fuentes-Blasco, M., Moliner-Velázquez, B., Servera-Francés, D., & Gil-Saura, I. (2017). Role of marketing and technological innovation on store equity, satisfaction and word-of-mouth in retailing. Journal of Product & Brand Management, 26(6), 650–666.

- INSTAT, Statistikat e Pagave, Insituti i Statistikave, Tremujori I, Mars, 2022 Oslo. M, "Guidelines for collecting and interpreting innovation data (3rd ed.). OECD Publishing, 2005.
- O’Cass, A., & Carlson, J. (2012). An e-retailing assessment of perceived website-service innovative- ness: Implications for website quality evaluations, trust, loyalty and word of mouth. *Australasian Marketing Journal*, 20(1), 28–36.
- Ozuem, W. Willis, M, *Influencer Marketing, Digital Marketing Strategies for Value Co-creation, Models and Approaches for Online Brand Communities*, Palgrave Macmillan, 2022.
- Rust. T. R, *The Future of Markerting*, *International Journal of Research in Marketing*, Volume 37, Issue 1, March 2020, Pages 15-26.
- Sharon Purchase Thierry Volery, *Marketing innovation: a systematic review*, *Journal of marketing management*, 2020, vol. 36, nos. 9–10, 763–793.
- Stieler, M, *Creating Marketing Magic and Innovative Future Marketing Trends*, *Proceedings of the 2016 Academy of Marketing Science (AMS) Annual Conference*, 2016 Schulkind, A, *Marketing for Small B2B Businesses: How Content Creates Marketing Muscle and Powers Traditional and Digital Marketing*, Apress; 1st ed. Edition, 2022.
- Ni, R. Shin, Sh, Y. *Network Marketing Strategy Analysis Based on SEO Applied Mechanics and Materials*, 2013.
- Vere. I. D, Sheahan. J, Dim, W, *Towards Re-imagining Industrial Design Education for the Contemporary Period*, *International Conference on Engineering and Product Design Education*, London South Bank University, 2022.
- Wungu, K.M, Matulesy. A, Suryanto.p, *Psychological Dynamics in the Creative Process of Copywriters inthe making of Advertisements*, *International Summit on Science Technology and Humanity (ISETH2019)*.

**RËNDËSIA E STUDIMEVE NË PROGRAMET  
MARKETING SIPAS PERCEPTIMIT TË STUDENTËVE.  
NJË STUDIM EMPIRIK RRETH FAKTORËVE QË  
NDIKOJNË NË ZGJEDHJEN E TYRE**

Romina Dhora<sup>1</sup>, Rudin Beka<sup>2</sup>, Alkida Hasaj<sup>3</sup>

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Turizmit*

**ABSTRAKT**

**Qëllimi i punimit.** Ky studim fokusohet në rëndësinë e programeve të edukimit në marketing për përgatitjen e karrierës dhe avancimin në punë, sipas perceptimit të studentëve dhe faktorëve që ndikojnë mbi zgjedhjen e profilit të studimeve.

---

<sup>1</sup> Romina Dhora (Bushati) është pedagoge në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” që nga viti 2006 e në vazhdim. Ajo përfundoi studimet master në marketing në Universitetin e Tiranës në vitin 2009 dhe doktoraturën në fushën e marketingut në Universitetin e Durrësit “Aleksandër Moisiu” në 2016-ën.

Romina jep mësim në departamentin e Turizmit dhe është titullare e disa lëndëve si: Turizëm kulturor, Turizëm gastronomik, Drejtim cilësie dhe shërbimesh në Turizëm dhe manaxhim ushqimi dhe pijesh, lëndë të cilat ofrohen në nivel bachelor dhe në nivel master shkencor dhe master professional.

<sup>2</sup> Dr. Rudin Beka është lektor pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” në qytetin e Shkodrës, Fakulteti Ekonomik. Lëndët e mësimi që ai jep janë Marketing Shërbimesh, Komunikim i Integruar dhe Menaxhim Evenimentesh. Ai zotëron një doktoraturë në dizajnin ambiental dhe interesat kryesore të kërkimit fokusohen rreth fushës së impresionizmit të produktit, inovacionit në turizëm dhe simbolika e markës. Ka eksperiencë të ndryshme ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, është ideator startupesh si dhe ka punuar për disa vite si konsulent marketingu për industrinë e turizmit dhe atë të ushqimit.

<sup>3</sup> Dr. Alkida Hasaj është lektore pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” në qytetin e Shkodrës, Fakulteti Ekonomik. Ajo mbaroi studimet e larta për Administrim - Biznes në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, gradën master për Marketing në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës dhe studimin e doktoratës në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Durrësit “Aleksandër Moisiu”, Shqipëri. Ajo ka kryer kërkime shkencore në Universitetin Politeknik të Katalonjës, Spanjë; Fazeza, Itali, Universiteti George Washington, Washington DC. Si drejtuese dhe anëtare e ekipit, ajo ka punuar në një numër projektesh kërkimore në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Ka punuar si konsulent marketing ndaj bizneseve të rishitjes.

Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit dhe dinamikat e tregut kanë ndikuar në ndryshime të rëndësishme në profesionin e marketingut.

**Dizenjimi/metodologjia/aplikimi-** Ky studim është eksplorues. Kërkuesit duan të njihen me perceptimet e studentëve rreth programeve marketing dhe faktorëve që ndikojnë në krijimin e këtyre perceptimeve. Pyetësi është mjeti i mbledhjes së informacionit.

Një pyetësor i strukturuar u përdor për të mbledhur të dhëna nga 150 të anketuar të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", të Fakultetit Ekonomik. Të dhënat u analizuan duke përdorur mesataren.

**Gjetjet e studimit** zbuluan se studentët janë përgjithësisht pozitivë për programet e marketingut duke i konsideruar si të rëndësishme për të krijuar karrierë dhe avancimin në punë.

**Implikimet praktike (nëse janë të aplikueshme).** Ky studim paraqet një model që mund të aplikohet nga universitetet kur duan të përgatisin një program të ri studimor

**Cila është vlera/origjinaliteti i punimit?** Ky punim paraqet një rëndësi të veçantë për universitetet që përpara se të prezantojnë një program të ri studimi është e rëndësishme të studiojnë tregun potencial të studentëve dhe të zhvillojnë programe studimi të udhëhequr nga kërkime tregu.

*Fjalët kryesore (kyçe): edukim, program studimi në marketing, faktorët ndikues*

**The importance of studies in marketing programs according to students' perception. An empirical study on the factors affecting their choice**

***ABSTRACT***

This study focuses on the importance of marketing education programmes for career preparation and job advancement according to the students' perceptions and the factors that influence their study profile.

The rapid growth of information technology and market dynamics have influenced significant changes in the marketing profession.

**Design/methodology/application-** This study is exploratory. The researchers want to know the perceptions of students about marketing programs and the factors that influence the creation of these perceptions. The questionnaire is the tool for collecting information. A structured questionnaire was used to collect data from 150 respondents of the University of Shkodra "Luigj Gurakuqi", Faculty of Economics. The data



were analyzed using the mean. The findings of the study revealed that students are generally positive about marketing programs considering them important to create a career and advance in the job.

**Practical implications (if applicable)** – this study presents a model that can be applied by universities when they want to prepare a new study program.

**What is the value/originality of the work?** - this paper is of special importance for universities before introducing a new study program, it is important to study the potential student market and develop study programs guided by market research.

**Keywords:** education, study program in marketing, influencing factors

## Hyrje

Profesionet e lidhura me marketingun pritet të përjetojnë një rritje të vazhdueshme. Studimi më i fundit nga Chartered Institute of Marketing (CIM 2022), ku u anketuan pikëpamjet e 500 16-21-vjeçarëve dhe më shumë se 500 prindërve, zbuloi se 36% e të rinjve e shohin marketingun si një profesion më të sigurt për stabilitet financiar sesa zgjedhjet e tjera të karrierës. Vetëm 16% mendojnë se marketingu është një opsion më pak i sigurt në klimën aktuale ekonomike.

Ndryshimet strukturore të tilla, si: globalizimi, progresi teknologjik, proceset digjitale dhe automatizimi kërkojnë aftësi të reja nga profesionistët e marketingut. Teoria bazë e aftësive e shekullit 21 bazohet në katër C-të e identifikuar si aftësi bazë: Mendimi kritik, Bashkëpunimi, Komunikimi dhe Kreativiteti (Kovács, I. (2021), ku fokusi, në rastin e profesionistit të marketingut është kryesisht tek mendimi kritik (Osmani et al., 2015).

Në mjedisin konkurrues të tregut të punës është e rëndësishme të studiohen perceptimet e studentëve lidhur me qëndrimet e tyre ndaj programeve të studimit që ofrohen në universitete. Kërkimet e bazuara mbi perceptimet e studentëve janë një burim i mirë informacioni në lidhje me vlerësimin, qëndrimet dhe pritshmëritë rreth një programi studimi, në këtë mënyrë, mund të përmirësohen programet e studimit apo të përgatiten më mirë në të ardhmen. Studimet në këtë fushë janë të mangëta për realitetin shqiptar dhe paraqet domosdoshmëri analiza e pritshmërive dhe perceptimeve të studentëve rreth programeve studimore në mënyrë që këto programe të organizohen gjithashtu sipas nevojave të tregut. Një çështje që konsiderohet e rëndësishme është nevoja që mësimet e tyre të perceptohen gjithashtu si relevante për industrinë nga palët e interesuara (Lambert, 2003).

Në një studim mbi perceptimet e studentëve për komunikimin e biznesit, Bacon, D. R. (2017), zbuloi se perceptimet e studentëve për rëndësinë e programit studimor që zgjedhin për të ardhmen e tyre përcakton nëse ata bëjnë apo jo përpjekje për të mësuar materialin e përmbajtjes. Te i njëjti studim u zbulua gjithashtu se studentët nuk përpiqen të mësojnë materialet që i perceptojnë si jorelevante për karrierën e tyre. Nxënësit që tashmë kanë krijuar një perceptim negativ për kurset nuk binden edhe kur instruktorët e tyre ua kanë theksuar rëndësinë e materialit që po mësojnë.

Sjellja e konsumatorit ka ndryshuar rrënjësisht, duke ndikuar në kërkesa të rëndësishme për profesionistët e marketingut, dhe prandaj, nevojiten aftësi të reja të forta dhe të buta për t'u bërë të suksesshëm.

### ***Rëndësia e marketingut dhe e programeve të edukimit në marketing***

Marketingu është një fushë e larmishme me sfida dhe barriera të shumta me të cilat do të duhet të përballen shumë studentë. Industria është gjithnjë në zhvillim dhe ka një ndjenjë të madhe kreativiteti të përzier me analitikë. Kur njerëzit marrin vendime bazuar në të dhëna dhe art, kjo është një recetë për sukses.

Shumë organizata dhe industri përfshihen në përpjekjet e marketingut për të shitur produkte dhe shërbime. Një kompani veshjesh mund të dëshirojë të nisë një fushatë të re reklamimi, ose një firmë këshilluese mund të dëshirojë të fitojë drejtime nga ndjekësit. Cilido qoftë motivimi, marketingu prek atë nevojë të brendshme të klientëve në mënyrë që ata të marrin vendimin më të mirë për dëshirën e tyre.

Marketerët konsiderohen pozicione të domosdoshme për një biznes (Brennan, R., Canning, L., & McDowell, R. (2020).

Marketingu analizohet nisur nga këndvështrime të ndryshme, duke filluar nga identifikimi i nevojave të konsumatorëve dhe kënaqësia e tyre e deri në dimensionet që kontribuojnë në mirëqenien e shoqërisë. Kotler (2006) e përcakton marketingun si një proces shoqëror dhe menaxherial nëpërmjet të cilit individët dhe grupet përftojnë atë që kanë nevojë nëpërmjet krijimit dhe shkëmbimit të produkteve apo shërbimeve me vlerë me të tjerët. Marketingu shihet gjithashtu si arti dhe shkenca e eksplorimit, krijimit dhe dhënies së vlerës me qëllim arritjen e kënaqësisë së tregut të synuar duke siguruar përfitim. Marketingu identifikon nevojat dhe dëshirat e paplotësuara. Ai identifikon, mat dhe kuantifikon madhësinë e tregut dhe fitimin potencial, përcakton se cilëve segmente të tregut mund t'ju shërbejë më mirë, harton dhe promovon produktet e shërbimet e duhura. Marketingu është një funksion organizativ dhe një terësi procesesh për krijimin, komunikimin dhe shpërndarjen e vlerës për konsumatorët dhe për

menaxhimin e marrëdhënieve me konsumatorët në një mënyrë sipas së cilës përfiton organizata.


Programet e marketingut janë të fokusuara në mësimin e koncepteve marketing, aftësisht dhe themelet e biznesit të nevojshme për të pasur sukses në një ambient dinamik. Programet e studimeve në marketing u krijojnë studentëve mundësi për të përftuar njohuri, aftësi, qëndrime dhe kompetenca duke përparuar sipas nevojave të tregut të punës. Objektivat specifike të studimeve në marketing synojnë të përmbushin objektivat sociale, profesionale dhe personale. Edukimi në fushën e marketingut i ndihmon studentët të zhvillojnë një qëndrim të mirë ndaj punës, duke kuptuar përgjegjësitë e tyre personale ndaj shoqërisë. Programet e edukimit në marketing përdorin një përzierje inovative të metodave të mësimdhënies, konceptuale, eksperimentale dhe të bazuara në projekte me qëllim përgatitjen e specialistëve dhe drejtuesve për sfidat e menaxhimit të sotëm të fokusuar tek klientët. Në të gjithë botën, ka vende të reja pune dhe miliona punë zëvendësuese në profesionet e marketingut. Karriera në marketing shtrihet në një gamë të gjerë industrish dhe biznesesh të cilat gjenden si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik (Qendra Burimore e Edukimit të Marketingut, 2020). Marketingu përfshin miliona njerëz si shitës, reklamues, shitës me pakicë, shitës me shumicë, bankierë, praktikues të marrëdhënieve me publikun, mësues dhe tregtarët elektronikë. Floyd dhe Gordon (2000) argumentuan se universitetet që ofrojnë programe marketing duhet të identifikojnë kërkesat e nxënësve për të zhvilluar një orientim ndaj klientit (Stafford 1994), dhe për të adoptojnë strategji efektive të marketingut (Hugstad 1997) në funksion të konkurrencës së fortë ndërmjet universiteteve. Schmidt, Debevec dhe Comm (1987) argumentuan se *“Furnizuesit e shërbimeve arsimore duhet të dinë cilat kritere do të ndikojnë në zgjedhjet e studentëve të tyre”*. Stafford (1994) arsyetoi se *“Universitetet duhet të jenë më të shqetësuar me faktorët që ndikojnë në zgjedhjen edhe kënaqësinë me shërbimet e ofruara në studimet në marketing”*.

Faktorë të tillë, si: mundësia e punës në të ardhmen, potenciali i të ardhurave, lloji i profesionit, përfitimet monetare, bonuset etj., luajnë rolin më të rëndësishëm në përcaktimin e diplomës së studentëve (Francisco et al. 2003; Simons et al. 2003). Tan dhe Laswad (2006), gjithashtu konkluduan se zgjedhja e diplomës së studentëve ndikohet ndjeshëm nga perspektivat e të ardhurave, prestigji dhe avancimet në punë për shkak të potencialit të fitimit dhe tregtueshmërisë ose fushës së mundësive. Motivimi i brendshëm i referohet motivimit që vjen nga brenda një individi dhe jo nga ndonjë faktor i jashtëm ose shpërblime të jashtme, të tilla si para

ose nota. Motivimi vjen nga kënaqësia që merr një person nga vetë detyra ose nga ndjenja e kënaqësisë e përfundimit të një detyre. Shumë studime treguan se interesi i studentit për lëndën është një nga faktorët e rëndësishëm që ndikojnë në zgjedhjen e tyre të drejtimit.

Kërkimet empirike dhe teorike kanë identifikuar tri kategori që kanë treguar se ndikojnë në zgjedhjen kryesore të studentëve: *Burime të ndryshme informacioni dhe ndikimi, karakteristikat e punës dhe përshtatja e interesit të studentëve për studimet* Bordón, P., Canals, C., & Mizala, A. (2020).

### Modeli konceptual



### Burimi: përpunim i kërkuesve

#### Burime të ndryshme informacioni dhe ndikimi nga palë të treta

Burimi i informacionit dhe ndikimit përfshin individë që ofrojnë informacion që ndikojnë në zgjedhjen kryesore të studentëve (Beggs, Bantham & Taylor, 2008). Disa studentë ndikohen nga rekomandimet indirekte të njerëzve që njohin, nga këshillat që marrin studentët nga prindërit, miqtë. Gjithashtu dhe këshilltarët e shkollës ndikojnë në zgjedhjen kryesore të studentëve. Llewellyn Smith, C., & McCABE, V. S. (2008) argumentoi se shërbimet e ofruara për studentët dhe materialet e paraqitura, janë faktorët që i bëjnë universitetet dhe drejtimet tërheqëse për shumë studentë. Pampaloni (2010) zbuloi se karakteristikat institucionale kishin një ndikim tek studentët për të zgjedhur një drejtim në një universitet të caktuar. Sipas studimit të tyre, Beggs, Bantham dhe Taylor (2008)

raportuan katalogët universitarë dhe broshurat e departamenteve, janë burime që ndikojnë në zgjedhjen. Duke i shtuar kësaj, marketingu i studentëve përmes vizitave në shkolla dhe bisedës me nxënës dhe prindër të vlerësuar si media popullore më me ndikim se çdo burim tjetër (Lafy, 2017).

### **Të ardhurat dhe mundësia për karrierë**

Të ardhurat konsiderohen si karakteristika më e rëndësishme e punës (Ly, S. (2021). Në studimin e tyre, Modestino, A. S., & Forman, B. (2021). zbuluan se fitimet ishin një përcaktues i rëndësishëm i zgjedhjes së programit të studimit. Arcidiacono, Hotz dhe Kang (2010) besojnë se zgjedhja e diplomës së kolegjit përcaktohet nga fitimet e ardhshme. Song dhe Glick (2004) gjithashtu vunë re se përfundimi i arsimit të lartë dhe lloji i diplomës së kolegjit që studentët zgjedhin ndikon drejtpërdrejt në mundësitë e tyre të karrierës, gjë që rezulton në fuqi të ndryshme fitimi.

Profesionistët e suksesshëm të marketingut janë bërë sipërmarrës dhe u janë hapur shumë mundësi punësimi, të cilat përfshijnë ndërmarrjet e vogla, botimet, menaxhim ngjarjesh, menaxhim pune, konsulencë biznesi, ofrues shërbimesh dhe analistët e tregut. Studentët e diplomuar në marketing duhet të zhvillojnë aftësitë e duhura për të pasur sukses në karrierën e tyre dhe duhet të kenë një ekuilibër të duhur të aftësive Key et al. (2019). Për shkak të rritjes së numrit të burimeve të gjithanshme të të dhënave, punëdhënësit kërkojnë nga punonjësit aftësi të zhvilluara për të trajtuar mjete të shumta digjitale (Bobbitt et al. (2000). Gonzalez-Padron dhe Ferguson (2015) zbuloi se inovacionet e mësimdhënies të tilla, si përvoja e thelluar me projektet mësimore, ofrojnë një mënyrë për të realizuar përvojën mësimore dhe në të njëjtën kohë, ato shërbejnë për të mbushur hendekun midis njohurive teorike dhe zbatimit praktik në rastin e marketingut. Aftësitë më të shpeshta që kërkohen në punë për punonjësit e sektorit të marketingut të përmendura në punë janë: Google Ads, Google AdSense, segmentimi i klientit, diferencimi, aftësia për të përmbushur afatet, përshtatshmëria, bashkëpunimi, zhvillimi i takimeve, vendimmarrja, krijimi, kryerja e shumë detyrave, organizimi, prezantimi, zgjidhja e problemeve, ndërmarrja e iniciativës, puna në grup, menaxhim i kohës, komunikim verbal, duke punuar në mënyrë të pavarur, marketingu omnichannel, WordPress, HubSpot, Moz Pro, SEMrush, MailChimp, Synup, Yext, Listimet e Drejtorisë, Oferta PPC (Thebalancecareers, 2020).

### **Preferencat personale kundrejt programeve marketing**

Bartolj dhe Polanec (2012) në studimin e tyre treguan se aftësitë e përgjithshme të studentëve luajnë një rol të rëndësishëm në shpjegimin e

zgjedhjes së profilit të studimeve. Sipas studimit, mesatarja e përgjithshme e studimeve, është gjithashtu një tregues i përzgjedhjes së profilit të studimit.

### **Qëllimi i studimit**

Qëllimi i këtij studimi është të përcaktojmë rëndësinë e programeve marketing, sipas këndvështrimit të studentëve duke analizuar gjithashtu variablat e zgjedhur për të përcaktuar ndikimin që kanë mbi përzgjedhjen e studentëve kur aplikojnë në institucionet e arsimit të lartë.

Studiuesit kanë si objektivi të eksplorojnë perceptimet e studentëve rreth faktorëve që ndikuan më së shumti në zgjedhjet e tyre të studimeve. U testuan hipotezat e mëposhtme:

- Studentët zgjedhin drejtimet që rekomandohen nga prindërit, miqtë, mësuesit dhe informacioni që sigurohet nga materialet informuese;
- Studentët do të zgjedhin diploma që iu ofrojnë atyre potencial mundësi punësimi dhe avancim në karrierë;
- Studentët do të zgjedhin drejtimet sipas preferencave dhe aftësive të tyre.

### **Metodologjia**

Për realizimin e këtij punimi janë përdorur të dhënat sekondare dhe primare. Sekondare janë siguruar përmes literaturës të kohës në lidhje me rëndësinë e marketingut dhe aplikimit të tij në nivel edukativ, rëndësisë që ka koncepti marketing për njerëzit etj. Të dhënat primare janë mbledhur përmes metodës sasiore dhe instrumentit të pyetësorit. Kampioni është zgjedhur në mënyrë të rastësishme në studentët Fakultetit Ekonomik. Janë përzgjedhur 150 studentë. Norma e përgjigjes është e plotë. Kampioni është zgjedhur në mënyrë probabilitare.

### **Rezultatet**

Për evidentimin e rëndësisë të marketingut dhe vërtetimin e hipotezës të ngritur është ndërmarrë një studim me të dhëna empirike. Siç është evidentuar tek metodologjia e punimit u është shpërndarë një pyetësor 150 studentëve dhe rezultatet e siguruar janë reflektuar më poshtë.

Përgjigjdhënësit ishin 77 % të gjinisë femërore dhe 23% meshkuj. Të papunë kryesonin me 65%, ndërsa 35 % ishin të punësuar.

Në lidhje me mendimet e shprehura rreth gjashtë pohimeve, interesimin në lidhje me marketingun apo praktikave të reja, në lidhje me marketingun, kryesisht ndikimit të marketingut digjital në performancën e biznesit, studentët shprehen se *“Marketingu digjital duhet të jetë një pjesë e*

*rëndësishme e studimeve të mia*". Këto rezultate evidentojnë një nivel të lartë interesi rreth marketingut dhe sidomos marketingut digjital.

<i>Shprehni mendimin tuaj në lidhje me përcaktimet e mëposhtme:</i>	Minimum	Makimum	Mesatare	Devijacioni standard	Variance
Jam i interesuar të mësoj më tepër rreth praktikave/metodave të reja marketing	1	5	4.5	0.68	0.47
Jam i interesuar të mësoj rreth ndikimit të marketingut digjital në performancën e biznesit	3	5	4.45	0.56	0.31
Jam i/e kënaqur me programin tim të studimeve	1	5	4.08	1.07	1.15
Marketingu digjital duhet të jetë një pjesë e rëndësishme e studimeve të mia	2	5	4.35	0.73	0.54
Metodat e studimit duhet të modernizohen	1	5	3.94	0.93	0.86
Përbajtja e programit të studimeve duhet të modernizohet	1	5	3.77	1.02	1.04

**Tabela 1.** Niveli i pranimit të marketingut dhe marketingut digjital

#	<i>Përcaktoni nivelin e ndikimit në zgjedhjen e programit të studimit:</i>	Minimum	Makimum	Mesatare	Devijacioni standard	Variance
1	Emri i universitetit	1	5	3.06	1.36	1.84
2	Ndikimi i prindërve	1	5	3.03	1.33	1.78
3	Materialet informuese	1	5	3.9	1	1.01
4	Ndikimi i miqve	1	5	3	1.15	1.32
5	Mundësia e sigurimit të një pune të mirë	1	5	4.4	0.86	0.75

6	Mundësia e avancimit në karrierë	1	5	4.41	0.97	0.94
7	Paga sipas profilit të studimeve	1	5	4.27	0.84	0.7
8	Prirja personale për fushën e studimit	1	5	4.21	0.82	0.67
9	Aftësitë personale	1	5	4.3	0.95	0.9
10	Nota e programeve të ngjashme apo të lidhura	1	5	3.7	0.99	0.97

**Tabela 2.** Faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e programit të studimit

Nga analiza e faktorëve që ndikojnë në zgjedhjen e programit të studimit janë kryesisht *mundësia e sigurimit të një pune të mirë, pagat, rritje personale në fushën e studimit, aftësitë personale.*

### **Konkluzione**

Ky studim u fokusua në analizimin e perceptimeve të studentëve mbi programet e studimit në marketing dhe u analizuan faktorët që ndikojnë mbi zgjedhjen e profilit të studimeve.

Pas evidentimit dhe analizës teorike arrihet në konkluzionet e mëposhtme: Marketingu dhe sidomos marketingu digjital përbën një fushë prioritare studimore nisur nga ndryshimet e tregut, kërkesat e bizneseve për profesionistë dhe pagesa të larta e mundësi më të larta për avancim në karrierë.

Kërkuesit arritën në përfundim që studentët kanë një qëndrim pozitiv kundrejt programeve të studimit në marketing, rezultatet e studimit evidentojnë një nivel të lartë interesi rreth marketingut dhe sidomos marketingut digjital.

Gjithashtu nga rezultatet e pyetësorit u identifikuan disa faktorë dominues në përzgjedhjen e fushës së studimeve të studentëve të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës. Nga analiza e faktorëve që ndikojnë në zgjedhjen e programit të studimit janë kryesisht *mundësia e sigurimit të një pune të mirë, pagat, rritje personale në fushën e studimit, aftësitë personale.*

Studimi ka limitimet e veta, do të ishte me interes të zgjerohej kampioni i studimit edhe në degë të tjera të Universitetit të Shkodrës për të analizuar këndvështrime të tjera edhe të studentëve të një formimi të ndryshëm nga



fusha e ekonomisë dhe gjithashtu mund të paraqesë interes analiza e ndryshimeve të perceptimeve sipas vitit të studimit.

### Referenca

- Bacon, D. R. (2017). Revisiting the relationship between marketing education and marketing career success. *Journal of Marketing Education*, 39(2), 109-123. <https://doi.org/10.1177/0273475317710061>
- Marketing Education Resource Centre (2020). Marketing education students' perceptions towards marketing education courses. [www.vuw.ac.nz/caplabtb/m302wo7/CRAIG DOUGLAS.DOC](http://www.vuw.ac.nz/caplabtb/m302wo7/CRAIG%20DOUGLAS.DOC).
- Kotler, P. & Keller, K.L (2006). *Marketing management (12th Ed.)*, India: Pearson Education Inc
- Chiruguru, S. (2018). The Essential Skills of 21st Century Classroom (4Cs). [https://www.researchgate.net/profile/Suresh\\_Chiruguru2/publication/340066140\\_The\\_Essential\\_Skills\\_of\\_21st\\_Century\\_Classroom\\_4Cs/links/5e75277d4585157b9a4d9964/The-Essential-Skills-of-21st-Century-Classroom4Cs.pdf](https://www.researchgate.net/profile/Suresh_Chiruguru2/publication/340066140_The_Essential_Skills_of_21st_Century_Classroom_4Cs/links/5e75277d4585157b9a4d9964/The-Essential-Skills-of-21st-Century-Classroom4Cs.pdf). Louisiana Computer Using Educators (LACUE), USA
- Osmani, M., Weerakkody, V., Hindi, N. M., Rajab, E., Eldabi, T., Kapoor, K., & Irani, Z. (2015). Identifying the trends and impact of graduate attributes on employability: a literature review. *Tertiary Education and Management*, 21(1), 367–379.
- Lambert, L. (2003). Leadership redefined: An evocative context for teacher leadership. *School leadership & management*, 23(4), 421-430.
- Grise-Owens, E. Y. (2000). *An exploration of gender in/equity in the university curriculum: A content analysis of the "Journal of Social Work Education, 1998–1999"*. Spalding University.
- Canary, D. J., & Stafford, L. (1994). Maintaining relationships through strategic and routine interaction.
- Hugstad, P. (1997). Marketing the marketing major. *Journal of Marketing Education*, 19(1), 4-13.
- Schmidt, S. L., Debevec, K., & Comm, C. L. (1987). Marketing majors' satisfaction with their college experience: Implications for strategic planning in marketing departments. *Journal of Marketing Education*, 9(3), 58-63.
- Kovács, I. (2021). Digital Marketing Soft Skills and University Students' Perceptions of Employability. *GiLE Journal of Skills Development*, 1(1), 25-36.
- Osborne, J., Simon, S., & Collins, S. (2003). Attitudes towards science: A review of the literature and its implications. *International journal of science education*, 25(9), 1049-1079.
- Tan, L. M., & Laswad, F. (2006). Students' beliefs, attitudes and intentions to major in accounting. *Accounting Education: an international journal*, 15(2), 167-187.
- Zafar, B. (2013). College major choice and the gender gap. *Journal of Human Resources*, 48(3), 545-595.
- Bordón, P., Canals, C., & Mizala, A. (2020). The gender gap in college major choice in Chile. *Economics of Education Review*, 77, 102011.

- Beggs, J. M., Bantham, J. H., & Taylor, S. (2008). Distinguishing the factors influencing college students' choice of major. *College Student Journal*, 42(2), 381-395.
- Llewellyn-Smith, C., & McCABE, V. S. (2008). What is the attraction for exchange students: the host destination or host university? Empirical evidence from a study of an Australian university. *International Journal of Tourism Research*, 10(6), 593-607.
- Pampaloni, A. M. (2010). The influence of organizational image on college selection: what students seek in institutions of higher education. *Journal of marketing for higher education*, 20(1), 19-48.
- Beggs, J. M., Bantham, J. H., & Taylor, S. (2008). Distinguishing the factors influencing college students' choice of major. *College Student Journal*, 42(2), 381-395.
- Alkhateeb, F. M., Clauson, K. A., & Latif, D. A. (2012). Availability and perceived value of masters of business administration degree programs in pharmaceutical marketing and management. *American Journal of Pharmaceutical Education*, 76(4).
- Jaradat, M. S., & Mustafa, M. B. (2017). Academic advising and maintaining major: Is there a relation? *Social Sciences*, 6(4), 151.
- Ly, S. (2021). 7. Factors to Consider When Choosing University Majors. *CAMBODIAN YOUTH'S*, 46.
- Modestino, A. S., & Forman, B. (2021). Pathways to Economic Mobility: Identifying the Labor Market Value of Community College in Massachusetts. Understanding Boston. *Boston Foundation*.
- Arcidiacono, P., Hotz, J., & Kang, S. (2010). Modelling college major choices using elicited measures of expectations and counterfactuals, IZADiscussion Papers, No. 4738, 1-29.
- Song, C., & Glick, J. E. (2004). College attendance and choice of college majors among Asian-American students. *Social Science Quarterly*, 85(5), 1401-1421.
- Bobbitt, L. M., Inks, S. A., Kemp, K. J., & Mayo, D. T. (2000). Integrating marketing courses to enhance team-based experiential learning. *Journal of Marketing Education*, 22(1), 15-24.
- Gonzalez-Padron, T., & Ferguson, J. M. (2015). Using a service audit project for improving student learning in a service-marketing course. *Marketing Education Review*, 25(2), 99-116.
- Martínez-López, F. J., Anaya-Sánchez, R., Fernández Giordano, M., & Lopez-Lopez, D. (2020). Behind influencer marketing: key marketing decisions and their effects on followers' responses. *Journal of Marketing Management*, 36(7-8), 579-607.
- Kovács, I. (2021). Digital Marketing Soft Skills and University Students' Perceptions of Employability. *GiLE Journal of Skills Development*, 1(1), 25-36.
- Harring, N., & Jagers, S. C. (2018). Why do people accept environmental policies? The prospects of higher education and changes in norms, beliefs and policy preferences. *Environmental Education Research*, 24(6), 791-806.
- Bartolj, T., & Polanec, S. (2012). College major choice and ability: Why is general ability not enough?. *Economics of Education Review*, 31(6), 996-1016.
- Brennan, R., Canning, L., & McDowell, R. (2020). *Business-to-business marketing*. Sage.

## NDIKIMI I SISTEMIT TË INFORMACIONIT KONTABËL NË EFEKTIVITETIN E FIRMAVE NË SHKODËR

Joana Marku<sup>1</sup>, Elidiana Bashi<sup>2</sup>

*Master Shkencor në Kontabilitet (MSc)*

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Financë - Kontabilitet*

### **ABSTRAKT**

Qëllimi i këtij punimi është të studiojë ndikimin e Sistemit të Informacionit Kontabël në efektivitetin e firmave në Shkodër, se si përdorimi i sistemeve të informacionit kontabël mund të ndikojë në efektivitetin dhe performancën e tyre.

Metodologjia e përdorur për të realizuar qëllimin e këtij punimi konsiston në mbledhjen e të dhënave duke përdorur pyetësorë.

Rezultatet treguan se ekziston një lidhje pozitive midis SIK dhe performancës organizative. Efektiviteti i firmave në përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara rritet nëpërmjet përdorimit të sistemeve të informacionit kontabël.

Punimi i vjen në ndihmë kompanive që dëshirojnë të rrisin efektivitetin e tyre në aspektin e përfitimit dhe përshtatshmërisë ndaj ndryshimeve të tregut, mund ta arrijnë këtë duke investuar në një sistem të mirë informacioni kontabël në proceset e tyre të kontabilitetit financiar. Duke investuar në sistemet e informacionit kontabël është strategjia e duhur për firmën, pasi rriten të ardhurat dhe ulen kostot.

Ky punim ka të veçantë, sepse përveç rolit që luan sistemi i informacionit kontabël në efikasitetin e firmave, gjithashtu në punim është studiuar edhe sistemi i informacionit kontabël i moderuar nga burimet njerëzore, strategjia e biznesit dhe kontrolli i brendshëm.

---

<sup>1</sup> Joana Marku ka përfunduar Bachelorin në vitin 2020 në degën Financë - Kontabilitet pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër dhe në vitin 2022 po në këtë universitet ka përfunduar Masterin shkencor në Kontabilitet si nxënëse ekselente. Që nga vitin 2021 punon ekonomiste në një firmë prodhuese dhe tregtuese.

<sup>2</sup> Prof. as. dr. Elidiana Bashi, pedagoge në departamentin e Financë - Kontabilitet në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Originaliteti i punimit është se rezultatet e studimit inkurajojnë dhe ofrojnë mundësi për të rritur cilësinë e sistemit të informacionit kontabël, duke marrë parasysh rëndësinë e tij për efektivitetin në firma.

**Fjalët kyçe:** Sistemi i informacionit kontabël, efektiviteti i firmës, burimet njerëzore, kontrollet e brendshme, strategjia e biznesit.

### **The Impact of the Accounting Information System on the Effectiveness of Firms in Shkodër**

#### ***ABSTRACT***

The purpose of this paper is to study the impact of the Accounting Information System on the effectiveness of firms in Shkodër, how the use of accounting information systems can affect their effectiveness and performance.

The methodology used to achieve the purpose of this paper consists of data collection using questionnaires.

The results showed that there is a positive relationship between AIS and organizational performance. The effectiveness of firms in meeting the goals and objectives determined increases through the use of accounting information systems.

The paper suggests that companies that wish to increase their effectiveness in terms of profitability and adaptability to market changes can achieve this by investing in a good accounting information system in their financial accounting processes. Investing in accounting information systems is the right strategy for the firm as it increases revenues and decreases costs.

This paper is special because in addition to the role played by the accounting information system in the efficiency of firms, the paper also studies the accounting information system moderated by human resources, business strategy and internal control.

The originality of the paper is that the results of the study encourage and provide opportunities to increase the quality of the accounting information system, taking into account its importance for effectiveness in firms.

**Keywords:** Accounting information system, firm effectiveness, human resources, internal controls, business strategy.

## I.1.Hyrje

Bizneset sot operojnë në një mjedis global shumë konkurrues i cili është çdo ditë në ndryshim dhe për këtë arsye kërkojnë një Sistem Informacioni Kontabël që ofron përgjigje të shpejta ndaj çështjeve komplekse të biznesit. Sistemet e Informacionit Kontabël janë sisteme që përdoren për të mbledhur, regjistruar, ruajtur, analizuar dhe për të aksesuar të dhënat e kompanisë.

Fushat në të cilat SIK mund të përdoret përfshijnë librin e shitjeve, librin e blerjeve, listën e pagave, kontabilitetin e kostos. SIK përmes sistemit të tij të kompjuterizuar të kontabilitetit prodhon pasqyrat financiare, përkatësisht pasqyrat e të ardhurave, bilancet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë.


Sistemi do të përpunojë të dhënat dhe do t'i transformojë ato në informacione kontabël gjatë fazave të hyrjes, përpunimit dhe daljes që do të përdoren nga një shumëllojshmëri e gjerë përdoruesish si përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm.

## I.2.Pyetjet kërkimore

1. Çfarë ndikimi kanë sistemet e informacionit kontabël, burimet njerëzore, strategjitë e biznesit dhe kontrollet e brendshme në efikasitetin e organizatës?
2. A luajnë një rol të rëndësishëm sistemet e informacionit kontabël të moderuara nga burimet njerëzore, strategjitë e biznesit dhe kontrollet e brendshme në efikasitetin e organizatës?

## I.3. Kuadri konceptual

*Figura 1: Kuadri konceptual*



#### **I.4. Hipotezat**

H1: Ekziston një marrëdhënie midis Sistemit të Informacionit Kontabël dhe efikasitetit të organizatës.

H2: Ekziston një marrëdhënie midis burimeve njerëzore dhe efikasitetit të organizatës.

H3: Ekziston një marrëdhënie midis strategjisë së biznesit dhe efikasitetit të organizatës.

H4: Ekziston një marrëdhënie midis kontrolleve të brendshme dhe efikasitetit të organizatës.

H5: Ekziston një marrëdhënie midis Sistemit të Informacionit Kontabël dhe efikasitetit të organizatës që moderohet nga një personel profesionistësh dhe kontabël.

H6: Ekziston një marrëdhënie midis Sistemit të Informacionit Kontabël dhe efikasitetit të organizatës që moderohet nga strategjia e biznesit, strategjia e menaxherit dhe angazhimi i tij.

H7: Ekziston një marrëdhënie midis Sistemit të Informacionit Kontabël dhe efikasitetit të organizatës që moderohet nga kontrollet e brendshme.

#### **II.1. Rishikimi i literaturës**

Ka shumë mënyra për të matur efektivitetin e një organizate, Scott (2005) renditi mbi 30 kriteret të ndryshme duke filluar nga produktiviteti, fitimet, rritja, qarkullimi, stabiliteti dhe qëndrueshmëria organizative.

Efektiviteti në organizatë mat sesa e suksesshme ka qenë organizata në arritjen e misionit të saj, ndjeshmërinë e saj në veprimet mjedisore dhe kapacitetin e saj për të kuptuar dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut, Mccann (2004). Një nga variablat më të rëndësishme është Sistemi i Informacionit Kontabël për të matur performancën e firmës. SIK konsiderohet si mekanizëm i rëndësishëm organizativ që është kritik për efektivitetin e menaxhimit në organizata, Sajady, et al (2008). Gjithashtu sa më të suksesshme të jenë strategjitë e biznesit, aq më shumë arrihen qëllimi dhe suksesi i organizatës. Çdo biznes që dëshiron të mbijetojë dhe të ketë sukses duhet të zhvillojë dhe zbatojë strategji, O'Brien & Marakas (2008). Kompanitë duhet të investojnë në fuqinë e tyre punëtore me të njëjtën forcë si asete fizike dhe investime financiare, sipas Flamholtz & Bullen (2004). Në fund themi se organizatat duhet të kenë një kontroll të brendshëm efektiv për të arritur misionin dhe performancën e synuar, O'Brien & Marakas, (2010).

Disa nga studimet që janë bërë nga autorë të ndryshëm në lidhje me SIK mund të përmendim, si: Grande, Estebanez, & Colomina (2011), të cilët hetuan marrëdhënien midis përdorimit të Sistemeve të Informacionit

Kontabël nga ndërmarrjet në Spanjë. Gjetjet treguan se firmat që përdorin SIK në të gjithë menaxhimin e tyre marrin një fitim më të lartë. Gjithashtu SIK çon në pasqyra financiare korrekte dhe raportim financiar të besueshëm.

Ndërsa Morrison dhe Asiedu (2016) analizuan përdorimin dhe përfitimet e SIK në ndërmarrjet e Ganës. Gjetjet e hulumtimit theksuan se Sistemet e Informacionit Kontabël luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin në kohë të informacionit, kapacitetin e madh të ruajtjes së të dhënave, reduktimin e punëve nga nëpunësit dhe rritjen e kënaqësisë së klientit.

### III.1. Metodologjia

Mbledhja e të dhënave u bë nëpërmjet pyetësorëve, pra të dhënat ishin dytësore. Pyetësi u shpërnda për 72 firma të mesme dhe të mëdha në Shkodër, ku 51 firma e plotësuan pyetësin. Kjo përfaqësoi një përqindje përgjigjeje prej 70%. Pyetësit u shpërndanë me Google Forms dhe të dhënat u analizuan duke përdorur SPSS dhe u prezantuan duke përdorur tabela dhe grafikë. Të dhënat u mblodhën dhe u analizuan duke përdorur metoda të analizës së të dhënave sasiore dhe cilësore. Pyetjet ishin të bazuara në një shkallë Likert.

### III.2. Modeli konceptual

Modeli i regresionit është një shprehje algebrike e formës:

$$Y = a + b_1X_1 + b_2X_2 + b_3X_3 + b_4X_4 + b_5X_5 + b_6X_6 + b_7X_7 + u_i \quad \text{ku;}$$

Y = Efikasiteti i organizatës (EO)

a = Konstante                      b = Pjerrësia e regresionit

X<sub>1</sub> = Sistemi Informacionit Kontabël (SIK);    X<sub>2</sub> = Burimet Njerëzore (BNJ);

X<sub>3</sub> = Strategjia e biznesit (SB);                      X<sub>4</sub> = Kontrolli i Brendshëm (KB);

X<sub>5</sub> = X<sub>1</sub> \* X<sub>2</sub>;    X<sub>6</sub> = X<sub>1</sub> \* X<sub>3</sub>;    X<sub>7</sub> = X<sub>1</sub> \* X<sub>4</sub>;    u<sub>i</sub> = term disturbance

### IV.1. Vlefshmëria dhe besueshmëria e të dhënave

Vlefshmëria e një pyetësi është në thelb shkalla në të cilën ai mat atë që pretendon të matë (Mugenda & Mugenda, 2003). Besueshmëria e këtij pyetësi në qoftë se marrim një alfa për të gjithë variablat rezultoi të ketë koeficientin Alpha Cronbach = 0,879 që vlerësohet se besueshmëria është e mirë dhe pyetësi mund të përdoret. George and Mallery (2003) sugjeruan alfa > 0,8.

### IV.2. Statistika përshkruese


Nga të anketuarit 43% ishin meshkuj dhe 57% ishin femra. Ndërsa mosha e tyre ishte 18-25 vjeç e 27% të anketuarve, 26-35 vjeç ishin 29% e të anketuarve, 36-45 vjeç ishin 24% e të anketuarve, 46-55 vjeç ishin 12% e të

anketuarve dhe mbi 55 vjeç ishin 8% e të anketuarve. Nga këto me arsim 9-vjeçar nuk kishte asnjë, 4% ishin me arsim të mesëm, 23% kishin mbaruar studimet bachelor, 59% kishin mbaruar studimet master dhe 14% doktoraturë. Përsa i përket pozicionit të tyre në kompani 12% e të anketuarve ishin drejtorë ose pronarë, 16% ishin menaxherë, 49% kontabilistë, 21% drejtorë sektori dhe 2% punonjës në administratë. Gjithashu 63% e kompanive të marra në studim ishin prodhues të shërbimeve dhe 37% prodhues e të mirave.

#### IV.3.1 Sistemi Informacionit Kontabël

Studiuesi kërkoi të dinte përgjigjen e të anketuarve mbi disponueshmërinë dhe natyrën e Sistemeve të Informacionit Kontabël. 70% janë pajtuar që SIK është shumë i rëndësishëm në vlerësimin e organizatës, 69% janë përgjigjur se rritja e efektivitetit të SIK rrit performancën. 71% aludojnë se cilësia e raporteve financiare ndikohet nga SIK duke ndikuar edhe në rritjen e cilësisë në vendimmarrje. 76% janë përgjigjur se SIK cilësor është një vlerë e shtuar për organizatën.

**Figura 2: Sistemi i Informacionit Kontabël**




Burimi: Gjetjet e studimit

Nga të dhënat e mbledhura sesi të anketuarit e vlerësuan SIK e tyre, 72% prej të anketuarve ranë dakord që sistemi rriti shpejtësinë në një masë të madhe; 73% nga të anketuarit pohuan që SIK ka rritur saktësinë dhe sigurinë e të dhënave në një masë mjaft të madhe. Në përgjithësi, më shumë se gjysma e të gjithë të anketuarve ranë dakord se organizimi i të dhënave



dhe ruajtja e informacionit në lidhje me transaksionet e organizatës është ndikuar pozitivisht nga përdorimi i sistemit të informacionit kontabël.

**Figura 3: Vlerësimi i performancës së SIK**




Burimi: Gjetjet e Kërkimit

### IV.3.2 Burimet Njerëzore

Studiuesi kërkoi të zbulonte natyrën e burimeve njerëzore brenda departamentit të financave të kompanive. Nga të anketuarit 65% janë pajtuar se stafi është i kualifikuar, gjithashtu stafi është i aftë për teknologjinë. 67% thanë se ndikimi i motivimit të punonjësve rrit cilësinë e SIK. 69% aluduan se eksperiencia ndikon në efektivitetin e SIK.

**Figura 4: Natyra e burimeve njerëzore**




Burimi: Gjetjet e Kërkimit

### IV.3.3 Strategjia e Biznesit

Studiuesi kërkoi të zbulonte nëse strategjia e biznesit ka ndonjë ndikim në cilësinë e raporteve financiare. SIK krijon marrëdhënie strategjike me klientët, furnitorët dhe partnerët e biznesit ku mesatarja e të anketuarve u përgjigjen me 66%; SIK ndihmon në sigurimin e informacioneve të nevojshme për të plotësuar objektivat specifike të strategjisë që ndjek menaxheri një rezultat 67%; SIK konsiderohet një strategji e re thelbësore për të fituar përparësi konkurruese një rezultat prej 64%; Strategjia e biznesit duke përdorur SIK luan një rol të rëndësishëm për të rritur të ardhurat dhe për të ulur kostot me një përgjigje mesatare prej 58% etj.

**Figura 5: Strategjia e Biznesit**




Burimi: Gjetjet e Kërkimit

### IV.3.4 Kontrollat e brendshme

Studiuesi mblodhi të dhëna në lidhje me natyrën e kontroleve të brendshme të praktikuara nga organizata. Kontrollat e brendshme ishin për sa i përket sigurimit të arritjeve të qëllimeve operacionale dhe performancës, uljen e mashtremeve që mund të ndodhin, një kontroll i brendshëm efektiv ndihmon për të arritur misionin dhe objektivat e organizatës, u sigurojnë aksionerëve që PF janë në përputhje me ligjet dhe sistemi gjeneron informacion të saktë kur kontrollat e brendshme janë efektive. Të anketuarit iu përgjigjën deklaratave me mesataren përkatësisht 73%, 70%, 75%, 66%, 68% siç tregohet në tabelën e mëposhtme.

**Figura 6: Kontrollat e brendshme**




Burimi: Gjetjet e Kërkimit

**IV.3.5 Efektiviteti organizativ**

Studiuesi mblodhi të dhëna mbi efektivitetin e përgjithshëm të kompanisë duke u bërë pyetje të mbyllura të anketuarve në tri dimensione cilësinë e raporteve financiare, menaxhimin e ndryshimeve dhe performancën organizative.

Përsa i përket pohimit se raportet që gjeneron SIK përmbajnë informacion të mjaftueshëm dhe të besueshëm mbi zbatimin e buxhetit rreth 79% e pohojnë këtë gjë; raportet financiare përmbajnë raportet e kërkuara të rrjedhës së parasë ku 72% ishin dakord dhe planifikimet e auditimit mund të nxirren nga SIK një mesatare prej 73%.


**Figura 7: Raportet financiare**



Burimi: Gjetjet e Kërkimit

Te aftësia e menaxhimit të ndryshimit punonjësit e dinë çfarë pritet prej tyre dhe janë të përkushtuar ndaj kompanisë me materialet dhe pajisjet e duhura për të kryer punën e tyre ku 67% e pohuan, kur ndodhin probleme menaxheri identifikon problemin dhe kërkon për alternativat e zgjidhjes pohimi 73%.


**Figura 8: Aftësia e menaxhimit të ndryshimit**



Burimi: Gjetjet e Kërkimit

I anketuari gjithashtu konstatoi nëse pas zbatimit dhe përdorimit të sistemit të informacionit të kontabilitetit, organizata raportoi performancë të përmirësuar në drejtim të stabilizimit të tregut të tyre në rritje të fitimeve, rritje të të ardhurave, ulje të kostove dhe rritje të pjesës së tregut. Përgjigjja ishte përkatësisht mesatarisht 76%, 75%, 67%, 62%.

**Figura 9: Performanca Organizative**



Burimi: Gjetjet e Kërkimit

#### **IV.4. Testi i normalitetit**

Shpërndarja e të dhënave është shumë me rëndësi në punimet statistikore, sepse në hulumtimet statistikore për aplikimin e shumë testeve, shpërndarja duhet që të jetë normale apo afër normales. Për shkak se numri i të dhënave tona është 51, do të përdoret testi Kolmogrov-Smirnov.

$H_0$ : Shpërndarja e të dhënave ndjek shpërndarjen normale.

$H_1$ : Shpërndarja e të dhënave nuk ndjek shpërndarjen normale.

Sipas nivelit të rëndësisë 5%, për shkak që vlera e testit për variablat SIK, BNJ, KB, EO, SIK\*SB, SIK\*KB është përkatësisht, 0,312, 0,251, 0,200, 0,141, 0,181, 0,202, janë më të mëdha se 5%, hipoteza  $H_0$  pranohet. Pra, mund të thuhet se të dhënat janë të shpërndara në mënyrë normale. Ndërsa vlera e testit për variablat SB dhe SIK\*BNJ janë 0,012 dhe 0,015 pra, më të vogla se 5%, hipoteza  $H_0$  nuk pranohet, pra të dhënat nuk janë të shpërndara në mënyrë normale.

#### **IV.5. Analiza e Korrelacionit**

Për të vërtetuar hipotezat fillimisht u ndërtua matrica e korrelacionit.

Në rrallë të parë vërejmë se variabli jonë i varur efikasiteti i organizatës ka një lidhje të fortë me variablat e pavarur.

Nuk dëshirohet që të ketë korrelacion të fortë ndërmjet ndryshoreve të pavarura, sepse në këtë rast kontributet e ndryshoreve të pavarura në model janë shumë të përafërta njëra me tjetrën dhe qenia apo mosqenia e ndryshoreve në model nuk e ndikon fuqinë e modelit. Në rastin tonë nuk ka korrelacion të fortë ndërmjet ndryshoreve të pavarura.

#### **IV.6. Analiza e regresionit dhe testimi i hipotezave**

##### **IV.6.1 Modeli 1**

Në analizën e regresionit duhet të përfshijmë main effects dhe interaction effect, sepse rekomandohet që asnjëherë të mos përfshihen interaction effects pa main effects në analizë. Prandaj në modelin e parë do të përfshijmë main effects pra, bëjmë analizën e regresionit sesi kanë ndikuar SIK, BNJ, SB, KB në EO.

**Tabela 1: Përmbledhja e modelit**

Model	R	R Square	Adjusted Square	R Std. Error of the Estimate	Durbin-Watson
1	,849	,722	,728	,501	1,58

Burimi: Gjetjet e Kërkimit

Koeficienti i determinacionit i cili është  $R^2=0,722$  që do të thotë se 72,2% e variacionit të efikasitetit të firmave në Shkodër arrin të shpjegohet nga

kontributi i përbashkët i variablave të pavarur. Kurse pjesa tjetër shpjegohet nga ndryshoret të cilat nuk janë përfshirë në model me anë të gabimit të rastësishëm.

Përsëri nga tabela një test me rëndësi është testi Durbin-Watson i cili tregon nëse ekziston autokorrelacion në modelin tonë. Zakonisht, vlerat e testit Durbin Watson ndërmjet 1,5 - 2,5 tregojnë se nuk ekziston autokorrelacion dhe në modelin tonë të parë është e pranueshme.

Tabela ANOVA bën testimin e hipotezave, ku në hipotezën bazë të gjitha  $\beta$ -tat janë zero dhe kjo nënkupton se asnjëri nga variablat e pavarur nuk kontribuon në shpjegueshmërinë e variablit të varur dhe hipotezën alternative ku të paktën njëra nga  $\beta$ -tat është e ndryshme nga zero dhe kjo do të thotë se njëri nga variablat e pavarur kontribuon në shpjegueshmërinë e variablit të varur. Vlera F e cila tregon rëndësinë e modelit dhe vlera Sig. e cila tregon nivelin e rëndësisë. Vlera e  $F=29,968$  dhe probabiliteti i marrjes së një vlere të tillë F nën hipotezën bazë është 0,000. Dhe kjo vlerë është më e vogël se 0,05, hipoteza  $H_0$  do të refuzohet. Prandaj ne refuzojmë hipotezën bazë dhe pranojmë atë alternative, ku të paktën njëri nga variablat shpjegues ka lidhje me variablin e shpjeguar.

**Tabela 2: Analiza e Variancës**

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	32,817	4	8,204	29,968	.000
	Residual	12,593	46	,273		
	Total	45,410	50			

Burimi: Gjetjet e Kërkimit

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vlerat e parashikimit të koeficientëve të modelit dhe do të shikojmë rëndësinë statistikore dhe interpretimin e tyre.  $\beta_0$  është intercepti ose konstantja, e cila tregon vlerën e EO kur vlera e të gjithë variablave të pavarur është e barabartë me 0, EO do të ketë rritje 0,808. Për testimin e 4 hipotezave të para do të bazohemi te vlera e p. Niveli i rëndësisë  $\alpha=0,05$  dhe rregulli për marrjen e vendimit është se nëse vlera p-së  $< 0,05$  hidhet poshtë hipoteza bazë dhe pranohet ajo alternative, në të kundert jo.

**Tabela 3: Parashikimet e parametrave**

Model	Unstandardized Coefficients	t	Sig.	95.0% Confidence Interval for B
	B	Std. Error		Lower Bound Upper Bound
1	(Constant) ,808	,167	4,829	,000 ,471 1,145

SIK	,344	,065	5,281	,000	,213	,475
BNJ	,542	,056	9,757	,000	,430	,654
SB	-,150	,091	-1,648	,065	-,253	,047
KB	,101	,043	2,357	,023	,015	,187

Burimi: Gjetjet e Kërkimit

$H_0$ : Sistemi i Informacionit Kontabël nuk ndikon në efikasitetin e organizatës.

$H_1$ : Sistemi i Informacionit Kontabël ndikon në efikasitetin e organizatës.

Koeficienti i pjerrësisë për SIK,  $\beta_1=0,344$  dhe p-(value) ( $\beta_1$ ) = 0,000 < 0,05; prandaj  $H_0$  hidhet poshtë, pra koeficienti  $\beta_1$  është statistikisht domethënës. SIK kontribuojnë në shpjegueshmërinë e EO, me rritjen me 1 njësi në SIK, do të sjellë rritje me 0,344 njësi në EO.

$H_0$ : Burimet njerëzore nuk ndikojnë në efikasitetin e organizatës.

$H_1$ : Burimet njerëzore ndikojnë në efikasitetin e organizatës.

Koeficienti i pjerrësisë për BNJ,  $\beta_2= 0,542$  dhe p-(value) ( $\beta_2$ ) = 0,000 < 0,05; prandaj  $H_0$  hidhet poshtë, pra koeficienti  $\beta_2$  është statistikisht domethënës. BNJ kontribuojnë në shpjegueshmërinë e EO, me rritjen me 1 njësi në BNJ, do të sjellë rritje me 0,542 njësi në EO.

$H_0$ : Strategjia e biznesit nuk ndikon në efikasitetin e organizatës.

$H_1$ : Strategjia e biznesit ndikon në efikasitetin e organizatës.

Koeficienti i pjerrësisë për SB,  $\beta_3= -0,150$  dhe p-(value) ( $\beta_3$ ) = 0,065 > 0,05; prandaj  $H_0$  nuk hidhet poshtë, pra koeficienti  $\beta_3$  nuk është statistikisht domethënës. SB nuk kontribuon në shpjegueshmërinë e EO.

$H_0$ : Kontrolli i brendshëm nuk ndikon në efikasitetin e organizatës.

$H_1$ : Kontrolli i brendshëm ndikon në efikasitetin e organizatës.

Koeficienti i pjerrësisë për KB,  $\beta_4=0,101$  dhe p-(value) ( $\beta_4$ ) = 0,023 < 0,05; prandaj  $H_0$  hidhet poshtë, pra koeficienti  $\beta_4$  është statistikisht domethënës. KB kontribuon në shpjegueshmërinë e EO, me rritjen me 1 njësi në KB, do të sjellë rritje me 0,10 njësi në EO.

Gjithashtu për të testuar vlefshmërinë e hipotezave mund të bazohemi edhe te vlera e t-së, për zgjedhje të mëdha, nëse vlera e t-së në vlerë absolute >2 atëherë pranohet hipoteza alternative dhe hidhet poshtë hipoteza bazë. Mund të bazohemi edhe tek intervalet e besueshmërisë, në momentin që kufiri i poshtëm dhe i sipërm kanë të njëjtën shenjë, atëherë nuk ekziston mundësia që ta përmbajë 0 dhe kështu refuzohet hipoteza bazë dhe pranohet ajo alternative. Që në rastin tonë si vlera e t-së si intervalet e

besueshmërisë i plotësojnë kushtet për variablat që dolën statistikisht domethënës.

#### IV.6.2 Modeli 2

Në modelin e dytë do të përfshijmë interaction effects, bëjmë analizën e regresionit sesi kanë ndikuar SIK\*BNJ, SIK\*SB, SIK\*KB në EO.

**Tabela 4: Përmbledhja e modelit**

Model	R	R Square	Adjusted Square	R Std. Error of the Estimate	Durbin-Watson
1	,809	,656	,678	,593	1,54

Burimi: Gjetjet e Kërkimit

Koeficienti i determinacionit i cili është  $R^2=0,656$  që do të thotë se 65,6% e variacionit të efikasitetit të firmave në Shkodër arrin të shpjegohet nga kontributi i përbashkët i variablave të pavarur.

Adjusted  $R^2$  në modelin e dytë përsëri është rritur dhe testi Durbin-Watson është i pranueshëm, pra nuk ka autokorrelacion.

Vlera e  $F=29,934$  dhe probabiliteti i marrjes së një vlere të tillë  $F$  nën hipotezën bazë është 0,000. Dhe kjo vlerë është më e vogël se 0,05, prandaj ne refuzojmë hipotezën bazë dhe pranojmë atë alternative, ku të paktën njëri nga variablat shpjegues ka lidhje me variablin e shpjeguar.

**Tabela 5: Analiza e Variancës**

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
2	Regression	29,809	3	9,936	29,934	.000
	Residual	15,601	47	0,331		
	Total	45,410	50			

Burimi: Gjetjet e Kërkimit

**Tabela 6: Parashikimet e Parametrave**

Model	Unstandardized Coefficients	t	Sig.	95.0% Confidence Interval for B			
	B	Std. Error		Lower Bound Upper Bound			
2	(Constant)	0,812	,123	6,694	,000	0,564	1,060
	SIK*BNJ	-,038	,034	-1,112	,272	-,106	,035
	SIK*SB	,115	,043	2,654	,011	,028	,203
	SIK*KB	,185	,062	2,984	,005	,017	,260

Burimi: Gjetjet e Kërkimit



$\beta_0$  konstantja, e cila tregon vlerën e EO kur vlera e të gjithë variablave të pavarur është e barabartë me 0, EO do të ketë rritje 0,812.

$H_0$ : SIK që moderohen nga BNJ nuk ndikojnë në efikasitetin e organizatës.

$H_1$ : SIK që moderohen nga BNJ ndikojnë në efikasitetin e organizatës.

Koeficienti i pjerrësisë  $\beta_5 = -0,038$  dhe p-(value) ( $\beta_5$ ) = 0,272 > 0,05; prandaj

$H_0$  nuk hidhet poshtë, pra koeficienti  $\beta_5$  nuk është statistikisht domethënës.

SIK që moderohet nga BNJ nuk kontribuojnë në shpjegueshmërinë e EO.

$H_0$ : SIK që moderohen nga SB nuk ndikojnë në efikasitetin e organizatës.

$H_1$ : SIK që moderohen nga SB ndikojnë në efikasitetin e organizatës.

Koeficienti i pjerrësisë  $\beta_6 = 0,115$  dhe p-(value) ( $\beta_6$ ) = 0,011 < 0,05; prandaj

$H_0$  hidhet poshtë, pra koeficienti  $\beta_6$  është statistikisht domethënës. SIK që

moderohet nga SB kontribuon në shpjegueshmërinë e EO, me rritjen me 1

njësi, do të sjellë rritje me 0,115 njësi në EO.

$H_0$ : SIK që moderohen nga KB nuk ndikojnë në efikasitetin e organizatës.

$H_1$ : SIK që moderohen nga KB ndikojnë në efikasitetin e organizatës.

Koeficienti i pjerrësisë  $\beta_7 = 0,185$  dhe p-(value) ( $\beta_7$ ) = 0,005 < 0,05; prandaj

$H_0$  hidhet poshtë, pra koeficienti  $\beta_7$  është statistikisht domethënës. SIK që

moderohet nga KB kontribuon në shpjegueshmërinë e EO, me rritjen me 1

njësi, do të sjellë rritje me 0,185 njësi në EO.

Gjithashtu si vlera e t-së si intervalet e besueshmërisë i plotësojnë kushtet për vlefshmërinë e hipotezave që dolën të rëndësishme statistikisht.

### IV.6.3 Modeli 3

Në modelin e tretë do të bëjmë analizën e regresionit duke përfshirë main effects dhe interaction effect.

**Tabela 7: Përmbledhja e modelit**

Model	R	R Square	Adjusted Square	R Std. Error of the Estimate	Durbin-Watson
1	,874	,765	,772	,406	1,63

Burimi: Gjetjet e Kërkimit

Koeficienti i determinacionit i cili është  $R^2 = 0,765$  që do të thotë se 76,5% e variacionit të efikasitetit të firmave në Shkodër arrin të shpjegohet nga kontributi i përbashkët i variablave të pavarur.

Adjusted  $R^2$  në modelin e tretë përsëri është rritur dhe testi Durbin-Watson është i pranueshëm, pra nuk ka autokorrelacion.

**Tabela 8: Analiza e Variancës**

Model	Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
3 Regression	34,760	7	4,965	20,049	,000
Residual	10,650	43	,247		
Total	45,410	50			

Burimi: Gjetjet e Kërkimit

Vlera e  $F=20,049$  dhe probabiliteti i marrjes së një vlere të tillë  $F$  nën hipotezën bazë është 0,000. Dhe kjo vlerë është më e vogël se 0,05, hipoteza  $H_0$  do të refuzohet. Prandaj ne refuzojmë hipotezën bazë dhe pranojmë atë alternative, ku të paktën njëri nga variablat shpjegues ka lidhje me variablin e shpjeguar.

**Tabela 9: Parashikimet e Parametrave**

Model	Unstandardized Coefficients	t	Sig.	95.0% Confidence Interval for B	
	B	Std. Error		Lower Bound Upper Bound	
3 (Constant)	,506	,216	2,345	,020	,217 ,660
SIK	,285	,104	2,744	,009	,076 ,493
BNJ	,431	,204	2,116	,040	,021 ,841
SB	-,088	,161	-,545	,588	-,412 ,237
KB	0,626	,123	5,078	,000	,378 ,874
SIK*BNJ	,025	,137	,185	,254	-,252 ,303
SIK*SB	,224	,051	4,353	,000	,120 ,327
SIK*KB	,236	,045	5,239	,000	,146 ,327

Burimi: Gjetjet e Kërkimit

$\beta_0$  konstantja, e cila tregon vlerën e EO kur vlera e të gjithë variablave të pavarur është e barabartë me 0, EO do të ketë rritje 0,506.

$p$ -(value)  $\beta_1, \beta_2, \beta_4, \beta_6, \beta_7, < 0,05$ ; prandaj  $H_0$  hidhet poshtë, pra koeficientët janë statistikisht domethënës. Në interpretimin e tyre mund të themi:

SIK kontribuon në shpjegueshmërinë e EO, me rritjen me 1 njësi, do të sjellë rritje me 0,285 njësi në EO.

BNJ kontribuon në shpjegueshmërinë e EO, me rritjen me 1 njësi, do të sjellë rritje me 0,431 njësi në EO.

KB kontribuon në shpjegueshmërinë e EO, me rritjen me 1 njësi, do të sjellë rritje me 0,626 njësi në EO.

SIK që moderohen nga SB kontribuojnë në shpjegueshmërinë e EO, me rritjen me 1 njësi, do të sjellë rritje me 0,224 njësi në EO.

SIK që moderohen nga KB kontribuojnë në shpjegueshmërinë e EO, me rritjen me 1 njësi, do të sjellë rritje me 0,236 njësi në EO.

p-(value)  $\beta_3, \beta_5 > 0,05$  prandaj  $H_0$  nuk hidhet poshtë, pra koeficientë nuk janë statistikisht domethënës pra nuk kontribuojnë në shpjegueshmërinë e EO.

#### IV.7. Përmbledhje dhe interpretim i gjetjeve

**Tabela 10. Përmbledhja e gjetjeve**

H <sub>1</sub>	Ekziston një marrëdhënie midis Sistemit të Informacionit Kontabël dhe efikasitetit të organizatës.	Pranohet
H <sub>2</sub>	Ekziston një marrëdhënie midis burimeve njerëzore dhe efikasitetit të organizatës.	Pranohet
H <sub>3</sub>	Ekziston një marrëdhënie midis strategjisë së biznesit dhe efikasitetit të organizatës.	Refuzohet
H <sub>4</sub>	Ekziston një marrëdhënie midis kontrolleve të brendshme dhe efikasitetit të organizatës.	Pranohet
H <sub>5</sub>	Ekziston një marrëdhënie midis Sistemit të Informacionit Kontabël dhe efikasitetit të organizatës që moderohet nga një personel profesionistësh dhe kontabël.	Refuzohet
H <sub>6</sub>	Ekziston një marrëdhënie midis Sistemit të Informacionit Kontabël dhe efikasitetit të organizatës që moderohet nga strategjia e biznesit, strategjia e menaxherit dhe angazhimi i tij.	Pranohet
H <sub>7</sub>	Ekziston një marrëdhënie midis Sistemit të Informacionit Kontabël dhe efikasitetit të organizatës që moderohet nga kontrollet e brendshme.	Pranohet

Burimi: Gjetjet e Kërkimit

Modeli përfundimtar paraqet sesi ndikojnë këto variabla duke parë edhe main effects dhe interaction effect së bashku. Nga ky model dolën të parëndësishëm statistikisht strategjia e biznesit dhe burimet njerëzore që ndikojnë në Sistemin e Informacionit Kontabël. Ndërsa variablat e tjerë janë të rëndësishëm statistikisht me nivel rëndësie 5%.

**Konkluzione**

Efikasiteti i kompanive në përbushjen e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara rritet nëpërmjet përdorimit të Sistemeve të Informacionit Kontabël.

Kompanitë kanë një staf kërkues ndaj punës gjithashtu dhe kontroll të brendshëm mjaft efektiv duke krijuar rritje në efikasitetin e organizatës.

Strategjitë e biznesit në SIK dhe kontrollet e brendshme në SIK ndikojnë drejtpërdrejt në efikasitetin e organizatës.

Kompanitë nuk ndjekin një strategji të duhur dhe stafi që përdor SIK nuk është mjaft i kualifikuar.

**Rekomandime**

Që kompanitë të kenë raporte cilësore dhe të kuptueshme, ata duhet të investojnë në SIK.

Kompanitë të adoptojnë SIK në përpjekje për të siguruar korrektësi në raportim dhe menaxhim të të dhënave.

Në burimet njerëzore të organizatës duhet të rriten udhëzimet e duhura dhe të sigurojnë që stafi është i kualifikuar në procesin e përdorimit të SIK.

Duhet investuar më shumë te strategjitë e biznesit, pasi luan një rol të rëndësishëm për të rritur të ardhurat dhe për të ulur kostot, gjithashtu krijon një marrëdhënie strategjike me klientët dhe furnitorët.

**REFERENCA**

- Amanamah, R.B., Morrison, A., & Asiedu, K. (2016). Computerized Accounting Systems Usage by Small and Medium Scale Enterprises in Kumasi Metropolis, Ghana. *Research Journal of Finance and Accounting*, Vol.7, No.16, 16.
- Flamholtz & Bullen (2004). "Factors influencing the alignment of accounting information systems in small and medium sized Malaysian manufacturing firms", *Journal of Information Systems and Small Business*, vol. 1, n.1-2: 1-20.
- Grande, E.U., Estebanez, R.P., & Colomina, C.M. (2011). The impact of Accounting Information Systems (AIS) on performance measures: empirical evidence in Spanish SMEs. *The International Journal of Digital Accounting Research*, Vol. 11, 2011 25 – 43.
- McCann, J. (2004). *Organizational Effectiveness: Changing Concepts for Changing Environments*. Human Resource, 27, 42-50.
- O'Brien, J. A., and G. M. Marakas. 2008. *Management Information Systems*. New York, NY: McGraw Hill, Inc.
- O'Brien, James A. & Maracas, George M. (2010). *Introduction to information system*. 15<sup>th</sup> edition. NY: McGraw-Hill Irwin.
- Sajady, H., Dastgir, M., Hashem, N. (2008), Evaluation of the effectiveness of accounting information systems. *International Journal of Information Science & Technology*, 6(2), 49-59
- Scott (2005). An analysis of organizational behavior and organizational performance. *Organizational Behavior & Human Performance*, 9(1), 78-99.

## **LARGIMI I KAPITALIT NJERËZOR, “BRAIN DRAIN” DHE NDIKIMI EKONOMIK**

Orsola Deda<sup>1</sup>, Fatbardha Molla (Beqiri)<sup>2</sup>

*Master shkencor në Kontabilitet  
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Financë - Kontabilitet*

### **ABSTRAKT**

Një nga problemet kryesore me të cilat përballet Shqipëria dhe rajoni është largimi i kapitalit njerëzor dhe sidomos ai i kualifikuar. Brain drain, fenomeni i emigrimit të kapitalit intelektual, po sjell pasoja ekonomike në vend çdo vit e më shumë. Ky punim është një vlerë e shtuar në kornizën e studimeve të migracionit dhe ekonomisë në Shqipëri për të cilën nuk ka mjaftueshëm hulumtime.

Punimi ka për qëllim të studiojë këtë fenomen, arsyet dhe pasojat që sjell në vend. Janë marrë në studim variabla, si: norma e papunësisë totale, pesha e borxhit publik në GDP, rritja e normës së GDP reale dhe indeksi i

---

<sup>1</sup> Orsola Deda, është diplomuar në vitin 2020 në Bachelor Financë-Kontabilitet pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”. Në vitin 2022 ka marrë titullin Master Shkencor Kontabilitet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi”. Ka marrë pjesë në internshipe në disa zyra kontabël dhe në Drejtorinë e të Ardhurave në Bashkinë Shkodër. Gjithashtu ka marrë pjesë në Konferencën Studentore 2022 “Sfidat e Zhvillimit Rajonal” organizuar nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” ku ka marrë dhe çmimin e parë.

<sup>2</sup> Fatbardha Molla (Beqiri) pas mbarimit të studimeve në 1993-1994 ka punuar në Degën e Thesarit Shkodër si specialiste e të ardhurave. Që nga viti 2004 punon si pedagoge e brendshme pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, për lëndet Analizë Financiare, Financë Publike, Kontabilitet Bujqësor, Hyrje në Financë, Kontabilitet Financiar, Kontabilitet Financiar i Avancuar, Parime të Kontabilitetit dhe Analizë Financiare. Pas vitit 2011 është titullare e lëndëve Analizë e Pasqyrave Financiare, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit në ciklin Master Shkencor Kontabilitet dhe Analizë Kredie në Master Profesional Financë - Bankë.

Gjatë vitit mësimor 2007-2008 dhe 2008-2009 ka punuar si pedagoge e jashtme pranë Universitetit Bujqësor Tiranë në departamentin e Financë-Kontabilitetit në lëndët Kontabilitet i Aplikuar dhe Bazat e Kontabilitetit. Ka arritur disa grada shkencore, si: Doktor i shkencave Ekonomike dhe Agrobiznesit” - 10 korrik 2009; Profesor i asociuar i Shkencave Ekonomike - 4 korrik 2012, Profesor - 12.04.2018 pranë departamentit “Financë-Kontabilitet” në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit në Universitetin Bujqësor Tiranë. Ka marrë pjesë në shumë Konferenca Shkencore dhe është autore e shumë artikujve brenda dhe jashtë vendit.

efektivitetit të qeverisë, për një analizë më të plotë. Ky studim mund t'u vijë në ndihmë organeve arsimore, qeveritare, organizatave që studiojnë migracionin dhe bizneseve. Metodologjia e përdorur për të realizuar qëllimin e këtij punimi konsiston në analizë empirike me model regresioni linear të shumëfishtë për të vlerësuar ndikimin ekonomik tek emigrimi. Tema është mbështetur në kërkim sekondar dhe janë përdorur të dhëna vjetore nga viti 2011 deri në vitin 2021.

Rezultatet zbulojnë një lidhje të fortë statistikisht domethënëse mes normës së emigrimit dhe variablave shpjegues që arrijnë të shpjegojnë 89.5% të variablit tonë të studimit. Emigracioni ulet nga investimet që bëhen nëpërmjet borxhit publik dhe ka lidhje negative me rritjen ekonomike. Gjetjet tregojnë që problemi i emigracionit ndikohet nga kombinimi i faktorëve ekonomik-politiko-arsimor. Çekuilibri i kërkesës dhe ofertës në tregun e punës bëhet nxitës për migracionin brenda dhe jashtë vendit.

**Fjalët kyçe:** kapitali njerëzor, brain drain, biznesi, rritja ekonomike, Shqipëri.

### **Human capital flight, “Brain Drain” and the economic impact**

#### **ABSTRACT**

One of the main problems faced by Albania and the region is the departure of human capital, especially the qualified one. Brain drain, the phenomenon of intellectual capital emigration, is bringing economic consequences to the country every year and more. This paper is an added value in the framework of migration and economy studies in Albania, for which there is not enough research.

The paper aims to study this phenomenon, the reasons and consequences it brings to the country. Variables such as the total unemployment rate, the weight of public debt in GDP, the growth rate of real GDP and the government effectiveness index have been studied for a more complete analysis. This study can be of help to educational bodies, government bodies, organizations that study migration and businesses. The methodology used to realize the purpose of this paper consists of empirical analysis with a multiple linear regression model to assess the economic impact on emigration. The topic is based on secondary research and used annual data from 2011 to 2021.

The results reveal a strong statistically significant relationship between the emigration rate and the explanatory variables that manage to explain 89.5% of our study variable. Emigration is reduced by investments made through

public debt and has a negative relationship with economic growth. The findings show that the immigration problem is influenced by a combination of economic-political-educational factors. The imbalance of demand and supply in the labor market becomes an incentive for migration inside and outside the country.

**Keywords:** human capital, brain drain, business, economic growth, Albania.

## 1. Kapitali njerëzor dhe rëndësia e tij në rritjen ekonomike

Kapitali njerëzor është një nga konceptet themelore të teorive ekonomike dhe konsiderohet si terësia e investimeve, në edukim dhe trajnime në lidhje me punën, që përmirësojnë produktivitetin e individit në tregun e punës. I pari ekonomist që dhe identifikon si aset kapitalin njerëzor është Adam Smith në “Pasuria e kombeve” ku identifikoi përmirësimin e aftësive si një burim themelor i progresit ekonomik dhe rritjes së mirëqenies.

Ka dy modele kryesore të rritjes ekonomike që përfshijnë dhe kapitalin njerëzor si faktor, por me përjasje të ndryshme. Modeli i rritjes Neo-klasik (Solow)<sup>3</sup> e konsideron rritjen e kapitalit njerëzor si ndikues në rritjen marxhinale të produktit të kapitalit fizik, duke rritur kështu prodhimin total. Gjithsesi, në periudhë afatgjatë, ekonomia do të arrijë një gjendje më të qëndrueshme dhe çdo rritje në normën e rritjes ekonomike do të jetë kryesisht rezultat i progresit teknologjik. Modeli Endogjen i rritjes u zhvillua nga ekonomistët Paul Romer (1986) dhe Robert Lucas (1988) dhe e vendoste kapitalin njerëzor në qendër të rritjes ekonomike. “Motori kryesor i rritjes është akumulimi i kapitalit njerëzor (njohurive) dhe burimi kryesor i diferencave në standardet e jetesës ndër shtete janë diferencat në kapitalet njerëzore”.<sup>4</sup>

## 2. Roli i kapitalit njerëzor në biznes dhe paraqitja në kontabilitet

Për bizneset, kapitali njerëzor është një aset i pashtershëm dhe prioritar që krijon vlerë të shtuar dhe është matja e vlerës ekonomike që një punonjës ofron, nëpërmjet njohurive dhe aftësive të tij.

Me rëndësi është që për këtë kapital të regjistrohen shpenzimet e personelit të njësive së biznesit, në varësi të ciklit të biznesit ku ndodhet kompania.

<sup>3</sup> Solow, M., R. (1956). A Contribution to the Theory of Economic Growth. 70(1), pp. 66-67.

<sup>4</sup> Lucas, Robert (1993). Making a Miracle. *Econometrica*. 61(2), pp. 251-272.

Gjendet me vlerë shtimi i nënlogarive të veçanta për operacionet kontabël që lidhen me zhvillimin dhe mbajtjen e stafit. Me pasurimin e pasqyarve financiare me këto llogari, mund të kryhet një analizë e shpenzimeve të kapitalit njerëzor më e thellë. Deklarimi i kapitalit njerëzor në aktive do ta afrojë vlerën kontabël të shoqërisë me vlerën e saj të tregut.

Vlera e tregut është ajo që inkurajon investitorin të marrë një vendim nëse do të investojë apo jo në një kompani.

Matja e vlerës së kontabël të burimeve njerëzore ndihmon në një dokumentim të saktë të aseteve të subjektit duke përfshirë kostot e rekrutimit, zgjedhjes, trajnimit dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor.

- Model i kostos historike

Kjo metodë merr parasysh të gjitha kostot përgjegjëse për kapitalin njerëzor në një organizatë, si: rekrutimin, punësimin, trajnimin dhe zhvillimin, largimet apo pezullimet nga puna, lejen e punës, eksperiencën, shtesat në pagë, ineficiencën ose humbjen e produktivitetit të punonjësve. Subjekti duhet të ndajë koston e kapitalit njerëzor që duhet trajtuar si shpenzim, pjesa e konsumuar gjatë vitit aktual, dhe pjesa që duhet kapitalizuar e cila pritet të gjenerojë përfitime në të ardhmen. (SNK 1)

- Modeli i vlerës aktuale

Metoda e vlerës përcakton vlerën e sotme ekonomike të punonjësit të një kompanie bazuar në vlerën prezente të përfitimeve të ardhshme, rregulluar me probabilitetin e mundësisë së ndodhjes së ngjarjeve të caktuara (largimi nga puna; pensionimi; vdekja.)

Shpërblimi në çdo njësi ekonomike drejtohet nga performanca ndërsa mbajtja e kapitalit njerëzor është funksion i marrëdhënies midis kostos së mbajtjes së tij dhe përfitimeve të pritshme.

### **3. Migrimi i kapitalit njerëzor dhe fenomeni “brain drain”**

Migrimi brenda vendit, qendëron aktivitetin ekonomik në disa qytete duke lënë në prapavijë zhvillimin ekonomik dhe mundësitë për network dhe një ekosistem më të shpërndarë në qytetet e tjera të vendit. Në rastin e vendeve në zhvillim, më problem paraqet migrimi në vendet e zhvilluara për disa arsye: situata e paqëndrueshme politike, mundësi më të mira në tregun e punës, papunësia, varfëria, lufta apo dhe pasojat e ndryshimeve klimatike.

“Brain Drain” (ikja e trurit) është emigrimi i punonjësve të kualifikuar dhe të aftë. 41% e emigrantëve të kualifikuar që jetonin në vendet e OECD në



2000 kanë emigruar përgjatë një dekade.<sup>5</sup> Largimi i kapitalit njerëzor të kualifikuar ka pasoja negative për vendet e origjinës dhe ato pritëse në tregjet e punës dhe në sektorë, si: shëndetësia, shërbimet dhe arsimit. Kur shkalla e emigrimit tejkalon një pragun e vlerësuar 20%, vendi i origjinës përjeton një humbje neto të kapitalit njerëzor. Humbja neto rritet në mënyrë eksponenciale me shkallën e emigrimit të kualifikuar dhe duke qenë se gratë në vendet në zhvillim ende përballen me akses të pabarabartë në arsimin terciar (Bachelor) dhe punët me kualifikim të lartë, emigrimi i grave të arsimuara ka të ngjarë të gjenerojë humbje relative më të larta të kapitalit njerëzor sesa emigrimi i meshkujve të kualifikuar.<sup>6</sup> Largimi i grupmoshës së re dhe trendi i uljes së lindjeve në vendet në zhvillim ka ndikuar në uljen dhe plakjen e popullsisë në të njëjtën kohë.

### 3.1. Shkaqet e “Brain Drain”

- Paqëndrueshmëria ekonomike, politike, korrupsioni në nivele të ndryshme të administratës shtetërore apo luftërat.
- Diskriminime me bazë gjinore, race ose feje në mundësitë për edukim dhe punësim.
- Standardi i ulët i jetesës, taksat e larta dhe mungesa e shërbimeve.
- Niveli i ulët i pagave, ulja e fuqisë blerëse dhe nivelet e larta të papunësisë. Kushtet jo të përshtatshme të punës.
- Ulja e cilësisë së sistemit arsimor dhe stafit pedagogjik.
- Mungesa e fondeve ose mosshfrytëzimi për qëllimin e caktuar për kërkime shkencore, biblioteka dhe sistemet teknologjike.
- Mungesa e investimeve dhe mbështetjes për sipërmarrje.
- Shtypja e demokracisë dhe censura.
- Mungesa e perspektivës dhe mundësive për promovim në punën aktuale, apo gjetjen e një pune tjetër më të mirë.
- Mundësi më të mira arsimimi në vendet pritëse në nivele (pas)universitare, bursa, kualifikime të njohura ndërkombëtarisht.

### 3.2. Pasojat e “Brain Drain”

Pasojat *negative* për zhvillimin e vendit, sidomos në aspektin arsimor dhe ekonomik me humbjen e eksperiencës, talenteve, ideve dhe inovacionit. Ky

---

<sup>5</sup> Docquier, F., Lohest, O. & Marfouk, A. (2007). Brain Drain in Developing Countries. The World Bank Economic Review 21 (2), pp. 196.

<sup>6</sup> Docquier, F., Lowell, L., B. & Marfouk, A. (2009). A Gendered Assessment of Highly Skilled Emigration. Vol. 35(2), pp. 298.

problem evidentohet më qartë në vendet me të ardhura mesatare, ku kapitali njerëzor ka arsye për t'u larguar, por edhe mundësitë financiare dhe institucionale. Impakti i fenomenit ndihet së pari uljen e cilësisë së shërbimeve nga një personel më pak i kualifikuar dhe në sektorë kritikë, si: shëndetësia, arsimit, biznesi dhe teknologjia. Efektet negative mund të ndihen dhe në vendet pritëse mbi emigrantët të cilët kryejnë punë për të cilat janë të mbikualifikuar. Kjo rezulton në fenomenin “brain waste” apo shpërdorimi i trurit, ku vetëm 30% e personave me shkallë të lartë edukimi (arsimim terciar) në vendet e OECD kanë fituar vende pune në pozicione të larta në vendet e Evropës dhe Amerikës së Veriut.<sup>7</sup>

Një tjetër tjetër pasojë është impakti mbi kostot fiskale në vend.<sup>8</sup> Sipas studimeve mbi “brain drain” u vu në dukje se emigrantët me aftësi të larta marrin me vete arsimin e tyre, i cili financohej nga taksat mbi banorët në vendin origjinë, por më pas nuk kontribuojnë në sistemin tatimor. Shkalla e financimit publik mbi arsimin varet nga një analizë që do të bëhej në këtë rast duke marrë parasysh dhe kostot sunk (të zhytura; kostot e kryera mbi një investim që nuk mund të kthehen mbrapsht.) Kjo varet nga politikat, sistemi i taksimit dhe prioritetet e çdo vendi.

Fenomeni rezervon dhe disa impakte *pozitive*, jo vetëm për emigruesit intelektualë, por edhe për vendin origjinë. Mundësitë për një arsim më të mirë në vende të zhvilluara dhe bursat për studentët e huaj stimulojnë kapitalin intelektual në edukim (pas)universitar dhe trajnime me anë të programeve që mund të kenë kusht kthimin në atdhe dhe dhënien e kontributit për një periudhë të caktuar kohe.<sup>9</sup> Ky shkëmbim eksperiencash u vjen në ndihmë institucioneve të vendeve origjinë në rritjen e cilësisë së metodave të tyre dhe adoptimin e teknologjive të reja inovative.

Remitancat janë kontributi më i drejtpërdrejtë i emigrantëve në vendin e tyre. Problem mbetet evidentimi se në çfarë shkalle emigrantët e kualifikuar sjellin remitanca në vendin origjinë. Ka periudha kur përjetohet “brain gain” ose fitim i trurit, pra një numër i caktuar i kapitalit intelektual të migruar kthehet në vendin origjinë nga përmirësimi i situatës ekonomike në vend ose i tregut të punës. Impakti i favorshëm evidentohet në sjelljen e

---

<sup>7</sup> UNESCO (2018). What a waste: ensure migrants and refugees' qualifications and prior learning are recognized. Global Education Monitoring Report Team, pp. 10.

<sup>8</sup> Bhagwati, J. & Hamada, K.(1974) The Brain Drain, International Integration of Markets for Professionals and Unemployment: A Theoretical Analysis. Journal of Development Economics, 19-42.


<sup>9</sup> Beine, M., Docquier, F. & Rapoport, H. (2008). Brain drain and human capital formation in developing countries: Winners and losers. Economic Journal 118(4): pp. 631-652.

eksperiencave, burimeve financiare dhe lidhjeve të biznesit nga jashtë vendit.

#### 4. Pasqyra e kapitalit njerëzor dhe *brain drain* në Shqipëri

Largimi i kapitalit njerëzor ka qenë një problem serioz për Shqipërinë që nga vitet '90 me valët e para migratore. Sipas një raporti të OECD, Shqipëria renditet e katërta në botë për nga migrimi i punonjësve me nivel të lartë kualifikimi. Kjo ka ndikuar në tregun e punës dhe ka kontribuar në fenomenin e ikjes së trurit. Për shkak të valëve konstante të emigrimit dhe trendit në rënie të numrit të lindjeve që nga viti 2014, popullsia e Shqipërisë ka ardhur duke u tkurrur çdo vit.

**Figura 2.** Numri i emigrantëve, migrantëve dhe migracioni neto në Shqipëri, 2011-2021.




**Burimi:** INSTAT

Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (IOM) dhe INSTAT zhvilluan një pyetësor migracioni në nivel Njësie Ekonomike Familjare (HouseHold).<sup>10</sup> Të dhënat treguan se 47,1% e personave me nivel të lartë arsimimi nga Shqipëria kanë emigruar. Këto shifra bëhen edhe më alarmante nëse

<sup>10</sup> INSTAT, IOM, CESS (2020). National Household Migration Survey in Albania.

vendosen në raport me moshën e emigrantëve me nivel të lartë kualifikimi pasi “brain drain” është më e përhapur si fenomen tek grupmoshat kyç për të ardhmen e një vendi, 15-24 vjeç. Sipas një indikatori të përlllogaritur nga Fund for Peace, indikatori (0 i ulët- 10 i lartë) i ikjes së trurit në Shqipëri ka pësuar rritje që nga viti 2013, duke rezultuar në vitin 2021 me 8.3 pikë, më e larta nga të dhënat që në 2007. Ky matës merr parasysh impaktin ekonomik të largimit të kapitalit njerëzor (për arsye ekonomike ose politike.)

**Figura 3.** Indeksi i brain drain (ikjes së trurit) në Shqipëri, 2007-2021



**Burimi:** Fragile States Index, Fund for Peace.

Sipas raportit të Fondit Monetar Ndërkombëtar në vitin 2019, emigracioni në Shqipëri dhe vende të tjera në zhvillim në të njëjtin stad, ka fshirë 0.6% deri 0.9% të GDP së vendit.<sup>11</sup> Me këto shifra dëmi për Shqipërinë me një GDP mesatare rreth 15 miliardë euro në vitet e fundit, shkon deri në 140 milionë euro në vit. Gjatë periudhës 2015-2019 popullsia në moshë pune u ul me 0.6%, ndërsa ajo mbi 65 vjeç u rrit me 12%. Ky trend mund të çojë në uljen e forcës punëtore me 20% deri në vitin 2050.<sup>12</sup>

<sup>11</sup> IMF .(2019). Albania:Second Post-Program Monitoring Discussions-Press Release and Staff Report, *IMF Staff Country Reports*, 2019(207),

<sup>12</sup> IMF .(2019). Demographic Headwinds in Central and Eastern Europe. Departmental Paper (11).

#### 4.1. Arsyet e migrimit nga Shqipëria

- Buxheti i shkurtuar për zhvillim dhe kërkim shkencor në Shqipëri. Që nga 2008 rezulton 0.15% e GDP. (Banka Botërore).
- Ndërhyrja politike në kërkimet shtetërore, institucionet e arsimit të lartë dhe institutet e studimit. Dështimi i dekomunizimit, nepotizmi dhe reformat e dështuara arsimore.<sup>13</sup>
- Sektori privat i dobët nga taksat e larta, mungesa e inovacionit dhe teknologjive të reja.
- Cilësia e arsimit në ulje ka bërë që studentët shqiptarë të zgjedhin gjithmonë e më shumë që të studiojnë jashtë vendit. Mbi 18 mijë studentë shqiptarë studiojnë jashtë dhe 94 % e tyre nuk duan të kthehen. (UNESCO, 2020)

**Figura 4.** Faktorët kryesorë për emigrimin nga Shqipëria



**Burimi:** CESS, Potential migration survey, 2018.

#### 4.2. Krahasimi me vendet e rajonit

Sipas raportit Balkan Barometer 2021<sup>14</sup>, në pyetësorin e opinionit publik dhe i biznesit, në rajonin e Ballkanit Perëndimor janë evidentuar të njëjtat probleme që vazhdojnë të pengojnë zhvillimin e rajonit prej vitesh, si: papunësia, situata ekonomike, korrupsioni dhe brain drain/emigrimi.

<sup>13</sup> AIIS (2005). Albanian Brain Drain: Turning the Tide. pp. 15.

<sup>14</sup> Regional Cooperation Council (2021). Balkan Barometer Public Opinion Survey.

**Tabela 1. Problemet e rajonit të Ballkanit Perëndimor sipas qytetarëve**

	Balkan Barometer 2015	Balkan Barometer 2021
Papunësia	64 %	49%
Situata ekonomike	58%	46%
Korrupsioni	15%	26%
Brain drain/emigrimi	0%	13%
Krimi	19%	16%


**Burimi:** Balkan Barometer 2021, Highlights.

Sipas raportit të OECD Shqipëria është e para në listën e emigracionit duke përbërë 29% të migracionit në vendet e OECD, ndjekur nga Bosnia Herzegovina me 20% dhe Maqedonia e Veriut me 18 %. Grupmosha e re (15-24 vjeç) e rajonit nuk është e mirë integruar në tregjet e punës dhe raportohet që rreth 1 në 4 persona të moshës 15-24 vjeç nuk merr pjesë në arsimim, trajnime apo punësim në Ballkanin Perëndimor.<sup>15</sup>

Një nga arsyet primare për emigrim është niveli i të ardhurave personale. Evidentohet se Shqipëria ka pagë minimale 236 €, e dyta më e ulët në rajon; pagë mesatare 384 €, më e ulëta në rajon dhe GDP/frymë (me fuqi blerëse të njëjtë) 16,667 \$, e dyta më e ulët në Ballkanin Perëndimor.

Nga ana tjetër situata më e mirë paraqitet për Malin e Zi me pagë minimale dhe mesatare më të lartë në rajon, po ashtu dhe GDP/frymë më të lartë në Ballkanin Perëndimor. Kjo i atribuohet kryesisht industrisë së zhvilluar të turizmit që përbën rreth 1/5 e GDP-së vendit. (EBRD, Transition report 2021)


**Figura 8.** Paga minimale, paga mesatare dhe GDP/frymë (me fuqi të njëjtë blerëse) për Ballkanin Perëndimor, 2021.



**Burimi:** Eurostat, IMF.

<sup>15</sup> OECD (2021), Multi-dimensional Review of the Western Balkans: Assessing Opportunities and Constraints, OECD Development Pathways, OECD Publishing, Paris.

**Figura 9.** Indeksi i brain drain (ikjes së trurit) në Ballkanin Perëndimor, 2006-2021.



**Burimi:** Fragile States Index, Fund for Peace.

Indeksi i brain drain tregon se vitet e fundit ka një rritje të largimit të kapitalit njerëzor të kualifikuar nga rajoni, sidomos tek të sapodiplomuarit nga universiteti. Shqipëria ka indeksin më të lartë 8.3, ndjekur nga Bosnia & Herzegovina me 6.5. Më mirë paraqitet situata e Malit të Zi që ka indeksin më të ulët në rajon 4.7, pavarësisht se në trend rritje.

## 5. Metodologjia

Metodologjia e përdorur për analizën empirike është modeli i regresionit linear të shumëfishtë për të vlerësuar ndikimin ekonomik tek emigrimi dhe anasjelltas. Kjo analizë statistike na ndihmon në modelimin dhe shpjegimin e lidhjes mes variablit të varur dhe variablave të pavarur ose shpjegues të zgjedhur. Janë përdorur të dhëna vjetore, pra një seri kohore e variablave në studim nga viti 2011 në vitin 2021. Numri i vëzhgimeve është 11 dhe kufizimi kryesor për një studim më të saktë dhe të detajuar është mungesa e informacionit për emigrimin vjetor para vitit 2011.

Qëllimi është analizimi i disa variablave ekonomikë dhe një indeksi, për një analizë më të plotë, për të parë ndikimin e tyre në emigracionin nga Shqipëria. Rezultatet janë marrë me ndihmën e programit statistikor SPSS statistics. Punimi është bazuar në burime sekondare, si: INSTAT, Banka

Botërore, United Nations, IOM, Eurostat, World Inequality Database dhe Fragile States Index.

### Model regresioni, ndikimi ekonomik tek emigracioni

$$Y = 27.33 + 0.42 X_1 - 0.31 X_2 - 12.4 X_3 + 0.72 X_4 + \mu$$

#### Variabli i varur:

**Y** - norma e emigrimit, tregon numrin e personave që emigrojnë për çdo 1000 persona në vit.

#### Variablat e pavarur:

**X<sub>1</sub>** - norma e papunësisë totale (%).

**X<sub>2</sub>** - borxhi publik/GDP, tregon sa % të GDP zë borxhi publik çdo vit.

**X<sub>3</sub>** - indeksi i efektivitetit qeveritar, merr vlerat nga -2.5 (efektivitet i dobët) në 2.5 (i lartë) dhe bazohet në perceptimet mbi cilësinë e shërbimeve publike, pavarësisë nga presionet politike dhe besueshmërinë në zbatimin politikave shtetërore (nga Banka Botërore).

**X<sub>4</sub>** - rritja ekonomike, që tregohet nga % e ndryshimit të GDP reale.

**μ** - termi i gabimit.

### 5.1. Statistikat përshkruese

*Tabela 2. Statistikat përshkruese të variablave*

Variablat	N	Mesatarja	Devijimi standard
<i>Norma e emigrimit (VV)</i>	11	14.7	3.01
<i>Norma e papunësisë</i>	11	14.18	2.21
<i>Borxhi publik/GDP</i>	11	69.7	5.59
<i>Indeksi efekt. qeveritar</i>	11	-0.09	0.13
<i>Rritja ekonomike</i>	11	3.1	2.05

**Burimi:** Autorja, SPSS (2022)

Gjatë periudhës marrë në studim, pra gjatë dekadës së fundit, në Shqipëri janë larguar mesatarisht 14.7 (pra mbi 14) persona për 1000 persona në vend, çdo vit, norma e papunësisë mesatarisht ishte 14.18%, masa e borxhit publik si pjesë e GDP mesatarisht ishte 69.7%, rritja e GDP reale ishte



mesatarisht 3.1 %. Ndërsa indeksi i efektivitetit qeveritar ishte mesatarisht -0.09, pra më afër skajit negativ -2.5 që tregon një efektivitet të dobët. Për arritjen në modelin përfundimtar janë marrë në studim lidhjet e variablit të varur edhe me disa variabla të tjerë të pavarur në studim, por për shkak të nivelit jo të mjaftueshëm të rëndësisë nuk janë përfshirë në modelin përfundimtar. Paga minimale, PBB për frymë, paga mesatare nuk mundën të përfshiheshin që tregon në një mënyrë se nuk mjafton vetëm rritja e këtyre indikatorëve në përmirësimin e situatës së largimit të kapitalit njerëzor.

**Tabela 3. Lidhja mes normës së emigrimit me variablat shpjegues**

Variablat	Koeficientët	Gabimi st.	p (Sig.)
<i>Konstantja</i>	27.33 ***	5.68	0.003
<i>Norma e papunësisë</i>	0.42 *	0.188	0.069
<i>Borxhi publik/GDP</i>	-0.307***	0.07	0.007
<i>Indeksi efekt. qeveritar</i>	-12.4**	3.35	0.01
<i>Rritja ekonomike</i>	0.715***	0.167	0.005
<i>N</i>	11		
<i>R</i>	0.946		
<i>R<sup>2</sup></i>	0.895		
<i>R<sup>2</sup> i rregulluar</i>	0.826		

**Burimi:** Autorja, SPSS (2022)

Shënim: Korrelacioni është i rëndësishëm statistikisht në nivelin 0.05, 0.01, dhe 0.000 për \*, \*\*, dhe \*\*\* respektivisht.

Konstantja tregon se nëse të gjithë variablat e pavarur janë zero në një moment të caktuar, 27.33 persona për 1000 vetë do të largoheshin në një vit nga vendi. Evidentohet se (në kushtet kur variablat e tjerë shpjegues mbeten konstantë në secilin rast): me rritjen me 1% të normës së papunësisë, norma e emigracionit rritet 0.42 njësi; me rritjen me 1% të GDP reale, norma e emigracionit rritet me 0.72 njësi; me rritjen me 1% të peshës së borxhit publik në GDP, ulet norma e emigrimit me 0.3 njësi; me rritjen e indeksit të efektivitetit qeveritar me një pikë (efektivitet më i lartë), ulet me 12.4 njësi norma e emigrimit. Këto koeficienta mund të shpjegohen me faktin që papunësia e lartë nxit emigrimin në një vend më të mirë, rritja e borxhit publik nxit investimet në vend që mund të ndikojë në uljen e emigrimit. Përmirësimi i indeksit të shëbimeve publike dhe efektivitetit, nga politikat shtetërore që ndërmerren, ulin numrin e emigrantëve. Ndërsa

rritja e emigrimit edhe pse rritet norma e GDP reale, tregon që rritja e GDP nuk mjafton vetëm për të mbajtur personat në vend, pasi ndikojnë dhe faktorë të tjerë. Në vendet në zhvillim, mundësitë më të mira ekonomike i japin shtysë emigrimit si investim për të ardhmen. Një rritje fillestare e normës së emigrimit bashkë me rritjen ekonomike që mund të jetë për një periudhë afatshkurtër, prandaj analiza mund të jetë më e plotë dhe shpjeguese pas disa vitesh.

Rezultatet e modelit të regresionit linear multivariabël tregojnë një nivel të lartë të  $R^2$  dhe  $R^2$  të rregulluar. Koeficienti e determinacionit tregon se 82.6% e variancës së normës së emigracionit shpjegohet nga variablat shpjegues, pra përafron shumë mirë të dhënat e vëzhgimit. Me nivel të lartë rëndësie 1% paraqiten variablat shpjegues: borxh publik/gdp dhe rritja e GDP reale. Asnjë nga variablat parashikues nuk asnjë VIF (faktor të variancës së inflacionit) nuk është mbi 10, por marrin vlera deri në 1.24, tregon që nuk ka multikolaritet mes variablave shpjeguese. Nga tabela e korrelacionit, lidhja më e fortë e variablit të varur është me peshën e borxhit publik në GDP (-0.66). Kjo lidhje negative mund të shpjegohet me faktin që borxhi përdoret për investime që ulin normën e emigrimit në një periudhë afatshkurtër, pasi në afatgjatë një borxh i lartë është një barrë e rëndë për gjeneratat e ardhme.

Për të provuar vlefshmërinë dhe rëndësinë e modelit, përdorimin testin global duke hedhur hipotezat dhe përdorur tabelën ANOVA.

**H<sub>0</sub>:** të gjithë koeficientët janë të barabartë me 0 (modeli është i parëndësishëm statistikisht).

**H<sub>1</sub>:** të paktën një nga koeficientët është i ndryshëm nga 0 (modeli është i rëndësishëm statistikisht).

Përdorim testin e Fisherit F, ku krahasojmë Fkritike, nga tabela e Fisherit në Apendiksin G, me  $F_{\logarituar}$  ose  $p(\text{sig.})$  e statistikës F me  $\alpha=0.05$ .

$F_{\logarituar}=12.845 > F_{\text{kritike}}(4,6)=4.53$   $p(\text{sig.}) e F= 0.004 < \alpha=0.05$

Këto dy tregues rezultojnë në rënien e hipotezës bazë, pra se modeli është i rëndësishëm statistikisht dhe të paktën një nga koeficientët është i ndryshëm nga zero.

## 6. Përfundimet e studimit

Bazuar në literaturën e rishikuar dhe punën studimore nxjerrim këto përfundime:

- ❖ Kapitali njerëzor ka një rëndësi të madhe për biznesin dhe pasurinë e një vendi, prandaj investimet në kualifikime, edukim dhe trajnime të tij janë të vlefshme. Paraqitja më e detajuar e kostove dhe vlerës së kapitalit njerëzor në një organizatë, ndihmon në saktësimin e vlerës kontabël duke e afruar me vlerën e tregut dhe ndikon pozitivisht në vendimet e investitorëve.
- ❖ Largimi i kapitalit njerëzor dhe sidomos atij të kualifikuar, ka marrë përmasa serioze duke ndikuar me hapa të shpejtë në uljen e popullsisë së Shqipërisë çdo vit. Dëmi në GDP nga shifrat e larta të emigracionit përlllogaritet mesatarisht 140 milionë euro në vit.
- ❖ Shqipëria renditet e katërta në botë në lidhje me emigrimin e kapitalit njerëzor të kualifikuar. Arsyet kryesore janë sistemi i dobët arsimor, mungesa e kërkimeve shkencore, korrupsioni, niveli i ulët i pagave, norma e paunësisë, kushtet jo të duhura të punës, mungesa e inovacionit dhe teknologjive të reja. Gjithashtu ajo paraqitet me treguesit më të ulët në rajon për pagën minimale, mesatare dhe GDP për frymë.
- ❖ Emigrimi i kapitalit njerëzor ka lënë një hendek në tregun e punës në Shqipëri, ku bizneset janë në krizë për fuqi punëtore, sidomos pas periudhës së pandemisë. Problem mbeten pagat e ulëta në krahasim me shpenzimet e konsumit dhe kushtet joadekuate të punës që dekurajojnë përpjekjet e të rinjve për punësimin më të shumtë në biznese.
- ❖ Analiza e regresionit zbuloi një marrëdhënie empirike të rëndësishme statistikisht mes “normës së emigracionit” dhe “ritjes ekonomike, peshës së borxhit publik dhe efektivitetit të qeverisë”, pra emigracioni ullet nga investimet që bëhen nëpërmjet borxhit publik, por sigurisht kjo kërkon analizë më të thellë, dhe ka lidhje negative me rritjen ekonomike. Pra rritja e GDP reale nuk është e mjaftueshme për frenimin e emigracionit. Variablat shpjegojnë “normën e emigracionit” në masën 89.5%.
- ❖ Këto përfundime tregojnë që problemi i emigracionit është i ndikuar nga kombinimi i faktorëve të sistemit ekonomik-politik-arsimor. Mungesa e diskutimeve konstruktive dhe këshillimit efektiv të karrierës bën që në arsimin e lartë të ketë mbingopje të disa degëve të studimit duke rezultuar në një treg pune të zbalancuar dhe sistem pagesash joadekuate. Çekuilibri i kërkesës dhe ofertës në tregun e punës bëhet nxitës për migracionin brenda dhe jashtë vendit.

## 7. Rekomandime

- ✓ Bashkëpunimi më i ngushtë i qeverisë me organizatat e huaja me fokus migrimin, në dokumentimin më të saktë të shifrave migratore, sipas

- nivelit të edukimit dhe në ndarjen mes emigrant të përkohshëm dhe të përhershëm.
- ✓ Orientimin e shpenzimeve publike drejt grupeve më vulnerabël, mbështetjes së rinisë, kapitalit njerëzor dhe inovacionit në vend. Ndhimohet në uljen e nivelit të lartë të borxhit publik që pavarësisht ndikimeve pozitive në periudhën afatshkurtër, është vetëm një barrë dhe pengesë për gjeneratat e ardhme të Shqipërisë drejt një zhvillimi ekonomik përtej tranzicionit vendnumëro.
  - ✓ Nxitjen e arsimit profesional, zanateve, trajnimeve dhe kualifikimeve të vazhdueshme për një shpërndarje në të mirë në tregun e punës dhe zhvillimin profesional të kapitalit njerëzor në vend.
  - ✓ Kalimin në “brain gain”, pra “fitimin e trurit” me bashkëpunime të profesionistëve dhe akademikëve shqiptarë nga diaspora me institucionet e vendit. Kjo duke nxitur projektet e përbashkëta të kërkimeve shkencore, konsultimeve me sektorin privat dhe shtetëror, konferenca ndërrajonale apo kontinentale dhe leksioneve në universitetet e vendit në kuadër të programeve exchange.
  - ✓ Përmirësimin e kulturës organizative dhe të punës në biznese, duke i dhënë rëndësinë e duhur kapitalit njerëzor me investime efektive si trajnime e kualifikime, pra si një aset i çmuar dhe i dobishëm për biznesin. Dhe jo me pikëpamjen e “punonjëseve” si një kapital lehtësisht i zevëndësueshëm dhe jo mjaftueshëm i rëndësishëm për t’i ofruar pagesën dhe kushtet e duhura të punës.
  - ✓ Sistemi i pagesave të ulëta në vend duhet të përditësohet në përputhje me nivelin e çmimeve, inflacionit në rritje dhe standardeve të jetesës në vend. Me pagën më të ulët mesatare në rajon, Shqipëria ka nevojë për një adresim të shpenzimeve publike drejt rritjes së nivelit të pagave dhe uljet hendeku me nivelin e pagave më të larta në rajon.

## 8. Kufizimet e studimit

Pavarësisht rëndësisë së studimit të kësaj teme, vështirësia e lartë qëndron në mungesën e të dhënave dhe informacioneve të plota mbi kontekstin e migracionit ndër vite. Shqipëria ka të dhëna vjetore mbi emigracionin, nga burimi zyrtar INSTAT, vetëm nga viti 2011. Kjo mungesë të dhënash vjetore që nga eksodi i viteve '90 ndikohet nga paqëndrueshmëria politike, institucionet e dobëta dhe mungesa e raportimeve për shkak të emigracionit të paligjshëm.

Kjo vlen dhe për variablat e marrë në studim dhe tjerë që nuk kanë të dhëna vjetore të qëndrueshme, sepse raportimet mungojnë ose në disa rasta janë të pasakta, pasi nuk përputhen me matjet e organizatave të huaja.

#### REFERENCA

- AHS (2005). Albanian Brain Drain: Turning the Tide.
- Banka Botërore (2021). Raporti Ekonomik i Rregullt për Ballkanin Perëndimor Nr: 19: Rimëkëmbje e vështirë.
- Beine, M., Docquier, F. & Rapoport, H. (2008). Brain drain and human capital formation in developing countries: Winners and losers. *Economic Journal* 118(4): pp. 631–652.
- Beine, M., Docquier, F. & Rapoport, H. (2001). “Brain Drain and Economic Growth: Theory and Evidence.” *Journal of Development Economics*, 64: 275-289.
- Bollard, A., David, M., Melanie M. & Rapoport, H. (2009) Remittances and the brain drain revisited: The microdata show that more educated migrants remit more. WB Policy Research Working Paper no. 5113.
- IMF (2021). Albania: 2021 Article IV Consultation-Press Release; Staff Report; and Statement by the Executive Director for Albania. pp. 9-10.
- IMF (2019). Albania: Second Post-Program Monitoring Discussions—Press Release and Staff Report, IMF Staff Country Reports, 2019(207)
- INSTAT, IOM, CESS (2020). National Household Migration Survey in Albania.
- Docquier, F., Lohest, O. & Marfouk, A. (2007). Brain Drain in Developing Countries. *The World Bank Economic Review* 21 (2).
- Docquier, F., Lowell, L., B. & Marfouk, A. (2009). A Gendered Assessment of Highly Skilled Emigration. Vol. 35(2), pp. 298.
- Flamholtz, E., Bullen, M. & Hua, W. (2002). Human resources accounting: a historical perspective and future implication management decision, 40(10), 947-954.
- Hilorme, T., Honchar, O., Korovchuk, Y. & Stefanyk, V. (2019). Human Capital Cost Accounting in the Company Management System. *Academy of Accounting and Financial Studies Journal* 23 (2): pp. 4-5.
- Ienciu, N.M. & Ienciu I-A. (2014). Determinants of the brain drain phenomenon: case of former communist countries from Central and Eastern Europe. *International Journals of Economics and Accounting*, Vol. 5, No. 3, pp.229–242.
- Lev, B. & Schwartz, S. (1971). On the Use of Economic Concepts of Human Capital in Financial Statement”: *The Accounting Review*. pp. 149.
- Krasulja, N., Blagojevic, M., V., Radojevic, I. (2016). Brain Drain, The positive and negative effects on the phenomenon. 62 (3), pp. 131- 142.
- Mokyr, J. (2018). The past and the future of innovation: Some lessons from economic history. *Explorations in Economic History* 69: 13–26.
- Muhammad, A., Egbetokun, A. & Memon, M. (2018). Human capital, social capabilities and economic growth. *Economies* 6: 2.
- Oded Stark, “Rethinking the Brain Drain”, *World Development*, 2004, 32 (1)
- OECD (1998). Human Capital Investment: An International Comparison. OECD Publishing, Paris, pp. 9.

- OECD (2021). Multi-dimensional Review of the Western Balkans: Assessing Opportunities and Constraints. OECD Publishing, Paris.
- Regional Cooperation Council (2021). Balkan Barometer Analytical Report.
- UNESCO (2018). What a waste: ensure migrants and refugees' qualifications and prior learning are recognized. Global Education Monitoring Report Team, pp. 10.
- Watson, T., W. (2020). Human capital as an asset: An accounting framework to reset the value of talent in the new world of work. World Economic Forum: pp. 13.

## **DECENTRALIZIMI I PUSHTETIT VENDOR DHE EFEKTET NË PASQYRAT FINANCIARE. RASTI I BASHKISË SHKODËR**

Albana Kastrati<sup>1</sup>, Gjovani Marleci<sup>2</sup>

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Financë - Kontabilitet  
Student në Masterin shkencor Kontabilitet*

### **ABSTRAKT**

Decentralizimi është një term që filloi të bëhej i njohur mbas mbarimit të revolucionit Francez. Në Shqipëri ky proces e ka zanafillën në vitet '90, atëherë kur Shqipëria kaloi nga një sistem ekonomik i centralizuar në atë të decentralizuar.

Qëllimi i këtij punimi është të evidentojë efektet që ka pasur ky proces në ndryshimin ekonomik-administrativ të njësive vendore në shtetin e Shqipërisë, kryesisht në bashkinë Shkodër.

Për të krijuar një tablo më të qartë të procesit të decentralizimit është bërë një analizë e shkurtër që tregon tiparet dhe format e këtij procesi, duke u ndalur më së shumti në efektet që ka pasur në pasqyrat financiare të njësisë vendore.

Efektet e decentralizimit në ekonomi krijojnë një hapësirë të madhe për manaxhimin korrekt të fondeve dhe planifikimin e projekteve të ndryshme vendore me qendër “njerëzit”. Prandaj në këtë punim vihet theksi tek ndikimi ekonomik i këtij procesi në gjendjen ekonomike të njësisë vendore. Në fund të këtij punimi do të japim disa konkluzione dhe rekomandime në

---

<sup>1</sup> Albana Kastrati, është lektore e parë pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi” që nga viti 2004. Ajo është e specializuar në fushën e kontabilitetit dhe jep mësim në këtë fushë në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Ajo është angazhuar edhe në mësimdhënie jashtë nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit, që ka universiteti “Luigj Gurakuqi” me universitetet e tjera të huaja. Ajo ka marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare dhe ka publikuar shumë artikuj.

<sup>2</sup> Gjovani Marleci është diplomuar në vitin 2022 në Bachelor Financë-Kontabilitet pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”. Ai është angazhuar në punë të ndryshme gjatë kohës së studimeve dhe ka marrë pjesë në projekte të ndryshme të universitetit. Në vitin 2022 ka filluar studimet në Masterin Shkencor në Kontabilitet pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi”.

lidhje me procesin e decentralizimit në Bashkinë Shkodër dhe efektet e tij në gjendjen ekonomike të kësaj bashkie.

**Fjalë kyçe:** decentralizim, bashkia Shkodër, pasqyra financiare, efekte ekonomike.

**Decentralization of local power and effects on the financial statements.  
The case of the municipality of Shkoder**

***ABSTRACT***

Decentralization is a concept that became known after the end of French Revolution. In Albania this is known after the years 90ties, when Albania passed through a centralized economic system to a decentralized one.

The main purpose of this paper is to highlight the effects that this proces has in administrative and economic change of local entities in Albania, especially in Shkodra city.

We study the effects in financial statements of Shkodra municipality to explain decentralization proces.

As we know from the literature review, the economic effects of decentralization create a huge area for correct management of sources and different local project planning with “human” in the center. That’s why in this paper we highlighted the economic effect of this process in the economic situation of the municipality.

In the end we will give some conclusions and recommendations about the economic effects of decentralization process in the economic state of Shkodra municipality.

**Keywords:** decentralization, Shkodra Municipality, financial statements, economic effects.

## **1. Hyrje**

Shqipëria është një nga vendet e cila ka kaluar disa periudha të vështira si ekonomike, po ashtu edhe politike. Ajo që dimë është se sistemi qeveritar në Shqipëri ka pësuar lëkundje të shumta dhe se vendimet merreshin pa një rend të caktuar. Duke marrë parasysh një vend, i cili nuk ka pasur stabilitet dhe se vendimet ndonjëherë në nivelin vendor kanë qenë jo të



mirëmenduara, vërehet dukshëm zhvillimi i ngadaltë i procesit të decentralizimit.

Në këto kushte mund të themi se Shqipëria, për shkak të pasojave të së shkuarës po vuan shumë në aspektin e zhvillimit ekonomik - politik. Në vitet e fundit ne shohim se ka pasur një përshpejtim për sa i përket procesit të decentralizimit dhe se bashkitë në çdo qytet të vendit po marrin vendime bazuar në kushtet që ato vetë i quajnë të arsyeshme për vazhdimësinë e rritjes ekonomike.

E vërteta është se procesi i decentralizimit ka filluar të jetë i dukshëm nga viti 2015 e në vazhdim, e cila nga perspektiva e zhvillimit vendor, shihet negativisht, sepse ky proces ishte planifikuar që të fillonte më herët. Decentralizimi shihet si zgjidhja më e mirë për sa i përket problemeve vendore, kjo për vetë faktin se ky proces fuqizon çdo bashki dhe u jep mundësinë atyre të bëjnë ndryshime që të gjithë shpresojnë që të ndodhin në të ardhmen.

Duke u thelluar më tej në analizën e këtij studimi, shohim se ky proces, edhe pse i dukshëm, vetëm në vitet e fundit ka sjellur një ndryshim pozitiv tepër të madh në aspektin ekonomik. Me një fuqizim vendor, u bë e mundur aplikimi i taksave sipas nevojave dhe përdorimi i kësaj rritjeje ekonomike për realizimin e shumë projekteve vendore me kryeqendër qytetin dhe njerëzit. Investimet bashkiake filluan të marrin një kuptim, dhe të arsyetojnë qëllimin që ato kanë. Pikërisht këto ndryshime të njëpasnjëshme sollën një impakt pozitiv në perceptimin që kanë njerëzit për këtë proces. Me anë të këtij studimi ne duam të nxjerrim në pah ndryshimet themelore që kanë rrjedhur si shkak i procesit të decentralizimit, efektet pozitive që ka pasur në vendimmarrjen vendore dhe në aspektin ekonomik të tyre. Ajo që dallohet është se ky proces ka një parim demokratik, i cili i jep një shkas më të madh ndryshimeve strukturore dhe i jep një hapësirë të madhe për përmirësim funksional dhe zhvillim politik - ekonomik.

## **2. Rishikimi i literaturës**

Decentralizimi është një nga proceset më të vështira për t'u implementuar, për vetë faktin, sepse nevojitet një ndryshim shumë i madh administrativ dhe ekonomik. Ky proces e ka zanafillën e tij që pas revolucionit Francez, ku ndikimi i një fryme të re demokratike bëri që pushteti të delegohej drejt njësive më të vogla, pikërisht ky proces u njoh me emrin "decentralizim". Edhe pse një proces i cili u bë i njohur për herë të parë, nuk pati pengesa në kryerjen e funksionit themelor të tij, e cila ishte zhvendosja e pushtetit. Franca ishte një nga shtetet e cila e shfrytëzoi më së miri këtë proces, funksionet administrative tashmë gjendeshin edhe në një nivel vendor.

E njëjta gjë nuk mund të thuhet për vendet e tjera të Evropës, kjo për arsye se kriza të shumta dhe luftërat e njëpasnjëshme nuk linin hapësirë për të bërë ndryshime të niveleve të mëdha, siç ishte decentralizimi. E vërteta është se këto vende Evropiane filluan ta pranojnë decentralizimin mbas fundit të “Luftës së Ftohtë”. Vendet të cilat ishin nën ndikim e një regjimi me idealizëm komunist dhe qeverisje diktatoriale, procesi i decentralizimit ishte thjesht një hap i cili pavarësisht kushteve dhe pengesave do të ndodhte në të ardhmen, kjo për vetë faktin, sepse këto vende diktatoriale ishin të gatshme të përkrahnin ndryshimin. Nga shumë shtete Evropiane ky proces u selektua si një strategji për të rritur fuqinë e tyre ekonomike dhe vendimmarrjen politike. Duke e parë nga perspektiva e udhëheqjes së një kombi, vende të ndryshme e përkrahnin këtë ndryshim, sepse ato delegonin disa funksione të cilat nuk ishte e nevojshme që ato t’i merrnin përsipër dhe me anë të delegimit të funksioneve ato mund të fokusoheshin në çështje më të rëndësishme për vazhdimësinë e kombit të tyre.

Decentralizimi është një përpjekje që vendet janë munduar të përkrahin, një përpjekje për të arritur stabilitetin politik dhe ekonomik në nivelin vendor. Decentralizimi si term përfshin shumë variabla në vetvete, nuk është thjesht një delegim pushteti. Ai është e ardhmja e një vendi dhe është një proces që duhet menduar mirë përpara se të zbatohet. Ndryshimet e shpejta sjellin pasiguri, pikërisht kjo pasiguri do të shfaqet në të ardhmen, prandaj proceset si decentralizimi duhen testuar dhe implelementuar me një strategji që i vendosin theksin zhvillimit ekonomik-politik si një element udhëheqës për të ardhmen e vendit.

Decentralizimi është një proces i cili bën ndryshimin e shpërndarjes së përgjegjësisë, por ajo që duhet të dimë është se ky proces ka impakt në tre komponentë të rëndësishëm. Ai ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në ristrukturimin administrativ, në strategjitë dhe zhvillimin ekonomik po ashtu edhe në vendimmarrjen politike. Prandaj procesi i decentralizimit përbëhet nga tre lloje të rëndësishme, të cilat janë decentralizimi administrativ, fiskal dhe politik. Ndërmjet këtyre llojeve ekziston një lidhje e ndërsjelltë.<sup>3</sup>

**Decentralizimi Administrativ** ka si qëllim rikonstruktimin e hierarkisë administrative. Mënyra më e mirë është dhënia e përgjegjësisë për të marrë vendime. Ai në vetvete ka tri forma të cilat janë: dekoncentrimi, delegimi dhe transferimi. Bazuar në këto tri forma, dekoncentrimi i pushtetit qendror tek njësitë vendore shikohet si një nga format më të dobëta. E njëjta gjë nuk

---

<sup>3</sup> Banka Botërore, Topic “What, Why and Where”, Subtopics “Different Forms of Decentralization” and “Rationale for Decentralization”, <https://www.worldbank.org>

mund të thuhet për delegimin dhe transferimin, pasi janë dy format më të rëndësishme në procesin e decentralizimit administrativ. Delegimi është një nga format ku pushteti transmetohet në çdo hallkë të strukturave udhëheqëse, kjo formë i lejon njësitë të niveleve të ndryshme të përkrahin strategjitë e tyre për ndryshim. Ndërsa transferimi, lejon që pushteti i sapo shpërndarë të transmetohet ndërmjet hallkave strukturore dhe të krijohet një ndërlidhje midis këtyre strukturave, gjithmonë me synimin e krijimit të një vizioni që do të përcjellë ndryshimin në të ardhmen.

**Decentralizimi Politik** është një nga llojet më të veçanta të decentralizimit, kjo për arsye se qeverisë vendore i jepet opsioni i zgjedhjes. Ndryshimet legjislative dhe të rregulloreve janë ato më të përhapurat të këtij lloji decentralizimi. Aftësia për t'i dhënë administratës mundësinë për të pasur sa më shumë pushtet në vendmarrjen publike, e bën këtë lloj decentralizimi t'i përshtatet më shumë demokratizimit.

**Decentralizimi Fiskal** është aftësia e menaxhimit të elementeve kryesore në përbërjen e të ardhurave vendore, siç është menaxhimi i sistemit të taksave.

### 3. *Decentralizimi në Shqipëri*

Decentralizimi në Shqipëri është i organizuar në tri periudha:

**Periudha e parë.** Decentralizimi u bë i njohur për herë të parë në Shqipëri gjatë viteve 90'. Me largimin e regjimit komunist në Shqipëri, filloi transformimi i qeverisë nga ajo komplet e centralizuar drejt asaj të decentralizuar. Dhe pikërisht në fillimet e viteve 90' dhe fundit të shekullit XI, shpallet faza e parë e decentralizimit. Kjo fazë në fillimet e saj ishte eksperimentale. Ajo kishte si synim sheshimin e pushtetit duke deleguar pjesën më të madhe të përgjegjësisë të të gjithë qeverive vendore. Në këtë mënyrë pushteti vendor mund të menaxhonte zonat territoriale më lehtë dhe të kishte një impakt më të madh në çështjet që nevojiteshin për zhvillimin e vendit. E mira e kësaj faze të decentralizimit ishte se shtyu "Këshillin e Ministrave" të asaj kohe që të bënte ndarjen territoriale në: 36 rrethe<sup>4</sup>, 44 bashki dhe 313 komuna.

➤ **Periudha e dytë.** Mbas përfundimit të fazës së parë eksperimentale, vjen faza e dytë më e avancuar e decentralizimit. Faza e dytë e decentralizimit përfshinte një hark kohor më të gjatë sesa faza e parë, këtu përfshihet fillimi i shekullit XXI dhe deri në fundet e vitit 2014. Gjatë kësaj faze, qeveria shqiptare kishte filluar t'i përshtatej më shumë qeverive të tjera të

---

<sup>4</sup> Neni 4, Ligji nr.7572, date 10.6.1992: "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal".

Evropës. Kjo fazë mund të quhet si një nga fazat më të suksesshme në zhvillimin e decentralizimit fiskal, kjo për arsye se gjatë kësaj periudhe u shpallën nene të cilët mbronin autonominë e njësive vendore. Me ligjet e reja që hynë në fuqi, sistemi i taksave pësoi një ndryshim tepër të madh dhe aftësia që qeveritë vendore kishin në menaxhimin e këtyre taksave bëri që shpërndarja autonome e pushtetit të ishte efikase. Ndryshe nga faza e parë, kjo fazë kishte ndikim tepër të madh nga forcat e jashtme. Në sytë e shteteve të zhvilluara Shqipëria shihej si një mjet për të arritur depërtimin në Evropën Përendimore, kryesisht në gadishullin e Ballkanit. Aftësia për të menaxhuar transfertat ndërmjet bizneseve të vogla dhe autonomia e vendosjes dhe mbledhjes së taksave, krijoi një hapësirë të madhe për zhvillimin rajonal. Prandaj u pa si një zhvillim i madh i decentralizimit fiskal.

**Periudha e tretë.** Mund të quhet edhe si periudha vendimtare për procesin e decentralizimit. Kjo fazë filloi mbas mbarimit të periudhës së dytë që ishte viti 2014 dhe akoma vazhdon në ditët e sotme. Kjo tregon se procesi i decentralizimit nuk ka mbaruar dhe nuk ka gjasa të mbarojë, pasi shpërndarja e përgjegjësive kërkon një periudhë tepër të gjatë. Faza e tretë e decentralizimit i kushtoi më shumë vëmendje riorganizimit administrativ. Ndërhyrjet nga vendet e Evropës ishin tepër të mëdha, kjo për arsye se Shqipëria kërkonte të bëhej pjesë e Eurozonës. Ky ishte shkaku që shtyu më tepër realizimin e decentralizimit ose siç tashmë njihet ndryshe me termin “vetëqeverisje vendore”. Programi administrativo - territorial, ishte synimi numër një i zgjedhjeve vendore të vitit 2015 dhe problemeve të mëparshme të ndarjeve administrative po i vinte fundi. Kjo periudhë njihet si më e rëndësishmja në evidentimin e efekteve pozitive të fazave të mëparshme, po ashtu gjatë kësaj periudhe u paraqitën edhe ndryshimet thelbësore që tashmë ishin diçka normale për njësinë vendore. Ndryshimi më i madh që u evidentua ishte në gjendjen ekonomike të njësisë vendore, pikërisht në ato variabla ekonomike, ku paraqitej efekti i autonomisë dhe i vendimmarrjes, rritjet e investimeve administrative ishin elementi i parë në përcjelljen e këtij ndryshimi.

#### **4. Metodologjia dhe analiza e rezultateve**

Në këtë analizë do të merret si bazë bashkia Shkodër, e cila përbëhet nga këto njësi administrative: **1. Shkodër, 2. Ana e Malit, 3. Berdicë, 4. Dajç, 5. Guri i Zi, 6. Postribë, 7. Pult, 8. Rrethinat, 9. Shalë, 10. Shosh dhe 11. Velipojë.** Në shqyrtim do të merren pasqyrat financiare të Bashkisë Shkodër në vitet 2008 – 2021. Ne do të shqyrtojmë ndikimin e

decentralizimit tek të ardhurat, shpenzimet dhe fitimi neto i Bashkisë Shkodër.

*Ndikimi tek të ardhurat.* Tashmë duke njohur më mirë procesin e decentralizimit dhe efektet e tij në burimet e të ardhurave sipas financimit, jemi të gatshëm të shohim disa dallime thelbësore tek gjendja ekonomike e njësisë vendore. Tabela 4-1 tregon totalin e të ardhurave të marra nga “Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve” për vitet 2008-2021.

**Tabela 4-1: Totali i të ardhurave të njësisë vendore për vitet 2008–2021**

VITI PËRPARA DECENTRALIZIMIT		VITI PAS DECENTRALIZIMIT	
2008	1,820,051,074	2015	2,053,177,635
2009	1,751,088,281	2016	2,893,625,737
2010	1,679,942,076	2017	2,837,539,323
2011	1,606,628,615	2018	2,623,742,704
2012	1,530,422,550	2019	2,608,842,699
2013	1,601,251,578	2020	2,942,497,539
2014	1,627,089,858	2021	2,781,424,602


**Burimi: Pasqyrat financiare të “Bashkisë Shkodër”**

Nga të dhënat shohim se përpara vitit 2015 decentralizimi nuk ka pasur efekt të madh në gjendjen ekonomike të njësisë vendore. Pas miratimit të ligjeve të reja në vitin 2014 dhe nga mesi i tij filloi të shfaqej procesi i decentralizimit duke i dhënë autoritet të plotë njësive vendore dhe ky autoritet përcillet në mënyrë pozitive siç tregohet tek tabela e mësipërme.

Të njëjtin informacion shpreh edhe grafiku 4-1, i cili tregon ndryshimet tek të ardhurat përpara procesit të decentralizimit dhe pas tij. Siç shihet përpara vitit 2015 të ardhurat e bashkisë kanë qenë në një nivel të vogël në krahasim me potencialin që mund të arrihej nga shfrytëzimi i të gjitha burimeve, kjo për arsye se njësia vendore ka pasur një akses të limituar në

autoritetin për të menaxhuar disa faktorë themelorë që përbëjnë taksat. Në vitin 2014 totali i të ardhurave në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve ishte 1,627,089,858 lekë, dhe në këtë periudhë pjesa më e madhe e vendimeve të rëndësishme merreshin nga autoriteti qendror. Me reformën e re shohim se në vitin 2015 ndryshimi nuk ka qenë i bindshëm përse i përket totalit të të ardhurave të cilat ishin 2,053,177,635 lekë, një rritje prej 426,087,777 lekësh. Edhe pse pritshmëritë ishin më të larta për vitin e parë të decentralizimit, rritja ishte më e madhe se çdo rritje tjetër ndër vitet pa praninë e decentralizimit, pra mund të themi se efekti i decentralizimit po fillonte të bëhej i dukshëm.

**Grafiku 4-1: Renditja e totalit të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2008-2021**



#### **Burimi: Pasqyrat financiare të “Bashkisë Shkodër”**

Përpara viteve të decentralizimit mund të shohim se të ardhurat e bashkisë kanë qenë çdo vit duke u zvogëluar dhe ky ishte një sinjal për qeverinë qendrore që të delegojë pushtetin e saj. Nëse marrim në shqyrtim vitin 2016 dhe e krahasojmë me vitin 2015 dhe vitin 2014, do të shohim se rritja ka qenë tepër e madhe, kjo për vetë faktin se tashmë njësi vendore kishte autoritet në menaxhimin e sistemit të taksave dhe kishte efektin për të ndikuar variablat që sillnin të ardhura. Rritja nga viti 2015 në vitin 2016 ka qenë 840,448,102 lekë, pothuajse sa dyfishi i rritjes nga viti 2014 në vitin 2015. Të gjithë këto të dhëna tregojnë se procesi i decentralizimit ka qenë një domosdoshmëri në rritjen e të ardhurave të njësisë vendore. Mund të shohim se në vitet 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 ka pasur disa luhajtje për sa i përket të ardhurave, por ajo që mund të themi është se një ndikim të

madh ka pasur edhe periudha e COVID-19, e cila ka dhënë efektet e veta në totalin e të ardhurave.

Një ndikim të madh tek ndryshimi i nivelit të të ardhurave ka pasur variabli “Të ardhura nga taksat e tatimet”, pra siç mund ta shohim decentralizimi i dha autoritetin njësisive vendore për të menaxhuar sistemin tatimor, gjë e cila përcillet pozitivisht në totalin e të ardhurave. Me anë të implementimit të strategjive që tashmë i kishin në zotërim arritën të krijonin një burim të qëndrueshëm të ardhurash. Një faktor tjetër në rritjen e të ardhurave janë edhe “Grantet”. Pikërisht këto të ardhura vijnë nga “Buxheti” i shtetit të cilat kanë synime të ndryshme, ato ndahen në grante të cilat njësia vendore mund t’i përdorë për arsye që ajo i specifikon si të nevojshme dhe në grante të cilat mund të përdoren vetëm sipas urdhrave të njësisë qendrore.

**Tabela 4-2: Grantet dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat për vitet 2013 – 2016**

**TË ARDHURAT NGA TASKAT DHE TARIFAT**

VITI	Përpara decentralizimit	VITI	Pas decentralizimit
2013	250,233,473	2015	309,039,914
2014	208,354,876	2016	341,595,495

**GRANTET**

VITI	Përpara decentralizimit	VITI	Pas decentralizimit
2013	1,100,979,297	2015	1,478,401,840
2014	1,159,030,699	2016	1,943,151,469

**Burimi: Pasqyrat financiare të “Bashkisë Shkodër”**

Pra nëse shohim **Tabelën 4-2** mund të dallojmë se ka një ndryshim të dukshëm ndërmjet dy periudhave. Ajo që dallohet më mirë është se “Grantet” përbëjnë peshën më të madhe të të ardhurave për bashkinë. Tek grantet përfshihen “Trasferrat e kushtëzuara” dhe “Trasferrat e pakushtëzuara”, të cilat jepen nga “Buxheti” për t’u përdorur sipas nevojave të caktuara.

**Ndikimi tek shpenzimet.** Edhe pse procesi i decentralizimit pati një ndikim tepër të madh tek të ardhurat, ajo që duhet të analizohet është se si e ka ndryshuar strukturën e shpenzimeve për njësinë vendore. Tabela 4-3 na jep një paraqitje të detajuar të ndryshimeve të shpenzimeve të bashkisë për vitet 2008-2021 pra për periudhën para decentralizimit dhe pas tij. Ajo që dallojmë është se përpara decentralizimit shpenzimet kanë qenë në rënie,

kjo për arsye se nuk i është dhënë shumë rëndësi sektorëve, të cilët kishin nevojë për përmirësime.


**Tabela 4-3: Totali i shpenzimeve për vitet 2008 – 2021.**

VITI	PËRPARA DECENTRALIZIMIT	PAS DECENTRALIZIMIT	
2008	1,439,738,576	2015	1,585,270,598
2009	1,517,750,100	2016	2,170,554,959
2010	1,397,992,696	2017	2,504,823,616
2011	1,397,288,511	2018	2,311,962,707
2012	1,356,419,427	2019	2,301,712,325
2013	1,383,681,883	2020	2,489,531,553
2014	1,466,303,883	2021	2,372,875,259

**Burimi: Pasqyrat financiare të “Bashkisë Shkodër”**

Ndërsa më poshtë në grafikun 4-2 tregohen ndryshimet në shpenzimet totale në vite.

**Grafiku 4-2: Totali i shpenzimeve për vitet 2008 – 2021**



**Burimi: Pasqyrat financiare të Bashkisë Shkodër**

Ajo që shohim si nga grafiku, ashtu edhe nga tabela e mësipërme është se në vitin 2014 shpenzimet kanë qenë përkatësisht 1,466,303,883 lekë dhe në vitin 2015 kanë qenë 1,585,270,598 lekë. Nëse ne i krahasojmë me vitin 2016 të cilat kanë qenë 2,170,554,959 lekë, do të shohim se ka një rritje tepër të madhe të shpenzimeve. Në vështrim të parë kjo mund të duket si diçka negative, por në të vërtetë shpenzimet tregojnë se njësia vendore po ndërmerr iniciativa për ndryshim. Po të krahasojmë vitet pas decentralizimit, vitet 2016 deri 2021, do të shohim se shpenzimet nuk përsuan luajtje të mëdha dhe nuk kanë pësuar as rritje të mëdha. Kjo tregon



se të ardhurat e grumbulluara po përdoren për investime të ndryshme. Një rritje e shpenzimeve ishte e pritshme, kjo për vetë faktin se bashkia pati edhe një rritje tepër të madhe të granteve të cilat kishin ndikim tek të ardhurat. Arsyeja përse kishte rritje të granteve ishte se pikërisht ato grante do të përdreshin në sektorë të cilët kishin nevojë për përmirësim si p.sh., sektori i shëndetësisë. E gjithë strategjia e rritjes së granteve për bashkinë ishte që ato në të ardhmen të përcilleshin si shpenzime për investime, pra të përcilleshin si shpenzime për sektorët që kishin më shumë nevojë për përmirësim. Me rritjen e investimeve në ato sektorë do të rritet edhe qëndrueshmëria e tyre duke sjellur mundësinë që vitin pasardhës fondet të përdoren për një sektor tjetër. Me rritjen e mirëqenies rritet edhe gjendja ekonomike e njësisë vendore.

***Efekti në “Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve”.*** Më parë pamë se çfarë ndikimi kishte procesi i decentralizimit tek të ardhurat dhe shpenzimet dhe kuptuam nëse ky proces ka ndikuar pozitivisht apo negativisht. Ajo që tashmë duhet të shohim është se çfarë ndikimi ka pasur tek fitimi i bashkisë në fund të mbylljes së vitit ushtrimor, pra të dimë rezultatin që del nga “Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve”. Në tabelën 4-4 paraqitet qartë se njësia vendore ka arritur të përmirësojë fitimin e saj gjatë çdo viti. Të renditura paraqiten shifrat që tregojnë ndryshueshmërinë e fitimit ndër vite dhe se në vitet ku është i pranishëm decentralizimi të ardhurat maksimale shkonin deri në 723,070,773 lekë në vitin 2016 ndërsa në periudhën përpara decentralizimit fitimi më i lartë ishte në vitin 2008 ku shkonte deri në 380,312,498 lekë. Një rritje e tillë e fitimit për njësinë vendore vjen si rezultat i rritjes së shpejtë të të ardhurave.

***Tabela 4-4: “Fitimi Neto” i njësisë vendore për vitet 2008 – 2021***

VITI PËRPARA DECENTRALIZIMIT		VITI PAS DECENTRALIZIMIT	
<b>2008</b>	380,312,498	<b>2015</b>	467,907,037
<b>2009</b>	233,338,181	<b>2016</b>	723,070,778
<b>2010</b>	281,949,380	<b>2017</b>	332,715,707
<b>2011</b>	209,340,104	<b>2018</b>	311,779,997
<b>2012</b>	174,003,123	<b>2019</b>	307,130,374
<b>2013</b>	217,569,695	<b>2020</b>	452,965,986
<b>2014</b>	160,785,975	<b>2021</b>	408,549,343

**Burimi: Pasqyrat financiare të Bashkisë Shkodër**

Nga tabela 4-3, pamë se edhe shpenzimet ishin rritur me një shpejtësi të konsiderueshme, por kjo ishte si rezultat i përdorimit të shpenzimeve si mjet për të rritur investimet, në ato sektorë që mendohet se kanë më shumë nevojë. Një rritje e fitimit të njësisë vendore na lë të kuptojmë se me rritjen e të ardhurave, rritja e shpenzimeve është mbajtur në një nivel të konsiderueshëm për të nxjerrë një fitim më të lartë sesa periudhat e tjera. Fitueshmëria e njësisë vendore bën të mundur që të rriten edhe të ardhurat nga burimet e financimit për vitin pasardhës, sa më i madh të jetë fitimi i këtij viti aq më shumë ka për të pasur ndikim kategoria e “Të trashëguara” në burimet e të ardhurave sipas financimit në vitin pasardhës.

#### **4. Konkluzione**

Decentralizimi është një proces tepër i vështirë për t’u realizuar dhe kërkon një kohë tepër të madhe për të implementuar të gjitha funksionet e tij. Por duhet pasur parasysh se ky proces është i vetmi që mund ta drejtojë një shtet drejt së ardhmes demokratike.

Decentralizimi prek në mënyrë direkte të ardhurat dhe shpenzimet e njësisë vendore, duke vendosur një balancë ndërmjet njëra - tjetrës, që fitimi në fund të jetë i arsyeshëm. Rritja e decentralizimit në njësitë vendore i jep atyre autonominë të kërkojnë fonde për të investuar në sektorët më me shumë nevojë. Tashmë është shumë më e lehtë që një investim të japë fitueshmëri në të ardhmen, kjo sepse njësitë vendore mund të përcaktojnë ato projekte që ato i selektojnë si më të arsyeshmit.

Nga analiza e mësipërme pamë që ka një lidhje pozitive ndërmjet decentralizimit dhe performancës ekonomike të bashkisë Shkodër. Rritja e madhe e shpenzimeve në “Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve” nuk krijon një problem të madh për njësinë ekonomike, sepse grantet që më përpara ishin shprehur si burim i të ardhurave, do të përdoren si shpenzim për investime në sektorë të ndryshëm. Mundësia për të menaxhuar sistemin tatimor dhe për të implementuar një sistem sipas nevojave lokale, bëri që të ketë ndryshime themelore në mënyrën e financimit të njësisë vendore, kjo shihet më së miri në rritjen e “të ardhurave vendore”.

Edhe pse nuk dallojmë një ndryshim tepër të madh në fitimin neto ndërmjet dy periudhave, ajo që duhet të kuptojmë është se me rritjen e të ardhurave janë rritur edhe investimet si nevojë e ndryshimeve vendore. Pra sektorë të ndryshëm po bëhen më të rëndësishëm. Pikërisht kjo është edhe një arsye se përse pjesa më e madhe e të ardhurave konvertohen në shpenzime afatgjata. Një nga format më të rëndësishme në fuqizimin ekonomik të njësisë vendore ishte decentralizimi fiskal, ku sollli një rikonstruktim

ekonomik të njësisë vendore, duke filluar që nga nivelet më të vogla që ishin e drejta për të mbledhur të ardhurat edhe deri tek autoriteti për të projektuar dhe menaxhuar investimet në të ardhmen.

Gjithmonë duke lënë mënjane faktorët ndikues të palëve të treta, procesi i decentralizimit solli një shkoputje të rëndësishme të njësisë vendore nga një pushtet i cinguar totalitar. Kjo lëvizje solli një harmoni dhe një bashkëpunim ndërmjet njësisë vendore dhe elementëve përbërës të saj, ku një nga elementët më të rëndësishëm ishte populli. Kjo bëri që tashmë bashkia të bëjë pyetjen “Si t’i vijmë në ndihmë popullit?” dhe ky ishte niveli më i rëndësishëm që duhet të arrihej, dhe që njësia vendore e arriti me sukses.

### **5. Rekomandime**

Duke qenë se decentralizimi është një dukuri e re në një shtet të cinguar më përpara nga një frymë diktatoriale, ky proces nuk u asimilua në mënyrën e duhur nga të gjithë sektorët e njësisë vendore, prandaj këto barriera dhe burokraci duhen të eliminohen në mënyrë që të ketë një uniformitet ndërmjet çdo elementi që e përbën këtë njësi.

Një rëndësi tepër të madhe duhet t’u kushtohet burimeve të financimit të njësisë vendore, sepse ato janë elementi kryesor për të arritur objektivat vendore. Duhet medoemos të implementohen strategji të ndryshme dhe inovative për menaxhimin e sistemit të taksave, pasi me anë të këtyre strategjive njësia vendore mund të zgjerojë burimet e veta të financimit pa pasur nevojë për ndërhyrjen e njësisë qendrore, me anë të kësaj autonomie do të bëhej e mundur realizimi i projekteve sektoriale.

Njësia qendrore duhet të minimizojë ndikimin që ka tek njësitë vendore, dhe duhet që më së shumti të rrisë “transfertat e pakushtëzuara” dhe të minimizojë “transfertat e kushtëzuara”, kjo do të lejonte njësinë vendore të kishte më shumë autoritet në menaxhimin e fondeve të veta dhe po ashtu të fokusohet më shumë në investimet e projektuara nga vetë ata.

Nuk duhet harruar rëndësia që kanë shpenzimet tek ecuria ekonomike e kësaj njësie, u kushtohet shumë vëmendje shpenzimeve që shkojnë për investime, por një element që gjithmonë është në rritje janë shpenzimet për administratën dhe struktura të tjera ndikuese, duhet të rishikohen burimet e shpenzimeve dhe gjithmonë me synimin e minimizimit të tyre, kjo do të bëjë që njësia vendore të ketë një fitim më të madh për ta përdorur si burim financimi për vitin pasardhës.

**REFERENCA**

- Binjaku, F. 2016. *Vetëqeverisja vendore*, Botimi I, Tiranë: ILAR.
- Bogdani, I. 2017. *Kontabiliteti publik dhe i organizatave jofitimprurëse*, Botimi IV, Tiranë: ALBPAPER.
- Dhamo, S. 2015. *Kontabiliteti financiar*, Botimi III, Tiranë: UBT.
- Shuli, I., Perri, R. 2016. *Analizë e pasqyrave financiare*, Botimi II, Tiranë: ALBPAPER
- Ebel, R., Yilmaz, S. *On the Measurement and Impact of Fiscal Decentralization*, Botimi I, Washington, DC: WORLDBANK.
- Këshilli i ministrave, Ministri për çështjet vendore. (2015, Korrik 29). *Strategjia ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015 – 2020*. Marrë nga: <https://www.bpe.al/sites/default/files/publications/Strategjia-ndersektoriale-per-decentralizimin-dhe-qeverisjen-vendore.pdf>
- The World Bank. (2013, Qeshor 6). *Decentralization*. Marrë nga: <https://www.worldbank.org/en/topic/communitydrivendevelopment/brief/Decentralization>
- USAID. (2011, Nëntor 10). *Albania: 2011- 2018 Country Development Cooperation Strategy*. Marrë nga: [https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/CDCS\\_USAID\\_Albania\\_2011-20182.pdf](https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/CDCS_USAID_Albania_2011-20182.pdf)
- Bashkia Shkodër. (2022, Prill 7). *Pasqyrat financiare, periudha 2015 – 2021*. Marrë nga <https://drive.google.com/drive/folders/1H-JzORiXLzjEtYetgNXol-XZZFpd-RNZ?usp=sharing>  
<https://drive.google.com/drive/folders/1NeGhV01FtSOu6qG0g7XW5ravJkNHDwqq?usp=sharing>
- Financat Vendore. (2022). *Të ardhurat totale sipas burimeve të financimit, vitet 2010 - 2021*. Marrë nga <http://financatvendore.al/data/revenues>
- Financat Vendore. (2022). *Shpenzimet e NjQV-ve sipas burimit të financimit, vitet 2010 - 2021*. Marrë nga <http://financatvendore.al/data/expenses>
- Bashkia Shkodër. (2022). *Qeverisja vendore*. Marrë nga [https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Qeverisja\\_vendore\\_1111\\_1.php](https://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Qeverisja_vendore_1111_1.php)

## NJË QASJE PËRSHKRUESE MBI ZHVILLIMIN E SEKTORIT FINTECH DHE PRITSHMËRITË E TIJ PËR RIMODELIMIN E SHËRBIMEVE FINANCIARE

Dorina Koçi (Janku)<sup>1</sup>, Ingrid Konomi<sup>2</sup>

*Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, departamenti i Financës*

### ABSTRAKT

Zhvillimi i shpejtë i sektorit FinTech ka sjellë përdorimin e teknologjisë në ofrimin e shërbimeve financiare, duke zhvilluar kështu industrinë e shërbimeve financiare. Në vendet në zhvillim, ku përfshihet edhe vendi ynë Shqipëria, zhvillimi i shërbimeve financiare digjitale ka krijuar mundësi dhe aksesin për herë të parë në shërbime financiare, sidomos për konsumatorët e paakses në sistemin bankar. Objektivi kryesor i këtij punimi është analiza e evolucionit të FinTech nga aspekti i sektorit financiar. Duke zbatuar një metodologji të bazuar në kombinimin e të dhënave përshkruese dhe shpjeguese, nëpërmjet rishikimit të literaturës dhe të dhënave dytësore të mbledhura nga studimet dhe raportet ekzistuese të kryera nga institucionet ndërkombëtare dhe të vendit, ky punim synon të ofrojë evidencë lidhur me pritshmëritë e sektorit FinTech në formimin e bizneseve të reja start-up, studimin e sipërmarrjes tek të rinjtë dhe nxitjen e krijimit të vendeve të reja të punës. Kërkimi do të përfshijë në mënyrë të veçantë, aspektet lidhur me efektet e sektorit FinTech në fusha të ndryshme të

<sup>1</sup> Dr. Dorina Koçi (Janku) është lektore në departamentin e Financës në FEUT në lëndët Shërbime Financiare, Investime, Drejtim Risku. Në qershor të vitit 2014 përfundon studimet e doktoraturës në fushën e financës duke marrë gradën shkencore "Doktor" në mbrojtjen e disertacionit me temë: *Kufizimet financiare dhe vendimi investues i firmave. Rasti i NVM-ve në Shqipëri*. Ajo ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, si: konferenca, trajnime, botime, projekte, recensuese në revista të huaja, mobilitete trajnime dhe mësimdhënie në kuadër të programit Erasmus+ në Universiteti i Ekonomisë Varna në Bullgari, Instituti Politeknik i Portos në Portugali Universiteti i Tuzlës në Bosnje Hercegovinë.

<sup>2</sup> Dr. Ingrid Konomi është lektore pranë Departamentit të Financës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Tiranës. Në vitin 2016 ka përfunduar studimet e doktoraturës në fushën e financës duke mbrojtur disertacionin me temë: *Analiza e strukturës së kapitalit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme shqiptare*. Dr. Konomi ka një ekperiencë të gjatë në fushën akademike jo vetëm si lektore, por dhe si drejtuese, ku ka mbajtur pozicionin e shefit të departamentit dhe dekanit pranë Fakultetit të Financës në Albanian University. Ajo është angazhuar në shumë aktivitete shkencore, si: konferenca, botime, projekte të ndryshme.

sektorit financiar, duke përfshirë modelet e biznesit, proceset financiare, metodat e pagesës, përshtatjen e tyre dhe sfidat dhe rekomandimet. Përmes këtij studimi kërkohet t'i jepet përgjigje pyetjeve: Cilët janë raportet lidhur me kërkesën aktuale dhe potenciale për këto shërbime FinTech në Ballkanin Perëndimor dhe çfarë duhet të tregojnë ato për zhvillimin e këtij sektori? Cilat janë pritshmëritë për të ardhmen në këtë sektor, sidomos në Shqipëri?

***Fjalët kyçe:*** FinTech, digjitalizim, rimodelim, shërbime financiare, start-up.

**A descriptive approach on the development of the FinTech sector and its expectations for the remodeling of financial services**

***ABSTRACT***

The rapid development of the FinTech sector has brought about the use of technology in the provision of financial services, thus developing the financial services industry. In developing countries, including our country Albania, the development of digital financial services has created the opportunity and access to financial services for the first time, especially for consumers without access to the banking system. The main objective of this paper is the analysis of the evolution of FinTech from the aspect of the financial sector. Applying a methodology based on the combination of descriptive and explanatory data, through literature review and secondary data collected from existing studies and reports carried out by international institutions and the country, this paper aims to provide evidence related to the expectations of the sector FinTech in the formation of new start-up businesses, teaching entrepreneurship to young people and encouraging the creation of new jobs. The research will include, in particular, aspects related to the effects of the FinTech sector in various areas of the financial sector, including business models, financial processes, payment methods, their adaptation and challenges and recommendations. Through this study, it is requested to answer the questions: What are the reports regarding the current and potential demand for these FinTech services in the Western Balkans and what should they show for the development of this sector? What are the expectations for the future in this sector, especially in Albania?

**Keywords:** Fintech, digitalization, remodeling, financial services, start-up.

## 1. Hyrje

Digjitalizimi po bëhet një përhapës i shpejtë i teknologjisë në çdo sektor të ekonomisë së një vendi. Në jetën tonë të përditshme dëgjojmë gjithnjë e më shumë për digjitalizimin në bujqësi, digjitalizimin në arsim, digjitalizimin në turizëm, digjitalizimin e shërbimeve publike etj. Një zhvillim i tillë i teknologjisë dhe për më tepër, përshtatja me tendencat e reja, po ndikon gjithnjë e më shumë në strategjitë e bizneset, për të fituar avantazh konkurrues dhe për të qenë fleksibël ndaj nevojave të klientëve. Studimi i Ballkan Barometrit (2020) evidenton se 80% e menaxherëve në Ballkanin Perëndimor i konsiderojnë aftësitë digjitale shumë të rëndësishme për zhvillimin e biznesit të tyre dhe 55% e kompanive të Ballkanit Perëndimor ofrojnë një formë trajnimit për të përmirësuar aftësitë digjitale të punonjësve të tyre. Komisioni Evropian vlerëson se pothuajse 90% e vendeve të punës në të ardhmen e afërt do të kërkojnë rehabilitim digjital. Ky digjitalizim si proces merr një rëndësi të veçantë për mundësinë që u jep bizneseve për të ofruar shërbimet e tyre jashtë vendit. Kjo rritje e shpejtë e kërkesës për shërbime digjitale është mbështetur nga FinTech, si një zgjidhje e natyrshme në drejtimin e pagesave digjitale veçanërisht në industrinë e shërbimeve financiare.

Shërbimet financiare të mundësuar nga teknologjia po rriten me shpejtësi si nëpërmjet përdorimit të tyre nga bankat dhe institucionet financiare. Një studim i fundit nga Ernst & Young vlerëson se 64% e konsumatorëve të shërbimeve financiare në mbarë botën kanë përdorur një ofrues Fintech në 2019, nga 16% në 2015 (World Bank Group, 2020). Transformimet u ofrojnë konsumatorëve dhe bizneseve mikro dhe SME cilësi të përmirësuar të shërbimit, zgjedhje të produktit si dhe rritje të aksesit në financa dhe kosto më të ulëta. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që ndodhen në zonat rurale, si bizneset e agroturizmit, mund të përfitojnë veçanërisht nga përfitimet që vijnë nga pagesat me celular, të cilat u mundësojnë të paguajnë, blejnë dhe paguhen më lehtë. Kjo thjeshton fluksin e parave, zvogëlon kostot dhe si rezultat rrit fitimin duke rritur edhe mundësitë e krijimit të vendeve të punës.

Për më tepër, sektori FinTech pritet të krijojë biznese të reja fillestare, të eksplorojë sipërmarrjen e të rinjve dhe të nxisë krijimin e vendeve të reja të punës. Disa gjetje të tjera nga Raporti i Punës FinTech 2021 i kryer nga Qendra për Financa, Teknologji dhe Sipërmarrje (CFTE) përforcojnë rritjen e shpejtë të sektorit FinTech. Në dekadën e fundit, më shumë se 200 miliardë dollarë janë investuar nga sipërmarrjet dhe fondet private të kapitalit në startup-et FinTech. Duke krahasuar startup-et FinTech me sektorin bankar, në vitin 2010 e gjithë industria FinTech përfaqësoje

vetëm 3% të sektorit bankar. Sot, sektori FinTech është i barabartë me 38% të sektorit bankar për sa i përket kapitalizimit të tregut. 100 bankat më të mëdha kanë një kapitalizim tregu të kombinuar prej 7.1 trilionë dollarë, ndërsa 100 kompanitë më të mëdha FinTech kanë një kapitalizim tregu të kombinuar prej 2.8 trilionë dollarë.

Recesioni global në vitin 2020 ka përkeqësuar situatën ekonomike në mbarë botën. Të ardhurat më të ulëta të popullatës, rritja e shkallës në sektorin e papunësisë dhe pasiguria financiare do të zvogëlojnë numrin dhe madhësinë e depozitave bankare dhe të kredive të tilla, si: kreditë hipotekore, kreditë për makina etj. Bankat tradicionale do të orientohen nga sektori FinTech. Digjitalizimi i pashmangshëm nuk është arsyeja e vetme. Ndryshimet në modelin e funksionimit, dhënia e kredive më të vogla dhe vlerësimi i klientëve më pak formalisht dhe përmirësimet në aftësitë digjitale të popullatës janë mundësitë për institucionet FinTech për të forcuar performancën e tyre në treg në vitet e ardhshme.

Megjithatë, ka një përqendrim të moderuar deri në të lartë të tregut në sektorin financiar, i cili kufizon nivelet e konkurrencës dhe inovacionit. Bankat në Ballkanin Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, priren të konkurrojnë më shumë përmes marzheve dhe normave të interesit sesa me përvojën e përdoruesit, që i dallojnë shërbimet FinTech. Duke qenë se bankat janë kryesisht në pronësi dhe me seli jashtë Shqipërisë, degët kombëtare mund të kenë vështirësi për të zhvilluar zgjidhje novatore lokale, për shkak të kontekstit të tyre brenda strukturës së grupit të tyre bankar. Megjithatë, ekzistojnë një sërë skemash të suksesshme partneriteti të ofruesve Bankë-FinTech.

## 2. Rishikim i Literaturës

Teknologjia financiare ose "FinTech" i referohet përdorimit të teknologjisë për të ofruar shërbime dhe zgjidhje financiare (Nicoletti, 2017). Ndërsa sipas Anyfantaki (2016), FinTech i referohet startupe-ve të teknologjisë që po shfaqen për të konkurruar me lojtarët tradicionalë të tregut bankar dhe financiar, duke ofruar disa shërbime, nga zgjidhjet e pagesave celulare dhe platformat e crowdfunding deri te menaxhimi i portofolit online dhe transfertat ndërkombëtare të parave. Arner et. al (2015) theksojnë se FinTech nuk është një zhvillim i natyrshëm i ri për industrinë e shërbimeve financiare. Në fakt, sipas tyre, FinTech i referohet thjesht aplikimit të teknologjisë në financa. Sipas Leong dhe Sung (2018), fintech mund të konsiderohet gjithashtu si *"çdo ide inovative që përmirëson proceset e shërbimeve financiare duke propozuar zgjidhje teknologjike sipas situatave të ndryshme të biznesit"*.



Zhvillimi i industrisë së shërbimeve financiare prej vitesh është ndikuar nga digjitalizimi në shpërndarjen e produkteve dhe shërbimeve financiare. Sot, gjithnjë e më tepër po flitet për konceptin e financave digjitale. Financa digjitale përfshin një numër produktesh të reja financiare, biznese financiare, softwer të lidhur me financat dhe forma të reja të komunikimit dhe ndërveprimit me klientët të ofruara nga kompanitë FinTech dhe ofruesit inovativ të shërbimeve financiare (Gomber et. al, 2017).

Ekosistemi FinTech i përbërë nga startup të FinTech, zhvillues teknologjie, qeveri, klientë financiarë dhe institucione financiare tradicionale u prezantua nga Lee dhe Shin (2018). FinTech mbulon një gamë të madhe aktiviteteve nga siguria e të dhënave deri tek shërbimet financiare që mundësojnë kompanive të automatizojnë strukturën e tyre ekzistuese të biznesit dhe të prezantojnë produkte dhe shërbime inovative (Nasir et.al. 2021). Sipas Imerman & Fabozzi (2020), ekosistemi FinTech mund të kategorizohet në 8 segmente industrie, përkatësisht:

- i. Pagesat dhe transfertat e parave;
- ii. Bankingu digjital;
- iii. Menaxherët e pasurisë digjitale, duke përfshirë robo-këshilltarët;
- iv. Inovacionet e tregjeve të kapitalit, duke përfshirë tregtimin algoritmik, tregtarët me frekuencë të lartë;
- v. Kreditimi FinTech, duke përfshirë shërbimin P2P (Peer-to-Peer) dhe huadhënësit e tregut;
- vi. Crowdfunding;
- vii. InsurTech, i cili u referohet risive në industrinë e sigurimeve;
- viii. PropTech, i cili u referohet risive në industrinë e pasurive të paluajtshme.

Firmat FinTech kanë potencialin për të zhvendosur ndërmjetësit tradicionalë duke shfrytëzuar ekonomitë e shkallës në analizën e të dhënave dhe duke ofruar shërbime financiare me kosto më të ulët për klientët e tyre në krahasim me operatorët ekzistues (Chemmanur et. Al, 2020).

Politikëbërësit dhe rregullatorët e shohin fintech si një mundësi për ta bërë sistemin financiar 'më efikas, efektiv dhe të qëndrueshëm' (Carney, 2017). Zhvillimi dhe aplikimi i FinTech ndihmon më shumë njerëz, veçanërisht të varfërit, të marrin shërbime financiare me kosto më të ulët dhe më të përshtatshme (Li & Xu, 2021). Inovacionet FinTech premtojnë t'u ofrojnë të varfërve akses në shërbime financiare, si: pagesat, kursimet, kreditë dhe sigurimet. Një total prej 1.7 miliardë njerëzish në mbarë botën, shumica e të cilëve jetojnë në vendet në zhvillim, janë të përjashtuar nga këto shërbime themelore financiare, duke penguar aftësinë e tyre për t'i shpëtuar kthetrave të varfërisë (Demirgüç-Kunt et al., 2018).

#### **4. Përdorimi, kërkesa aktuale dhe potenciale për shërbimet Fintech**

Sektori i teknologjisë financiare (FinTech) është zhvilluar me shpejtësi në Ballkanin Perëndimor në vitet e fundit. Kjo industri ka të ngjarë të vazhdojë të forcojë pozicionin e saj në treg për shkak të sfidave që solli pandemia, pasi më shumë institucione dhe biznese zgjedhin shërbimet “vetëm digjitale”. Komoditeti dhe shkathtësia janë dy avantazhet konkurruese të industrisë FinTech, të cilat janë thelbësore për të përballuar pasiguritë e sotme ekonomike.

Kufizimet e karantinës në Shqipëri rriten përdorimin e shërbimeve në distancë, nga blerjet në internet tek shpërndarja, argëtimi dhe pagesat me celular. Njerëzit e mësuar me avantazhet e botës digjitale ka të ngjarë të vazhdojnë ta përdorin atë në mënyrë aktive në periudhën pas COVID-19. Shërbimet financiare digjitale mund të ndihmojnë lehtësisht të dy: konsumatorin përfundimtar dhe institucionet/kompanitë. Institucionet Fintech përmes shërbimeve të tyre të pagesave mund të lidhin në mënyrë efektive dhe efikase sipërmarrësit me bankat, punonjësit e tyre, furnitorët, si dhe me të gjithë tregun. Gjithashtu, shërbimet e pagesave digjitale të ofruara nga FinTech mund të ndihmojnë organizatat qeveritare për t’iu përgjigjur nevojave të një grupi të veçantë individësh dhe biznesesh të vogla, në një kohë shumë të shkurtër. Pavarësisht rritjes së lartë të përdorimit të kartave dhe pagesave digjitale, në vendet e Ballkanit Perëndimor, ka ende një potencial të pashkelur për shërbime të tjera të ofruara nga sektori FinTech, të cilat vijnë nga rritja e penetrimit të internetit dhe punonjësve të IT. Megjithatë, krahas situatës pandemike, pengesa të tjera do të vazhdojnë të mos favorizojnë zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori në rajonin tonë, si:

- Akses i kufizuar në kapital dhe financa;
- Përdorimi i lartë i parasë cash;
- Akses më i ulët në teknologjitë e pagesave nga ana e konsumatorit;
- Aspektet rregullatore të industrisë.

Megjithatë, pasiguria e zgjatur do të zvogëlojë numrin e startup-eve të Fintech dhe nga ana tjetër do t’u japë vrull kompanive të afta të përballen me sfidat. Lojtarët e rinj do ta kenë të vështirë të arrijnë: aksesin e kufizuar në kapital do t’i detyrojë ata të mbyllën, duke ua lënë industrinë kompanive më të vjetra/më me përvojë dhe më të forta, të cilat kanë kapitalizuar këtë situatë për të shtuar më shumë shërbime në portofolet e tyre, të zgjerohen në tregje gjeografike të reja dhe të investojnë në imazhet e tyre.

#### 4.1 Ndryshimet demografike dhe kulturore

Rajoni i Ballkanit Perëndimor ka parë kohët e fundit rritje në përdorimin e shërbimeve FinTech. Pronësia e kartave të debitit u rrit me 3% në të gjithë rajonin midis 2014-2017, ndërsa numri i njerëzve që kryenin pagesa online u rrit me 7%. Megjithatë, në vitin 2019, vetëm 8% e popullsisë kombëtare të Ballkanit Perëndimor përdorte shërbimet bankare online, krahasuar me 58% në BE (INSTAT 2017, cituar në Bankën Botërore, 2020). Për më tepër, pronësia e llogarisë aktualisht mbetet e ulët me një mesatare rajonale prej 61.3% krahasuar me mesataren e Eurozonës prej 95.3%. Kjo përkundër faktit se 80.3% e familjeve në Ballkanin Perëndimor (me përjashtim të Shqipërisë) kanë akses në internet dhe 98.8% depërtim të kartave SIM, nga të cilat 63% janë 3G ose 4G me brez të gjerë celular. Tabela 2 ofron disa tregues kyç për përdorimin dhe kërkesën ekzistuese dhe potenciale për shërbimet FinTech për Ballkanin Perëndimor. Mund të shohim se niveli i aksesit në internet është në rritje, siç është edhe përdorimi në bankingun online, veçanërisht në Maqedoninë e Veriut.

**Tabela 1:** Treguesit për kërkesën potenciale për shërbimet FinTech

2019/2018	Niveli i aksesit në internet në familje	Përdorimi i bankingut online (%)	Bëjnë blerje në internet	Nuk bëjnë blerje në internet; shqetësime lidhur me sigurinë e pagesës	Individë me aftësi digjitale në nivel bazik ose më tej	Specialistë të punësuar të TIK-ut (.000)
Shqipëria	:/2019	:/2	5	:	28/21	:
Bosnia dhe Herzegovina	72/69	5/5	23/18	5/:	24/:	:
Kosova	93/93	5/1	30/22	12/9	28/21	:
Maqedonia e Veriut	82/72	15/9	29/25	12/16	32/32	12/12
Serbia	80/73	18/15	34/35	6/9	46/39	68/64
Mali i Zi	74/72	3/2	16/12	15/21	:/50	5/5
Bullgaria	75/72	9/7	22/21	3/6	29/29	96/71
Kroacia	86/83	47/41	49/41	14/20	49/50	166/156
Rumania	84/81	8/7	23/20	3/8	31/29	190/185
EU 28	90/89	58/54	63/60	6/7	58/57	9000/8500

*Burimi: Eurostat 2018 – 2019, cituar në Grupin e Bankës Botërore, 2020*

Nga ana tjetër, në Shqipëri në vitin 2020, sipas Bankës së Shqipërisë, 60% e popullsisë konsiderohej pa akses në bankë. 38% e të rriturve kishin të

paktën një llogari bankare; 6% e të rriturve kishin të paktën një kartë krediti dhe 7% e tyre bëjnë pagesa online. Ndërsa, 96% e të gjitha transaksioneve ende bëhen me para cash.

Megjithatë, që nga situata e pandemisë, njerëzit po bëjnë më shumë blerje në internet dhe kanë më pak shqetësime për sigurinë e sistemeve të pagesave në internet. Për sa i përket përdorimit të TIK-ut në sipërmarrjet shqiptare, INSTAT jep të dhënat e mëposhtme për tre vitet e fundit.

#### ***Gjatë vitit 2020:***

- 27.6% e kanë rritur numrin e takimeve në distancë të kryera nëpërmjet platformave Skype, Zoom, MS Teams etj.
- 19.2% e ndërmarrjeve me akses në distancë në e-mailin e ndërmarrjes së sistemit kanë rritur numrin e punonjësve.
- 13.5% e ndërmarrjeve kanë rritur numrin e punonjësve në sistemet e TIK-ut të ndërmarrjes që kanë akses në distancë përveç e-mail-it.

#### ***Gjatë vitit 2021:***

- 13.3% e ndërmarrjeve kanë shitur produkte/shërbime përmes faqeve të internetit, aplikacioneve të përgatitura, faqeve të e-commerce dhe platformave të përdorura nga ndërmarrje të ndryshme për procesin e tregtimit e produkteve.
- Pjesën më të madhe të e-commerce e kanë ndërmarrjet që veprojnë në fushën e informacionit dhe komunikimit me 32.2%, të ndjekura nga aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor me 29.0% dhe shërbimet administrative dhe mbështetëse me 26.1%.
- Përdorimi i software-it për menaxhimin e marrëdhënieve me klientët (CRM) janë përdorur nga 24,8 % e ndërmarrjeve përgjatë vitit 2021 nga 22,5 % që rezultoi në vitin 2020.

#### ***Gjatë vitit 2022:***

- 13,8 % e bizneseve kanë shitur produkte/shërbime përmes faqes së internetit, aplikacioneve të dedikuara, faqeve të internetit e-commerce dhe aplikacioneve të përdorura nga ndërmarrje të ndryshme për tregtimin e produkteve.
- Peshën më të madhe të tregtisë elektronike e zënë ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në fushën e informacionit dhe komunikacionit me 31,6 %, të ndjekura nga akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit me 29,7 % dhe shërbimet në aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 25,6 %.
- 38,6 % e ndërmarrjeve kryejnë takime në distancë duke aplikuar platformat Skype, Zoom, MS Teams, WebEx etj., dhe 42,0 % e

ndërmarrjeve kishin akses në distancë në sistemet e postës elektronike (e-mail), dokumentet e ndërmarrjes apo aplikacionet e biznesit në softuerët e ndërmarrjes.

- 26,3 % e ndërmarrjeve kanë ne stafet e tyre specialistë të fushës TIK, të cilët kanë si detyrë primare të zhvillojnë, operojnë apo të mirëmbajnë sistemet dhe aplikacionet TIK të ndërmarrjeve.

E ardhmja duket premtuese në Shqipëri, për shkak të ndryshimeve demografike dhe kulturore. I ashtuquajti brezi i mijëvjeçarit mund të konsiderohet padyshim 'digjitalisht' vendas, pasi ky brez është rritur me teknologjitë digjitale si një normë, duke sjellë një psikologji dhe perspektivë të re në lidhje me shërbimet financiare. Produktet dhe shërbimet në të gjithë sektorët duhet të jenë së pari në celular, të shpërndahen duke përdorur kanale digjitale dhe të personalizohen për përdoruesin fundor. FinTech mishëron vërtet këtë ndryshim demografik dhe kulturor në fushën e shërbimeve financiare (Banka Botërore, 2020).

Bërja e shërbimeve financiare të disponueshme dhe të përbalueshme për publikun mund të çojë në rritjen e aktivitetit dhe rritjes ekonomike. Hulumtimet kanë treguar se platformat lehtësisht të aksesueshme për të gjithë, pavarësisht nga të ardhurat e tyre dhe të integruara fort në strukturën financiare të shoqërisë, i hapin rrugën rritjes gjithëpërfshirëse dhe të përshpejtuar. Kompanitë FinTech që duan të ofrojnë transferta elektronike parash dhe mënyra alternative të pagesave fizike në kohë reale, mund ta shtyjnë ekonominë përpara, gjë që ndikon në krijimin e mundësive të reja të punës dhe përfshirjen financiare. Pritet që kjo të ketë një efekt të drejtpërdrejtë në uljen e ekonomisë informale, rritjen e aktiviteteve të tregtisë elektronike dhe uljen e rasteve të mashtrimit.

## **5. Konkluzione**

FinTech po transformon botën e financave me ritme progresive duke përdorur gjithnjë e më tepër teknologji më të reja. Çdo ditë e më shumë po zhvillohen shërbime digjitale, të cilat gradualisht kanë ndryshuar sjelljen e klientëve dhe kanë zëvendësuar modelet tradicionale të biznesit. Këto shërbime janë aplikuar në industri të ndryshme, veçanërisht në sektorin financiar. Duke shfrytëzuar avancimin e teknologjisë, FinTech ka lehtësuar përdorimin e shërbimeve të ndryshme financiare, për një gamë të gjerë përdoruesish dhe me kosto më të ulët. Ky sektor teknologjik, pavarësisht se është zhvilluar së fundmi, ka krijuar terren të fortë për ndërtimin e produkteve dhe shërbimeve financiare dhe rimodelimin e tyre në të ardhmen. Ky zhvillim ka rezultuar dukshëm në sfida të rëndësishme për sistemin tradicional bankar dhe të pagesave; megjithatë, në të njëjtën kohë rrit ndjeshëm fleksibilitetin dhe përdorimin e shërbimeve financiare.

## BIBLIOGRAFIA

1. Anyfantaki, S. (2016) “The evolution of financial technology (FinTech)”, *Economic Bulletin*, vol. 44, pp. 47-62.
2. Arner, D. W., Barberis, J. N. & Buckley, R. P. (2015) “The evolution of Fintech: A new post-crisis paradigm?”, University of Hong Kong Faculty of Law Research Paper No. 2015/047; UNSË Laë Research Paper No. 2016-62.
3. Balkan Barometer. (2020), *Business Opinion*, Analytical Report, retrieved from <https://www.rcc.int/balkanbarometer/publications>
4. Bregu, L. (2020), Shqipëria - Drejt zgjerimit të përfshirjes financiare, Central Bank Payment News, Banka e Shqipërisë.
5. Carney, M. (2017). The promise of fintech—Something new under the sun?, Deutsche Bundesbank G20 conference, Wiesbaden. Retrieved from <https://www.bankofengland.co.uk/speech/2017/the-promise-of-fintech-something-new-under-the-sun>
6. Chemmanur, T., Imerman, M., Rajaiya, R., & Yu, Q. (2020). Recent development in Fintech Industry. *Journal of Financial Management, Market and Institutions* 08 (01) <https://doi.org/10.1142/S2282717X20400022>
7. CFTE (2021), *The Fintech Job Report: Technology is eating finance*, Version 1.1
8. Çeku, G., Këllezi, J., & Sulaj, P. (2020). *Zhvillimet e reja në fushën e pagesave-Një treg i hapur për konkurrencë dhe shërbim cilësor*, Bankieri, No. 37, p. 12-15, Shoqata Shqiptare e Bankave.
9. Demirgüç-Kunt, A., Klapper, L., Singer, D., Ansar, S., & Hess, J. (2018). The global finindex database 2017: Measuring financial inclusion and the fintech revolution. World Bank Group. Retrieved from <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/29510>
10. Feyen, E., Frost, J., Gambacorta, L., Natarajan, H., & Saal, M. (2021). Fintech and the digital transformation of financial services: implications for market structure and public policy, BIS Papers, No 117.
11. Gomber, P., Koch, JA. & Siering, M. (2017). Digital Finance and FinTech: current research and future research directions. *Journal of Business Economics* 87, 537-580 <https://doi.org/10.1007/s11573-017-0852-x>
12. INSTAT (2021), Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje, 2021.
13. Lee I, Shin YJ (2018) FinTech: ecosystem, business models, investment decisions, and challenges. *Bus Horizons* 61(1):35–46.
15. Leong, K. & Sungm, A. (2018). FinTech (Financial Technology): What is it and how to use technologies to create business value in fintech way? *International Journal of Innovation, Management and Technology* 9 (2), 74-78.
16. Li, B., Xu, Z. (2021). Insights into financial technology (FinTech): a bibliometric and visual study. *Financ Innov* 7, 69. <https://doi.org/10.1186/s40854-021-00285-7>
17. Nasir A, Shaukat K, Iqbal Khan K, A. Hameed I, Alam TM, Luo S. (2021). Trends and Directions of Financial Technology (Fintech) in Society and Environment: A Bibliometric Study. *Applied Sciences*. 11(21). <https://doi.org/10.3390/app112110353>
18. Nicoletti, B. (2017) “Financial Services and Fintech”, *The Future of FinTech*, pp. 3–29

## LEGJISLACIONI I TRASHËGIMISË KULTURORE NË VENDIN TONË NGA PUSHTIMI OSMAN DERI NË DITËT E SOTME

Sabrina Kuçi<sup>1</sup>, Samina KRAJA<sup>2</sup>

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Gjeografisë  
Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër*

### ABSTRAKT

Ky punim trajton legjislacionin shqiptar përgjatë viteve në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, duke e krahasuar atë përgjatë viteve, si dhe duke patur në fokus ndryshimet e shumta politike të ndodhura në Shqipëri që nga periudha osmane e deri në ditët e sotme.

Ky punim provon se sa shumë ka ndryshuar ligji duke iu përshtatur nevojave të kohës, si dhe sa kanë ndikuar legjislacionet e huaja në zgjerimin e koncepteve të trashëgimisë kulturore, përfshirjen e trashëgimisë jomateriale apo edhe raportet shtet-privat në të mirë të mirëmbajtjes, konservimit dhe rijetëzimit të trashëgimisë kulturore materiale. Në një panoramë të përgjithshme forma aktuale e ligjit ka kaluar në disa faza ndryshimesh politike të vendit tonë, duke filluar me periudhën e para

---

<sup>1</sup> M. Sc. Sabrina Kuçi ka përfunduar studimet e larta 5-vjeçare në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës në degën Urbanistikë, Tiranë. Pas përfundimit të studimeve të larta ka punuar për një periudhë 4-vjeçare, pranë Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, në pozicione të ndryshme duke filluar si specialiste deri tek Përgjegjëse për Sektorin e Legalizimit dhe Urbanizimit. Sot, prej 5 vitesh, punon si specialiste arkitekthe pranë Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Sektorin e Arkeologjisë, Artit, Arkitekturës dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore. Përgjatë viteve ka marrë pjesë në trajnime, projekte dhe konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Që nga viti 2022 është pjesë e stafit akademik të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, departamenti i Gjeografisë në lëndën e Planifikimit Urban.

<sup>2</sup> M. Sc. Samina Kraja ka përfunduar studimet e larta Bachelor në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin “Luigj Gurakuqi” dhe Master Shkencor në “E drejtë Private dhe Biznesi”, profili Biznes, në Universitetin European të Tiranës. Ka mbaruar shkollën e Avokatisë pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë, duke kaluar me sukses provimin kualifikues për titullin “Avokat”. Gjatë studimeve ka punuar për një periudhë të shkurtër kohore si specialiste pranë Sektorit të Regjistrimit Fillestar të Pasurive të Paluajtshme në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës). Sot, prej 4 vitesh punon si specialiste juriste pranë Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

çlirimit kur ligji për trashëgiminë kulturore kishte mangësi në shtjellim, por edhe në moszbatueshmëri, duke vazhduar me periudhën komuniste, ku shohim hapat e para të një baze ligjore më të plotë mbi trashëgiminë kulturore, duke ardhur në ditët tona ku duket qartazi përafrimi me *acquis communautaire* si dhe elaborimi i çështjeve të trashëgimisë kulturore, shtjellimi dhe zgjerimi i koncepteve të reja apo dhe këndvështrimeve të reja që lidhen direkt ose indirekt me pasuritë kulturore, monumentet e kulturës si dhe trashëgiminë jomateriale.

Metologjia e përdorur është ajo e rishqyrtimit të literaturës, ligjeve apo vendimeve të kohës, dhe një analizë krahasuese mes të dhënave apo procedurave të implemetuara më parë dhe asaj aktuale, duke qenë edhe pjesë e një drejtorie që në fushën e veprimit ka promovimin, studimin, restaurimin, konservimin apo përmirësimin e kushteve e trashëgimisë materiale dhe jomateriale.

### **Cultural heritage legislation in our country from the ottoman conquest to present days**

#### ***ABSTRACT***

This paper deals with the Albanian legislation over the years in the field of tangible and intangible cultural heritage, comparing it over the years, as well as focusing on the numerous political changes that have occurred in Albania since the Ottoman period until today.

This paper proves that how much the law has changed, adapting to the needs of the time, as well as how much foreign legislation has influenced the expansion of the concepts of cultural heritage, the inclusion of intangible heritage or even state-private relations in favor of the maintenance, conservation and revitalization of material cultural heritage. In a general overview, the current form of the law has gone through several stages of political changes in our country, starting with the pre-liberation period when the law on cultural heritage was lacking in detail but also in its inapplicability, continuing with the communist period where we see the first steps of a legal basis more complete on cultural heritage, coming to our days where the alignment with the *acquis communautaire* is clearly visible as well as the elaboration of cultural heritage issues, the elaboration and expansion of new concepts or new perspectives that are directly or indirectly related to cultural assets, cultural monuments and intangible heritage.



The methodology used is that of re-examining the literature, laws or decisions of the time, and a comparative analysis between the data or procedures implemented before and the current one, being also part of a directory that deals with promotion, study, restoration, conservation or improvement of the conditions of tangible and intangible legacies.

### **Hyrje**

Legjislacioni i trashëgimisë kulturore nuk është një çështje e trajtuar gjerësisht, ndaj dhe artikujt e botuar për të nuk janë të shumtë, ndonëse ligji në vetvete ka pësuar ndryshime të vazhdueshme duke u përmirësuar apo zgjeruar jo vetëm në koncepte, por edhe në çështje që lidhen apo prekin fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale. Qëllimi i këtij shkrimi shkencor është të paraqesë në mënyrë më specifike ndryshimet ligjore mbi këtë fushë duke bërë edhe një krahasim të asaj çfarë janë konsideruar pasuri kulturore apo evolimit të këtij koncepti përgjatë viteve. Çështjet që ky punim trajton janë: Vështrimi historik i legjislacionit, Legjislacioni i Trashëgimisë Kulturore nën ndryshimet politike në Shqipëri dhe përfundime. Metodologjia e përdorur është ajo e rishikimit të literaturës përsa i përket ligjeve, analizimi dhe krahasimi i tyre duke evidentuar përmirësimet ose jo.

### **Vështrim historik**

Në një panoramë të përgjithshme të vështrimit historik, ligji mbi trashëgiminë kulturore apo monumentet e kulturës, antikrat siç njiheshin dikur, kanë pësuar ndryshime të shumta përgjatë këtyre viteve që nga shpallja e Pavarësisë. Sipas konsultimeve me botime të ndryshme, akti i parë ligjor në Shqipërinë pas shpalljes së Pavarësisë është Qarkorja e Ministrisë së Arsimit nr.923, datë 19.06.1922<sup>3</sup>, duke na dhënë një pasqyrë të asaj çfarë janë antikrat, vlerat dhe rëndësia e tyre. Në ndihmë të tij, si dhe për një akt më të plotë juridik i referohemi ligjit nr.129, datë 28.05.1929 “Për Monumentat Kombëtare”, i cili ishte i përbërë nga 18 artikuj. Ky ligj jo vetëm na informon mbi atë çka termi “Monument Kulture” nënkupton, por edhe na tregon mbi procedura se si duhet të operohet në rastet, si: shitja, ruajtja, restaurimi dhe mbrojtja e tyre.<sup>4</sup>

Në periudhën e pas Çlirimit, e cila përkon edhe në një periudhë ku vendet e Ballkanit fillojnë të vlerësojnë trashëgiminë kulturore<sup>5</sup>, tentativa e parë për

<sup>3</sup> [https://www.bksh.al/burime/fletore\\_zyrtare1](https://www.bksh.al/burime/fletore_zyrtare1). Viti 1992.

<sup>4</sup> Arkivi Qendror i Shtetit.

<sup>5</sup> Orhani E (2015), Historia e restaurimit të monumenteve të kulturës në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore, fq 81-86, Doktoratura, Universiteti i Tiranës;

përmirësimin apo riformulimin e ligjit mbi trashëgiminë kulturore është Dekreti nr.586, datë 17.03.1948 “Mi mbrojtjen e Monumentave të Kulturës dhe të sendeve natyrale të rralla”. Më pas ky dekret ndiqet nga ai i datës 23.09.1971, me nr.4874 “Mbi mbrojtjen e monumenteve kulturore dhe sendeve ose pasurive natyrale të rralla” duke përmirësuar kështu ligjin mbi trashëgiminë kulturore. I përbërë nga 12 nene, jep një informacion mbi tjetërsimin, zhvendosjen, gërmimin, restaurimin, si dhe ndërhyrjeve apo punimeve në objekte monument kulture. Një hap i rëndësishëm për të na treguar rëndësinë e evidentimit, shpalljes, mbrojtjes dhe ruajtjes të monumenteve, por edhe evolimit të ligjeve si dhe nevojën për të përmirësuar këndvështrimin mbi këto pasuri kulturore materiale dhe jomateriale, ishte krijimi i Institutit të Monumenteve të Kulturës në vitin 1965. Ky institucion, kaq i rëndësishëm për trajtimin e monumenteve të kulturës, kishte edhe degët e tij në rrethe të quajtura Atelie Restaurimi, të cilat ishin nën varësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës së kohës.

Me ndryshimet e viteve ‘90, erdhi ndryshimi i parë në ligjin e trashëgimisë kulturore përmes ligjit nr.7867, datë 12.10.1994 “Për mbrojtjen e Pasurive Kulturore të Luajtshme dhe të Paluajtshme”. I ndarë në tre krerë, me një total prej 33 neneve, ky ligj përcakton jo vetëm dispozitat e përgjithshme për trajtimin dhe ruajtjen e pasurive kulturore në përgjithësi, por trajton në mënyrë të veçantë pasuritë kulturore të paluajtshme. Ky ligj u zbatua për thujtse nëntë vite pa ndryshime gjatë viteve, deri në vitin 2003. Me dekretin nr.3804, datë 05.05.2003 miratohet ligji nr.9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”. Ligj i cili miratohet si një detyrim kushtetues në fushën e trashëgimisë kulturore, por edhe si nevojë gjithëpërfshirëse të trajtimit të kategorive të pasurive kulturore të luajtshme apo të paluajtshme. Deri në vitin 2013 ky ligj ka pësuar disa herë ndryshime duke u përshtatur nevojave të trashëgimisë kulturore.

Në vitin 2018, miratohet ligji nr.27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë kulturore dhe Muzetë”, i cili konsiderohet rregullimi ligjor më i plotë i bërë ndër vite në fushën e trashëgimisë kulturore, me synimin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Europian në fushën e kulturës, ndonëse ende jo i plotë me aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

## Legjislacioni i trashëgimisë kulturore në ndryshimet politike në Shqipëri

Referuar ndryshimeve politike në vendin tonë shohim 3 periudha të rëndësishme që kanë ndikuar edhe në ndryshimet e legjilacionit në fushën e trashëgimisë kulturore:

### ▪ *Periudha para Çlirimit (deri në 1945)*

Para shpalljes së Pavarësisë dhe krijimit të shtetit, rezulton se akti i parë normativ i mbrojtjes të pasurive kulturore në Shqipëri është Rregullorja e brendshme e datës 1/V/1305 (1889), i përbërë nga 43 nene, “Për rregullimin e muzeumit mbretëror”. Ky akt normativ ishte shpallur nga Perandoria Osmane, ku pati fuqi edhe në vendin tonë. Rregullorja parashikonte zbulimin dhe mbrojtjen e monumenteve dhe ndërtesave të vjetra që do të zbuloheshin nga gërmimet, ku do të vendoseshin në muzeum, të rregulloheshin për ekspozim apo të publikoheshin përmes botimeve.<sup>6</sup>

Më 8.7.1328 (1912) hyri në fuqi ligji “Mbi mbrojtjen e monumenteve (abidat), i përbërë nga 6 artikuj. Nga ky ligj u përcaktuan “antikitetet”, term i cili përfshinte fortesat, muret, burgjet, e çdo ndërtesë. Termi “antikitetet”, “antikate” apo “vjetërsinat” do të përdorreshin gjatë gjithë periudhës para çlirimit.

Të dy aktet e mësipërme mbetën vetëm akte formale, duke mos u zbatuar në asnjë moment në territorin shqiptar dhe duke mbetur formale.<sup>7</sup>

Pas shpalljes së Pavarësisë, akti i parë zyrtar i shpallur nga shteti shqiptar, i cili ishte në fillimet e tij, do të ishte Qarkorja e Ministrisë së Arsimit, e datës 19.06.1922 “Për monumentat Kombëtare”. Kjo Qarkore i drejtohej kryeinspektorëve, inspektorëve, mësuesve të katundit apo qytetit, duke i adresuar që pas gjetjes së antikave t’i drejtohen kryetarit të bashkisë për dorëzim. Në këtë Qarkore parashikohet një kategori e kufizuar e asaj që do të përbënte antikate. Gjithashtu parashikohej që pranë çdo bashkie do të kishte një vend të posaçëm për depozitimin dhe ruajtjen e antikave.

Një akt më i plotë juridik do të ishte ai i datës 28.05.1929 “Për Monumentat Kombëtare”. Ky dekret-ligj përbëhej nga 18 artikuj. Krahasimisht me Qarkoren e Ministrisë së Arsimit të lartpërmendur, ky dekret-ligj, në

<sup>6</sup> Papa M (1972) Mbrojtja ligjore e pasurive kulturore në vendin tonë, Monumentet, fq. 139-141.

<sup>7</sup> Hajzeri P (2019), Historiku i mbrojtjes institucionale të monumenteve të trashëgimisë kulturore-hiatorike, me theks të veçantë në trevat shqiptare, Qendra Kombëtare “Rrënjët tona”.

artikullin 2 zgjeron parashikimin e objekteve të cilat për vlera “vjetërije ose mjeshtriye”, do të konsiderohen “Monumenta Kombëtare”. Institucioni i cili ngarkohej me detyrën e ruajtjes dhe mbrojtjes të Monumentave Kombëtare ishte Ministria e Arsimit, me anë të Komisionit të përgjithshëm të Monumentave Kombëtare, me qendër në Tiranë, si dhe në qarqe do të funksionte Komisioni i Monumentave Kombëtare i rrethit përkatës. Ministria e Arsimit kishte kompetencë në hartimin e një ligji të plotë, i cili do të ishte në funksion të mbrojtjes së monumenteve dhe çdo veprim mbi monumentet të tilla, si: shitja, shitja për të dalë jashtë vendi, mirëmbajtja, etj., procese që do të bëheshin me leje nga ky institucion. Rezulton se ky ligj nuk është hartuar asnjëherë nga Ministria e Arsimit, pasi nuk ka asnjë burim që e ka cituar atë. Pavarësisht faktit që dekret-ligji i vitit 1929 konsiderohej më i plotë, ai nuk parashikonte mënyrën e mirëmbajtjes së monumenteve, sigurimin e fondit për shpenzimet e nevojshme, por kufizohej vetëm në parashikimin e një shpërblimi për ata persona të cilët gjejnë apo zbulojnë antikat. Ajo që evidentohet në këtë dekret-ligj është parashikimi që bën artikulli 17, nga ku rezulton se Shqipëria kishte lidhur marrëveshje me shtetet e huaja, konkretisht për gërmime arkeologjike, të cilat mbeten në fuqi.

#### ▪ *Periudha pas Çlirimit (1945-1990)*

Pas shpalljes së Shqipërisë Republikë Popullore, fillon edhe veprimtaria e vlerësimit të trashëgimisë kulturore, nga ku hyri në fuqi Dekret ligji nr.44, datë 2.III.1948, “Mbi mbrojtjen e monumentave të kulturës dhe të sendeve natyrale të rralla”, i përbërë nga 15 nene. Në këtë dekret bëhet ndarja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme kulturore, ku përcaktohet dhe sanksionohet mbrojtja e tyre nga Shteti, pa marrë parasysh pronësinë apo posedimin e tyre. Për studimin shkencor dhe mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe sendet e rralla ngarkohet Instituti i Studimeve.

Për herë të parë parashikohen shpenzimet për mirëmbajtjen e monumenteve, si një hap i rëndësishëm në përkujdesjen ndaj monumenteve. Ky ligj parashikon edhe shkeljet në fushën e monumenteve të kulturës duke parashikuar gjoba. Pas këtij dekret - ligji, miratohet edhe Rregullorja nr.150, datë 9.4.1955, duke kontribuar në fushën e pasurive kulturore duke e organizuar më mirë mbrojtjen e monumenteve të kulturës me anë të mirëmbajtjes së tyre apo restaurimin.

Një hap i rëndësishëm në përmirësimin e trajtimit të pasurive kulturore ishte edhe krijimi i Institutit të Monumenteve të Kulturës, në vitin 1965.

Dalja e problemeve të reja apo thellimi i njohurive në fushën e trashëgimisë kulturore, bënë që të rishikohej legjislacioni i dalë. Dekret-ligji i mësipërm pasohet me atë me nr.4874, datë 23.9.1971 “Mbi mbrojtjen e monumenteve kulturale dhe të pasurive natyrale të rralla”, i përbërë nga 12 nene.

Ky dekret-ligj, i cili është mbështetur në ligjin Italian dhe në Kartën Ndërkombëtare për konservimin dhe restaurimin e monumenteve dhe asambleve monumentale të vitit 1964, shoqërohet edhe me disa rregullore, të cilat në tërësi shquhen për koncepte të qarta të vlerësimit, organizimit të institucioneve të ngarkuara për mbrojtjen e monumenteve.<sup>8</sup>

Dekret-ligji i vitit 1971 organizon më hollësisht veprimtarinë në fushën e monumenteve të kulturës duke ngarkuar disa institucione të tilla, si: komitetet ekzekutive të këshillave popullorë për ruajtjen e monumenteve kulturale, historike, sendet ose pasuritë natyrale të rralla<sup>9</sup>, Këshilli i Ministrave për shpalljen e monumenteve kulturale e historike dhe sendet ose pasuritë natyrale të rralla me karakter kompleks ose me rëndësi të veçantë kombëtare<sup>10</sup>, Ministria e Arsimit dhe Kulturës për nxjerrjen e rregullave për përcaktimin, studimin, mbrojtjen dhe restaurimin e monumenteve kulturale,<sup>11</sup> apo pronari për shpenzimet e tjera për mirëmbajtjen e objektit (ndërtesë)<sup>12</sup>, nga ku parashikohet edhe marrja e kredisë si dhe institucioneve të tjera, në varësi të veprimtarisë për monumentet e kulturës.

Në mbështetje të dekret-ligjit të vitit 1971, u hartua edhe Rregullorja për mbrojtjen e monumenteve kulturale e datës 01.06.1972, nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës. Kjo rregullore bëri një ndarje dhe përcaktim të monumenteve, parashikon rregulla të gërmimeve arkeologjike, punimeve konservuese, institucionet e ngarkuara me mbrojtjen dhe administrimin e monumenteve kulturale, duke dhënë zgjidhje për çështje të reja të dala në atë kohë<sup>13</sup>.

#### ***-Periudha pas viteve ‘90***

Pas viteve 90’, me rënien e regjimit komunist dhe me ndryshimet sociale të kohës, trashëgimia kulturore u vlerësua më shumë, nën shembujt

<sup>8</sup> Dollani A, Gjata K, Demaj Plyku M, (2017) “Analizë Strukturore, Metoda Përforcuese dhe teknika të muraturave në ndërtesat historike”, fq 38-40.

<sup>9</sup> Neni 3 i ligjit nr.4874, date 23.09.1971 “Mbi Mbrojtjen e Monumenteve Kulturale e Historike dhe të Pasurive Natyrale të Rralla”.

<sup>10</sup> Ibid, neni 4.

<sup>11</sup> Ibid, neni 10.

<sup>12</sup> Ibid, neni 8.

<sup>13</sup> Revista “Mbrojtja e monumenteve” (1972), fq 41.

perëndimorë, ndaj në këto kushte u mendua edhe përmirësimi i legjislacionit të trashëgimisë kulturore.

Me detyrimin kushtetues për herë të parë në këtë fushë, me të paturit tashmë një strategji kulturore afatgjatë, u miratua ligji nr.7867, datë 12.10.1994 “Për mbrojtjen e pasurisë kulturore, të luajtshme dhe të paluajtshme”, i përbërë nga 33 nene. Me anë të këtij ligji zëvendësohet termi “monument kulture” në “pasuri kulturore”<sup>14</sup>, duke zgjeruar fushën e trashëgimisë kulturore.

Në kuadër të ndryshimeve ligjore, vihet re se për herë të parë parashikohet financimi i restaurimeve të monumenteve jo vetëm nga buxheti i shtetit, por edhe nga fondacionet, organizata e institucione të huaja shtetërore apo private, persona privatë si dhe nga të ardhurat e përdorimit të monumenteve<sup>15</sup>, por që mbeti i patrajtuar në shkallën e duhur, pasi nuk doli në zbatim të saj asnjë akt nënligjor.

Në mbrojtjen e tyre ligjore, ligji parashikon edhe kategorizimin si vepër penale të shkeljeve në pasuritë kulturore, duke treguar ashpërsimin e dënimit në fushën e trashëgimisë kulturore.<sup>16</sup>

Risia që ligji solli, ishte heqja e së drejtës ekskluzive të institucioneve të huaja në kryerjen e gërmimeve si dhe të restaurimeve, duke parashikuar kryerjen edhe nga persona të kualifikuar, institucione të huaja të specializuara, me autorizimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve<sup>17</sup>.

Megjithatë, pavarësisht përpjekjes të bërjes së një ligji gjithëpërfshirës dhe integral për trashëgiminë kulturore, ai la jashtë trajtimit kategoritë e pasurive kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të trashëgimisë kulturore jomateriale, ligji i '94 u zbatua pjesërisht. Ndryshimet e pas vitit '90, ngjarjet e vitit '97, nga ku një pjesë e madhe e pasurive kulturore u shkatërruan, u shemben totalisht, u rrëmbyen dhe u shitën, brenda dhe jashtë vendit, problemet e ndryshme të pronësisë, qenë tregues se ky ligj nuk veproi siç duhej, pasi u evidentua edhe fakti që nuk kishte parashikime

---

<sup>14</sup> Neni 1 i ligjit “Pasuritë kulturore të luajtshme e të paluajtshme që ekzistojnë dhe zbulohen në tokat private e shtetërore, në lumenj, liqene e në shelfin kontinental mbrohen nga shteti”.

Trajtimi dhe ruajtja e pasurive kulturore bëhet nga shteti, dhe kur është e nevojshme në bashkëpunim me persona juridike a fizikë.

<sup>15</sup> Ibid, neni 21.

<sup>16</sup> Ibid, neni 30.

<sup>17</sup> Ibid, neni 20.

ligjore për shumë veprime që u kryen mbi këto pasuri<sup>18</sup>. Ndonëse i paplotë apo me mangësi, ky ligj u zbatua për afro nëntë vite.

Për shkak të daljes në pah të problematikave që dolën nga ligji i vitit '94, orientimit gjithnjë e më shumë të shtetit shqiptar drejt politikave që vendet perëndimore kishin dhe mënyrës së trajtimit të këtyre vlerave, u miratua ligji nr.9048, datë 07.04.2003, i cili u pasua me ndryshime.

Ligji i vitit 2003, parashikon një bashkëpunim privat-shtet në mirëmbajtjen e pasurive kulturore, duke aplikuar edhe kredi të butë për private, një tentativë e mëparshme, por më i elaboruar, si një formë lehtësimi dhe angazhimi në financim, por edhe pse në kushte të tjera nga viti 1971, mbeti i pazbatuar në praktikë.

- Për monumentet e kategorisë I dhe II, në pronësi private, restaurimi përballohet nga shteti, për aq sa ruhen vlerat historiko-artisitike.<sup>19</sup>
- Për restaurimet e tjera për monumentet e kategorisë I, shpenzimet përballohen në masën 60% nga shteti dhe 40% nga pronari i objektit.
- Për monumentet e kategorisë II, shpenzimet përballohen 30% nga shteti dhe 70% nga pronari i objektit.

Tashmë me miratimin e këtij ligji u përkufizuan dhe u klasifikuan pasuritë kulturore materiale dhe jomateriale duke zgjeruar rrethin e procedurave ligjore duke mbrojtur më mirë ligjërisht dhe teknikisht pasuritë kulturore.

Me miratimin e Kodit Civil në 1994, filloi një “epokë” e re në krijimin e precedentit në procedurat e pronësisë në rastet e transaksioneve të shitjes, shpronësimit etj.

Vëmendja ndaj fushës së trashëgimisë kulturore, gjithashtu shihet në këtë ligj me anë të krijimit të institucioneve të cilat ngarkohen me identifikimin, dokumentimin, studimin dhe mbrojtjen e këtyre pasurive, siç është Departamenti i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Komisioni Kombëtar i Restaurimit etj., duke ndarë detyrat dhe përgjegjësitë, në funksion të organizimit tashmë në mënyrë të përveçëm.

Ligji përcakton rregullat e procedurës së miratimit dhe të zbatimit të projekteve të restaurimit, nga ku projektet hartohen nga subjekte të licencuar në fushën e trashëgimisë kulturore, miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe zbatohen nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.

<sup>18</sup> Relacion i Këshillit të Ministrave, Arkiva e Kuvendit të Shqipërisë.

<sup>19</sup> Neni 36 i ligjit nr.9048, datë 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”.

Për here të parë ligji përcakton konceptin e “zonave-muze” si njësi territoriale brenda qytetit, me vlera muzeale, e cila përbëhet nga një grup objektesh me vlera të rëndësishme kulturore<sup>20</sup>. Përcaktohet koncepti i “qendrave historike” si ansambli qytetar ose fshatar me vlera historiko-kulturore që mbrohet nga shteti<sup>21</sup>. Përcaktohet koncepti i “parqeve arkeologjike” si hapësira me vlera mjedisore, në të cilën ruhen rrënoja ndërtimore, të zbuluara prej gërmimeve arkeologjike që mbrohen nga shteti. Në këtë mënyrë fillojnë e miratohen VKM të veçanta për secilën zonë-muze të shpallur, qendër historike dhe park arkeologjik, duke filluar nga viti 2005 të tilla, si: Vendim nr. 619, datë 07.07.2015 “Per miratimin e Rregullores së Administrimit të Qytetit - Muze të Gjirokastrës”, Vendim nr.554, datë 18.06.2015” Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Pogradecit dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj apo Vendim nr. 1197, datë 3.12.2009 “Për shpalljen e Kalasë së Tiranës “Zonë Arkeologjike A” dhe miratimin e rregullores së administrimit të saj” etj. Ligji i vitit 2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” shfuqizoi tërësisht dispozitat e ligjit të mëparshëm të vitit 2003, duke patur në fokus përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën e trashëgimisë kulturore.

Ky ligj parashikon dhe sqaron koncepte të reja, të papërdorura më parë në legjislacionet e mëparshme, duke zgjeruar fjalorin e trashëgimisë kulturore. Një risi e këtij ligji është parashikimi ligjor i trashëgimisë kulturore me interes fetar, me anë të nenit 15, nga ku bashkësitë fetare kanë tashmë tagrin e propozimit për regjistrimin e vlerave kulturore.

Parashikimi i zgjeruar i përdorimit të pasurive kulturore, me anë të bashkëpunimit privat-shtet siguron një mbrotjtje më të plotë dhe një përdorim të frytshëm të këtyre pasurive, duke u hapur për publikun si dhe duke gjeneruar të ardhura.

Në vitin 2021 hapet për herë të parë nënprogrami “Bonusi i Rijetëzimit” nga Ministria e Kulturës pjesë e Fondit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale<sup>22</sup>, nga ku parashikohen dy skema, mirëmbajtje / konservim dhe restaurim / rijetëzim<sup>23</sup>, duke iu dhënë mundësi pronarëve

---

<sup>20</sup> Neni 3, pika 35 e ligjit nr.27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.

<sup>21</sup> Ibid, neni 3, pika 23.

<sup>22</sup> Vendim nr.737, datë 17.9.2020 “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale”.

<sup>23</sup> Rregullore nr.1087/3, datë 15.03.2022 “Për përcaktimin e procedurave të aplikimit, kriteret e vlerësimit për administrimin e “Bonusit të Rijetëzimit”, pjesë e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë kulturore materiale”.



/poseduesve, që përmes bashkëpunimit me shtetin, të përdoret në mënyrë sa më eficiente pasuria kulturore e paluajtshme.

Përpos llojeve të pasurive kulturore, ky ligj trajton edhe llojet e pasurive kulturore jomateriale të tilla, si: lojërat popullore të ruajtura në kujtesë, folklori gojor, folklori muzikor vokal, dijeberja lidhur me artizanatin, gatimet tradicionale etj., të cilat njiheshin si pjesë e traditës, kulturës apo trashëgimisë tonë, por për të cilat nuk kishte një mbrojtje apo rregullim ligjor.

Reformohet struktura institucionale duke shtuar funksionet dhe kompetencat e organeve ekzistuese, si dhe duke parashikuar institucione të reja, siç është ngritja e Inspektoriatit Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore,<sup>24</sup> i cili nuk është funksional ende.

Me anë të parashikimeve ligjore, tentohet të krijohet një raport i drejtë ndërmjet të drejtës së pronës nga pronari / poseduesi dhe interesit publik të pasurisë kulturore, duke krijuar një bashkëpunim ndërmjet pronarit /poseduesit të pasurisë kulturore dhe institucioneve të specializuara, duke ndërmarrë hapa për të siguruar pasurinë kulturore në rast të rrezikut të dëmtimit.<sup>25</sup>

Një nga 3 tagrat që pronari i një pasurie ka është ai i disponimit të pronës<sup>26</sup>, me anë të së cilës pronari ka të drejtën e përcaktimit të fatit të pronës së tij, e cila përfshin dhe shkatërrimin e saj. Tek pronari i pasurisë kulturore kjo e drejtë nuk ekziston, çka nënkupton se e drejta e pronarit kufizohet. Një kufizim i tillë lind për shkak se pronari ka detyrimin për t'u kujdesur për të ruajtur dhe mbajtur në gjendje të mirë pasurinë kulturore<sup>27</sup>, të vlerave kulturore që objekti mbart, si nevojë e mbrojtjes së interesit publik. Shkatërrimi i pasurive kulturore përbën vepër penale sipas parashikimeve të Kodit Penal<sup>28</sup>.

Me ratifikimin e Konventës së Peizazhit, miratuar me ligjin nr.87/2016 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Peizazhit", lindën detyrime të tilla, si: mbrojtja, menaxhimi dhe planifikimi i peizazhit kulturor apo bashkëpunimi në nivel rajonal dhe më gjerë, duke ndihmuar kështu në një rritje cilësore të peizazhit. Ky ligj përcakton procedura dhe autoritete përgjegjëse për vlerësimin, ruajtjen e vlerave kombëtare të peizazhit kulturor.<sup>29</sup>

<sup>24</sup> Neni 27 i ligjit nr.27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë".

<sup>25</sup> Ibid, neni 23, pika 1.

<sup>26</sup> Neni 149 i Kodit Civil.

<sup>27</sup> Neni 21, pika 1 a, e ligjit nr.27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë".

<sup>28</sup> Neni 160 i Kodit Penal.

<sup>29</sup> Pjesa e katërt e ligjit nr.27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë".

Konventa e Parisit e vitit 2001 si dhe konventa për “Mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore” tashmë përfshihen në mbrojtjen e trashëgimisë nënujore, me anë të parashikimit ligjor të neneve 151-162. Veprimtaria arkeologjike nënujore rregullohet përmes licencave, si dhe ligji parashikon shpërblim për personat të cilët zbulojnë dhe deklarojnë gjetjet rastësore detare në ujërat e brendshme territoriale.<sup>30</sup>

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i këtij ligji në fushën e trashëgimisë kulturore është përafrimi i legjislationit shqiptar me atë të BE-së, specifikisht me Direktivën 2014/60/EU “Mbi kthimin e objekteve kulturore të hequr në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar”. Lëvizja e objekteve kulturore përpara këtij ligji nuk kishte rregullim ligjor në përafrim me rregulloret dhe direktivat e Bashkimit Evropian, duke krijuar probleme të shumta me qarkullimin fizik ndërkombëtar të këtyre pasurive, duke i lëvizur ilegalisht si dhe nga persona të paautorizuar. Lëvizja e objekteve kulturore parashikohet në titullin III të ligjit “Qarkullimi civil dhe fizik i pasurive kulturore”, duke përcaktuar daljen e përkohshme<sup>31</sup>, daljen pa kthim,<sup>32</sup> tregtia e pasurive kulturore së bashku me licencat, duke rregulluar në mënyrë eksplicite qarkullimin kombëtar dhe ndërkombëtar të objekteve pasuri kulturore.

## Përfundime

Trashëgimia kulturore në vendin tonë ka përjetuar ndryshime të rëndësishme legislative. Këto ndryshime dallohen qartazi që nga konceptet bazë të trashëgimisë kulturore, të cilat në këtë fushë kanë ardhur duke u zgjeruar që nga viti 2003, dhe duke përfshirë një gamë të gjerë përkufizimesh në ligjin e vitit 2018. Në kuadër të përmirësimit mund të përmendim gjithashtu futjen e koncepteve të reja në ligjin e 2018-ës, siç ishte koncepti i trashëgimisë jomateriale, e konstatuar si mungesë që nga ligji i vitit 1994.

Raporti shtet - privat, ndarja e të drejtave dhe detyrimeve, sanksionet në të mirë të ruajtjes së interesit kulturor publik, ka qenë një nga ndryshimet thelbësore të ligjit, duke u përmirësuar në formën e tij më të plotë me ligjin nr.27/2018. Në zbatim të kësaj, por jo vetëm, edhe në të mirë interesit publik për trashëgiminë kulturore

Në kuadrin e ndarjes së detyrave apo përgjegjësive që lindin nga disa procese siç janë restaurimi, konservimi, studimi, promovimi apo mbrojtja

<sup>30</sup> Ibid, neni 162.

<sup>31</sup> Ibid, neni 124.

<sup>32</sup> Ibid, neni 123.

e pasurive kulturore, ligji aktual është elaborimi më i plotë që i është bërë trashëgimisë kulturore në këtë çështje. Kjo vjen si rrjedhojë e krijimit të komisioneve të reja, grupeve të punës, drejtorive apo institucioneve që vijnë në ndihmë dhe trajtojnë në mënyrë të veçantë secilën çështje. Ajo ç'ka shihet problematike në këtë çështje është fakti se ky ligj ende mbetet i paplotë në miratimin e një bazë ligjore për organizimin apo mënyrën e funksionimit të Inspektoriatit Kombëtar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

Një problematike ndër vite ka qenë largimi i shumë veprave, artefakteve apo gjetjeve arkeologjike nga vendi ynë, përmes lejimit të gërmimeve arkeologjike misioneve të huaja, të ndodhura në Shqipëri duke filluar nga periudha e para Çlirimit. Përmirësimi dhe evolimi i ligjit ka arritur formën e tij më të plotë me ligjin nr.27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, pasi është hartuar në përafrim më *acquis communautaire* të BE-së, me direktivën “Mbi kthimin e pasurive kulturore të hequra në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar” si dhe Rregulloren “Për eksportin e mallrave kulturore”.

Vlerësimi i trashëgimisë kulturore përbën një risi për trashëgiminë kulturore, i cili konsiston në ushtrimin e funksioneve apo aktiviteteve ku qëllimi është njohja, promovimi apo shfrytëzimi i pasurive kulturore duke ndikuar në një zhvillim të qëndrueshëm. Ky vlerësim realizohet me bashkëpunim shtet-privat. Një nga programet që sqaron më së miri këtë qasje është nënprogrami i “Bonusit të Rijetëzimit”, që është një financim i Ministrisë së Kulturës, pjesë e Fondit të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore, për të gjithë pronarët e banesave private pjesë të Qendrave Historike, Zonave Arkeologjike apo Pasurive Kulturore me qëllim mirëmbajtjen/ konservimin/ rijetëzimin e ndërtesave, por duke i dhënë atyre një funksion të ri ose në të shumtën e rasteve duke e kthyer në ambiente shërbimi, i cili ndikon pozitivisht në rritjen e ekonomive familjare, nxit punësimin dhe përmirëson kushtet ekonomike të qytetit.

## BIBLIOGRAFIA

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.7867, datë 12.10.1994 “Për mbrojtjen e pasurisë kulturore, të luajtshme dhe të paluajtshme”.
- Ligji nr.9048, datë 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”.
- Ligji nr.27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.
- Vendim nr.737, datë 17.9.2020 “Për përcaktimin e rregullave për administrimin e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale”.

- Vendim nr. 619, datë 07.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Administrimit të Qytetit -Muze të Gjirokastrës”.
- Vendim nr.554, datë 18.06.2015 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Pogradecit dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj apo Vendim nr. 1197, datë 3.12.2009 “Për shpalljen e Kalasë së Tiranës “Zonë Arkeologjike A dhe miratimin e rregullores së administrimit të saj”.
- Rregullore nr.1087/3, datë 15.03.2022 “Për përcaktimin e procedurave të aplikimit, kriteret e vlerësimit për administrimin e “Bonusit të Rijetëzimit”, pjesë e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë kulturore materiale”.
- Papa, Miltiadh (1972): Mbrojtja ligjore e pasurive kulturore në vendin tonë, Monumentet, nr 3, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Tiranë.
- Hajzeri, Pajazit (2019): Historiku i mbrojtjes institucionale të monumenteve të trashëgimisë kulturore-historike, me theks të veçantë në trevat shqiptare, Libër i Kuvendit “Vazhdimësia historiko-gjuhësore dhe etnokulturore e shqiptarëve”, Qendra Kombëtare “Rrënjët tona”, Tiranë.
- Arkivi Qendror i Shtetit.
- Dollani Arta, Gjata Klodjana, Demaj Plyku Marsela (2017): “Analizë strukturore, Metoda Përforcuese dhe teknika të muraturave në ndërtesat historike, Strengthening Capacities in the Cultural Heritage Field through Training Course, Tirana, Voskopoja.
- Orhani Edlir, (2015) Historia e restaurimit të monumenteve të kulturës në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore, Doktoratura, Universiteti i Tiranës.  
<https://unitir.edu.al/doktoratura-edlir-orhani-fakulteti-i-histori-filologjise-departamenti-i-arkieologjise-dhe-trashegimise-kulturore-2/>
- [https://www.bksh.al/burime/fletore\\_zyrtare1](https://www.bksh.al/burime/fletore_zyrtare1).
- Revista “Mbrojtja e Monumenteve”, 1972, “Shtëpia botuese e Librit Politik”, Tiranë;
- Relacion i projektligjit “Për Trashëgiminë Kulturore”, Këshilli i Ministrave, arkiva e Kuvendit të Shqipërisë”.

**ISSN 2411 - 4960**

*Doli nga shtypi prill, 2023– tirazhi 120 kopje – Formati 176 x 250mm.  
Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*